

ELJONA PLAKU

LIBËR MËSUESI

HISTORIA ME ZGJEDHJE

12

Shtëpia Botuese & Shtypshkronja FILARA
Tiranë, 2018



BOTIME SHKOLLORE, 2018



Titulli i librit:

**LIBËR MËSUESI
HISTORIA ME ZGJEDHJE 12**

Autore:

Msc. Eljona Plaku

Korrektor:

Ekleva Progonati

Arti grafik:

Studio grafike FILARA

Punoi: Gazmir Myteberi

Botimi i parë FILARA

Tiranë, 2018

ISBN:

© Shtëpia Botuese, FILARA

Shtypur në shtypshkronjën FILARA

Adresa:

**Rruga "Sabaudin Gabrani"
Ish - kombinati "Misto Mame" Tiranë**

Tel: 04 225 88 01

Cel: 069 33 30 983

Cel: 069 66 99 693

E-mail: filarabotime@yahoo.com

website: www.filarabotime.com

**Librin e mësuesit, planin mësimor mund ta
shkarkoni në formatin Word, PDF
falas nga faqja jonë e internetit
www.filarabotime.com**

LIBËR MËSUESI HISTORIA ME ZGJEDHJE 12

PËRMBAJTJA

I. Plani mësimor vjetor

1. Plani mësimor sintetik	4
2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe	5
3. Përmbajtja e kurrikulës	7
4. Rezultatet e të nxënit për konceptet dhe kompetencat historike	8
5. Udhëzime për vlerësimin	9
6. Ndarja e tematikave sipas periudhave	11

II. Planifikimi mësimor për periudhën e parë (*shtator-dhjetor*)

18

III. Planifikimi ditor për periudhën e parë (*shtator-dhjetor*)

48

IV. Përsëritje, periudha e parë (*shtator-dhjetor*)

137

V. Model testi, periudha e parë (*shtator-dhjetor*)

139

VI. Planifikimi ditor për periudhën e dytë (*janar-mars*)

144

VII. Përsëritje, periudha e dytë (*janar-mars*)

116

VIII. Model testi, periudha e dytë (*janar-mars*)

118

IX. Planifikimi ditor për periudhën e tretë (*prill-qershor*)

228

X. Përsëritje, periudha e tretë (*prill-qershor*)

252

I. PLANI MËSIMOR VJETOR

Lënda: Historia me zgjedhje

Klasa: XII

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla: VI

1. PLANI MËSIMOR SINTETIK

36 javë x 4 orë në javë = 136 orë gjithsej

Ndarja vjetore e orëve	Numri i orëve
Njohuri të reja	91 orë
Përsëritje	11 orë
Teste	2 orë
Ese historike	2 orë
Vizita studimore	24 orë
Vlerësim i portofolit	3 orë
Veprimtari praktike	3 orë

2. REZULTATET KRYESORE TË TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE QË REALIZOHEN NËPËRMJET LËNDËS SË HISTORISË

a. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (komunikon dhe shprehet në mënyrë efektive).

Nxënësi:

- **zhvillon** aftësitë e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;

- **përdor** funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

b. Kompetenca e të menduarit (mendon në mënyrë krijuese).

Nxënësi:

- **zhvillon** aftësitë e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- **zhvillon** mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;

- **zhvillon** mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;

- **analizon** të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, p.sh. shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;

- **ndërton** dhe interpreton grafikë, diagrame dhe tabela statistikore për paraqitjen e të dhënave historike.

c. Kompetenca e të nxënit (mëson për të nxënë në mënyrë të pavarur).

Nxënësi:

- **zhvillon** aftësitë e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;

- **përzgjedh** të dhëna nga burime të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën;

- **parashtro** pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;

- **zbaton** në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, veprimtari ose detyrë që i kërkohet;

- **ndërlidh** temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;

- **vlerëson** pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

d. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (kontribuon në mënyrë aktive).

Nxënësi:

- **zhvillon** aftësitë për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar, vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike;

- **harton** hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;

- **zhvillon** një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;

- **diskuton** individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes;

- **bashkëvepron** në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

e. Kompetenca personale (kultivon dhe përcjell idetë vetjake).**Nxënësi:**

- **zhvillon** aftësitë personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- **kupton**, nëpërmjet kërkimit historik, përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- **përdor** aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

f. Kompetenca qytetare (përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët).**Nxënësi:**

- **zhvillon** aftësitë qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
- **shqyrton** burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, shpjegon natyrën, shkaqet, pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore;
- **kupton** se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija;
- **shqyrton** burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore;
- **zhvillon** mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- **kupton** perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- **shpjegon** origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;
- **shqyrton** një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

g. Kompetenca digjitale (përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin).**Nxënësi:**

- **zhvillon** aftësitë digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik;
- **akseson** një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe i analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- **komunikon**, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- **bashkëpunon**, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

3. PËRMBAJTJA E KURRIKULËS

Programi i historisë, gjatë shkallës së gjashtë të kurrikulës, klasa XII, trajton në mënyrë të integruar historinë e qytetërimeve botërore dhe historinë e shqiptarëve në periudhat antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, në mënyrë që nxënësi të kuptojë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvlerësinë ndërmjet qytetërimeve. Studimi i përvojës së shqiptarëve në të kaluarën, veçoria dhe larmia e saj, është e domosdoshme që nxënësi të kuptojë kushtet shoqërore dhe shtysat e saj. Duke njohur, përmes fakteve, përvojën e kaluar të bashkësisë ku jeton, nxënësi thellohet në zbulimin dhe kuptimin e rrënjëve të identitetit të tij dhe të traditave të trashëguara.

Programi i historisë e ndihmon nxënësin që të kuptojë në mënyrë kritike realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes. Përmbajtja e dhënë në programin e historisë për shkallën e gjashtë të kurrikulës ofron mundësi për zhvillimin dhe ndërtimin e koncepteve, njohurive, aftësive/shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe duhet të jepen në mënyrë të integruar në të gjithë tematikat e përcaktuara në program, me qëllim ndërtimin dhe zbatimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Tematikat dhe projektet/situatat e sugjeruara të dhëna në program janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas koncepteve dhe kompetencave historike. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për secilën klasë të shkallës së gjashtë të kurrikulës.

4. REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET DHE KOMPETENCAT HISTORIKE

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të zotërojë nxënësi **për ndërtimin e koncepteve historike: kuptimi kronologjik, ndryshimi dhe vazhdimësia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, rëndësia për realizimin e kompetencave historike: kërkimi historik, përdorimi i burimeve, analiza shkak-pasojë, interpretimi, shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.**

SHKALLA E GJASHTË				
REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Shkaku dhe pasoja	Shpjegimi dhe komunikimi
Nxënësi: -	Nxënësi: -	Nxënësi: -	Nxënësi: -	Nxënësi: -

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	Ndryshimi dhe vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Rëndësia
Nxënësi: -	Nxënësi: -	Nxënësi: -	Nxënësi: -

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe t'i pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përfundimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre. I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes së lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (p.sh.: vetëvlerësimi, intervista me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.).

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim, *mësuesi duhet të ketë parasysh:*

- a. *përcaktimin* e qëllimit dhe të strategjisë së vlerësimit;
- b. *përzgjedhjen* e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- c. *përdorimin* e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- d. *dallimin* qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, që ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre. Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten. Mësuesi i historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup, si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit. Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatuar në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Ky vlerësim mund të bëhet përmes:

A. Vëzhgimit

Mësuesi vëzhgon aspekte të tilla, si:

- **aftësinë** e nxënësit për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- **ndërveprimet** e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- **cilësinë** e prezantimit të punimeve;
- **interesat**, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- **pjesëmarrjen** dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;

- **përgjegjësinë** vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- **përkushtimin** dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- **pyetjet** që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë etj.

Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënë, në mënyrë që të krijojë një pamje të përgjithshme të ecures së zhvillimit të tyre.

B. Detyrave dhe testeve

Mësuesi u jep nxënësve detyra të ndryshme në klasë, me anë të të cilave arrijnë të vlerësojnë:

- **procesin** e punës dhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve;
- **aftësinë** e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet.

Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale. Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa tematika, të cilët i bashkojnë rezultate të ndërlidhura të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim. Ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e ndërmjetme disaminutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësit, tek ato njëorëshe, teste me alternativa ose me zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është edhe testimi përfundimtar.

C. Projekteve

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull, në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe në studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për ta mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit, si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënë.

D. Paraqitjes dhe prezantimit të punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë në lëndën e historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe, si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënë në veçanti. Mësuesi nuk është i detyruar t'i vlerësojë me notë nxënësit në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në evidencë për secilën orë mësimore.

E. Dosjes së nxënësit

Dosja e nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një shkalle të caktuar të kurrikulës. Ajo mund të përmbajë listën e objektivave në fillim të vitit, anketat e përdorura gjatë një vërtetimi, burimet historike të përdorura për të kuptuar ndryshimin dhe vazhdimësinë, të tilla si: fotografi, pamje ose skica, vizatimet e kryera në klasë, poezi ose tregime mbi tema të caktuara historike, provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera (afishe, pllakate), albume, ese, artikuj publicistikë etj. Dosja është një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që nxënësi demonstroi në punime të ndryshme të arkivuara gjatë viteve në të, për vetëvlerësimin e nxënësit, si dhe për vlerësimin e ecures së tij nga ana e prindërve. Kjo dosje mund të përdoret edhe si informacion për ecurinë e nxënësve për mësuesit e rinj, kur ata ndryshojnë shkollë.

6. NDARJA E TEMATIKAVE SIPAS PERIUDHAVE

ORA	TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		PRILL-QERSHOR (39 ORË)
		SHTATOR-DHIJTOR (52 ORË)	JANAR-MARS(45 ORË)	
1	TEMATIKA I: HISTORIA DHE HISTORIANI (5 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (2 ORË) VEPRIMTARI PRAKTIKE (3 ORË)	Historia dhe vlerat e saj		
2		Burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve		
3		Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1 Tema: Të njohim burimet e shkruara të autorëve antikë për ilirët dhe Ilirinë		
4		Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 2 Tema: Si të punosh me burimet historike?		
5		Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 3 Tema: Ndërtimi i historikut të krahinës suaj duke u mbështetur në burime historike		
6	TEMATIKA II: ANTIKITETI (14 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (11 ORË) PËRSËRITJE (2 ORË) VLERËSIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT (1 ORË)	Lindja, zhvillimi dhe rënia e qytetërimit grek		
7		Shoqëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik grek		
8		Roma nga monarkia në perandori		
9		Shoqëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik romak.		
10		Marrëdhëniet mes formacioneve politike greko-romake në antikitet		
11		Përsëritje 1		
12		Procesi i formimit të etnosit ilir dhe qytetërimin të tij.		
13		Mbretëria Ilire		
14		Mbretëria Dardane.		
15		Mbretëria dhe republika në Epir		
16		Arsimi, kultura, besimi tek ilirët sipas autorëve antikë		
17		Ndikimi i qytetërimin greko-romak në kulturën ilire		
18		Përsëritje 2		
19		Vlerësim i portofolit të të nxënës 1		

20	Transformimet e Perandorisë Romake dhe hapësira ilire në mesjetën e hershme (shek. IV-VI)		
21	Dyndjet e popujve dhe ndryshimi i përbërjes etnike në Ballkan		
22	Vazhdimësia iliro-arbërore		
23	Arbëria në përballjen Lindje-Perëndim		
24	Dobësimi i Bizantit në Ballkan		
25	Formacionet shtetërore në trevat shqiptare (shek. XII)		
26	TEMATIKA III: MESJETA (SHEK. IV-XIV)		
27	Principatat kryesore arbërore shek. XIV-XV. Tiparet dhe mënyra e qeverisjes.		
28	Republika e Venedikut (Shën Markut) dhe zotërimet veneciane në Shqipëri Përsëritje 3		
29	Përhapja, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IV-XIV)		
30	Roli i krishterimit në jetën shoqërore të arbërve		
31	Arbëria dhe Bizanti. Aspekte të së drejtës dhe veçoritë e jetës ekonomike		
32	Veçoritë e jetës ekonomike në trojet arbërore		
33	Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në Mesjetë		
34	Fshati arbëror shek. VI-XIV		
35	Qytetet arbërore në Mesjetë midis civilizimit bizantin dhe atij europian.		
36	Kultura mesjetare arbërore mes civilizimit bizantin dhe atij bizantin		
37	Përsëritje 4		

38	TEMATIKA IV: PERIUDHA MODERNE (SHEK. XV-FILLIMI I SHEK. XX) (34 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (28 ORË) PËRSËRITJE (4 ORË) TESTIM NJOHURISH (1 ORË) ESE HISTORIKE (1 ORË)	Ardhja e osmanëve në Ballkan. Rezistenca e shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit		
39		Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe koha e tij		
40		Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane		
41		Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane		
42		Statusi i feve të ndryshme në kuadër të legjisllacionit të Perandorisë Osmane		
43		Rilindja Europiane		
44		Rilindja Europiane dhe shqiptarët		
45		Përsëritje 5		
46		Perandoria Habsburge		
47		Islamizimi i shqiptarëve		
48		Qyteti dhe kultura shqiptare (shek. XVI-XIX)		
49		Zhvillimi fetar dhe politik në Europë dhe në Perandorinë Osmane		
50		Iluminizmi dhe filozofia në Europën Perëndimore (shek. XVIII)		
51		Përsëritje 6		
52		Testim njohurish për periudhën e parë		

53			Rusia u bë fuqi e madhe botërore (shek. XVIII- fillim i shek. XIX)	
54			Pashallëqet shqiptare dhe përpjekjet për shpëtimet përfundimtare nga Perandoria Osmane	
55			Revolucioni Francez dhe krijimi i modelit të shtetit komb	
56			Kongresi i Vjenës dhe restaurimi i Europës pas Napoleonit	
57			Rusia dhe kryengritja serbe për shpëtimet nga Perandoria Osmane. Pansllavizmi	
58			Kryengritja greke, roli i Fuqive të Mëdha në fitoren e Pavarësisë dhe ndërtimin e shtetit	
59			Çështja shqiptare dhe qëndrimi i Perandorisë Osmane	
60			Shqiptarët dhe Tanzimat (1839-1879)	
61			Përsëritje 7	
62			Fuqizimi i nacionalizmave ballkanikë	
63			Nacionalizmi shqiptar dhe përpjekjet e para për organizim	
64			Kërcënimi rus në Ballkan, Perandoria Osmane dhe Kongresi i Berlinit	
65			Reagimi shqiptar - Lidhja e Prizrenit	
66			Dokumente themelore të nacionalizmit shqiptar	
67			Përpjekjet shqiptare për afirmimin e gjuhës dhe kulturës kombëtare	
68			Perandoria Osmane, Austro-Hungareze dhe Ruse në fillim të shek. XX	
69			Luftërat Ballkanike dhe Pavarësia e Shqipërisë	
70			Përsëritje 8	
71			Ese historike 1: 1. Rugëtimi i pavarësisë së Shqipërisë. 2. Konferenca e Ambasadorëve të Londrës dhe roli i saj në krijimin e shtetit shqiptar. 3. Gjuha kombëtare - gurëthemeli për vazhdimësinë e një kombi.	

72			Lufta e Parë Botërore dhe Paqja e Versajës	
73			Rinohja e shtetit të pavarur shqiptar dhe përcaktimi i kufijve të tij	
74			Aspekte të organizimit dhe të konsolidimit të shtetit shqiptar(1920-1939)	
75	TEMATIKA V: PERIUDHA BASHKËKOHORE (1919-DERI MË SOT) (65 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (34 ORË) PËRSËRITJE (3 ORË) TESTIME NJOHURISH (2 ORË) VLERËSIM I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT (2 ORË) VIZITË STUDIMORE (24 ORË)		Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të europianizimit të saj (1920-1939).	
76			Interesimi i shtetit amë për shqiptarët jashtë kufijve (1920-1939)	
77			Krijimi i Mbretërisë Serbo-Kroate-Slovene/Jugosllavisë si shtet shumetnik	
78			Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhojat e saj në Ballkan	
79			Fuqitë e Mëdha dhe bashkëpunimi Ballkanik - Konferencat e viteve '30	
80			Përsëritje 9	
81			Ideologjitë totalitare dhe Ballkani	
82			Ravijëzimi i blloqeve ndërluftuese dhe momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore	
83			Përpjekjet për shmangien e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit Italian të Shqipërisë	
84			Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar	
85			Rezistenca shqiptare kundër Boshtit, si pjesë e luftës së Aleatëve të Kombeve të Bashkuara	
86			Lëvizjet e rezistencës në Ballkanin Perëndimor (Jugosllavi dhe Greqi)	
87			Diplomacia e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946	
88			Fillimet e Luftës së Ftohtë	
89			Krijimi i Bllokut Perëndimor	
90			Shqipëria dhe marrëdhëniet me Perëndimin	
91			Krijimi i Bllokut Lindor	
92			Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948)	
93			Shqipëria dhe BRSS (1948-1961)	
94			Marrëdhëniet ndërmjet dy blloqeve	

95			Përsëritje 10	
96			Testim njohurish për periudhën e dytë	
97			Vlerësim i portofolit të të nxënës 2	
98				Kina brenda dhe jashtë blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë
99				Shqipëria dhe Kina
100				Zhvillimet brenda blloqeve - Blloku Lindor
101				Zhvillimet brenda blloqeve - Blloku Perëndimor
102				Tipare të artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në dy blloqet kundërshtare
103				Vetizolimi i Shqipërisë
104				Përfundimi i Luftës së Ftohtë
105				Përfundimi i Luftës së Ftohtë
106				Karakteristikat e tranzicionit në vendet ish-komuniste
107				Shqipëria në tranzicion
108				Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi
109				Ndryshimet që solli teknologjia
110				Përsëritje 11
111				Testim njohurish për periudhën e tretë
112				Jeta në kampet e punës, internimit dhe burgjet në Shqipëri gjatë regjimit komunist, 1945-1990 (vizitë studimore në vendet e kujtesës) 24 orë mësimore
113				
114				
115				
116				
117				
118				
119				
120				
121				
122				
123				

124				
125				
126				
127				
128				
129				
130				
131				
132				
133				
134				
135				
136				<i>Vlerësim i portofolit të të nxënit 3</i>

II. PLANIFIKIMI MËSIMOR PËR PERIUdhËN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)						
ORË	TEMATIKA	TEMA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT	SITUATA E TË NXËNIT	VLERËSIMI	BURIMET
1	TEMATIKA 1: HISTORIA DHE HISTORIANI (5 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (2 ORË) VEPRIMTARI PRAKTIKE (3 ORË)	Historia dhe vlerat e saj	Evidenton rëndësinë dhe vlerat e të mësuarit të historisë duke u ndalur në rëndësinë e historisë kombëtare. Zgjedh shembuj të trajtimit të historisë me objektivitet ose subjektivitet dhe dallon ndryshimet midis dy trajtimeve.	Historia nuk është thjesht një lëndë që do të cilësohej “e mërzitshme” nga disa prej nesh, ajo është një domosdoshmëri për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar të tashmen. Pa praninë e historisë, formimi shkencor i secilit prej nesh do të ishte i paplotë! Ja përse pranohej se rrënjët e historisë janë filleza e çdo individi, komuniteti apo kombi, e si të tilla duhen kultivuar te njeriu.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues	Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti
2		Burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve	Njihet me burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve. Evidenton autorë vendës dhe të huaj në shkrimin e historisë së shqiptarëve. Thekson rolin e rëndësishëm të burimeve arkivore, në shkrimin e historisë.	Në një intervistë, Robert Elsie do të shprehej kështu në lidhje me historinë e shqiptarëve: “Shqipëria nuk ka një traditë të gjatë shkrimi. Historia e Shqipërisë është e shkruar nga të huajt dhe jo nga shqiptarët, por ka shumë kujtesë kolektive në popullin shqiptar. Kjo kujtesë duhet shfrytëzuar sa jemi në kohë.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues	Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti
3		Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1. Tema: Të njohim burimet e shkruara të autorëve antikë për ilirët dhe Ilirinë	Njihet me përmbajtjen e burimeve kryesore të shkruara për ilirët nga autorët antikë. Organizon informacionet e dhëna sipas aspekteve të ndryshme të jetesës së ilirëve. Gjykon historinë e ilirëve si themel i historisë së shqiptarëve.	Pavarësisht se nuk kemi një histori të shkruar për ilirët, ashtu si e kanë popujt e tjerë antikë, autorët e antikitetit kanë dhënë informacione për ta. Informacionet e tyre përfshijnë të dhëna nga aspekte të ndryshme të jetës dhe ngjarjeve politike të kohës. Përmes këtyre informacioneve mund të shpjegosh dhe rindërtosh jetën e ilirëve.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues	

4	Veprimtari praktike e sugjeruar nr.2. Tema: Si të punosh me burimet historike?	Zbulon kuptimin për arkivin dhe llojet e tij. Fiton aftësi për të seleksionuar dokumentet arkivore. Zhvillon aftësi kompjuterike për të kërkuar dokumente ose për të parë të dhënat e digitalizuara.	Arkivat janë koleksione të informacionit - të njohura si shënime. Këto vijnë në shumë forma, si: letra, raporte, regjistrime video, harta, fotografi dhe filma, fotografi digjitale, regjistrimet e zërit. Arkivi nuk është një bibliotekë.	Vlerësim në grup Vlerësim individual	
5	Veprimtari praktike e sugjeruar nr.3. Tema: Ndërtimi i krahinës suaj duke u mbështetur në burime historike	Zhvillon aftësinë e kërkimit historik dhe të përdorimit të burimeve parësore dhe dytësore. Ndërton historinë e vendbanimit bazuar në analizën shkak-pasojë, interpretim, gjykim të ngjarjeve, objekteve apo figurave historike.	Gjendet një ngjarje që dominon historinë e krahinës ku ndodhen nxënësit tuaj dhe lexohet në klasë. Nëpërmjet saj nxitet kurioziteti për të vijuar më tej, me të tjera fakte dhe dëshmi të së kaluarës së krahinës suaj.	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim në grup Vlerësimi ndër nxënës	
6	TEMATIKA II: ANTIKITETI (14 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (11 ORË) PËRSËRITJE (2 ORË) VLERËSIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT (1 ORË)	Lindja, zhvillimi dhe rënia e qytetërimit grek	Grekët e lashtë e quanin veten helenë (në fakt, besonin se qenë pinjoll të heroit mitik Helen) dhe tokën e tyre Ellade ("Hellás"). Akoma sot, në greqisht, Greqia quhet Hellas. Atëherë, nga vjen fjala Greqi?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Teksti mësimor Interneti http://www.bota.al/2016/09/Historia-botërore-dhe-qytetërimi,-K-Grimberg
7	Shoqëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik grek	Përkakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit grek. Evidenton ndikimin e qytetërimeve të para në qytetërimin grek dhe romak. Shpjegon fazat e zhvillimit të qytetërimit grek dhe tiparet e organizimit ekonomik-shoqëror. Përkakton elemente të jetës së përditshme të shoqërisë, botës kulturore materiale dhe shpirtërore në qytetërimin antik grek. Gjykon mbi arritjet e qytetërimit grek në fushën e shkencës, filozofisë, demokracisë.	Shkenca, politika, arti, poezia, teatri... Nuk ka fushë të dijes Perëndimore që nuk e ka pak Greqi të lashtë në të kaluarën e saj. Prej më shumë se 2000 vjetësh, bota e klasikitetit helen është një fanar, një pikë referimi nga e cila herët a vonë kthehesh për të parë. Por kush qenë vërtet ata njerëz? Në çfarë fushash u shprehën?	Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim në grup	Interneti http://www.bota.al/2016/09/Historia-botërore-dhe-qytetërimi,-K-Grimberg

8		Roma nga monarkia në perandori	Përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik romak. Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimit antik romak. Shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Romën antike.	Legjenda e Romulit dhe Remit tregon historinë e vëllezërve binjakë të rritur nga ujkonja, që bëhen etërit themelues të Romës. Nëna e djemve, Rea Silvia, kishte qenë e detyruar të bëhej një Virgjëreshë Vestal (priftëreshat që merrnin pjesë në ziarrin e shenjtë të Vesta) nga uzurpatori Amulius. Ajo pastaj mbeti shtatzënë ose me perëndinë Mars ose me Herkulin. Kur Amuliusi mësoi për këtë, ai urdhëroi që binjakët e mitur të hidheshin në lumin Tiber, ku ata u lanë të vdisnin... Vazhdojeni ju legjendën.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg Interneti http://www.bota.al/2017/03
9		Shoqëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik romak	Shpjegon tiparet e organizimit ekonomik-shoqëror në Romën antike. Dallon elemente të jetës së përditshme në qytetërimin antik romak. Përkshuan tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimin antik romak.	Jeta në qytetin e Romës, rrotullohej rreth qytetit, Romë, i cili shtrihej mbi 7 kodra. Kishte struktura monumentale, si Koloseu, Panteoni, Forumi i Trajanit, shatërvanë, shëtitore, ujësjellës, teatro etj.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Teksti mësimor Roma e Lashtë, R. Gjini Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg Interneti http://www.exploreunivers.com
10		Marrëdhëniet mes formacioneve politike greko-romake në antikitet	Shpjegon karakteristikat kryesore të organizimit institucional-politik, social-ekonomik në qytetërimet antike. Analizon shkaqet e konfliktit dhe rrjedhojat e tyre (Lufta e Trojës, luftërat greke-persiane dhe Luftërat Punike).	Shprehja më karakteristike për të shprehur qëndrimin e spartanëve kundrejt luftës ishte shprehja që Nëna Spartane i thoshte djalit të saj kur po ikte për luftë, "I tan i epi tas" ose "kthehu me mburojë ose mbi të".	Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Roma e Lashtë, R. Gjini Greqia e lashtë, Sh. Dervishi Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg http://www.tiranaobserver.al http://www.bota.al/2016/10
11		Përsëritje 1				

12	Procesi i formimit të etnosit ilir dhe qytetërimit të tij	Shpjegon formimin e etnosit ilir mbështetur në gjurmët arkeologjike të periudhës prehistorike dhe historike. Shpjegon konceptet <i>etnogjenezë</i>, <i>etnos</i>, <i>ilir</i>, <i>Iliri</i>, <i>Epir</i>, <i>epirotë</i> etj.	Kultura dhe etnosi ilir kanë origjinë autoktone (vendëse). Ata lindën dhe u formuan në bazë të një procesi të gjatë dhe të pandërprerë, gjatë mijëvjeçarit të dytë dhe të parë p.e.s.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Teksti mësimor Ilirët dhe Iliria, te autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali Nga Ilirët te shqiptarët, N. Ceka Interneti https://www.shqiperia.com/historia/iliret.php.htm Mbretëria Dardane, L. Përzhita
13	Mbretëria Ilire	Shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Ilirinë antike. Shpjegon dhe analizon shkaqe mbi marrëdhëniet e Ilirëve me fqinjët.	Historia e Ilirisë është e lidhur me zhvillimin e shteteve sklavopronare dhe mbretëritë e tjera, me ushtritë e strategët e saj, sidomos me Maqedoninë, Spartën, Athinën etj. Çfarë ju tregon kjo gjë për Ilirinë?	Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Ilirët dhe Iliria, te autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali Nga Ilirët te shqiptarët, N. Ceka Interneti https://www.shqiperia.com/historia/iliret.php.htm
14	Mbretëria Dardane	Shpjegon organizimin shtetëror të fisit ilir të dardanëve. Arsyeton mbi marrëdhëniet e Mbretërisë Dardane me fqinjët. Analizon rëndësinë e mbretërve ilirë në jetën politike shoqërore të Ilirëve dhe rolin e tyre	Dardanët arritën që të bëheshin një fuqi e madhe ushtarake gjatë sundimit të mbretit Bato dhe Monun. Në të gjitha aleancat, dardanët shfaqen si forcë kryesore në Ballkan. Pothuajse e gjithë historia e lashtë e dardanëve na paraqitet si histori luftërash të pandërprera	Vlerësim individual	

15	Mbretëria dhe Republika në Epir	Shpjegon organizimin shtetëror të epirotëve. Arsyeton mbi marrëdhëniet e mbretërisë dhe Republikës së Epirit me fqinjët. Analizon rëndësinë e mbretërive epirotë në jetën politike-shoqërore.	Pirroja qe një nga strategët më të mëdhenj të kohës helenistike. Kur e pyetën njërin nga shokët e Aleksandrit të Maqedonisë, se kush ishte tani strategu më i shquar, ai iu përgjigj: "Pirroja kur të arrijë moshën e pjekurisë".	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	
16	Arsimi, kultura, besimi tek ilirët sipas autorëve antikë	Vlerëson disa burime historike të autorëve antikë grekë dhe romakë për kulturën ilire, gjuhën, simbolet, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët, praktikatat e besimit dhe varrimit. Përkshkruan tipare të artit, kulturës dhe besimit tek ilirët.	Lexohet dhe diskutohet dokumenti 1. "Babai i historisë", Herodoti, në shekullin e V p. I. K., shkruan: "Shtëpitë e tyre (ilirëve) janë ndërtuar në këtë mënyrë: në mes të liqenit, mbi trarë të vënë kryq, janë vendosur shtroja dërrasash. Ato lidhen me tokën me anë të një ure. Atje rrojnë në këtë mënyrë: secili mbi këto shtroja ka një kasolle, në të cilën banon dhe ka një qepen të lidhur mirë, i cili shërben për të zbritur poshtë në liqen. Fëmijët e vegjël i lidhin për këmbë me litar, nga frika se mos bien poshtë në liqen..."	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	
17	Ndikimi i qytetërimit greko-romak në kulturën ilire	Gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire nga ndikimi i qytetërimit grek dhe romak. Përcakton format e organizimit shoqëror dhe mënyrat e jetesës në shoqërinë ilire. Krahason kulturën ilire me atë të shqiptarëve sot.	Via Egnatia është ndërtuar për të lehtësuar qarkullimin e lirë të njerëzve si dhe për të realizuar lidhjen e Romës me provincat më të largëta. Ajo fillonte nga Durrësi dhe nëpërmjet Ohrit e Selanikut të shpinte në Kostandinopojë. Me një gjatësi rreth 861 km, Via Egnatia ka qenë e përshtatshme për lëvizjen e udhëtarëve dhe të karvaneve.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit informues Vlerësim në grup	
18	Përsëritje 2				
19	Vlerësim i portofolit të të nxënit 1				

20	TEMATIKA III: MESIETA (SHEK. IV-XIV) (18 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (16 ORË) PËRSËRITJE (2 ORË)	Transformimet e Perandorisë Romake dhe hapësira ilire në mesjetën e hershme (shek. IV-VI)	Evidenton shkaqet e kalimit të qendrës së perandorisë nga Roma në Kostandinopojë. Përkthehet tiparet e jetës sociale dhe ekonomike të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI).	Burimet e shkruara antike përmendin Probin, sundimtarin e Ilirikut, i cili që nga fundi i shek. III e sonë, duke mbledhur taksat në mënyrë të padrejtë, i kishte dobësuar krahinat veriore ilire, para se ato të shkatërroheshin nga barbarët. Çfarë ju tregon kjo e dhënë për gjendjen e Perandorisë Romake?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Roma e Lashtë, R. Gjini Teksti mësimor Ilirët dhe Iliria, të autorët antikë, S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali https://www.shqiperia.com/Kriza-e-sistemit-antik-te-prodhimit-dhe-e-Perandorisë-Romake
21		Dyndjet e popujve dhe ndryshimi i përbërjes etnike në Ballkan	Evidenton lëvizjet e popujve në Ballkan dhe pasojat e tyre. Tregon në hartë shtrirjen e hapësirës shqiptare dhe të sllavëve në Ballkan. Shpjegon ndryshimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Europën Perëndimore gjatë dhe pas dyndjeve të popujve.	“Kur shkatërrohen qytetet dhe vriten njerëzit, ikin dhe rrallohen edhe kafshët, zogjtë e peshqit. Për këtë është dëshmitar, Iliriku, dëshmitar është Thrakia, dëshmitar është dhe vendi ku kam lindur (qyteti Stridon në Dalmati), ku çdo gjë u zhduk, përveç qiellit e tokës, gjembave që rriten dhe pyjeve të dendur”. Profeti Sofon.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	
22		Vazhdimësia iliro-arbërore	Shpjegon të dhënat për vazhdimësinë ilire-arbërore. Vlerëson vazhdimësinë ilire-arbërore në vendbanim.	“Ilirë ishim, arbër u bëmë, albanë na thërrasin, shqiptarë përgjigjemi!” N. Bacaj. Pse ka ndryshuar emri i shqiptarëve ndër shekuj?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	
23		Arbëria në përballjen Lindje-Perëndim	Arsyeton përfshirjen e arbërve në konfliktet e normanëve dhe anzhuinëve me Perandorinë Bizantine. Përcakton në hartë hapësirën ku kaluan normanët, anzhuinët dhe kryqtarët. Përcakton pasojat e kalimit të kryqtarëve në territoret arbërore.	Një pjesë e kryqëzatave, kaloi mespërmes Shqipërisë. Ata kaluan nëpër “Rrugën Mbretërore”, përgjatë luginës së lumit Shkumbin. Kryqtarët i shkakton popullsisë vendëse mjerrme të pallogaritshme.	Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski Interneti http://www.drita.info/2016/08/11/

24	Dobësimi i Bizantit në Ballkan.	Shpjegon shkaqet e rënies së Kostandinopojës (1204). Evidenton formacionet shtetërore latine dhe bizantine që u krijuan pas vitit 1204 në hapësirën bizantine. Përkshkruan marrëdhënien e Arbërisë me Despotatin e Epirit.	R. Kroulejt shkruan: "Për Konstandinin, një mbrojtje e suksesshme e qytetit, varej nga ndihma e Europës së krishterë. Raundi i pafundmë i misioneve diplomatike që i parapriu rrethimit, u ndërmor për të kërkuar, para, trupa ushtarake dhe mjete materiale për kauzën e krishterimit. Përditë, qytetarët e Kostandinopojës shohin në drejtim të detit për ndonjë flotë – një skuadron të galerave veneciane apo gjenoveze... Por deti mbeti qëllimisht i zbrazët".	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski "Lufta e Shenjtë për Kostandinopojën dhe përplasja e Islamit me Perëndimin", Roxher Kroulejt
25	Formacionet shtetërore në trevat shqiptare (shek.XII)	Shpjegon gjendjen politike në Ballkan në shek. XII. Shpjegon kushtet e krijimit të Principatës së Arbrit (shek. XII). Gjykon mbi mënyrën e organizimit dhe të qeverisjes së Principatës së Arbrit.	Në një letër, që Papa i dërgonte Dhimitrit më 1208 e quante këtë kryezot "Nobili Viro Demetrio arbanesi principi" d.m.th. "burrë fisnik, princ i arbëreshëve". Më 1909, Papa në një letër të dytë e quan atë me një titull akoma më të lartë juridik "Judek" d.m.th. "Gjykatësi i arbëreshëve". Çfarë tregon kjo për fuqinë e Dhimitrit?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	
26	Principatat kryesore arbërore shek. XIV-XV Tiparet dhe mënyra e qeverisjes	Shpjegon shkaqet e zhvillimit të principatave arbërore në shek. XIV, tiparet dhe mënyrën e tyre të qeverisjes. Tregon ndërveprimin mes principatave arbërore dhe formacioneve të tjera shtetërore në Ballkan.	Gjergj I Balsha, Gjergj Balsha II, Leka I Dukagjini, Teodor Muzaka, Andrea Topia, Karl Topia, Gjin Bue Shpata, Gjon Kastrioti, Cili ka qenë roli dhe statusi i këtyre figurave historike në historinë arbërore mesjetare?	Vlerësim për të nxënëit informues. Vlerësim në grup	
27	Republika e Venedikut (Shën Markut) dhe zotërimet veneciane në Shqipëri	Përkshkruan marrëdhëniet midis Venedikut dhe Perandorisë Bizantine. Përcakton në hartë shtrirjen e zotërimeve veneciane në Arbëri	Arbëria Venedikase (Albania vënetia) është një koncept historiko-geografik i përdorur për zotërimet venedikase të përtej detit në Dalmacinë Jugore dhe në krahinën e Shkodrës, territore që tanimë i përkasin Malit të Zi dhe Shqipërisë.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	
28	Përsëritje 3				

29	Përhapia, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IV-XIV)	Evidenton rëndësinë e pjesëmarrjes së klerës kishtarë shqiptarë në Sinodet e para Ekumenike. Analizon ndryshimet e juridiksionit kishtar të trevave shqiptare ndërmjet Papatit të Romës dhe Patriarkanës së Kostandinopojës. Përcakton pasojat e Skizmës së Madhe në hapësirën shqiptare.	“Peshkopët e kishës romake Damasi, Valeriani dhe të tjerët që morën pjesë në Sinodin e Shenjtë (në Serdikë) përshëndesin vëllezërit e tyre të dashur nga zotipeshkopët në Ilirik, peshkopët e Ilirikut përshëndesin në emër të zotit kishat e perëndisë dhe peshkopët e dioqezës së Azisë, Frygisë, Karofrygisë dhe Pakatianës” Theodoreti, historiani kishtar shek. V.	Vlerësim në grup	
30	Roli i krishterimit në jetën shoqërore të arbërve	Dallon ndikimin e krishterimit në trashëgiminë tonë kulturore materiale dhe jomateriale (arkitekturë, skulpturë, pikturë, letërsi/kodikë, muzikë etj.).	Bazilika paleokristiane e Linit ndodhet në pjesën perëndimore të Kepit të Linit dhe përfaqëson një nga monumentet më të rëndësishme të Shqipërisë. Struktura ishte e dekoruar me mozaikë shumëngjyrësh me motive floreale, gjeometrike dhe skena eukaristike, tipike të periudhës paleokristiane. Gërmimet arkeologjike dhe të dhënat numizmatike mbështesin datimin e bazilikës dhe të dyshemesë me mozaik në shek. V – VI.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	
31	Arbëria dhe Bizanti. Aspekte të së drejtës dhe veçoritë e jetës ekonomike	Shpjegon karakteristikat e ligjit agrar bizantin dhe ndikimin e tij në hapësirën shqiptare. Dallon karakteristikat e sistemit feudal bizantin në hapësirën shqiptare dhe e krahason me sistemin feudal evropian.	Nxirr konkluzionin: Në fund të shek. XIV një pronar nga familja Dukagjini i përgjigjej thirrjes së kryezotit për luftë duke u paraqitur me 40 kalorës e 100 këmbësorë.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	

32	Vecoritë e jetës ekonomike në trojet arbërore	Vlerëson rëndësinë e zhvillimit të zejeve, tregjeve ndërkrahinore dhe panairëve fetare për jetën ekonomike.	Që në shek. XI dhe akoma më shumë në shekujt pasardhës, tregtarë venecianë sillnin në Durrës produkte të ndryshme, një pjesë të të cilave e çonin drejt Lindjes nëpërmjet rrugës Egnatia. Veprimtari e ethshme zhvillohej edhe në krahun e kundërt, nga Kostandinopoja e Selaniku për në Durrës, e prej këndej, me anije, për në Venedik.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	
33	Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në Mesjetë.	Shpjegon shkaqet dhe tregon drejtimit e emigrimeve shqiptare në shek. XIV-XV. Evidenton përmasat e emigrimeve arbërore në Greqi dhe në Itali gjatë shek. XIV-XV.	Kujto emërtimet: arvanitas, alvanitas, arbëreshë. Çfarë të kujtojnë nga historia e shqiptarëve?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	
34	Fshati arbëror shek. VI-XIV.	Evidenton ndryshimet që ndodhën në fshatin arbëror gjatë mesjetës. Identifikon dallimet mes fshatrave fushorë dhe atyre malore, në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe lirive që zotëronin.	Edhe në viset malore, të cilat kishin qenë tradicionalisht "vatra të fshatarësisë së lirë", vihet re diferencimi shoqëror në shek. XIII-XIV. Krerët e fshatrave grumbullojnë jo vetëm toka dhe bagëti, por edhe pushtet. Kujtoni shembuj nga historia sesi familjet feudale rritën ndikimin dhe rolin e tyre në këtë periudhë?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	

35		Qytetet arbërore në Mesjetë midis civilizimit bizantin dhe atij evropian	Përshkruan jetën sociale dhe ekonomike në qytetet arbërore në bazë të statuteve dhe kanuneve (shek. XIII-XIV). Evidenton rolin e institucioneve qeverisëse në jetën e qyteteve arbërore. Arsyeton mbi shkallën e zhvillimit të qyteteve në Arbërinë mesjetare, duke i krahasuar me qytetet bizantine dhe ato europiane (shek. XIII-XIV).	Në shek. XIII edhe qendra të tjera shqiptare, si Drishti, Deja, Shasi, Prizreni, Lezha, Kruja, Berati, Kanina etj., bënë një hap të rëndësishëm drejt kthimit të tyre nga kështjella me fizionomi kryesisht ushtarake, në qendra urbane të zhvilluara. Në pamundësi për t'u zhvilluar brenda rrethit të mureve të trashëguara nga e kaluara, qytetet në fjalë u shtrinë jashtë tyre. U formuan kështu lagjet e jashtme (proastion, suburbium), të cilat shumë shpejt u kthyen në qendra të jetës ekonomike të qytetit. Këtu zhvilloheshin tregjet dhe ishin përqendruar dyqanet e punishtet.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	
36		Kultura mesjetare arbërore mes civilizimit bizantin dhe atij bizantin	Vlerëson ndikimet kulturore europiane dhe bizantine në hapësirën arbërore në arsim, letërsi, arkitekturë, skulpturë, pikturë, arte etj.	Lexim i legendës së "Gjergj Elez Alisë". Shfrytëzohet material i plotë, jo vetëm paragrafi që jepet në tekst. Shfrytëzohet material nga Eposi i Kreshnikëve.		
37		Përsëritje 4				
38	TEMATIKA IV: PERIUdHA MODERNE (SHEK. XV-FILLIMI I SHEK. XX) (34 ORË GJITHSEJ) NUOHURI TË REJA (28 ORË) PËRSËRITJE (4 ORË) TESTIM NUOHURISH (1 ORË) ESE HISTORIKE (1 ORË)	Ardhja e osmanëve në Ballkan. Rezistenca e shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit	Evidenton sulmet e para të pushtimit osman në Ballkan dhe në territoret shqiptare. Analizon situatën politike në Bizant dhe në gjithë rajonin e Ballkanit. Analizon përpjekjet e princave ballkanikë dhe arbërorë për t'u përballur me pushtimin osman dhe koalicionet e krijuara me këtë funksion.	Osmanët ishin pasardhës të turqve oguzë. Këta u shpërngulën si tribu nga Azia Qendrore dhe u vendosën në Anadoll në fund të shek. XI, pas disfatës së rëndë ushtarake që turqit selxhukë i shkaktuan Perandorisë Bizantine (1071. Turqit oguzë hynë në histori kur prijësi i tyre Ertogrulli mori si shpërblim prej sultanit selxhuk një zotërim të vogël në brigjet e lumit Sangaria (Sakaria). I biri i Ertogrullit, Osmani I (1290-1323), e zgjeroi zotërimin atëror dhe e ktheu në një shtet të pavarur me emrin Emirati Osman, që u bë bërthama e Perandorisë Osmane	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran Skënderbeu, O. Schmit Jeta dhe bëmat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, M. Barleti

39	Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe koha e tij	Përshkruan raportet e vendosura mes shtetit osman dhe familjeve fisnike shqiptare. Shpjegon strategjinë e Gjergj Kastriot Skënderbeut për arritjen e bashkimit në planin e brendshëm.. Shpjegon nevojën dhe procesin e kalimit nga aleanca e princërve te shteti i përqendruar dhe vë në dukje tiparet e këtij të fundit.	“Gjergj Kastrioti Skënderbeu është më i famshmi nga të gjithë, jo vetëm nga të gjitha krahinat ilire, të prefekturës së Epirit të ri, Dardanisë, por edhe të një pjesë të Epirit të vjetër të cilat i bashkoi...” – Guillaume de Vaudoncourt, 1821. Cili është mesazhi që merrni përmes këtij vlerësimi që një studiues i huaj i bën figurës së Skënderbeut?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	
40	Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane	Shpjegon parimet e organizimit territorial dhe shtetëror të Perandorisë Osmane. Vë në dukje raportin mes qendërimit dhe decentralizimit të pushtetit në kuadër të perandorisë. Diferencon qëndrimin e shtetit osman ndaj krahinave të ndryshme dhe trajtimit të tyre nga pikëpamja e organizimit të brendshëm. Analizon sistemin ekonomik dhe fiskal të zbatuar nga autoritetet osmane.	Taksat më kryesore ishin ajo e martesës, gjoba për faje e delikte, taksa e tapisë, e sendeve që lënë sklevërit e arratisur, e dhjeta e kullotës etj. Sipas kanunnameve të reja, në qoftë se nusja ishte bijë myslimani, madhësia e taksës së martesës që dhëndri duhej t'i jepte spahiut ishte 60 akçe, në rast se nusja ishte vejushë dhëndri duhej t'i jepte po spahiut 30 akçe. Kur nusja ishte bijë jomyslimani, dhëndri jepte gjysmën e saj. Gjrobat ishin në varësi të fajit të bërë, për shkelje të normave të së drejtës dokesore, si për rrahje, plagosje, vrasje, vjedhje, përdhunim, deheje me verë etj. Ju duken taksa të çuditshme, në këndvështrimin aktual të detyrimeve?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran Interneti
41	Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane				

42	Statusi i feve të ndryshme në kuadër të legjislacionit të Perandorisë Osmane	Analizon pozicionin e feve të ndryshme në kuadër të legjislacionit të Perandorisë Osmane. Vlerëson trajtimin e popullsisë jomyslimane në Ballkan dhe në trojet shqiptare nga pikëpamja e të drejtave politike dhe ekonomike nën sundimin osman.	Islamizimi i popullsisë shqiptare ishte një proces me ndikime të ndjeshme edhe në shumë aspekte të kulturës shpirtërore. Në doket, martesat dhe në krijimtarinë artistike (gojore dhe të shkruar) u dukën shpejt elementët e kulturës islamiko-orientale. Martesat në përgjithësi filluan të bëheshin brendapërbrenda secilit komunitet fetar (djemtë myslimanë me vajza myslimane, ndërsa ata të krishterë me vajza të krishtera), ndërkohë që popullsia e islamizuar nisi të dallohej edhe nga mënyra e veshjes. Më të shpikatura këto dallime ishin në veshjen e grave myslimane që banonin në qytete, të cilat filluan të përdornin ferehenë për të mbuluar pjesërisht ose tërësisht fytyrën në publik. Në vitin 1453, Gutenberg i bëri provat e para të shkrirjes së shkronjave një nga një dhe bëri shtypin me to. Ky vit merret si vit zbulimi i shtypshkronjës. Presën e parë me material të drurit për shtyp me shkronja lëvizëse një nga një e punoi në Mainz. Me zbulimin e saj filloi një periudhë e re në veprimtarinë grafike, ndërsa dituria u bë pasuri gjithënjëzore. Mësuesja përzgjedh foto të disa prej rilindësve shqiptarë. Nxënësit dallojnë figurat historike. Mësuesja flet qartë dhe shkurt.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran Interneti
43	Rilindja Europiane	Shpjegon kuptimin e konceptit Rilindje, parimet intelektuale bazë të saj, figurat më përfaqësuese të kësaj lëvizjeje. Përkthyer prirjet kryesore të artit dhe të arkitekturës së Italisë në shek. XV-XVI.	Në vitin 1453, Gutenberg i bëri provat e para të shkrirjes së shkronjave një nga një dhe bëri shtypin me to. Ky vit merret si vit zbulimi i shtypshkronjës. Presën e parë me material të drurit për shtyp me shkronja lëvizëse një nga një e punoi në Mainz. Me zbulimin e saj filloi një periudhë e re në veprimtarinë grafike, ndërsa dituria u bë pasuri gjithënjëzore.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti
44	Rilindja Europiane dhe shqiptarët	Shpjegon përhapjen e ideve të Rilindjes europiane në trojet shqiptare. Identifikon figurat më përfaqësuese të rilindësve shqiptarë. Përkthyer rolin e rilindësve shqiptarë dhe atyre europianë në njohjen e vlerave të popullit shqiptar në luftë kundër pushtuesve osmanë nën drejtimin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut.	Mësuesja përzgjedh foto të disa prej rilindësve shqiptarë. Nxënësit dallojnë figurat historike. Mësuesja flet qartë dhe shkurt.		
45	Përsëritje 5				

46	Perandoria Habsburge	Vë në dukje krijimin e Perandorisë Habsburge, karakterin e saj politiko-fetar dhe procesin e zgjerimit dhe fuqizimit të saj.	Habsburgët, që nga themeluesi i tyre, Rudolphi I në shekullin trembëdhjetë, kishin ndërtuar plot zell një legjendë mbi origjinën e tyre, që i veçonte ata nga njerëzimi i zakonshëm. Rrëfehej se Rudolphi, tek kish dalë për gjah, kish takuar një prift që mbante kungatën e një njeriu që po vdiste. Prifti ndeshi në një përdua të tejfryrë në mal dhe nuk dinte si të kalonte. Rudolphi i ofroi menjëherë kalin e tij dhe e udhëhoqi për në anën tjetër, por kur prifti kërkoi që t'ia rikthente kalin, ai kundërshtoi, duke thënë që nuk do të mund të hipte kurrë në një kafshë që kish mbajtur Trupin e Krishtit.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim në grup	Teksti mësimor Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg Interneti Historia e Popullit Shqiptar
47	Islamizimi i shqiptarëve	Tregon procesin e përhapjes së fesë islame në territoret shqiptare. Identifikon rrugët e përhapjes së procesit të islamizimit. Analizon shkaqet e islamizimit të popullsisë shqiptare.	Islamizimi fillonte me kryefamiljarët dhe meshkujt e rritur, të cilët bashkëjetonin me anëtarët e tjerë të familjes së paislamizuar ende. Pastaj procesi në fjalë shtrihej te gratë dhe te fëmijët. Detyrimi ekonomik ka qenë rruga kryesore për islamizimin në masë të shqiptarëve.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Teksti mësimor Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg
48	Qyteti dhe kultura shqiptare (shek. XVI-XIX)	Shpjegon rëndësinë e pozitës gjeografike dhe gjeopolitike të viseve shqiptare në kuadër të planeve ekspansioniste të Perandorisë Osmane. Përshkruan mënyrën e organizimit të brendshëm të qendrave urbane shqiptare. Evidenton zhvillimin e kulturës shqiptare dhe ndikimet e saj nga elemente të kulturave Lindore dhe Perëndimore.	Sipas Robert Elsie, "Akademia e Re ose Hellënikon Frontistëron ishte një qendër e dijes e themeluar më 1744 në Voskopojë. Akademia e Re, Biblioteka dhe e vetmja Shtypshkronjë e Perandorisë së asaj kohe, ka qenë një trekëndësh kulturor unik në Ballkanin e mesit të shekullit XVIII.	Interneti Historia e Popullit Shqiptar	

49	Zhvillimi fetar dhe politik në Europë dhe në Perandorinë Osmane	Vë në dukje zhvillimet fetare dhe politike në Europë në kuadër të procesit të Reformacionit dhe ndikimet e tyre në situatën e brendshme dhe të jashtme të shteteve europiane. Analizon ndikimin e ardhjes së fesë islame në Europë dhe pozicionin e Perandorisë Osmane në lidhje me zhvillimet fetare-politike në Europë, në funksion të synimeve të saj gjeostrategjike. Evidenton përhapjen e Protestantizmit në Europë dhe kundërpërgjigjen e kishës katolike ndaj tij.	Giordano Bruno, ishte filozof, prift, kozmolog dhe okultist italian. Bruno u dogj për së gjalli në turrën e druve, pas shtatë viteve burgim, i akuzuar nga Kisha Katolike Romake dhe realizuar nga Inkuizicioni Romak për shkak të të pasurit të mendimeve të kundërta me besimin katolik. Bruno thoshte se dielli lëviz e ndryshon pozicion kundrejt yjeve, se edhe atmosfera e Tokës lëviz bashkë me të etj.	Teksti mësimor Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg Interneti Historia e Popullit Shqiptar
50	Iluminizmi dhe filozofia në Europën Perëndimore, shek. XVIII.	Evidenton zhvillimet në fusha të ndryshme të shkencës në Europën e shek. XVII. Shpjegon përhapjen e mendimit kritik kundrejt dijeve tradicionale dhe ndikimit të fesë mbi shkencën. Shpjegon përmbajtjen e ideve kryesore iluministe dhe evidenton rrymat kryesore të mendimit iluminist. Identifikon figurat kryesore të iluminizmit me theks të veçantë te filozofët francezë.	“Unë nuk jam dakord me atë që thua, por do ta mbroj deri në vdekje të drejtën tënde që ta thuash.” Volter. Diskuto duke zëbërthyer shprehjen.	Teksti mësimor Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg Interneti Historia e Popullit Shqiptar Teksti mësimor
51	Përsëritje 6			
52	Testim njohurish për periudhën e parë			

OR	PLANIFIKIMI MËSIMOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)			
	TEMA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT	SITUATA E TË NXËNIT	BURIMET
TEMATIKA IV PERIUdhA MODERNE (SHEK. XV-FILLIMI I SHEK. XX) (34 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (28 ORË) PËRSËRITJE (4 ORË) TESTIM NJOHURISH (1 ORË) ESE HISTORIKE (1 ORË)				
53	Rusia u bë fuqi e madhe botërore (shek. XVIII- fillim i shek. XIX)	Vë në dukje konsolidimin dhe modernizimin e shtetit rus dhe daljen e Rusisë si fuqi e madhe botërore. Tregon rolin dominues të Rusisë në botën ortodokse dhe rëndësinë e këtij pozicionimi në drejtimet e politikës së jashtme të saj, duke u përqendruar kryesisht te Ballkani.	<i>“Rusia nuk ishte më një zonë e depresuar e Orientit të largët, por pjesë përbërëse e Europës. Jo më e ngjirë në liturgji dhe struktura mesjetare e bizantine, ajo dominonte detet dhe ulej në klubin e ngushtë e monarkive të mëdha. Pjetri i siguroi një pjesë të rëndësishme në skenën europiane”. Si e gjykoni pohimin e bërë nga historiani Uilliam Marshall?</i>	Pjetri i Madh, A. Tolstoi Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg.
54	Pashallëqet shqiptare dhe përpjekjet për shkëputje përfundimtare nga Perandoria Osmane	Shpjegon kuptimin politiko-administrativ të termit pashallëk dhe zhvillimin e tij në territoret shqiptare. Analizon zhvillimin e pashallëqeve shqiptare dhe politikën e tyre që çonin drejt synimit për shkëputje përfundimtare nga Perandoria Osmane. Vlerëson rolin dhe ndikimin e pashallarëve të mëdhenj shqiptarë në skenën ndërkombëtare euroaziatike.	Pashallëqet shqiptare janë një pjesë e rëndësishme e historisë së popullit tonë. Ju kujtohet Konfederata Ilirike? Pse u projektua? Si e kujtoni figurën e Ali Pashë Tepelenës? Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje nga jeta e tij?	Historia e Popullit Shqiptar Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës, I. Koçollari
55	Revolucioni Francez dhe krijimi i modelit të shtetit komb	Evidenton karakterin e shoqërisë franceze dhe diferencimin e saj të thellë në prag të përmbysjes së monarkisë. Shpjegon raportin e ri të vendosur shtet-kishë dhe karakterin laik të shtetit francez pas revolucionit. Analizon konceptin e shtetit-komb dhe faktorët historikë që çuan në formimin e shteteve-kombe në Europë.	<i>“Revolucioni francez ka qenë burimi dhe fillimi i të gjitha koncepteve të sotme komuniste, anarkiste dhe socialiste”. Diskutoni mbi thënien e Princit Pjetër Kropotkini, një studiues rus.</i>	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg. Historia politike e Revolucionit Francez, A. Aulard.

56	Kongresi i Vjenës dhe restaurimi i Europës pas Napoleonit	Përshkruan fazat e fundit të Revolucionit Francez dhe rënien e sistemit republikan. Evidenton karakterin ekspansionist të shtetit francez nën drejtimin e Napoleon Bonapartit dhe krijimin e Perandorisë Franceze. Argumenton karakterin restaurues të vendimeve të Kongresit të Vjenës.	Historiani A.Bopp, në librin e tij “Napoleoni dhe shqiptarët”, tregon dhe për marrëdhëniet e Napoleonit me Ali Pashën. Megjithatë, fakte të reja tregojnë se Napoleoni i vlerësonte shqiptarët dhe tregonte një interes të veçantë për pozicionin gjeografik e strategjik të Shqipërisë. Madje, për një periudhë mjaft të shkurtër, vetëm në muajin qershor 1806, ekzistojnë shumë letra të shkruara prej Napoleonit rreth Shqipërisë. Si e komentoni ju këtë lidhje me shqiptarët?	Vlerësim individual	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg. Ditari sekret i Napoleon Bonapartit, Patrik Ravinjan
57	Rusia dhe kryengritja serbe për shërbime nga Perandoria Osmane. Panslavizmi	Vë në dukje përpjekjet e popullit serb për shërbime nga Perandoria Osmane. Evidenton rolin kyç të Rusisë si mbrojtëse e lëvizjes serbe për shërbime. Shpjegon konceptin e panslavizmit dhe analizon idetë kryesore të tij.	Rusia është cilësuar përherë si “nëna” e sllavëve të Ballkanit. A mund të sillni mendime, të mbështetura në fakte, lidhur me këtë pohim?	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Interneti Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg. Teksti mësimor
58	Kryengritja greke, roli i Fuqive të Mëdha në fitoren e Pavarësisë dhe ndërtimin e shtetit	Vë në dukje centralitetin e idesë së ortodoksizmit në përpjekjet për shërbime të popujve ballkanikë dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në Ballkan. Tregon rolin e shoqërisë Filiki Eteria në organizimin e kryengritjes greke dhe zhvillimin e saj.	Është fakt, tashmë nuk mund të diskutohet, edhe pse deri tani pjesërisht ishte fshehur që 90 ndër 100 heronjtë e kryengritjes së vitit 1821 ishin arvanitas. Diskutoni rreth pjesëmarrjes së arvanitasve në Kryengritjen Greke të vitit 1821.	Vlerësim individual	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
59	Çështja shqiptare dhe qëndrimi i Perandorisë Osmane	Vë në dukje përpjekjet e shqiptarëve për shërbime nga Perandoria Osmane pas rënies së pashallëqeve. Evidenton qëndrimin e shtetit osman ndaj shqiptarëve dhe çështjes shqiptare.	Çfarë ju kujtojnë këto figura historike: Mustafa Pashë Bushatliu, Omer Pashë Vrioni, Iliaz Bej Vlora?	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
60	Shqiptarët dhe Tanzimatit (1839-1879)	Shpjegon thelbin e Tanzimatit dhe domethënien e tyre për shqiptarët. Tregon përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për përparimin e çështjes shqiptare me theks të veçantë në përhapjen e arsimit dhe të kulturës.	Në reformat e Tanzimatit, edhe pse u tha se garantohej barazia mes kombeve, shqiptarët nuk u trajtuan si komb më vete, por si turq, latinë e grekë. Si mendoni ju, pse këtij populli nuk iu lejua të krenohet me prejardhjen?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Shqipëria dhe tanzimatit, Zana Lito Historia e Popullit Shqiptar Interneti

61	Përsëritje 7	Identifikon thelbin e ideologjive nacionaliste greke dhe serbe.	Rikujtoni konceptet: “Megali Idea” dhe “Naçertania”. Diskutoni rreth thelbit të tyre.	Vlerësim individual	Shqipëria dhe tanzimati, Zana Lito.
62	Fuqizimi i nacionalizmave ballkanikë	Gjykon mbi ndikimin e tyre në zhvillimin e çështjes shqiptare që nga shek. XIX e deri sot.	Nacionalizmi shqiptar është shfaqur me Rilindjen Kombëtare, e cila ishte një lëvizje kulturore e politike për formimin dhe përhapjen e vetëdijes kombëtare shqiptare dhe për themelimin e një shteti kombëtar. Po sot si shfaqet nacionalizmi te shqiptarët?	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia e Popullit Shqiptar Interneti
63	Nacionalizmi shqiptar dhe përjekjet e para për organizim	Evidenton reagimin e Perandorisë Osmane ndaj nacionalizmit në Ballkan në mesin e shek. XIX dhe veçoritë e nacionalizmit shqiptar. Dallon rreziqet me të cilat përballëshin viset shqiptare në raport me fqinjët dhe përjekjet e nacionalistëve shqiptarë për t'u bërë atyre ballë.	Traktati i Shën-Stefanit nuk e zinte fare në gojë Shqipërinë, e cila për Rusinë nuk ekzistonte si subjekt të drejtash politike. Sipas Traktatit të Shën-Stefanit, gati gjysma e trojeve shqiptare u jepej shteteve sllave ballkanike. Si ndikoi ky Traktat në zgjimin e shqiptarëve?	Vlerësim individual	Teksti mësimor
64	Kërcënimi rus në Ballkan, Perandoria Osmane dhe Kongresi i Berlinit	Shpjegon thelbin e Krizës Lindore dhe ndikimin e luftërave ruse-turke në dobësimin progresiv të Perandorisë Osmane. Evidenton vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, të imponuara nga Fuqitë e Mëdha mbi Perandorinë Osmane.	Ditën kur u hap Kongresi i Berlinit, më 13 qershor 1878, qytetarët shkodranë i drejtuan ministrin të jashtëm britanik, lordit Bikonstfid, një memorandum me një përmbajtje të lartë patriotike. Aty thuhej midis të tjerave: “Shqipëria nuk mund të përfaqësohet nga qeveria osmane. Shqiptari, qoftë katolik, qoftë ortodoks, qoftë mysliman, e urren aq pushtuesin turk sa edhe çdo pushtues tjetër të huaj. Porta e Lartë e ka mundur por jo nënshtruar Shqipërinë...”	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia e Popullit Shqiptar Interneti
65	Reagimi shqiptar-Lidhja e Prizrenit	Evidenton situatën dhe rreziqet për trojet shqiptare pas Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit. Analizon zhvillimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ballafaqimin e qëndrimeve të drejtuesve të saj dhe rëndësinë e kësaj ngjarje.	“Vetëm mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës mund ta çojnë atdheun në mesin e vendeve të qytetëruara”. Diskutoni për thënien e Naum Veqilharxhit.	Vlerësim individual	Lidhja e Prizrenit, K. Frashëri
66	Dokumente themelore të nacionalizmit shqiptar	Argumenton rëndësinë e veprave të rilindësve shqiptarë për njohjen dhe projektimin e çështjes shqiptare. Interpreton vizionin e rilindësve për të ardhmen e një Shqipërie të pavarur.	Komentoni vargjet: “Lumja ti moj Korça, lule, që i le pas shoqet e tua! Si trimja në ballë u sule, ta paçim përjetë hua!	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Teksti mësimor
67	Përjekjet shqiptare për afirmimin e gjuhës dhe kulturës kombëtare	Evidenton përjekjet e shqiptarëve për përhapjen e gjuhës shqipe, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Përkshkruan procesin e krijimit të alfabetit të shqipes deri në Kongresin e Manastirit.			

68	Perandoria Osmane, Austro-hungareze dhe Ruse në fillim të shek. XX.	Evidenton arsyet pse Ballkani ishte vend i përplasjeve mes interesave të Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane. Argumenton synimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike për rregullimin gjeopolitik të Ballkanit pasosman.	"Në çdo 10 nëntor, ora e Turqisë ndal disa sekonda në nderim të Ataturkut, që vdiq në vitin 1938." Diskutoni përmes kësaj thënie rëndësishme e Ataturkut në krijimin e shtetit turk.	Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar
69	Luftërat Ballkanike dhe Pavarësia e Shqipërisë	Shpjegon raportet dhe ekuilibrat mes shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane në fillim të shek. XX. Përshkruan shkaqet dhe zhvillimin e Luftës I Ballkanike dhe ndikimin e saj në ngjarjet që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.	"Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/1912 pas fjalëve që tha z. Kryetar Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria më sot të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme". Reflektoni mbi rëndësinë e këtij dokumenti	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Interneti
70	Përsëritje 8.				Lidhja e Prizrenit, K. Frashëri
71	Ese historike 1: 1. <i>Rrugëtimi i Pavarësisë së Shqipërisë</i> 2. <i>Konferenca e Ambasadorëve të Londrës dhe roli i saj në krijimin e shtetit shqiptar</i> 3. <i>Gjuha kombëtare – gurë themeli për vazhdimësinë e një kombi</i>	Vlerëson rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Argumenton mbi rolin e Kuvendit të Vlorës në krijimin e institucioneve të para drejtuese. Diskuton rolin e KAL në përcaktimin e kufijve të shtetit shqiptar. Analizon rëndësinë e zhvillimit të gjuhës për të qytetëruar një komb.	Ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë përfaqëson fitoren e përbashkët të të gjitha trevave shqiptare prej Rrafshit të Dukagjinit në veri e deri në Çamëri në jug, prej brigjeve të Adriatikut e të Jonit në perëndim e deri në fushat e Kosovës, të Tetovës, në pellgun e Shkupit, në luginën e Preshevës e të Kumanovës, në lindje.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor

TEMATIKA V. PERIUDHA BASHKËKOHORE(1919-DERI MË SOT) (65 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (34 ORË) PËRSËRITJE (3 ORË) TESTIME NJOHURISH (1 ORË) ESE HISTORIKE (1 ORË) VLERËSIM I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT (2 ORË) VIZITË STUDIOMORE (24 ORË)				
72	Lufta e Parë Botërore dhe Paqja e Versajës	Evidenton parimet themelore të pranuar nga Konferenca e Versajës për ravijëzimin e hartës së re politike. Analizon rrjedhjat që sollën shpërbërjet e Perandorive të Mëdha (Habsburgase, Osmane dhe Ruse). Pasqyron hartën e re politike të Europës pas Paqes së Versajës.	Vrasja e Franz Ferdinand dhe gruas së tij Sophie, Dukesha e Hohenberg, ndodhi më 28 qershor 1914 në Sarajevë kur ata u plagosën nga Gavriilo Princip. Vrasja solli drejtpërdrejt në Luftën e Parë Botërore, kur Austria-Hungaria më pas lëshoi një ultimatum për Mbretërinë e Serbisë, e cila u refuzua pjesërisht. A mund të parandalohej LIB?	Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
73	Rinjohja e shtetit të pavarur shqiptar dhe përcaktimi i kufijve të tij	Përshkruan ecurinë e procesit të njohjes së shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në Konferencën e Paqes dhe atë të Ambasadorëve në Paris. Arsyeton mbi rëndësinë e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe ndikimin që ajo pati në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris.	Presidenti U. Uillson ka qenë një mik i përhershëm i shqiptarëve. Ka mbetur prej tij shprehja e jashtëzakonshme “një votë kam, edhe atë do t’ia jap Shqipërisë”. Diskutoni mbi rëndësinë që kishte Shqipëria asokohe, një shtet i vogël, për një Fuqi të Madhe si SHBA.	Historia e Popullit Shqiptar
74	Aspekte të organizimit dhe të konsolidimit të shtetit shqiptar (1920-1939)	Evidenton organizimin e shtetit shqiptar në vitet 1912-1914. Ballafaqon statutet e viteve 1920-1939 dhe shpjegon ecurinë e ndryshimeve në to. Dallon elemente të ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit kombëtar në Shqipërinë e viteve 1920-1939.	Vitet 1920-1939, përbëjnë një periudhë intensive në përpjekjet për ndërtimin e shtetit shqiptar Cilën ngjarje veçoni nga ajo kohë? Përse?	Interneti Teksti mësimor

75	Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të europianizimit të saj (1920-1939)	Tregon elementet e qytetërimit Perëndimor në hartimin e legjislacionit shqiptar (kode), në ndërtimet publike dhe në jetën e përditshme. Evidenton përpjekjet për emancipimin e gruas dhe të shoqërisë shqiptare. Evidenton ndarjen e shtetit nga feja si një nga parimet bazë të shtetit modern. Analizon masat dhe përpjekjet e shtetit shqiptar për të reformuar jetën e komuniteteve fetare në Shqipëri.	Lordi Donogal i Britanisë bëri një udhëtim nëpër Shqipëri në vitin 1938. Në shkrimin e tij, në gazetën "Sunday Dispatch" ai shprehu habinë e madhe që kushtet e jetesës ishin shumë më të mira se ajo që ishin raportuar më parë. Rugët ishin më të gjera se të Jugosllavisë. Qytetarët ishin të veshur mirë dhe të sjellshëm. Në Tiranë kishte hotele të klasit të parë, ushqim të mirë, dyqane me parfume, filma për aparatet e tij fotografik Laika dhe orëndreqës të mirë. Ai u shpreh pozitivisht për aeroportin e Tiranës, për gratë e çliruara nga perçja, për qytetin-port të Durrësit dhe së fundmi për sjelljen dashamirëse të njerëzve.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues	Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U Lakër
76	Interesimi i shtetit amë për shqiptarët jashtë kufijve (1920-1939)	Analizon përpjekjet e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene/Jugosllavi dhe në Greqi. Evidenton përpjekjet e shtetit shqiptar për të penguar shkëmbimin e popullsisë shqiptare nga Greqia dhe Jugosllavia drejt Turqisë. Evidenton përpjekjet e shtetit amë për mbështetjen e diasporës shqiptare.	Në Lidhjen e Kombeve, më 17 dhjetor 1920, të huajt dëgjuan një orator burri, fjala e të cilit ra si bombë, sikurse thotë haptas "Daily Telegraph-i". Dhe përfaqësuesi i 400 milionë kinezëve që dëgjonte me vëmendje Nolin e një milion shqiptarëve duke mos ditur se ç'popullsi ishim ne, e pyeti Nolin: - A s'më thoni hirësi, ç'popullsi përfaqësoni? - Noli i përgjigjet: - Një milion, por mos harroni se janë një milion shqiptarë. Vlerësoni figurën e Nolit.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues	Historia e Popullit Shqiptar Shqiptarët, E. Jacques Interneti Teksti mësimor
77	Krijimi i Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene/Jugosllavisë si shtet shumetnik	Evidenton momentet kryesore në krijimin e shtetit jugosllav si shtet shumetnik. Dallon tipare të jetës ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi. Gjykon mbi pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi.	Kujtohet roli i familjes së Karagjorgjeviçëve dhe Rusisë në krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene		Historia e Ballkanit, G. Castellan

78	Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhjat e saj në Ballkan	Vë në dukje momentet kyç të krizës ekonomike botërore. Analizon ndikimet që kriza ekonomike botërore pati në ekonominë dhe në politikën shqiptare dhe ballkanike.	Dërgesat e emigrantëve, sidomos e atyre nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përbënin një zë të konsiderueshëm në ekonominë shqiptare. Para krizës ekonomike, emigrantët dërgonin mesatarisht 10 milionë franga ari në vit. Gjatë krizës, ata dërgonin më pak se 4 milionë franga, çka dobësoi më shumë fuqinë blerëse e paguese të detyrimeve fiskale nga ana e familjeve shqiptare. Lidhni ngjarjet ndërkombëtare me ato kombëtare.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Europa në kohën tonë, U. Lakër
79	Fuqitë e Mëdha dhe bashkëpunimi Ballkanik – Konferencat e viteve '30	Dallon ndikimin që Fuqitë e Mëdha patën në Ballkan në periudhën midis dy luftërave botërore. Analizon paktin Kellog-Briand, duke evidentuar ndikimin që pati ai në bashkëpunimin ballkanik. Përshkruan disa nga vendimet e Konferencave Ballkanike të viteve '30. Evidenton qëndrimin që shteti shqiptar mbajti ndaj këtyre vendimeve.	Kujtoni interesin e shprehur nga shtetet perëndimore (Itali, Francë, Angli) mbi shtetin shqiptar pa Luftën së Parë Botërore. Cila prej tyre përbënte një rrezik serioz për vendin tonë, asokohe?	Historia e Popullit Shqiptar Interneti	Historia e Popullit Shqiptar Interneti
80	Përsëritje 9			Teksti mësimor	Teksti mësimor
81	Ideologjitë totalitare dhe Ballkani	Përshkruan gjendjen politike të Ballkanit në vitet '20-'30. Shpjegon bazën ideologjike të sistemeve autoritare në Ballkan. Analizon ndikimin e ideologjisë komuniste në vendet e Ballkanit.	Franca krijoi më 1920 të ashtuquajturën "Antanta e Vogël" - Praga, Beograd, Bukureshti- e emërtuar me lajkë si "Cordon sanitaire" i Europës Juglindore, do të duhej ta mbronte Europën Juglindore si nga Perandoria gjermane, ashtu edhe nga Rusia bolshevike. Diskutoni për interesin francez mbi Ballkanin.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U. Lakër Historia e Popullit Shqiptar
82	Ravijëzimi i blloqeve ndërluftuese dhe momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore	Identifikon blloqet kundërshtare të Luftës së Dytë Botërore. Evidenton procesin e formimit të Boshtit dhe të Aleancës së Kombeve të Bashkuara dhe shpjegon karakteristikat e secilit prej tyre. Përshkruan momentet më kryesore të Luftës së Dytë Botërore.	Gjykoni mbi informacionin: Më 1938, kur kryeministri i Britanisë, Neville Chamberlain, u kthye nga Munihu për të shpallur "paqen në kohën tonë" Winston Churchill denoncoi në mënyrë të famshme vendimin që Britania dhe Franca sapo kishin marrë. "Juve ju dha të zgjidhni mes luftës dhe turpit, - tha ai. - Ju zgjidhët turpin dhe ju do të keni edhe luftën."	Vlerësim për të nxënëit informues	Interneti Teksti mësimor Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U. Lakër

83	Përpjekjet për shmagjen e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit italian të Shqipërisë	Evidenton ecurinë e marrëdhënieve shqiptaro-italiane në prag të pushtimit të Shqipërisë. Shpjegon tentativat e A. Zogut në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për të shmangur pushtimin italian. Evidenton reagimin e shqiptarëve në prag të pushtimit të Shqipërisë nga Italia e Musolinit.	“...Në botën e jashtme, pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste u dënua përgjithësisht prej opinionit të popujve lindashës, por nuk gjeti ndonjë kundërshtim prej qeverive. Lidhja e Kombeveve s’e ngriti zërin fare; Anglia dhe Jugosllavia e pranuan si një punë të kryer. Kjo e fundit u kënaq me premtimin e Duce-s që Italia nuk do të përqëndronte forca ushtarake në kufirin shqiptar-jugosllav dhe nuk do t’interesohej fare për Shqiptarët e Kosovës. Sa për Greqinë, ajo u përpoq të mos i jepte asnjë shkak zemërimi Italisë. Vetëm Shtetet-e-Bashkuar të Amerikës u shprehën kundër. Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme, Cordell Hull, në një deklaratë që bëri më 8 Prill, e dënoi sulmin e përdhunë fashist si një kërcënim për paqen...”	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia e Popullit Shqiptar
84	Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar	Analizon diferencat mes pushtimit italian dhe atij gjerman në lidhje me organizimin e brendshëm të Shqipërisë. Analizon qëndrimet e autoriteteve pushtuese ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë e në Çamëri dhe evidenton arsyet e këtyre qëndrimeve. Shpjegon reagimin e shqiptarëve të Kosovës e të Çamërisë ndaj pushtuesve, duke diferencuar rrymat e ndryshme politike në gjirin e tyre.	Keni mësuar se gjatë Luftës së Dytë Botërore, një numër jo i pakët shqiptarësh, e midis tyre shumë intelektualë, bashkëvepruan me pushtuesit. Pse ndodhi ky bashkëpunim, sidomos në radhët e intelektualëve?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Interneti Teksti mësimor. Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U. Lakër
85	Rezistenca shqiptare kundër Boshtit, si pjesë e luftës së Aleatëve të Kombeve të Bashkuara	Vë në dukje vendin e rezistencës shqiptare në kuadrin e rezistencës europiane kundër Boshtit. Evidenton qëndrimin e Aleatëve të Mëdhenj ndaj rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Analizon rolin e misioneve të Aleatëve të Mëdhenj në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore.	Diskutohet pyetja kyç: Si e kanë ndikuar dhe e ndikojnë rrjedhën e së ardhmes së Shqipërisë zhvillimet politike të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri?	Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar Interneti

86	Lëvizjet e rezistencës në Ballkanin Perëndimor (Jugosllavi dhe Greqi)	Tregon situatën në Ballkanin Perëndimor pas pushtimit të saj nga Gjermania e Hitlerit. Evidenton grupet kryesore të rezistencës në Jugosllavi dhe në Greqi dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Identifikon përpjekjet për bashkëpunim të rezistencës në Shqipëri me atë në Greqi dhe në Jugosllavi.	Reflektoni: Në vendet e Ballkanit u vu re një ndarje e forcave ndërluftuese. Mungesa e bashkëpunimit mund të cilësohet si një arsye e pushtimit të zgjatur të Ballkanit nga pushtuesit nazi-fashistë.	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Teksti mësimor Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U. Lakër
87	Diplomacia e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946	Evidenton rëndësinë e Kartës së Atlantikut dhe parimeve të saj në nxitjen e rezistencës antifashiste. Analizon vendimet e konferencave kryesore të Aleatëve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës dhe shpjegon ndikimin e tyre në botën e Pasluftës. Evidenton ndryshimet dhe ngjashmëritë në planet e Aleatëve të Mëdhenj për botën e Pasluftës.	Prezantohen emrat e “Tre të Mëdhenjve”, duke nxitur në klasë diskutim rreth rolit të secilit prej tyre gjatë LUIB. Thëksi vihet te Konferencat e organizuara gjatë luftës, me qëllim vendosjen e paqes.		Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor Historia e Ballkanit, G. Castellan
88	Fillimet e Luftës së Ftohtë	Përshkruan ndarjen politiko-ideologjike të Europës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Dallon bazën e doktrinave të palëve kundërshtarë të Luftës së Ftohtë dhe vë në dukje momentet që shënojnë fillimin e Luftës së Ftohtë. Ballafaqon përplasjen e interesave të ish-Aleatëve të Luftës së Dytë Botërore në Europë, si dhe tregon ngjarjet fillestare të këtyre përplasjeve.	Pas LUIB, SHBA dhe BS nisën të kërkojnë dominim ndërkombëtar dhe, ndërkohë që kishte aguar tashmë epoka bërthamore, ato ndërtuan, testuan dhe magazinuan armë bërthamore shumë të fuqishme, që mund të shkatërronin botën. Konflikti, pa një veprim total ushtarak, mori emrin Lufta e Ftohtë, një term që ndoshta është pagëzuar prej një artikulli të vitit 1945 të Xhorxh Oruellit, për të përshkruar një konfrontim ideologjik mes dy fuqive. Diskutoni mbi këtë përplasje ideologjike, ekonomike dhe ushtarake.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Europa në kohën tonë, U. Lakër

89	Krijimi i Bllokut Perëndimor	Evidenton ndryshimin e fuqisë dhe balancave mes shteteve të Europës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore. Vë në dukje gjendjen e vështirë të pasluftës në Europë, përpjekjet për tejkalimin e saj dhe nevojën për krijimin e një aleance politiko-ushtarake transatlantike. Argumenton nevojën për një proces integrimi mes vendeve Perëndimore si kundërpeshë kundrejt rrezikut sovjetik.	Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar
90	Shqipëria dhe marrëdhëniet me Perëndimin	Tregon raportet e diferencuara të Shqipërisë me Aleatët e Mëdhenj antifashistë menjëherë pas luftës. Analizon qëndrimet e anglo-amerikanëve ndaj qeverisë shqiptare, e drejtuar nga Enver Hoxha, dhe kërkesat e tyre për legjitimimin e sistemit me anë të zgjedhjeve të lira. Evidenton arsyet e prishjes së marrëdhënieve të qeverisë komuniste shqiptare me Britaninë e Madhe dhe SHBA-së.	Vlerësim për të nxënit informues	Interneti Teksti mësimor. Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U. Lakër
91	Krijimi i Bllokut Lindor	Përkrahet vendin që zinte Europa Lindore dhe Qendrore në synimet gjeostrategjike të Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore. Shpjegon taktikat dhe rrugët e përdorura nga Bashkimi Sovjetik për vendosjen e regjimeve komuniste në Europën Lindore. Përcakton arsyet e krijimit të KNER-it dhe Traktatit të Varshavës, si mekanizmat kryesorë të kontrollit sovjetik mbi vendet e Europës Lindore.	Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar Interneti

92	Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948)	Shpjegon rolin e emisarëve jugosllavë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Analizon format dhe metodat e përdorura prej jugosllavëve për vendosjen e kontrollit të tyre në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948. Argumenton rolin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.	Përmendet Mbledhja e Mukjes. Renditen vendimet dhe më pas arsyet e anulimit. Hidhet tema për diskutim: A u shit Kosova me anulimin e Mbledhjes së Mukjes?	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues	Teksti mësimor Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U Lakër
93	Shqipëria dhe BRSS (1948-1961)	Evidenton rolin e BS-së në raport me Shqipërinë gjatë viteve 1945-1953. Tregon ndryshimet e ndodhura në BS pas vdekjes së Stalinit dhe shpalosjes së Kursit të Ri të Hrushovit, duke evidentuar ndikimin e tyre në politikën shqiptare. Shpjegon zhvillimet në Konferencën III të PPSH-së për Tiranën dhe gjykon mbi domethënien e saj për të ardhmen e Shqipërisë.	Jepni mendimet tuaja: Pse u lidhën marrëdhëniet me BS? Pse këto marrëdhënie morën rrjedhë tjetër pas vdekjes së Stalinit?	Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar Interneti
94	Marrëdhëniet ndërmjet dy blloqeve	Shpjegon rrjedhojat e përplasjes mes blloqeve në arenën ndërkombëtare dhe vë në dukje momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë. Arsyeton mbi konfliktin në fushën ideologjike mes blloqeve dhe pasqyrimin e tij nëpërmjet propagandës. Analizon ecurinë e marrëdhënieve mes dy superfuqive, konceptin e “detantës” dhe zbatimin e saj në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.	Shfaqet në video-projektor imazhi “The red iceberg”, i një autori të panjohur. U kërkohet nxënësve të interpretojnë imazhin, si parahyrje e mësimi të ri.	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues	Teksti mësimor Historia e Ballkanit, G. Castellan Europa në kohën tonë, U Lakër
95	Përsëritje 10				
96	Testim njohurish për periudhën e dytë			Vlerësim individual	

97	Vlerësim i portofolit të të nxënit 2			Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	
----	--	--	--	---	--

ORA	PLANIFIKIMI MËSIMOR PËR PERIUdhËN E TRETË (PRILL - QERSHOR)				
	TEMA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT	SITUATA E TË NXËNIT	VLERËSIMI	BURIMET
TEMATIKA V: PERIUdHA BASHKEKOHORE (1919-DERI MË SOT) (65 ORË GJITHSEJ) NJOHURI TË REJA (34 ORË) PËRSËRITJE (3 ORË) TESTIME NJOHURISH (2 ORË) VLERËSIM I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT (2 ORË) VIZITË STUDIIMORE (24 ORË) NË KËTË PERIUdhË ZHVILLOHEN NGA KJO TEMATIKË: NJOHURI TË REJA (12 ORË) PËRSËRITJE (1 ORË) TESTIM NJOHURISH (1 ORË) VLERËSIM I PORTOFOLIT (1 ORË) VIZITË STUDIIMORE (24 ORË)					
98	Kina brenda dhe jashtë blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë	Evidenton situatën në Kinë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, marrjen e pushtetit nga komunistët dhe rolin e Kinës në Bllokun Lindor të udhëhequr nga BS-ja. Evidenton veçantitë e komunizmit kinez. Shpjegon marrëdhëniet kineze-sovjetike, duke dalluar fazat e ndryshme deri në prishjen e tyre.	Nxënësve u shfaqen imazhe të “tank man = njeriut tank”, i cili është bërë simbol i protestës antikomuniste në sheshin Tian an Men në vitin 1989. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këtij simboli.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbërg Historia e Popullit Shqiptar Interneti
99	Shqipëria dhe Kina	Analizon raportet shqiptaro-kineze dhe identifikon arsyet e forcimit të tyre, sidomos në vitet ‘60 të shek. XX. Vë në dukje bashkëpunimin ekonomik dhe ndihmën kineze për zhvillimin e Shqipërisë. Shpjegon reflektimin e Revolucionit të Madh Kulturor kinez në Shqipëri.	Në videoprojektor shfaqet kronika e shkurtër në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-kineze gjatë komunizmit, sipas gazetës New York Times. https://www.youtube.com/watch?v=YZYXXpYtPg Bëhet një diskutim i shkurtër rreth materialit audio-vizual.	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Teksti mësimor
100	Zhvillimet brenda blloqeve - Blloku Lindor	Shpjegon format dhe instrumentet e kontrollit të Bllokut Lindor nga ana e BS-së, duke dalluar mes atyre politike, ekonomike dhe ushtarake. Analizon pasqyrimin e liberalizimit hrushovian dhe të restaurimit brezshnjëvian në situatën e brendshme të vendeve anëtare të Bllokut Lindor.	KNER dhe Traktati i Varshavës u krijuan me iniciativën e BS dhe dominuan Bllokun Lindor pas LIIB. Si i gjykoni ju: Si organizma që duan t’i kundërvihen demokracisë apo si mekanizma për të rritur influencën e Moskës? Diskutoni.	Vlerësim për të nxënëit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbërg Historia e Popullit Shqiptar Interneti
101	Zhvillimet brenda blloqeve – Blloku Perëndimor	Evidenton arsyet e zhvillimit të shpejt ekonomik-shoqëror të Europës Perëndimore në periudhën e pasluftës. Tregon tensionet ekonomiko-shoqërore në Europën Perëndimore, SHBA dhe shpjegon përpjekjet për kapërcimin e tyre	Vendosen në tabelë imazhet e tre figurave të njohura historike: Margaret Theçerit, Martin Luter King dhe Xhorxh Marshall. Nxënësve u drejtohen këto pyetje: 1. Kush janë këto figura historike? 2. Cila është pesha që ata mbajnë në historinë e Bllokut Perëndimor?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Teksti mësimor

102	Tipare të artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në dy blloqet kundërshtare	Krahason rolin e njerëzve të artit, kulturës e shkencës në shoqërinë e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor. Analizon rolin e arsimit në vendet e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor, duke evidentuar diferencat e mundshme mes tyre.	Dëgjohet kënga "The wind of change". https://www.youtube.com/watch?v=V022x8XYc8 Disa fraza të saj shkruhen në tabelë dhe hapet diskutimi: Si mund të ndikojë muzika në emancipimin social?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbreg Historia e Popullit Shqiptar Interneti
103	Vetizolimi i Shqipërisë	Shpjegon arsyet e thellimit të izolimit ndërkombëtar të Shqipërisë nga fundi i viteve '70 të shek. XX. Analizon karakterin autarkik të shtetit komunist dhe pasojat e vetizolimit në jetën dhe ekonominë e vendit. Vë në dukje ndikimin e vetizolimit në krizën e gjithanshme të regjimit komunist.	Shfaqen dy imazhe: 1. "Radha për ushqime në dyqane" 2. "Tollon" Nxiten nxënësit për diskutim përmes pyetjes: Si e përcjellin vetizolimin e Shqipërisë komuniste këto imazhe?	Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim individual	Teksti mësimor Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbreg
104	Përfundimi i Luftës së Ftohtë	Përshkruan konkurrencën e gjithanshme mes blloqeve në periudhën e pasluftës.	"Sekretari i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqen, nëse kërkon begatinë për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, nëse kërkon liberalizimin: Eja këtu, te kjo portë! Z. Gorbaçov, hape këtë portë! Z. Gorbaçov, shembe këtë mur!"	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim individual	Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
105	Përfundimi i Luftës së Ftohtë	Gjykon mbi rolin e lëvizjeve kundër regjimeve komuniste në liberalizimin relativ të disa prej vendeve të Bllokut Lindor. Vlerëson ardhjen në krye të BS-së të Mikhail Gorbaçovit dhe frymën reformiste të sjellë prej tij në BS dhe në Bllokun Lindor në përgjithësi. Analizon arsyet e rënies së Bllokut Lindor dhe të përfundimit të Luftës së Ftohtë.	Ky është një fragment nga fjalimi që presidenti amerikan Ronald Reagan mbajti në Berlin më 12 qershor 1987.	Vlerësim për të nxënësit informues Vlerësim individual	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbreg Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
106	Karakteristikat e tranzicionit në vendet ish-komuniste	Evidenton situatën e re me të cilën u përballën qytetarët e vendeve të Bllokut Lindor në fillimet e periudhës së tranzicionit. Tregojnë rrugët dhe format e ndryshme për zhvillimin ekonomik dhe për kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë. Gjykon rreth aspekteve pozitive dhe negative të tranzicionit mbi shoqëritë e vendeve ish-komuniste.	NATO dhe Traktati i Varshavës funksionuan gjatë Luftës së Ftohtë, për t'iu kundërvënë njëra-tjetrës. Përse NATO është ende një organizatë e fuqishme, ndërsa Traktati i Varshavës është shpërbërë?	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimbreg Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor

107	Shqipëria në tranzicion	Shpjegon karakterin dhe natyrën e tranzicionit shqiptar drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Analizon tiparet e transformimit ekonomik-shoqëror të Shqipërisë gjatë tranzicionit. Gjykon mbi arritjet dhe dështimet e tranzicionit në Shqipëri.	Termi “tranzicion” na shoqëron prej më shumë se 25 vitesh. Si e përjetoni ju tranzicionin shqiptar?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg
108	Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi	Evidenton nismat për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Analizon arkitekturën dhe efektivitetin e procesit të integritetit të vendeve ish-komuniste në Europën e Bashkuar. Gjykon mbi pikat e forta dhe të dobëta të Bashkimit Europian dhe të debatit për të ardhmen e tij.	BE është një aktor i rëndësishëm ndërkombëtar. Aktualisht BE është në proces zgjerimi. Anëtarësimi në BE ka kundërshtarët dhe mbështetësit e tij. Ju çfarë qëndrimi mbani?	Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues	Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor
109	Ndryshimet që solli teknologjia	Vlerëson rolin e shkencës dhe të teknologjisë në jetën shoqërore dhe ekonomike bashkëkohore. Gjykon mbi pasojat pozitive dhe negative të teknologjisë sidomos në lidhje me rininë.	Shkenca dhe teknologjia e ka ndryshuar jetën shoqërore sidomos përgjatë viteve të fundit. Arritjet kanë efektin e vet pozitiv dhe negativ. Sipas jush, cila arritje apo shpikje teknologjike e ka transformuar më tepër jetën e njerëzve?	Vlerësim për të nxënëit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg Historia e Popullit Shqiptar Interneti
110	Përsëritje 11			Vlerësim individual	Interneti
111	Ese historike			Vlerësim diagnostikues	Teksti mësimor

112-135	Jeta në kampet e punës, internimit dhe burgjet në Shqipëri gjatë regjimit komunist, 1945-1990. (vizitë studimore në vendet e kujtesës) 24 orë mësimore	Përforcon njohuritë për periudhën në studim. Angazhohet në kryerjen e detyrës në mënyrë praktike dhe të kënaqshme. Shoqërizohet, duke qenë më pranë shoqeve/shokëve/mësueses/it. Eksponon veten gjatë procesit të vizitës studimore. Zhvillon kuriozitetin për të panjohurën. Kupton rëndësinë e ruajtjes së vendeve të kujtesës si dëshmi historike.	E nisim me rrëfim. Shkëputet një pjesë nga libri i Gjetë Vocaj "Takim fatal me diktatorin". "Unë isha në të njëjtin kabanon me 180 veta. Shtretërit ishin dykatësh dhe dita-ditës ne ngjesheshim me njëri-tjetrin. Përgjegjësi i kabanonit na përcaktonte vizën se deri ku duhet të shtriheshim, derisa nisëm që të flinim në brinjë". Kjo gjë ka qenë shumë e tmerrshme. Ushqimi ishte i përcaktuar. "Ka qenë gjenocid më vete kjo pjesë. Përditë vdisnin njerëz. Ndërsa, ata mendonin: Një armik më pak". Ushqimi ndahej në mënyrë të tillë, që të burgosurve t'ua merrte shpirtin dalëngadalë. "Burgje ka pasur dhe ka në të gjithë botën, por burgu komunist dhe kampet e përndarimit në Shqipëri kanë thyer rekorde në shfarosje. Atë pjesë, që kishte pak forcë fizike, i fusnin nëpër miniera që të punonin. Ndërsa, pjesën tjetër, që ishin më të fuqishëm, i çonin në vende të tjetra. "Për mëngjes kishim lëng me ujë të nxehtë; që i hidhnin brenda bishta qepësh. Ndërsa, të gjithë kazanit i hidhnin një dorë oriz dhe kripë. Në drekë ishte e njëjta gjë, vetëm se nuk i hidhnin oriz, por makarona. Për në darkë vetëm çaj pa sheqer". Hapet diskutimi dhe jepen idetë e para lidhur me vizitën studimore.	Vlerësim për të nxënëit informues Vlerësim individual Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit informues	Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg Historia e Popullit Shqiptar Interneti Teksti mësimor. Takim fatal me diktatorin, GJ. Vocaj Enver Hoxha dhe diktatura staliniste në Shqipëri, B. Fischer Komunizmi përmes kumenteve arkivore: Represioni në periudhën e vetizolimit IDMC Burgjet dhe kampet e përqendrimit, K. Dervishi.
136	Vlerësim i portofolit të të nxënëit 3				

III. PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E PARË (SHTATOR-DHIJETOR)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla:VI	Klasa:XII
Tema mësimore: Historia dhe vlerat e saj		Situata e të nxënit	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton rëndësinë dhe vlerat e të mësuarit të historisë duke u ndalur në rëndësinë e historisë kombëtare. - Zgjedh shembuj të trajtimit të historisë me objektivitet ose subjektivitet dhe dallon ndryshimet midis dy trajtimeve.		Fjalët kyçe: histori, kulturë materiale, autorë antikë, koloni greke, Republika Romake, ilirë, barbarë, epirotë, kaonë, thesprotë, arbër, shqiptarë, epigrafi, numizmatikë.	
Burimet: teksti, interneti, harta e Ilirisë, Arkeologjia (Myzafer Korkuti), botime letrare si Iliada dhe Odiseja të Homerit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi - bashkëbisedim			
Si ora e parë e mësimi, zhvillonin një bisedë me nxënësit, ku të përdorni pyetje kyçe, të cilat do të përfshijnë secilin prej nxënësve dhe do t'ju japin një informacion paraprak me nivelin e tyre.			
Përqendrohuni te këto pyetje:			
1. Çfarë është historia?			
2. Cili autor antik cilësohet si “babai i historisë”?			
3. Keni lexuar ndonjë vepër letrare me subjekt historik? Nëse po, tregoni diçka rreth saj.			
4. Po ndonjë film me subjekt historik, ju kujtohet?			
Pasi është nxitur pjesëmarrja e sa më shumë nxënësve, mbyllet faza e parashikimit me pyetjen:			
• Si ndikon historia në jetën tonë?			
Kërkoju nxënësve që të shkruajnë mendimin në fletore (për ta krahasuar me mendimin final, pasi të jetë njohur edhe me njohuritë e reja).			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - ditari dypjesësh

Mësuesi/ja përdor në këtë fazë teknikën e ditarit dypjesësh. Tabela ndahet në dy pjesë dhe plotësohet sipas çështjeve të dhëna. Të njëjtën veprim e realizojnë edhe nxënësit në fletoren e tyre.

Çështja	Komenti
Fillesat e historisë	- Shkenca e historisë i ka fillesat 3 mijë vjet p.e.s, kohë e cila përkon me lindjen e shkrimit. Kjo e bën historinë shkencën më të vjetër, të krijuar nga shoqëria njerëzore. - Ajo është studimi i së kaluarës njerëzore, nëpërmjet dokumenteve të lëna nga shoqëria njerëzore. - Në evidentimin e historisë jep një ndihmë të madhe arkeologjia. Arkeologët, përmes zbulimeve të tyre, ndihmojnë në rindërtimin e aspekteve të ndryshme të shoqërisë njerëzore.

Zhvillimi i historisë	• Historia filloi një fazë të re me lindjen e qyteteve. Ishte koha kur shoqëria njerëzore pësoi transformime të mëdha, duke u zhvilluar dhe modernizuar. Tashmë fokusi i historianëve ishte: përshkrimi i ngjarjeve, vendeve, natyrës, besimit dhe traditave të popujve të ndryshëm. • Ndihmë për zhvillimin e historisë kanë dhënë studiuesit e saj. Historianët e parë dokumentohen në veprat e dijetarëve nga radhët e grekëve dhe romakëve të lashtë, si p.sh: Herodoti, Homeri, Aristoteli, Skylasi, Tit Livi, Polibi, Thukiditi e deri tek autorët e mesjetës. • Kontribut shumë të vyer në njohjen e shoqërive njerëzore dhe dokumentimin e të dhënave, shpesh kanë dhënë fushatat ushtarake, si p.sh. ato të Aleksandrit të Madh të Maqedonisë. Përmes pushtimeve, ai jo vetëm përhap kulturën helenistike, por u dha mundësi historianëve ta dokumentojnë atë.
Informacionet e para në lidhje me historinë e shqiptarëve	• Rreth 80 autorë antikë kanë shkruar të dhëna për pararendësit tanë, ilirët. Kështu ka nisur të shkruhet historia e një populli, i cili është krijuar si etnos rreth 2200-1200 vjet pr.e.s. • Informacionet e para lidhen me fiset ilire të kaonëve dhe thesprotëve, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në Luftën e Trojës. • Përveç historianëve antikë grekë e romakë, në shkrimin e historisë së shqiptarëve kanë dhënë kontributin e tyre historianët bizantinë, osmanë e së fundmi ata perëndimorë.
Burimet e informacionit për historinë e shqiptarëve	• Në listën e burimeve për njohjen dhe shkrimin e historisë rolin më të rëndësishëm e kanë dokumentet e shkruara, të cilat janë një informacion më i besueshëm për të kaluarën. Përveç tyre, një historian i shërbejnë: gërmimet arkeologjike, të dhënat antropologjike, gjuhësia, numizmatika, epigrafia, arkitektura, veglat e punës, stolitë etj. • Një historian ka një punë mjaft të vështirë, në shkrimin e historisë. Atij i duhet të përzgjedhë nga sasia e informacionit apo materialit me objektivitet dhe i pandikuar nga ndjenja të caktuara.

Faza e tretë: Përforsimi - punë me tekstin

Mësuesi/ja në këtë fazë i rikthehet tekstit, i cili bëhet i domosdoshëm për konsolidimin e njohurive. I fton nxënësit të vëzhgojnë ilustrimet në tekst për disa çaste e më pas t'u përgjigjen pyetjeve:

- Cila është lidhja e fotove të dhëna në tekst me historinë e shqiptarëve?
- Si mund të merrni informacion historik duke përdorur hartën e Ilirisë?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra: Ushtrimi 7, rubrika "vetëvlerësim", faqe 8.

Listoni burimet që hedhin dritë mbi historinë e popullit shqiptar nga parahistoria deri sot.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla:VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve		Situata e të nxënit: Në një intervistë, Robert Elsie do të shprehej kështu në lidhje me historinë e shqiptarëve: “Shqipëria nuk ka një traditë të gjatë shkrimi. Historia e Shqipërisë është e shkruar nga të huajt dhe jo nga shqiptarët, por ka shumë kujtesë kolektive në popullin shqiptar. Kjo kujtesë duhet shfrytëzuar sa jemi në kohë.”	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: Njihet me burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve. Evidenton autorë vendës dhe të huaj në shkrimin e historisë së shqiptarëve. Thekson rolin e rëndësishëm të burimeve arkivore, në shkrimin e historisë. Gjykon mbi domosdoshmërinë e botimeve bashkëkohore mbi historinë e popullit shqiptar.		Fjalët kyçe: maqedonë, thrakë, arkiv, studiues të huaj.	
Burimet: teksti, “Rrethimi i Shkodrës” (1505) dhe “Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut” të Marin Barletit, “Historia e popullit shqiptar”, botim i Akademisë së Shkencave viti 2000.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Qytetari.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI			
Përgatitja për të nxënit (10min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE			
Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI			
Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim			
Mësuesi/ja i fton nxënësit në një bisedë paraprake duke u lexuar “situatën e të nxënit”. Pas bisedës kalohet në zhvillimin e teknikës “pyetja sjell pyetjen”.			
1. Pse është e domosdoshme të shkruhet historia?			
2. Ku mund të mbështetesh për të shkruar historinë?			
3. Si ka ndryshuar mënyra e të konceptuarit të historisë si shkencë?			
4. Pse autorët antikë grekë dhe romakë kanë shfaqur interes për historinë ilire?			
Dëgjohen përgjigjet e nxënësve dhe bëhen plotësimet në rast nevojë.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i drejtuar dhe tabela konceptuale

Orientoju nxënësit në lexim të drejtuar për disa minuta. Gjatë kësaj kohe organizo tabelën konceptuale në dërrasën e zezë. Pasi nxënësit të kenë përfunduar leximin, duke u mbështetur në rubrikat e tabelës, plotësojeni atë. Aktivizimi i sa më shumë nxënësve do të jetë element kyç për një orë cilësore.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIU DHËN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)

Arsyet që i nxitën historianët antikë të shkruajnë për ilirët	Ngjarje që nxitën kuriozitetin e historianëve antikë	Grupimi i historianëve që kanë shkruar historinë e shqiptarëve	Burimet arkivore, ku mund të mbështetet historia e shqiptarëve	Botime të rëndësishme për historinë e shqiptarëve
– Kurioziteti për njohjen e fqinjëve. – Interesat ekonomike dhe tregtare. – Interesat politike në lidhje me formacionet shtetërore të kohës.	– Lufta e Peloponezitetit në shek. V pr.e.s. – Luftërat iliro-maqedone. – Luftërat dardano-maqedone. – Luftërat iliro-romake. – Luftërat civile romake. – Kryengritjet ilire antiromake.	Grupi i parë (autorët që japin të dhëna për popullin dhe vendin) Përfaqësues: Skylaksi dhe Theopompi. Grupi i dytë (autorë që pasqyrojnë ngjarjet politike) Përfaqësues: Homeri, Thukiditi, Polibi, Pausania, Tit Livi, Apiani etj.	1. Arkivat e Vatikanit 2. Arkivat e Raguzës 3. Arkivat e Napolit 4. Arkivat e Perandorisë Osmane 5. Arkivat shqiptare (krijohen pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë).	Nga Marin Barleti, veprat: - “Rrethimi i Shkodrës” (1505) - “Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut” (1508-1510). Nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë: – “Historia e plotë e Shqipërisë”, 1959. – “Historia e Popullit Shqiptar”, 2000.

Faza e tretë: Përforsimi - pyetja binare

Në këtë fazë, nxitet diskutimi në klasë në lidhje me pyetjen binare:

“Historinë e shqiptarëve e shkruajnë më mirë shqiptarët apo të huajt?”

Mësuesi/ja bën kujdes të zhvillojë në klasë një diskutim frytdhënës dhe qytetar, duke i orientuar herë pas here edhe me shembuj konkretë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Lihet i lirë nxënësi të zgjedhë mes dy detyrave të përcaktuara në ushtrimin 5, faqe 10.

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime:

a. Pse themi se historia e shqiptarëve është rezultat i kontributit të studiuesve të huaj dhe vendës?

Argumentoni mendimin tuaj.

b. Përshkruani: thelbin e kontributit të historianëve Gustav Majer, Milan Shuflai, George Han, Norbert

Jokël në ndërtimin e historisë së shqiptarëve pasi të mblidhni informacion për ta.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1 “Të njohim burimet e shkruara të autorëve antikë për ilirët dhe Ilirinë”		Situata e të nxënit: Pavarësisht se nuk kemi një histori të shkruar për ilirët, ashtu si e kanë popujt e tjerë antikë, autorët e antikitetit kanë dhënë informacione për ta. Informacionet e tyre përfshijnë të dhëna nga aspekte të ndryshme të jetës dhe ngjarjeve politike të kohës. Përmes këtyre informacioneve mund të shpjegosh dhe rindërtosh jetën e ilirëve.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Njihet me përmbajtjen e burimeve kryesore të shkruara për ilirët nga autorët antikë. - Organizon informacionet e dhëna sipas aspekteve të ndryshme të jetesës së ilirëve. - Gjykon historinë e ilirëve si themel i historisë së shqiptarëve.		Fjalët kyçe: liburnë, kaonë, prostatë, paionë, pellazgë, japodë, dardanë.	
Burimet: teksti i historisë, Historia e Popullit Shqiptar, internet, mjete didaktike, harta memece e Ilirisë, poster.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi - organizimi i nxënësve Mësuesi/sja e ka prezantuar temën e mësimi që një orë më parë, ndaj në këtë orë fillohet menjëherë me organizimin e grupeve. Bëhet kujdes që grupet të kenë nivele të ndryshme nxënësish. Këshillohet që kryetari i grupit të zgjidhet nga vetë anëtarët e grupit.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - punë në grupe - tabelë konceptuale - punimi i hartës - diagrami i Venit

Pasi grupet janë organizuar, shpërndaju fletat e punës. Fletat e punës do të jenë tre, të shumëfishuara sa grupe ke parashikuar të krijosh.

Fleta e parë – tabela konceptuale

Nxënësve u shpërndahet modeli dhe jepen udhëzimet përkatëse sesi duhet plotësuar.

Kërkesa	Informacioni që vjen nga autorët antikë	Autori
Gratë ilire	<i>Gratë e Paionisë janë shumë të mençura. Ato mbajnë mbi kokë shtamën, i japin të pijë fëmijës duke e mbajtur varur në gji, kalin e të shoqit e tërheqin prej kapistre dhe e shpien për ujë dhe me duar thurin sende për veshje... Ilirët lejonin të huajt të pranishëm në tryezë të pinin bashkë me gratë e tyre..." Në Iliri, gratë ruajnë dhentë ose shkojnë për dru, ose gatruajnë, ose ruajnë kasollen... Vajzat ilire, virgjëresha zakoni, nuk i ndalonte të shkonin para martesës me atë që duan të enden vetëm dhe të kenë fëmijë..."</i>	Eliani, vitet 170-235 Varroni, vitet 116-27 p.e.s
Numri i popullsisë		
Besimi ilir		
Prejardhja e ilirëve		
Ekonomia e ilirëve		
Ndarja e punëve sipas gjinisë		
Udhëheqësit politikë		
Udhëheqësit shpirtërorë		
Udhëheqësit ushtarakë		

Grupet ndahen në dy nëngrupe. Secili prej nëngrupeve, sipas aftësive, punon me njërin prej fletave të punës. P. sh.

Nëngrupi i parë punon në fletën e dytë - Harta memecë e Ilirisë. Anëtarët e këtij grupi vendosin në hartë territoret dhe fiset ilire të dhëna në informacionet e autorëve antikë.

Nëngrupi i dytë punon në fletën e tretë - Diagrami i Venit. Anëtarët e këtij grupi krahasojnë në një diagram Veni mënyrën e jetesës së ilirëve me atë të shqiptarëve sot.

Faza e tretë: Përforsimi - prezantim i punimeve - vlerësim i nxënësve

Gjatë kësaj faze secili grup prezanton detyrat e realizuara. Ata lexojnë punimet sipas ndarjes paraprake. Pjesa tjetër e klasës dëgjon dhe diskuton lidhur me paraqitjen e punimeve. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Punimet e realizuara vendosen në portofolin e të nxënit, duke u shoqëruar me një relacion përmbledhës nga ana e mësuesit/es.

Vlerësimi:

Vlerësim në grup për punën e kryer.

Vlerësim individual për zbatimin e detyrave dhe përfshirjes në grup.

Detyra: Shkruani një ese historike "Autorët antikë dhe ilirët".

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr. 2 “Si të punosh me burimet arkivore (vizitë në arkiv)?”		Situata e të nxënit: Arkivat janë koleksione të informacionit - të njohura si shënime. Këto vijnë në shumë forma, si: letra, raporte, regjistrime video, harta, fotografi dhe filma, fotografi digjitale, regjistrimet e zërit. Arkivi nuk është një bibliotekë.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Zbulon kuptimin për arkivin dhe llojet e tij. • Fiton aftësi për të seleksionuar dokumentet arkivore. • Zhvillon aftësi kompjuterike për të kërkuar dokumente ose për të parë të dhënat e digjitalizuara. • Identifikon të dhënat historike nga afër dhe mëson t’i organizojë ato. • Vlerëson rëndësinë e arkivave, në ruajtjen e historisë lokale, kombëtare e më tej.		Fjalët kyçe: arkiv, specialistë të arkivit, udhëzues të kërkimit, arkiva digjitale, arkiva personale, arkivi i shtetit.	
Burimet: Teksti i historisë, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Vizitë në grup Diskutim Nxjerrja e konkluzioneve			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – vizita në muze - formulimi i pyetjeve - kërkimi arkivor

Gjatë vizitës në muze, nxënësit tregojnë durim dhe interes për të dëgjuar dhe hulumtuar. Kërkohet ndihma e specialistëve të kërkimit. Ata e njohin shumë mirë arkivin dhe do të dinë t’ju orientojnë sipas çështjes historike që ju keni zgjedhur të trajtoni.

Gjatë vizitës nëpër pavijonet e arkivit, nxënësit duhet të jenë të gatshëm për të bërë pyetje, të cilat janë formuar që më parë, teksa ata kanë kërkuar në lidhje me çështjen e zgjedhur. Të gjitha informacionet që u jepen në arkiv mbahen shënim. Kjo do ta bëjë nxënësin më të organizuar për realizimin me sukses të punimit përfundimtar.

Nëse do t’ju lejohet, kërkoni nxënësve të bëjnë foto për të pasuruar më tej punimin personal.

Vizita juaj duhet të përqendrohet më së tepërmi në shfrytëzimin nga afër të burimeve që lidhen me

çështjen që ju intereson. Kërkoni ndihmën e specialistëve të arkivit për ta realizuar kërkimin tuaj shpejt dhe saktë. Merrni çdo gjë që do t'ju nevojitet për të realizuar një detyrë cilësore. Mund të përdorni mjetet që lejohen në arkiva, si fotokopjet, fotografitë apo mbajtjen e shënimeve.

Kujdes: respektoni rregullat e sigurisë në arkiva!

Faza e parë: Përgatitja për vizitën

Para se të nisni vizitën, organizohuni në klasë në lidhje me hapat e mëposhtëm.

1. Informoni nxënësit mbi arkivat, rolin dhe llojet e tyre.
2. Zgjidhni një çështje të vlefshme historike që ju intereson.
3. Formuloni “tezën” tuaj të hetimit. Kjo është absolutisht thelbësore për një studim të suksesshëm.

Faza e tretë: Përforcimi - nxjerrja e konkluzioneve

Kjo fazë mund të realizohet edhe gjatë rrugës së kthimit, në një bisedë reflektuese gjatë një ndalese.

Mësuesi/sja në këtë fazë bën vlerësimin e vizitës dhe nxjerr përfundimet. Nxënësit shprehin përshtypjet e tyre dhe tregojnë risitë dhe vlerat e kësaj vizite.

Vlerësimi: Vlerësim individual në lidhje me interesin e shfaqur gjatë vizitës dhe realizimin e punimit përfundimtar.

Detyra: Teza e zgjedhur për hetim dorëzohet në orën pasardhëse dhe dokumentohet në portofolin e të nxënësit.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr. 3 “Ndërtimi i historikut të krahinës suaj duke u mbështetur në burime historike”		Situata e të nxënit: Gjendet një ngjarje që dominon historinë e krahinës ku ndodhen nxënësit tuaj dhe lexohet në klasë. Nëpërmjet saj nxitet kurioziteti për të vijuar më tej, më të tjera fakte dhe dëshmi të së kaluarës së krahinës suaj.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Zhvillon aftësinë e kërkimit historik dhe të përdorimit të burimeve parësore dhe dytësore. - Ndërton historinë e vendbanimit bazuar në analizën shkak-pasojë, interpretim, gjykim të ngjarjeve, objekteve apo figurave historike.		Fjalët kyçe: hulumtim arkivor, histori të rrëfyera, dokumente parësore, dokumente dytësore.	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min) N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min) P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Bashkëbisedim Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëheq, nëpërmjet prezantimit të një ngjarjeje të rëndësishme historike, të ndodhur në krahinën tuaj. Tërhiqet vëmendja e nxënësve përmes leximit ose paraqitjes së një videoje (kur është e mundur të gjendet). Pasi është bërë prezantimi i informacionit, nxënësit përfshihen në bashkëbisedim për pyetjet e mëposhtme: 1. Kishit informacion paraprak për këtë ngjarje? 2. Ku keni marrë më herët informacion për të? 3. Dini ngjarje të tjera të ndodhura në këtë krahinë, që të mund të ketë ndikuar në historinë tonë kombëtare? 4. Cilat janë ndjesitë që shfaqen te ju, kur dalloni emrin e fshatit, qytetit apo krahinës suaj në tekstet shkollore?			

Faza e dytë: Tryezë e rrumbullakët - diskutim - punë në grupe

Që kjo fazë të realizohet më së miri, lajmërojnë nxënësit që një orë më parë të sjellin imazhe fotografike, dëshmi gojore, materiale arkivore në lidhje me historikun e krahinës së tyre. Nëse materialet janë siguruar, atëherë vazhdoni më tej.

Hapi i parë-diskutim-tryezë e rrumbullakët

Shfaqni në video-projektor materialet që dispononi, radhë njëra pas tjetrës. Nxisni diskutimin dhe debatin mes nxënësve nëpërmjet pyetjeve kyçe:

1. Çfarë ju vjen ndër mend teksa shihni këto foto?
2. A mendoni se fotografitë janë një burim autentik informacioni?
3. Si mund t'i vinin në ndihmë një historiani fotografitë?
4. Si i vlerëson dokumentet e shkruara?
5. A mund të përzgjidhni nga imazhet dhe dokumentet e paraqitura, më të rëndësishmet?
6. Sa me vlerë janë dëshmitë gojore?
7. Pse ato kërkojnë një kujdes të veçantë?
8. Si historian, a mundesh përballë këtyre të dhënave të ndërtosh një historik të krahinës tënde?

Hapi i dytë - punë në grupe

Pasi keni përfunduar diskutimin, organizojini nxënësit në grupe. Secilit prej grupeve shpërndajuni kopje të materialeve që u shfaqën në video-projektor. Udhëzoni nxënësit që të organizojnë dokumentet në poster ose libërth. Secili prej anëtarëve të grupeve duhet të punojë me një kategori të caktuar të burimeve.

Faza e tretë:


Prezantimi i punimeve në forma të ndryshme; poster, album, libërth ose program kompjuterik. Nxënësit shohin punimet e grupeve dhe japin vlerësimet përkatëse. Punimet dokumentohen në Portofolin e të nxënit.

Vlerësimi: Vlerësim në grup për punën e realizuar. Vlerësim individual për pjesëmarrjen në diskutim dhe rolin e luajtur në grup.

Detyra: Nuk parashikohen.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Lindja, zhvillimi dhe rënia e qytetërimit grek		Situata e të nxënit: Grekët e lashtë e quanin veten helenë (në fakt besonin se qenë pinjoll të heroit mitik Helen) dhe tokën e tyre Ëllade (“Hellás”). Akoma sot, në greqisht, Greqia quhet Hellas. Atëherë nga vjen fjala Greqi?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit grek. • Evidenton ndikimin e qytetërimeve të para në qytetërimin grek dhe romak. • Shpjegon fazat e zhvillimit të qytetërimit grek dhe tiparet e organizimit ekonomik-shoqëror. • Përcakton në hartë shtrirjen dhe qendrat kryesore të qytetërimit grek. • Shpjegon dhe krahason organizimin politik të qytet-shteteve në Greqinë antike. • Shpjegon shkaqet e rënies së qytetërimit grek dhe kontributin e tij në qytetërimin Perëndimor.		Fjalët kyçe: akej, dorë, qytete-shtete, periudha arkaike, kolonizimi grek, Greqia e Madhe, prytani, demos, bulea, regjim demokratik, regjim monarkik, agora, akropol.	
Burimet: Teksti mësimor, Greqia e Lashtë, Sh. Dervishi. Interneti http://www.bota.al/2016/09/Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi – Bashkëbisedim Në këtë fazë zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit. U drejtohen nxënësve dy pyetje kyçe dhe më pas nxitet pjesëmarrja e tyre në bashkëbisedim. 1. Cila është lidhja mes emërtimeve Helladë - Greqi? 2. Çfarë rëndësie kanë poemat e Homerit “Iliada” dhe “Odisea” për historinë e Greqisë së Lashtë? Nxënësit japin përgjigje, ose lexojnë pjesë nga poemat, duke i komentuar në aspekt historik.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar – kllaster

Për të realizuar me sukses këtë fazë, nevojitet pjesëmarrje aktive e nxënësve. Ata orientohen fillimisht në "lexim të orientuar", duke i shkruar në tabelë rubrikat kryesore të kllasterit. Udhëzohen nxënësit që, gjatë leximit, të fokusohen në elementët që nevojiten për plotësimin e secilës rubrikë dhe nënrubrikë. Ju mund të realizoni një kllaster që të këtë edhe më tepër nënrubrika. Gjatë plotësimit të tyre aktivizohen nxënësit duke shkruar në tabelë dhe në fletoren e shënimeve të historisë.

Faza e tretë: Përforsimi - punë me tekstin

Gjatë kësaj faze punohet me pyetjet në tekst. Situata quhet e realizuar nëse nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve:

- Kur kanë ardhur grekët në jug të Ballkanit?
- Në ç'mënyrë relievi ka luajtur rol në krijimin e qyteteve?
- Cilat janë dy modelet politike të qeverisjes në botën antike greke?
- Pse ra qytetërimi grek?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në plotësimin e kllasterit.

Detyra: Shteti spartan përcaktohet si një shtet ushtarak. A ekzistojnë forma të qeverisjes ushtarake në ditët tona? Jepni gjykimin tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi						Data:		
Fusha: Shqipëria dhe mjedisi		Lënda: Histori		Shkalla: VI		Klasa: XII		
Tema mësimore: Shqipëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik grek				Situata e të nxëniti: Shkenca, politika, arti, poezia, teatri... Nuk ka fushë të dijes Perëndimore që nuk e ka pak Greqi të lashtë në të kaluarën e saj. Prej më shumë se 2000 vjetësh, bota e klasicitetit helen është një fanar, një pikë referimi nga e cila herët a vonë kthehesh për të parë. Por kush qenë vërtet ata njerëz? Në çfarë fushash u shprehën?				
Rezultatet e të nxëniti të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan elemente të jetës së përditshme të shqiptarëve, botës kulturore materiale dhe shpirtërore në qytetërimin antik grek. • Gjykon mbi arritjet e qytetërimit grek në fushën e shkencës, filozofisë dhe demokracisë.				Fjalët kyçe: metekë, teatri grek, agoraja, akropoli, Lojërat Olimpike.				
Burimet: Teksti mësimor, Greqia e Lashtë, Sh. Dervishi. Interneti http://www.bota.al/2016/09/Historia-botërore-dhe-qytetërimi , K. Grimberg.				Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve								
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxëniti (10min)								
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)								
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)								
Faza e parë: Parashikimi - diskutim - paraqitje grafike Lexohet situata e të nxëniti dhe hapet diskutimi rreth saj. Nxënësit sjellin të dhëna lidhur me arritjet e grekëve të lashtë në fusha të ndryshme të dijes. Arritjet listohen në tabelë të organizuara sipas fushave të dijes:								
Letërsi	Muzikë	Teatër	Politikë	Arkitekturë	Sport	Astronomi	Filozofi	Matematikë

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - DRTA - punë në grupe.

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe duke i udhëzuar të lexojnë njësitë mësimore. Më pas nxënësit sistemojnë njohuritë në fletore.

Grupi i parë:

Shtresat shoqërore në antikitetin grek. Dallimet dhe ngjashmëritë mes dy poliseve kryesore:

Sparta dhe Athina.

Grupi i dytë:

Arkitektura në qytetin e Athinës. Merret në fokus Porti i Pireut.

Grupi i tretë:

Edukimi spartan dhe Edukimi athinas.

Grupi i katërt:

Arritjet në letërsi. Fragmente nga veprat e mëdha të letërsisë greke.

Grupi i pestë:

Besimi fetar dhe Lojërat Olimpikë, si model i ndikimit në qytetërimet e atëhershme dhe të sotme. Gjatë kohës që grupet punojnë, mësuesi/ja i ndjek nga afër, bën sugjerime, korrigjon dhe vlerëson.

Faza e tretë: Përforsimi - Diagram Veni

Bazuar në rezultatet dhe arritjet e secilit prej grupeve, në tabelë. Konceptohet një diagram Veni, në lidhje me arritjet shoqërore, kulturore dhe shkencore mes dy poliseve kryesore: Spartës dhe Athinës.

Qytetërimi spartan	Të përbashkëta	Qytetërimi athinas
- I dha jetë një modeli qeverisës oligarkik. - Jeta e qytetarëve organizohej nga shteti. - Shtresa kryesore e shoqërisë ishin spartanët. Pas tyre vinin Periekët dhe Iliotët. - Edukimi i fëmijëve në Spartë ishte shumë i rreptë.	- Poliset më të fuqishme të botës greke. - Arsimimi ishte një kombinim i mësimin me edukimin fizik e ushtarak.	- I dha jetë modelit qeverisës demokratik. - Të drejtat u takonin qytetarëve, me pronë ose pa pronë. - Shtresat shoqërore organizoheshin në: të pasur(eupatridët), demos, metekët, sklevërit. - Edukimi i fëmijëve bëhej nga prindërit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe plotësimin e skemave të sugjeruara nga mësuesi/ja.

Detyra: Ushtrimi 5, faqe 23.

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime:

a. Në Greqinë antike lindi dhe u zhvillua mendimi politik demokratik, ai intelektual e shkencor. Si është

e mundur? Tregoni arsyet. Argumentoni.

b. "Shkolla e Greqisë". Shpjegoni, pse e mori këtë emër?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Roma nga monarkia në perandori		Situata e të nxënit: Legjenda e Romulit dhe Remit tregon historinë e vëllezërve binjakë të rritur nga ujkona, të cilët bëhen etërit themelues të Romës. Nëna e djemve, Rea Silvia, kishte qenë e detyruar të bëhej një Virgjëreshë Vestal (priftëreshat që merrnin pjesë në zjarrin e shenjtë të Vesta) nga uzurpatori Amulius. Ajo pastaj mbeti shtatzënë ose me perëndinë Mars ose me Herkulin. Kur Amuliusi mësoi për këtë, ai urdhëroi që binjakët e mitur të hidheshin në lumin Tiber, ku ata u lanë të vdisnin... Vazhdojeni ju legjendën.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit antik romak. • Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimit antik romak. • Shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Romën antike.		Fjalët kyçe: komicie centurione, komicie kuriale, comicie e familjeve, senati, oligarkia patriciane, republikë aristokrate, patricë, plebej, nobilitas, res publica, triumvirat, August, principatë, e drejta romake, dominat, Luftëra Punike.	
Burimet: Teksti mësimor, Roma e Lashtë, R. Gjini; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg, interneti http://www.bota.al/2017/03		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi – marrëdhënie pyetje-përgjigje Në këtë fazë, duke marrë në konsideratë faktin që nxënësit kanë njohuri në lidhje me qytetërimin romak, zhvillohet teknika e marrëdhënie pyetje-përgjigje. Nxënësve u drejtohen këto pyetje: 1. Kur është krijuar Roma? 2. Cilat kanë qenë format qeverisëse të Romës së Lashtë? 3. A ju kujtohet legjenda që flet për themelimin e Romës? 4. Si e kujtoni figurën e Jul Çezarit? 5. Po të Oktavian Augustit? Pasi merren përgjigje të mundshme nga ana e nxënësve, disa prej tyre shkruhen në njërin krah të tabelës. Përzgjidhen ato përgjigje që do të jenë në funksion të njohurive të reja.			



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - organizuesi grafik kronologjik

Në video-projektor shfaqet harta e shtrirjes së fiseve që dominonin Gadishullin Apenin në antikitet.

Harta sigurohet të jetë memece, me qëllim që të jenë nxënësit ata që do dallojnë zonat e shtrirjes së etruskëve, keltëve, umbrëve, samnitëve, mesapëve, grekëve, kartagjenasve etj. Pas këtij hapi, nxënësve u tërhiqet vëmendja dhe përqendrohen në ndërtimin e njohurive të reja përmes organizuesit grafik kronologjik, në lidhje me format e qeverisjes që u zhvilluan në Romën e Lashtë. Për secilën formë qeverisëse paraqitet informacion i përmbledhur.

PERIUdhA E MONARKISË (753-509 PR.L.K)

Mbretërit më të dëgjuar të periudhës së mbretërisë kanë qenë: Romuli, Numa Pompilio, Tullo Ostilio, Anco Marzio dhe mbretërit e dinastisë etruske.

Dinastia etruske mori disa masa:

1. Forcoi dhe ndërtoi murin e parë rrethues të Romës.
2. U krijuan komiciet centurionë, krahas atyre kuriale si organe legislative.

PERIUdhA REPUBLIKANE (509-31 P.E.S)

1. Dëbimi i mbretit të fundit etrusk të Romës, Tarkuino Superbo.
2. Qeverisja e qytetit iu besua dy konsujve të parë.
3. Midis patricëve dhe plebejve nisi një luftë e zgjatur.
4. Në vitin 287 p.e.s, plebejtë fituan të drejta të barabarta politike me patricët.

Institucionet drejtuese të Romës në periudhën e Republikës organizoheshin kështu:
Pushteti legjislativ = senati
Pushteti ekzekutiv = dy konsuj të zgjedhur për një vit
Demokracia qytetare = komiciet

Perandoria Romake (27 p.e.s – 395)

Luftërat që i paraprinë vendosjes së Perandorisë ishin:

1. Luftërat në drejtim të Gadishullit Ballkanik kundër Ilirisë, Maqedonisë, Epirit dhe Greqisë, të cilat u pushtuan deri në shek. I p.e.s.
2. Lufta civile për pushtet mes konsujve dhe mbështetësve të tyre në senat.
3. Luftërat Punike mes Romës dhe Kartagjenës.

Ndryshimet në qeverisje:

1. Viti 60 p.e.s, u krijua Triumvirati (Pompeu, Krasi dhe Cezari)
2. Viti 31 p.e.s, u krijua regjimi i quajtur Principat, nën drejtimin e Oktavianit.
3. Viti 27 p.e.s, Oktaviani mori titullin perandorak "Cezar".
4. Viti 284, perandori Dioklecian i dha pushtetit perandorak karakter hyjnor.

Faza e tretë: Përforsimi - punë me tekstin

Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja i orienton nxënësit në leximin e thelluar të tekstit. Pas leximit, nxënësit kanë kohë 5 deri në 8 minuta për të punuar një detyrë në klasë, e cila do të vendoset në portofolin e të nxënit.

Kërkesa: Argumentoni karakterin demokratik të Republikës Romake.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra: Çfarë elementi të përbashkët ka shoqëria romake në periudhën e Perandorisë me projektet europiane të së sotmes?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shoqëria, kultura, shkenca në qytetërimin antik romak	Situata e të nxënit: Jeta në Romën e Lashtë rrotullohej rreth qytetit Romë, i cili shtrihej mbi 7 kodra. Kishte struktura monumentale, si Koloseu, Panteoni, Forumi i Trajanit, shatërvanë, shëtitore, ujësjellës, teatro etj.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon tiparet e organizimit ekonomik-shoqëror në Romën antike. • Dallon elemente të jetës së përditshme në qytetërimin antik romak. • Përshkruan tiparet e artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në qytetërimin antik romak. • Vlerëson rëndësinë e së drejtës romake.	Fjalët kyçe: plebejë, patricë, Pax Romana, Koloseu, forumi, terme, gladiatorë, amfiteatri, Eneida, insula.		
Burimet: Teksti mësimor, Roma e Lashtë, R. Gjini; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti http://www.explorerunivers.com	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)			
N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)			
P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)			
Faza e parë: Parashikimi - teknika e të pyeturit Nxënësit tashmë janë të mirinformuar për qytetërimet në antikitet. Për të provuar qëndrueshmërinë e njohurive të tyre mund të përdorni pyetjet e mëposhtme: 1. Cila ishte forma e parë e qeverisjes në Romë? 2. Si ishte e organizuar qeverisja e republikës romake, sipas gjykimit të historianit grek Polibi? 3. Si plebejtë i fituan të drejtat politike? 4. Pse lindi nevoja për një pushtet të përqendruar midis shek. I p.e.s.? 5. Cili ishte karakteri i pushtetit perandorak në kohën e Oktavian Augustit? 6. Në cilën periudhë Perandoria Romake arriti kulmin dhe zgjerimin e saj maksimal? 7. Cilat ishin dy modelet social-politike mbi të cilën u organizua shoqëria greke? 8. Si lidhej dhe ndahej jeta e përditshme në Athinë e në Spartë? 9. Si lidhej dhe ndahej edukimi në Athinë e në Spartë? 10. Cilat janë arritjet në epokën e artë të kulturës greke?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - punë me tekstin - fletat e ekspertëve

Pasi është mbyllur faza e parë, klasa organizohet në grupe me 4 anëtarë. Secilit grup i shpërndahen këto materiale: fleta udhëzuese, fleta e ekspertit nr. 1, fleta e ekspertit nr. 2, fleta e ekspertit nr. 3, fleta e ekspertit nr. 4. Nxënësit rigrupohen sipas ekspertëve dhe fillojnë punën me

tekstin dhe plotësimin e fletës përkatëse.
Modelet e fletave që mund të përdoren.

Fleta e ekspertit nr. 1

Emër _____

Mbiemër _____



Kërkesa: Plotësoni skemën e ndarjes së shoqërisë në Perandorinë Romake.
Jepni informacion lidhur me kushtet në të cilat jetonte secila prej shtresave.

Fleta e ekspertit nr. 2					Emër _____	Mbiemër _____			
Plebejë	Patricë	Pax romana	Koloseu	Panteoni	E drejta romake	Forumi	Terme	Gladiatorë	Insula

Kërkesa: Plotësoni tabelën me shpjegimin e saktë për secilin koncept.

Fleta e ekspertit nr. 3


Emër _____ Mbiemër _____

Çështja	Komenti
Mënyrat e argëtimit në Perandorinë Romake	
Arritjet në arkitekturë në Perandorinë Romake	
Gjuha dhe zhvillimi i letërsisë latine	
Besimi fetar në Romën e Lashtë	

Kërkesa: Plotësoni ditarin dypjesësh.

Fleta e ekspertit nr. 4

Emër _____ Mbiemër _____



Kërkesa: Plotësoni në skemë tiparet kryesore të së drejtës romake.

Faza e tretë: Përforcimi - prezantim i rezultateve

Pasi kanë punuar së bashku ekspertët, kthehen në grupet fillestare dhe informojnë anëtarët e grupit mbi gjetjet e tyre. Nga secili grup ngrihet një përfaqësues që bën përmbledhjen e punës së realizuar. Fletat e ekspertëve dokumentohen në portofolin e të nxënit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në punën e grupit.

Detyra:

“Romakët ngriheshin herët në mëngjes, shkonin te berberi e pastaj në punë, të cilën e linin në mesditë. Pasdite merreshin me dëfrime”. Në ç’mënyrë jeta e përditshme e romakëve është e ngjashme dhe e ndryshme me mënyrën e jetesës së shoqërisë shqiptare sot?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Marrëdhëniet mes formacioneve politike greko-romake në antikitet		Situata e të nxënit: Shprehja më karakteristike për të shprehur qëndrimin e spartanëve kundrejt luftës ishte shprehja që Nëna Spartane i thoshte djalit të saj kur po ikte për luftë, “I tan i epi tas” ose “Kthehu me mburojën ose mbi të”.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon karakteristikat kryesore të organizimit institucional-politik, social-ekonomik në qytetërimet antike. • Analizon shkaqet e konfliktit dhe rrjedhojat e tyre (Lufta e Trojës, Luftërat greke-persiane dhe Luftërat Punike). • Evidenton bashkëpunimin dhe konfliktet në botën greke dhe atë romake. • Evidenton trashëgiminë antike dhe ndikimin e saj në ditët e sotme.		Fjalët kyçe: Lidhja e Peloponezit, Lidhja e Delosit, Lufta e Peloponezit, Mbretëria Maqedone, Luftërat Punike.	
Burimet: Teksti mësimor, Roma e Lashtë, R. Gjini; Greqia e lashtë, Sh. Dervishi; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi - braingstorming Mësuesi/ja shkruan në dy pjesë të ndryshme të tabelës dy togfjalësja:			
Qytetërimi grek		Qytetërimi romak	
Nxitet klasa për të sjellë informacionet nëpërmjet evokimit të njohurive. Mësuesi/ja përmbledh përgjigjet e nxënësve dhe ndërton skemën “braingstorming”. Të dhënat përdoren për të bërë lidhjen me fazën e dytë.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - diagram Veni



Mësuesi/ja ndërton në tabelë një diagram Veni në lidhje me dy qytetërimet antike të mësuara. Gjatë shpjegimit të informacionit të ri, mësuesi/ja ndalet të plotësojë elementë në diagramin e Venit. Nxënësit këshillohen të krahasojnë mes gjetjeve të tyre paraprake dhe informacionit që sjell mësuesi/ja.

Qytetërimi antik grek	Të përbashkëtat	Qytetërimi antik romak
• Greqia e periudhës arkaike ishte e dominuar nga Mikenat. • Në fund të epokës arkaike, rivaliteti do të përfshinte dhe polise të tjera. • U krijuan disa lidhje (aleanca) me qëllim fuqizimin dhe mbrojtjen nga armiqtë: Lidhja e Delosit dhe Lidhja e Peloponezit.	• Të dyja qytetërimet përbëjnë një trashëgimi të pasur për shoqërinë njerëzore. • U hodhën bazat e një modeli të qeverisjes demokratike.	• Roma krijoi Perandorinë më të madhe të kohës. • Roma u konfliktua shumë herët me fqinjët, në dëshirën e saj për ekspansion. • Zhvilloi Luftërat në Gadishullin Ballkanik. • Zhvilloi Luftërat Punike (gjithsej 3).

Faza e tretë: Përforcimi - Pyetja binare

Në këtë fazë, pasi nxënësve u është qartësuar informacioni i ri, u bëhet me dije se do të realizohet një debat i shkurtër në kohë. Debat i do të fokusohet në këtë pyetje:

U vendos modeli i demokracisë në qeverisje si ka qenë rreth 2000 vjet më parë?



Vlerësimi:

Vlerësim individual i nxënësve për pjesëmarrjen aktive në secilën etapë mësimore.

Detyra:

“Qytetërimi romak me të drejtën romake i dha shoqërisë njerëzore sistemin juridik më të përparuar për kohën, i cili u bë dhe baza e sistemeve juridike moderne”. Në ç’mënyrë? Argumentoni me shembuj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Procesi i formimit të etnosit ilir dhe qytetërimit të tij		Situata e të nxënit: Kultura dhe etnosi ilir kanë origjinë autoktone (vendëse). Ata lindën dhe u formuan në bazë të një procesi të gjatë dhe të pandërprerë, gjatë mijëvjeçarit të dytë dhe të parë p.e.s.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon formimin e etnosit ilir mbështetur në gjurmët arkeologjike të periudhës prehistorike dhe historike. • Shpjegon konceptet etnogjeneze, etnos, ilir, Iliri, Epir, epirotë. • Përcakton kohën, rrethanat dhe tiparet e lindjes së qytetërimit ilir.		Fjalët kyçe: etnosi ilir, varrimi me tuma, etnogjeneze, etnos, populli ilir, ilirë, Iliri, Epir, fise epirote, protourbane, çarku, familja patriarkale, vëllazëri, fis, urna, hyji i Diellit, kulti i gjarprit.	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Nga Ilirët të shqiptarët, N. Ceka; interneti https://www.shqiperia.com/historia/iliret.php.htm		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënësit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Pasi është prezantuar te nxënësit situata e të nxënësve, kalohet në një bashkëbisedim në lidhje me njohuritë paraprake që nxënësit kanë mbi etnosin ilir. U drejtohen disa pyetje, të cilat synojnë të nxënësin pjesëmarrje të gjerë të nxënësve:

1. Si u formua etnosi ilir?
2. Cilat janë gjurmët arkeologjike të periudhës prehistorike dhe historike që e dëshmojnë këtë?
3. Cilat janë faktet dhe burimet mbi origjinën ilire?
4. Cilat janë tiparet e qytetërimit ilir në fushën ekonomiko-social?
5. Cilat janë marrëdhëniet e tij me botën mesdhetare?

Gjatë bashkëbisedimit shkruhen në tabelë vetëm ato pyetje që mbeten pa komente ose përgjigje. Mësuesi/ja merr përsipër të thellohet më tepër për këto pyetje gjatë fazës së dytë.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë me tekstin dhe fletoren e shënimeve. Në tabelë vizatohet modeli i ditarit dypjesësh, me të cilin nxënësit janë familjarizuar edhe në orët e mëparshme. Jepen udhëzime mbi punën individuale që i duhet të kryejë çdo nxënësi. Fillimisht përcaktohet çështja dhe më pas komentohet.

Çështja	Komenti
Etnogjeneza ilire	Lidhur me krijimin e etnosit ilir ka dy pikëpamje të ndryshme. Pikëpamja e parë i trajton ilirët si një popullsi e ardhur gjatë dyndjes së popujve indoeuropianë gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s. nga rajone të ndryshme të Europës (vendet nordike, Gjermania, Polonia, Hungaria etj.). Sipas kësaj teorie, gadishulli ballkanik u indoeuropianizua gjatë dyndjeve të popujve indoeuropianë, gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s. Një nga dukuritë kryesore të popullsisë së ardhur ishte varrimi me tuma, dëshmi e organizimit familjar dhe fisnor të tyre. Pikëpamja e dytë, e cila gjen mbështetje më të gjerë dhe që mbështetet në të dhënat e arkeologjisë shqiptare, është ajo që e trajton formimin e etnosit ilir si rezultat i përzierjes së popullsisë vendëse, e njohur me emrin konvencional si popullsi pellazge me elementin indoeuropian të ardhur nga dyndja e sipërpërmendur. Si rezultat i bashkëjetesës dhe shkrirjes së popullsisë vendëse, e cila përbënte shumicën me popullsinë e ardhur rishtas, u krijua populli ilir, i cili konsiderohet si një nga popujt më të hershëm të Ballkanit dhe Europës.
Shtirja e fiseve ilire	Burimet antike të mëvonshme na japin këto të dhëna për vendndodhjen e fiseve kryesore ilire. Duke filluar nga veriu i gadishullit ballkanik, japodët banonin midis gjirit të Istrias dhe lumit Todanij (Zemanje) dhe në brendësi deri te lumi Oeneus (Una). Në jug të japodëve banonin liburnët nga bregu i detit deri pranë lumit Titius (Krka). Në hapësirën midis lumenjve Krka dhe Neretva banonin dalmatët. Përgjatë lumit Sava banonin një sërë fisesh ilire, si versiatët, agrianët, drionët, breukët, aesidiatët dhe autaraitët. Midis lumit Neretva dhe Drilon banonte fisi i madh i ardianëve. Më në jug, nga lumi Ardaksanus deri në lumin Aoos, banonte fisi tjetër i madh ilir, taulantët. Albanët (zona Krujë -Tiranë). Në anën e djathtë të lumit Vjosa banonin bylinët dhe në lindje të tyre atintanët, ndërsa në bregun e majtë banonin amantët. Në luginën e Genusit (Shkumbini) banonin sesaretët, ndërsa në Çermenikë banonin kandavët që kufizoheshin me enkelejtë, që banonin në perëndim të liqenit Lyknid (Liqeni i Pogradecit), ndërsa në lindje të këtij liqeni banonin lynkestët. Fusha e Korçës banohej nga desaretët etj.
Vendbanimet protourbane	U shfaqën në shek. VII-V pr.l.k. Lindja e tyre dëshmon se shoqëria ilire kishte hyrë në rrugën e qytetërimit. Disa prej qendrave protourbane ishin: Mashkjezë, Gajtan, Margëlliç, Klos, Amantia, Belsh etj. zbulimet arkeologjike tregojnë se në këto vendbanime dallohej diferencimi shoqëror dhe shkalla e lartë e zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë, zejtarisë, shkëmbimit të mallrave. Nga pikëpamja e organizimit shoqëror, baza e organizimit ishte familja patriarkale, ndërsa bashkimi i disa familjeve të tilla përbënte një vëllazëri, ndërkohë që disa vëllazëri të bashkuara përbënin një fis. Nëse fshati ishte vendbanimi i një apo disa familjeve patriarkale, vendbanimet e fortifikuara duket se shërbejnë edhe si qendra e një apo disa fiseve të afërta midis tyre.
Zhvillimi i qyteteve.	Në shek. V, ilirët kishin arritur një nivel të lartë zhvillimi sa që kishin krijuar qytetet e tyre sipas modeleve greke. Shek. IV-III pr.l.k, përbëjnë periudhën e lulëzimit të qytetit ilir. Qytete të mëdha themelohen si: Bylisi, Amantia, Nikaja, Antipatrea, Albanopolisi, Meteoni, Ulçini, Rizoni, Dimali etj. Tiparet kryesore të qytetit ilir, ashtu si dhe qytetet greke bashkëkohore, ishin: muri rrethues mbrojtës, qendra e qytetit-agoraja, ku ishin ndërtuar objektet publike, si teatri, stadiumi, shëtitore, tempuj etj. Sistemi i qeverisjes në një pjesë të qyteteve ishte i ngjashëm me qytetet greke, ku kishte një këshill-bulea dhe një qeveritar-prytani që zgjidhej çdo vit. Vendimet më të rëndësishme i merrte mbledhja e popullit-damosia.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me hartën

Në këtë fazë, nxënësi përforcon dijen e fituar përmes aktivitetit praktik. Pasi është rilexuar informacioni në tekst, nxënësve u shpërndahen harta memece të Ilirisë. Detyra e nxënësit është gjetja dhe emërtimi i vendndodhjes së fiseve më të rëndësishme ilire.

Vlerësimi: Vlerësim individual i nxënësve për pjesëmarrjen aktive në secilën etapë mësimore.

Detyra: Ushtrimi 6, në faqen 35.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Mbretëria Ilire		Situata e të nxënit: Historia e Ilirisë është e lidhur me zhvillimin e shteteve skllavopronare dhe mbretëritë e tjera, me ushtritë e strategët e saj, sidomos me Maqedoninë, Spartën, Athinën etj. Çfarë ju tregon kjo gjë për Ilirinë?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon dhe krahason format e organizimit shtetëror në Ilirinë antike. • Shpjegon dhe analizon shkaqe mbi marrëdhëniet e ilirëve me fqinjët.		Fjalët kyçe: federata fisnore, mbretëria e Bardhytit, Mbretëria Maqedonase, etolë, Mbretëria Ilire.	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Nga Ilirët të shqiptarët, N. Ceka; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	

Faza e parë – Parashikimi – parashikim me terma paraprake

Nxënësit kanë njohuri të mira në lidhje me shtetin ilir, pasi janë njohur me këtë pjesë të historisë që në klasën e gjashtë e deri në klasën e njëmbëdhjetë, prandaj mund të zhvillohet me sukses teknika PTP. Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa terma kyçe dhe bazuar mbi to fton nxënësit të ndërtojnë një tekst historik, për afro 8 minuta. “ilirë, federate fisnore, liqeni i Ohrit, enkelejtë, taulantët, ardianët, konflikte, Mbretëria Maqedonase, Roma, Galauri, Bardhyti, Glaukia, Agroni, Teuta, Genti.” Pasi është realizuar teksti, disa nxënës lexojnë shkrimet e tyre. Jepen mendime mbi cilësinë e punimeve.


Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Tabela konceptuale

Në këtë fazë, organizohen njohuritë në tabelën konceptuale. Gjatë shpjegimit, mësuesi/ja ndalet herë pas here për të plotësuar tabelën konceptuale, të cilën e ka realizuar në dërrasë. Të njëjtin veprim e kryejnë nxënësit në fletoren e tyre të shënimeve.

Shteti ilir	Dinastitë	Mbretërit më të suksesshëm	Armiqtë e përhershëm	Konfliktet më të rëndësishme
U mundësua nga kalimi i organizimit shtetëror të Federatave fisnore në Mbretëri Ilire. Ky proces ndodhi në territoret e Ilirisë Jugore, të cilat dalloheshin për një urbanizim të hershëm e më të zhvilluar, për një organizim më të mirë politik dhe ushtarak. Koha e krijimit përkon me çerekun e fundit të shek. V p.e.s.	Dinastia e Enkelejeve	Galauri, Syras, Bardhyli, Grabo, Kleitos.	Mbretëria Maqedonase Republika Romake	1. Shek. V, konflikti me maqedonasit që udhëhiqeshin nga Arkaleos. 2. V. 393 pr.I.k, rrëzimi nga fronti i Maqedonisë i mbretit Amyntas dhe duke vendosur Argaiosin. 3. 359 pr.I.k, lufta kundër Maqedonisë, ilirët drejtoheshin nga Bardhyli. 4. 335 pr.I.k, revolta e ilirëve kundër maqedonasve, nën drejtimin e mbretit Kleitos.
	Dinastia e Taulantëve Dinastia e Ardianëve	Glaukia, Monuni, Mytili, Agroni, Teuta, Genti.		5. 312 pr.I.k, konflikti me maqedonasit. Glaukia shtriu pushtetin mbi Apolloni e Dyrrah.
				6. 231 pr.I.k, trupat e Mbretërisë Ilire në sulm kundër etolëve, në ndihmë të akarnanisë. 7. 230 pr.I.k, Teuta pushton Foiniken. 8. 229 pr.I.k, Lufta e Parë Ilirë-Romake 9. 219 pr.I.k, Lufta e Dytë Ilirë-Romake. 10. 168 pr.I.k, Lufta e Tretë Ilirë-Romake.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin – linja e kohës.

Udhëzohen nxënësit që të vendosin në linjën e kohës ngjarjet më të rëndësishme që ndodhën në botën ilire në periudhën e shekujve V-II pr.I.k. Vizatohet në fletore linja e kohës, sipas modelit që mësuesi/ja realizon në dërrasë. Më pas veçohen nga teksti ngjarjet kryesore të periudhës së caktuar. Nxënësit punojnë individualisht për vendosjen e tyre në tabelë sipas modelit. Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e nxënësve.



Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra: Ushtrimi 5, faqe 38. Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni qëndrimet tuaja:

a. Analizoni shkaqet e marrëdhënieve të Mbretërisë Ilire me fqinjët. Cili është qëndrimi juaj? Pse?

b. “Në betejën e zhvilluar pranë Shkodrës ushtria ilire u mund, gjë që shënon dhe fundin e Mbretërisë Ilire”. Pse ra Mbretëria Ilire? Cili është qëndrimi juaj?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Mbretëria Dardane		Situata e të nxënit: Dardanët arritën që të bëheshin një fuqi e madhe ushtarake gjatë sundimit të mbretit Bato dhe Monun. Në të gjitha aleancat, dardanët shfaqen si forcë kryesore në Ballkan. Pothuajse e gjithë historia e lashtë e dardanëve na paraqitet si histori luftërash të pandërprera.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Shpjegon organizimin shtetëror të fisit ilir të dardanëve. - Arsyeton mbi marrëdhëniet e mbretërisë dardane me fqinjët. - Analizon rëndësinë e mbretërve ilirë në jetën politike shoqërore të ilirëve dhe rolin e tyre.		Fjalët kyçe: autariatët, skordiskët, galabrët, thunatët, gradina, dulloi, keltë.	
Burimet: Mbretëria Dardane, L. Përzhita; Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë – Parashikimi – bashkëbisedim Lexohet situata e të nxënit dhe më pas kalohet në një bashkëbisedim me qëllimin pasurimin e të dhënave paraprake në lidhje me Mbretërinë Dardane. 1. A përputhen gjeografikisht termit Dardani-Kosovë? 2. Kanë jetuar fise të tjera në Mbretërinë Dardane, përveç dardanëve? 3. Çfarë ju kujtojnë emrat: Longar, Bato dhe Monun?			

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Lexim i orientuar dhe organizuesi grafik i informacionit.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë në heshtje tekstin për deri në pesë minuta kohë. Gjatë kësaj kohe shkruan në tabelë linjat kryesore të organizuesit grafik. Përgjatë leximit nxënësit duhet të nënvizojnë dhe mbajnë shënime, me qëllimin plotësimin e shpejtë dhe sa më të qartë të organizuesit grafik të informacionit.

Mbretëria Dardane

U krijua në shek. IV p.e.s.
Territori i saj shtrihej në veri deri te lumenjtë Augrus (Ibar) dhe Margus (Morava).
Fqinjët e tyre ishin autariatët dhe skordistët.
Përbëhej nga fise të ndryshme: dardanët, thumatët dhe gabrët.
Bujqësia ishte dega kryesore e ekonomisë.
Diferencimi pasuror kushtëzonte konfliktet që rriteshin vazhdimisht.
Qendrat e fortifikuara njiheshin si Gradina.

Ngjarjet që kanë dominuar historinë e Mbretërisë Dardane

- v. 335 pr.I.k, dardanët ngritën krye kundër maqedonasve.
- v. 279 pr.I.k, Mbretëria Dardane përballoi invazionin kelt. Ndhmoi edhe Maqedoninë me 20 000 luftëtarë kundër tyre.
- v. 231 pr.I.k, mbreti Longar i udhëhoqi në luftë kundër maqedonasve
- v. 229 pr.I.k, përmbledh shumë ngjarje (zaptimin e territorit të tribalëve në lindje, shkëputën fisin e penestëve nga sundimi ilir, u sulmua Maqedonia, që solli dhe vrasjen e Demetrit II.
- v. 219 pr.I.k, dardanët çliruan Pajoninë nga sundimi maqedonas.
- v. 208-200 pr.I.k, lufta kundër maqedonasve u bë përmes aleancave
- v. 167-97 pr.I.k, periudhë qetësie, edhe pse nën pushtuesit ishin afër
- v. 76 pr.I.k, Dardania bie në duart e romakëve.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Vazhdon puna me tekstin, duke u fokusuar në rëndësinë e mbretërive ilire dhe ndikimin që ato patën në qytetërimet e kohës kur u zhvilluan. Informacioni në tekst vjen i organizuar në një skemë.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra: Identifikoni, përmes kërkimit historik, rolin e Longarit në luftërat kundër Maqedonisë.


Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Mbretëria dhe Republika në Epir		Situata e të nxënit: Pirroja ishte një nga strategët më të mëdhenj të kohës helenistike. Kur e pyetën njërin nga shokët e Aleksandrit të Maqedonisë se kush ishte tani strategu më i shquar, ai iu përgjigj: "Pirroja kur të arrijë moshën e pjekurisë".	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon organizimin shtetëror të epirotëve. • Arsyeton mbi marrëdhëniet e mbretërisë dhe Republikës së Epirit me fqinjët. • Analizon rëndësinë e mbretërve epirotë në jetën politike-shoqërore.		Fjalët kyçe: epirotë, koinon, Lidhja Molose, Aleanca Epirote.	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Nga Ilirët të shqiptarët, N. Ceka; interneti. https://www.shqiperia.com/historia/iliret.php.htm		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë – Parashikimi – brainstorming – diskutim 5-minutësh

Gjatë kësaj faze, nxënësve u kërkohet që të evokojnë njohuritë në lidhje me shtetin e Epirit. Përmes fjalëve dhe termave kyçe ndërtohet në tabelë pema e mendimit-brainstorming.



Mendimet e nxënësve radhiten në tabelë, ndërsa gjatë diskutimit pesëminutësh mbi termat rrethohen ato që vlerësohen si më të rëndësishme.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – DRTA

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në këtë fazë do të zbatohet teknika DRTA. Në dërrasë ndërton modelin që do të ndiqet për të organizuar informacionin sipas rubrikave përkatëse. Nxënësit mbajnë shënime dhe dëgjojnë me kujdes udhëzimet. Pas kësaj nis puna me tekstin.

“√” Informacioni është i njohur	“_” Informacioni që dija ndryshon nga ky që ka teksti	“+” Informacioni është i ri	“?” Informacioni është i paqartë
Emërtimi epirotë u dedikohet autorëve antikë, të cilët quanin me këtë emër banorët që jetonin në tokën apeiros përballë ishullit të Korkyrës. Territori i banuar nga epirotët kufizohej në veri me ilirët, në jug me grekët, në perëndim nga deti Jon, në verilindje nga maqedonasit dhe, në lindje nga thesalët. Epiri banohej nga fise të shumta, por fiset më të rëndësishme që luajtën rol kryesor ishin: <i>kaonët</i> , <i>thesprotët</i> dhe <i>molosët</i> .	Si mbret i parë i molosëve njihet <i>Admeti</i> , në fillim të shek. V.p.e. s., kurse më mirë njihet sundimi i mbretit <i>Tharypa</i> (423-385 p.e.s.).	Si pasues i Tharypës, në fronin molos, vjen Alketa (385-370 p.e.s.) i biri i tij, i cili mori fronin me ndihmën e Dionisit, sundimtari i Sirakuzës dhe i ilirëve.	Megjithatë, vetë autorët antikë grekë na bëjnë me dije se Hellada fillon përtej gjirit të Ambrakisë (Straboni VIII,1: Efori thotë se fillimi i Helladës është Akarnania nga ana e perëndimit, sepse kjo takon e para me fiset epirote), çka do të thotë se Epiri nuk ishte pjesë e Helladës. Po sipas Strabonit (Libri VII,4): ata që kalojnë këtë rrugë (Egnatia) duke u nisur nga viset pranë Epidamnit dhe Apollonisë, në të djathtë kanë fiset e Epirit, që lagen nga deti i Siqelisë gjer në gjirin e Ambrakisë.

Tabela është një model, secili nxënës mund të ketë një organizim ndryshe, në varësi të nivelit mësimor që ka. Secili prej tyre duhet të punojë dhe të shprehet lirshëm, me qëllim rritjen e interesit dhe realizimin me sukses të rezultateve të kompetencave.

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim

Gjatë kësaj faze hapet diskutimi në klasë për pohimin:

Epiri nuk është pjesë e Helladës, por e Ilirisë.

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni më shumë informacion dhe formuloni përgjithësime për pyetjet e mëposhtme:

- Cila është origjina e epirotëve sipas autorëve antikë grekë?
- Cilat janë pikëpamjet kundër origjinës ilire të tyre?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Arsimi, kultura, besimi tek ilirët sipas autorëve antikë		Situata e të nxënit: Lexohet dhe diskutohet dokumenti 1. “Babai i historisë”, Herodoti, në shekullin e V p. I. K., shkruan: “Shtëpitë e tyre (ilirëve) janë ndërtuar në këtë mënyrë: në mes të liqenit, mbi trarë të vënë kryq, janë vendosur shtroja dërrasash. Ato lidhen me tokën me anë të një ure. Atje rrojnë në këtë mënyrë: secili mbi këto shtroja ka një kasolle, në të cilën banon dhe ka një qepen të lidhur mirë, i cili shërben për të zbritur poshtë në liqen. Fëmijët e vegjël i lidhin për këmbë me litar, nga frika se mos bien poshtë në liqen...”	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vlerëson disa burime historike të autorëve antikë grekë dhe romakë për kulturën ilire, gjuhën, simbolet, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët, praktikën e besimit dhe varrimit. • Përshkruan tipare të artit, kulturës dhe besimit tek ilirët. • Identifikon vazhdimësinë iliro-shqiptare në këto fusha.		Fjalët kyçe: prejardhje indoeuropiane, bazilika, terrakota, kulti i tokës mëmë, kulti i Diellit, kulti i gjarprit.	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Nga Ilirët te shqiptarët, N. Ceka; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK, Artet figurative.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE	P- PËRFORCIMI
Përgatitja për të nxënit (10min)	Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	Përforsimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe(indoeuropiane, bazilika, terrakota, kulti i tokës, kulti i Diellit, kulti i gjarprit) dhe u kërkon nxënësve që të ndërtojnë fjali me to, të cilat synojnë shpjegimin e tyre. Për ato fjalë që nuk njihen mjaftueshëm nga ana e nxënësve, mësuesi/ja nis bashkëbisedimin me qëllimin përforsimin e tyre.

Bashkëbisedimi nxitet edhe përmes pyetjeve të tilla:

1. Si janë trashëguar kultet ilire deri te shqiptarët?
2. Pse interesoheshin autorët antikë për Ilirinë (rasti i Homerit dhe Herodotit, merret si shembull)?

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – punë në dyshe

Nxënësit duhet të organizohen në dyshe (mund të ruani vendosjen e tyre nëpër banka, nëse e shihni të arsyeshme). Pasi të jenë organizuar, u caktohen pjesë nga teksti për lexim secilës dyshe nxënësish. Përmes ndihmës së njëri-tjetrit ata organizojnë informacionin sipas rubrikave të caktuara.

Rubrikat	Informacioni i organizuar	
Gjuha ilire	• Është një ndër gjuhët më të vjetra, me prejardhje indoeuropiane. • Kishte ngjashmëri të mëdha me gjuhën trake. • Edhe pse nuk ka burime të shkruara, ka dëshmi të shumta që vërtetojnë ekzistencën e saj, në formën e toponimeve, emrave vetjakë, fjalëve të ndryshme etj. • Autorët antikë thonë se ilirët kishin gjuhën e tyre, e cila ndryshonte nga ajo latine dhe greke.	
Arti	• Përbën një element të rëndësishëm të shoqërisë antike ilire. • Shfaqet në aspekte të ndryshme të jetës si: në zbukurimet e veshjes, në formën e unazave, inventarët e varreve etj. • Dëshmohet në mjeshtëritë e ndërtimeve të veçanta (mozaikë, bazilika). • U ndikua nga arti grek dhe romak, falë marrëdhënieve të shpeshta që kishin me ta.	
Besimi	Pagan	• Ilirët kishin të tyret kultet e tokës mëmë, diellit dhe gjarprit. • Gjatë kontaktit me botën greke, u përhap në Iliri Panteoni grek i perëndive. • E njëjta gjë ndodhi edhe gjatë pushtimit romak në territorin ilir.
	Krishterimi	• U përhap që në shekujt e parë tek ilirët. • Ka dëshmi të prezencës së Shën Palit dhe dishepujve të tjerë, në territorin ilir. • Nisi ndërtimi i bazilikave, duke filluar nga shek. IV e.s.
Arsyet përse autorët antikë shkruan për Ilirinë dhe ilirët	• Burimet kryesore për ilirët i gjemë tek autorët grekë dhe romakë. • Ishin fqinjë dhe ishte normale të interesoheshin për ta. • Në Iliri janë zhvilluar ngjarje me rëndësi politike dhe ushtarake (fushata ushtarake e Pirros, qëndrimi i Oktavianit në Apolloni etj.). • Iliria ishte një territor i madh, ndër më të mëdhenjtë në Ballkan dhe pa diskutim që tërhiqte vëmendjen e historianëve dhe gjeografëve të antikitetit.	

Faza e tretë: Përfundimi – punë me tekstin

Gjatë kësaj faze kalohet gradualisht në këto hapa:

- Bëhet interpretimi i imazheve që janë vendosur në tekst në funksion të njohurive të reja.
- Vëzhgohet harta arkeologjike dhe lokalizohen kishat në: Bylis, Lin, Mesaplik, Butrint.
- Nxirren përfundime nga Dokumenti i Herodotit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion: Pse ngjashmëritë më të mëdha të ilirishtes ishin me gjuhën trake? Formuloni gjykimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Ndikimi i qytetërimit greko-romak në kulturën ilire. Shoqëria ilire.		Situata e të nxënit: Via Egnatia është ndërtuar për të lehtësuar qarkullimin e lirë të njerëzve, si dhe për të realizuar lidhjen e Romës me provincat më të largëta. Ajo fillonte nga Durrësi dhe nëpërmjet Ohrit e Selanikut të shpinte në Kostandinopojë. Me një gjatësi rreth 861 km, Via Egnatia ka qenë e përshtatshme për lëvizjen e udhëtarëve dhe të karvanëve.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire nga ndikimi i qytetërimit grek dhe romak. - Përcakton format e organizimit shoqëror dhe mënyrat e jetesës në shoqërinë ilire. - Krahason kulturën ilire me atë të shqiptarëve sot.		Fjalët kyçe: qytete koloni, panteoni romak, portreti romak, togati, proces romanizimi, qëndresa ilire.	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë. S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Nga Ilirët te shqiptarët, N. Ceka; Interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Gjatë kësaj faze lexohet situata e të nxënësve, e cila shoqërohet me disa fotografi dhe harta të rrugës së antikitetit, “Egnatia”. Pas kësaj nxënësit nxiten në një bashkëbisedim mbi rëndësinë e kësaj rruge në të kaluarën dhe sot. Për të arritur një pjesëmarrje më të gjerë të nxënësve, mësuesi/ja ndërhyr herë pas here me pyetje nxitëse.

1. Si e konsideroni faktin që ishin romakët që e ndërtuan këtë rrugë?
2. Sa me vend ju duket shprehja: “udhëtarë, rrugët bëhen duke ecur”?
3. A mund të përdoret edhe sot rruga “Egnatia”?

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Grupi i ekspertëve

Klasa organizohet në disa grupe me 4 anëtarë. Secili anëtar është në rolin e një eksperti. Atyre u jepet nga një numër identifikimi. Secili numër ka një detyrë specifike. Fillimisht ekspertët mbledhen së bashku dhe punojnë rreth çështjes që u caktohet. Ata i japin zgjidhjen e saktë secilës pyetje, nën mbështetjen e vazhdueshme të mësuesit/es. Pasi është arritur realizimi i secilës detyrë, ekspertët rikthehen në grupet fillestare dhe i ndajnë dijet e fituara me anëtarët e tjerë.

• Eksperti nr. 1 – Ndikimi i qytetërimit grek në Iliri

U jep përgjigje pyetjeve:

1. Cilët faktorë kushtëzuan përhapjen e qytetërimit grek në Iliri?
2. Si ndikoi qytetërimi grek në tregti?
3. Në cilat fusha ishte më i ndjeshëm ndikimi i qytetërimit grek?
4. Analizoni, nivelin e ndikimit grek te fiset e ndryshme ilire.

• Eksperti nr. 2 – Roma pushton Ilirinë. Qëndresa ilire ndaj sundimit romak

U jep përgjigje pyetjeve:

1. Kur u shtri sundimi romak në Iliri?
2. A ishte i njëjtë ky sundim në të gjithë territorin?
3. Si reagues ilirët ndaj sundimit romak?
4. Analizoni kryengritjen e viteve 6-9 kundër sundimit romak.

• **Eksperti nr. 3 – Ndikimi i qytetërimit romak në Iliri**

U jep përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Si u shfaq ndikimi i qytetërimit romak tek ilirët në fushën e arkitekturës, gjuhës dhe artit?
2. Si u zbatua “E drejta romake” në Iliri?
3. Po ilirët ndikuan te romakët? (lidheni me perandorët romakë me origjinë ilire)
4. Analizoni procesin e romanizmit në Iliri.

• **Eksperti nr. 4 – Mënyra e jetesës tek ilirët**

U jep përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Çfarë tregon për ilirët krijimi i qyteteve që në shekujt V-IV pr.l.k?
2. Cilat ishin tiparet e zhvillimit ekonomik tek ilirët?
3. Tregoni ndryshimet negative dhe pozitive të zhvillimit ekonomik në Iliri.
4. Analizoni mënyrën e jetesës së ilirëve në raport me fqinjët grekë dhe romakë.

Faza e tretë: Përforcimi – prezantim i gjetjeve

Në këtë fazë, grupet e ekspertëve e kanë mbaruar detyrën. Atyre u është dhënë një letër me përmasa 50 x 60 (tabak i bardhë), në të cilin përmbledhen gjetjet e tyre. Zgjidhet njëri prej anëtarëve që të bëjë prezantimin e tyre ose secili ekspert brenda grupit prezanton gjetjet e veta. Në fund të prezantimeve, mësuesi/ja bën vlerësime individuale dhe në grup.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit individualisht dhe në grup për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion për:

- a. Ndikimin e qytetërimit grek dhe romak në Iliri/ vendbanimin tuaj.
 - b. Mënyrën e jetesës së fisit ilir që ka banuar në vendbanimin tuaj. Gjeni të përbashkëtat e mënyrës së jetesës së tyre me mënyrën e jetesës së banorëve të vendbanimit tuaj.
- Formuloni përfundimet tuaja.


Planifikimi ditor i orës së mësimimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Transformimet e Perandorisë Romake dhe hapësira ilire në Mesjetën e Hershme (shek. IV-VI)		Situata e të nxënimit: Burimet e shkruara antike përmendin Probin, sundimtari i Ilirikut, i cili që nga fundi i shek. III e. sonë, duke mbledhur taksat në mënyrë të padrejtë, i kishte dobësuar krahinat veriore ilire, para se ato të shkatërroheshin nga barbarët. Çfarë ju tregon kjo e dhënë për gjendjen e Perandorisë Romake?	
Rezultatet e të nxënimit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton shkaqet e kalimit të qendrës së perandorisë nga Roma në Kostandinopojë. • Përshkruan tiparet e jetës sociale dhe ekonomike të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI). • Vlerëson qytetet, portet dhe arteriet e rëndësishme rrugore të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI).		Fjalët kyçe: latifonde, ekonomi feudale, Kodeksi i Justinianit, Kodeksi i Theodosit.	
Burimet: Roma e Lashtë, R. Gjini; teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë, S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënimit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë – Parashikimi – Braingstorming


Nxënësit kanë marrë shumë njohuri deri momentalisht në lidhje me Perandorinë Romake, prandaj mund të zhvillohet me shumë sukses teknika braingstorming rreth saj. Në tabelë renditet çdo e dhënë që vjen nga nxënësit për Perandorinë Romake, që nga krijimi e deri te rënia e saj.



Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – pema e mendjes – lexim i orientuar i tekstit

Në këtë fazë, mësuesi/ja i orienton nxënësit në leximin e tekstit për një lexim më frytdhënës, orientohen nxënësit që të fokusohen në gjetjen e përgjigjeve për këto pyetje.

1. Cilat ishin shkaqet e krizës në Perandorinë Romake që u shfaq që nga shek. III? Po pasojat?
 2. Në cilat aspekte dëshmohet se Perandoria Romake ishte në krizë?
 3. Cilat ishin shkaqet e ndryshimeve të shumta në hapësirën ilire në shek. IV-VI?
 4. Cilat ishin veçoritë dhe pasojat e krizës në Iliri? Si e dëshmojmë?
- Pas një leximi intensiv, gjetjet e nxënësve organizohen nga mësuesi/ja në tabelë në formën e Pemës së mendjes.



Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Në këtë fazë, mësuesi/ja i fton nxënësit në diskutim në lidhje me çështjet:

- Roli i latifondeve në ekonominë romake.
- Apolonia u braktis gjatë periudhës së krizës. Pse?

Korrupsioni në radhët e administratës civile dhe gjyqësore në Perandorinë Romake.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra: Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime:

Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Kalimin e qendrës së perandorisë nga Roma në Kostandinopojë?
- b. Tiparet e jetës sociale dhe ekonomike të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI).
- c. Qytetet, portet dhe arteriet e rëndësishme rrugore të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI).

Planifikimi ditor i orës së mësim		Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI
Tema mësimore: Dyndjet e popujve dhe ndryshimi i përbërjes etnike në Ballkan		Klasa: XII
Rezultatet e të nxën		Situata e të nxën
Nxënësi:		
• Evidenton lëvizjet e popujve në Ballkan dhe pasojat e tyre.		
• Tregon në hartë shtrirjen e hapësirës shqiptare dhe të sllavëve në Ballkan.		
• Shpjegon ndryshimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Europën Perëndimore gjatë dhe pas dyndjeve të popujve.		
Burimet: Roma e Lashtë, R. Gjini; teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë, S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
P- PARASHIKIMI	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE	P- PËRFORCIMI
Përgatitja për të nxën	Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – PTP

Gjatë kësaj faze është e këshillueshme të përdoret teknika PTP (Parashikim me Terma Paraprakë). Nxënësve u jepen termat kyçe, të cilat do të përdoren për të ndërtuar një tekst historik. Për realizimin e tij, nxënësi mund të punojë individualisht ose në dyshe me shokun e bankës. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës lexojnë tekstin e shkruar para klasës.

“Barbarë, Perandoria Romake e Perëndimit, Hunë, gotë, vizigotë, sllavë, Perandoria Bizantine, tkurrje.”

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Pyetja sjell përgjigjen

Nxënësit orientohen në tekst, në faqet 55-57, për të lexuar në heshtje për gati 4 minuta. Pas kësaj kalohet në përpunimin e përmbajtjes përmes teknikës “Pyetja sjell përgjigjen”.

Mësuesi/ja hedh në qarkullim një pyetje dhe merr nga nxënësit përgjigjet e mundshme. Në rast se përgjigjet nuk janë të nivelit të pritshëm, atëherë ndërhyjnë mësuesi/ja me përgjigjen e plotë e të saktë.

Pyetja nr. 1 - Kush ishin popujt barbarë që u dyndën në Europë në shek. IV?

Barbarët e shek. IV konsideroheshin ata popuj që nuk ishin pjesë e Perandorisë Romake. Mes tyre përmenden: hunët, gotët, vizigotët, frankët etj.

Pyetja nr. 2 - A u dyndën barbarët edhe në territoret ilire?

Po. Barbarët mbërritën edhe në trojet ilire. Të dhënat tregojnë se në vitin 378 vizigotët arritën në brigjet e Adriatikut dhe, pasi morën miratimin e perandorit Theodos, u vendosën në veri dhe perëndim të gadishullit Ballkanik. Në vitin 383 gotët shkatërruan Apolloninë, ndërsa deri në vitin 392 shkatërruan Bylisin. Ndërsa hunët nën drejtimin e Atilës u dyndën në pjesën Veriore dhe Lindore të Ballkanit.

Pyetja nr. 3 – A i kishin të dyja anët e medaljes dyndjet barbare?

Dyndjet barbare shpesh ishin të ashpra dhe hera-herës jo. Kjo për faktin se popujt barbarë shpesh arritën


marrëveshje me Perandorinë, e cila kishte hyrë në marrëdhënie me disa prej tyre. Barbarët përfshiheshin në ushtrinë romake ose paguheshin për të mbrojtur territoret kufitare të saj. Por nuk ishin të pakta rastet kur këto marrëveshje shkeleshin, duke u bërë shkas që barbarët të sulmonin Perandorinë në shenjë pakënaqësie.

Dhe vazhdohet kështu me secilën prej pyetjeve që diktohet nga ana e mësuesit/es.

1. Kur u nda Perandoria Romake, cili ishte fati i trojeve ilire?
2. Cilat janë dallimet mes dyndjeve barbare dhe dyndjeve sllave?
3. Me cilat pasoja u përballën territoret e Perandorisë Romake të Perëndimit dhe Perandorisë Bizantine gjatë dyndjeve barbaro-sllave?
4. Sa ndikuan dyndjet barbare në përçarjen apo bashkimin e banorëve të krahinave ilire?

Faza e tretë: Përforcimi – Diagram Veni

Në këtë fazë, ndaloni në krahasimin e natyrës së popujve barbarë dhe popujve sllavë, të cilët u dyndën në Ballkan e më gjerë në Europë. Të dhënat nxënësit i prezantojnë në një diagram Veni që e hartojnë në fletoren e tyre të klasës. Mësuesi/ja punon modelin e përgjithshëm në tabelë dhe e plotëson me ndihmën e nxënësve.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në plotësimin e secilës teknikë mësimore me sukses.

Detyra:

Lexoni dokumentin dhe shkruani të dhënat kryesore për të; refleksionin tuaj mbi mesazhin që përcjell.


Planifikimi ditor i orës së mësimimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Vazhdimësia ilire-arbërore		Situata e të nxënimit: “Ilirë ishim, arbër u bëmë, albanë na thërrasin, shqiptarë përgjigjemi!” N. Bacaj. Pse ka ndryshuar emri i shqiptarëve ndër shekuj?	
Rezultatet e të nxënimit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon të dhënat për vazhdimësinë ilire-arbërore. • Vlerëson vazhdimësinë ilire-arbërore në vendbanim. • Diskuton mbi ecurinë e emrit tonë nga ilirë-arbër në shqiptarë.		Fjalët kyçe: kulturë e Komanit, krishterim, kler, Sinode të Shenjta, arbër, marrëdhënie feudale, kronistë bizantinë, bazilika paleokristiane, qendra peshkopale, logjika linguistike	
Burimet: Teksti mësimor; Ilirët dhe Iliria, tek autorët antikë, S. Islami, F. Prenda, H. Ceka, S. Anamali; Historia e Popullit shqiptar, Vol. II; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënimit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim për njohuritë paraprake

Lexohet situata e të nxënësve. Në dërrasë shkruhet shprehja “Ilirë ishim, albanë na thërrasin, shqiptarë përgjigjemi!”. U kërkohet nxënësve të rikujtojnë njohuritë e mëparshme në lidhje me vazhdimësinë etnokulturore mes ilirëve-arbërve dhe shqiptarëve. Diskutimi nxitet nga mësuesi/ja edhe përmes pyetjeve të momentit që mund të lindin gjatë diskutimit.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Organizuesi grafik – Komentim i dokumenteve

Dhënia e informacionit të ri realizohet përmes një ndërthurjeje të dy teknikave. Fillimisht lexohet dokumenti nr. 1 që lidhet me shënimet e Strabonit për periudhën e shek. IV. Pas leximit të tij, mësuesi/ja organizon informacionin për Ilirinë e shekujve të dyndjeve barbare.



Kalohet në leximin e dokumentit nr. 2 që lidhet me emrin mesjetar të shqiptarëve. Pas leximit të tij, kërkohet mendimi i nxënësve për këtë dokument e më tej kalohet në organizimin e informacionit të ri në tabelë nga ana e mësuesit/es, në dy grafikë.



Faza e tretë: Përforsimi – Punë me tekstin

Për të përforsuar më tej njohuritë e fituara, kalohet në interpretimin e fotove të dhëna në tekst. Fotot janë një burim i madh informacioni dhe mund të nxisin diskutimin në mënyrë tërësisht spontane, ndaj këshillohet të mos anashkalohen.

Nxënësve u drejtohet pyetja:

- **Cili është mesazhi që ju përcjellin këto imazhe në lidhje me vazhdimësinë iliro-arbërore?**

Mësuesi/ja mund të përzgjedhë edhe imazhe të tjera dhe t'ua shpërndajë nxënësve për ta bërë edhe interesante këtë fazë të mësimi.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në plotësimin e organizuesve të informacionit.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për: Vazhdimësinë iliro-arbërore në vendbanimin tuaj. Shoqëroni përfundimet me dokumente dhe ilustrime që e dëshmojnë këtë vazhdimësi. Vendoseni punimin në portofolin e të nxënësit.

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Arbëria në përballjen Lindje-Perëndim		Situata e të nxënit: Një pjesë e kryqëzatave kaloi mespërmes Shqipërisë. Ata kaluan nëpër “Rrugën Mbretërore”, përgjatë luginës së lumit Shkumbin. Kryqtarët i shkaktuan popullsisë vendëse mjerime të pallogaritshme.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Arsyeton përfshirjen e arbërve në konfliktet e normanëve dhe anzhuinëve me Perandorinë Bizantine. • Përcakton në hartë hapësirën ku kaluan normanët, anzhuinët dhe kryqtarët. • Përcakton pasojat e kalimit të kryqtarëve në territoret arbërore.		Fjalët kyçe: Mbretëria e Sigelisë, dinastia normane, kryqëzatat katolike, dinastia anzhuine, kryqtarë, troje arbërore, despot.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti http://www.drita.info/2016/08/11/		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Në videoprojektor shfaqet pamja e hartës së kryqëzatave kryesore. Në pamundësi të videoprojektorit përdoret imazhi në tekst (faqe 62). Përmes hartës, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

1. Çfarë ishin kryqëzatat?
2. Cilat ishin kryqëzatat më të rëndësishme?
3. A mund të shpjegoni qëllimet e vërteta të kryqëzatave, duke u mbështetur në rrugën e ndjekur prej tyre?
4. Cilat territore i vuajtën më shumë pasojat e kryqëzatave.
E rëndësishme është që gjatë bashkëbisedimit të sigurohet pjesëmarrje e madhe e nxënësve të klasës, sidomos e niveleve të ndryshme.


Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Tabela kronologjike

Lexohet me vëmendje teksti. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që gjatë leximit të nënvizojnë ngjarjet kryesore së bashku me vitet në të cilat kanë ndodhur. Nxënësve u bëhet e qartë që ky veprim do t’u shërbejë gjatë plotësimit të tabelës kronologjike. Secili nxënës angazhohet për të qenë pjesë aktive e etapës vijuese.

Viti	1071	1081	1096-1099	1149	1185	1272	1274	1280
N G J A R J A	Mbretëria e Siqelisë fillon sundimin dyshekullor në territoret arbërore. Synimi ishte ekspansioni drejt Konstandi-nopojës.	Trupat normane, të Mbretërisë së Siqelisë, zbarkuan në Vlorë e Butrint dhe filluan avancimin drejt Durrësit. Bizantinët kërkojnë ndihmën e flotës veneciane.	Kryqtarët kaluan në territoret arbërore, madje këto të fundit u shndërruan në furnizuese të ushtrive në kalim të kryqtarëve.	Normanët, në drejtimin e mbretit Ruxheri II, zbarkuan në Korfuz dhe u drejtuan në veri. Avancimi i tyre u ndërpre shpejt.	Tentativa e fundit e normanëve për zbarkim në bregdetin arbëror. Nën drejtimin e mbretit Guljelm I morën Durrësin dhe më pas marshuan drejt Selanikut.	Karli I Anzhu ra dakord me fisnikët vendës arbër për bashkimin e Mbretërisë së Arbrit me atë anzhuine.	Fisnikët arbër, të pakënaqur nga bashkë-punimi me anxhuinët, u rikthyen në anën e bizantinëve. Së bashku i mundën anxhuinët në këtë vit.	Beteja për marrjen e Beratit, anxhuinët u thyen.

Faza e tretë: Përforsimi – Punë me tekstin

Në këtë fazë, vëmendja përqendrohet te marrëveshja mes Karlit I Anzhu dhe fisnikëve vendës. Nxënësit shkruajnë në fletore pikat kryesore të kësaj marrëveshjeje së bashku me pasojat që reflektoi në shoqërinë arbërore. Mund të përdoret një model i tillë:



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni qëndrimet tuaja.


a. Cili është refleksioni juaj mbi përballjen e arbërve me konfliktin lindje-perëndim? Si e vlerësoni qëndrimin e tyre?

b. “Me kryqëzatat, Europa Perëndimore luajti për herë të parë rol kryesor ndërkombëtar”. Pse?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Dobësimi i Bizantit në Ballkan		Situata e të nxënit: R. Kroulej shkruan: “Për Konstandinin, një mbrojtje e suksesshme e qytetit, varej nga ndihma e Europës së krishterë. Raundi i pafundmë i misioneve diplomatike që i parapriu rrethimit, u ndërmor për të kërkuar, para, trupa ushtarake dhe mjete materiale për kauzën e krishterimit. Përditë, qytetarët e Kostandinopojës shohin në drejtim të detit për ndonjë flotë – një skuadron të galerave veneciane apo gjenoveze...Por deti mbeti qëllimisht i zbrazët”.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon shkaqet e rënies së Kostandinopojës (1204). • Evidenton formacionet shtetërore latine dhe bizantine që u krijuan pas vitit 1204 në hapësirën bizantine. • Përshkruan marrëdhënien e Arbërisë me Despotatin e Epirit. • Përcakton raportin e Arbërisë me Perandorinë e Nikesë. • Shpjegon rolin e Arbërisë në rivalitetin mes Despotatit të Epirit dhe Perandorisë së Nikesë.		Fjalët kyçe: Perandoria Bizantine, Kryqëzata IV, Mbretëria e Sigelisë, Republika e Venedikut (e Shën Markut), Perandoria e Nikesë, Despotati i Epirit (Despotati i Artës).	
Burimet: Teksti mësimor; interneti; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; Lufta e Shenjtë për Kostandinopojën dhe përplasja e islamit me Perëndimin”, Roxher Kroulej		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim - Braingstorming

Nxënësit rikujtojnë njohuritë paraprake në lidhje me dy konceptet kryesore që do të trajtohen në këtë temë mësimore. Idetë organizohen në tabelë, në formën e braingstroming. Pas përfundimit të ideve bashkëbisedohet në lidhje me arsyet që mund të kenë ndikuar në dobësimin e Perandorisë Bizantine.



Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Ditari dypjesësh

Gjatë kësaj faze, nxënësit i hedhin një sy të shpejtë informacionit në tekst. Më pas, ata plotësojnë në fletore ditarin dypjesësh sipas modelit që mësuesi/ja paraqet në tabelë.

Di	Mësova
Kryqëzatat ndikuan në dobësimin e ndikimit të Perandorisë Bizantine në Ballkan	Shkaqet e dobësimit lidhen me disa faktorë, mes të cilëve: • Konfliktet e vazhdueshme mes Perandorisë Bizantine dhe Mbretërisë së Siqelisë. • Fuqizimi në rritje i formacioneve shtetërore në Ballkan si serbët. • Rivaliteti tregtar midis venecianëve dhe bizantinëve. • Kryqëzata IV i dha goditjen e fundit Perandorisë Bizantine më 13 prill 1204. • Në territorin bizantin u krijuan disa shtete latine. Përfituesi kryesor në këtë situatë ishte Republika e Venedikut.
Rënia e Kostandinopojës nxiti krijimin e formacioneve shtetërore në hapësirën bizantine.	• Kryqtarët krijuan disa mbretëri të krishtera në Lindje. • Normanët krijuan Principatën e tyre. • U krijua Perandoria e Nikesë. • U krijua Despotati i Epirit.
Despotati i Epirit njihet ndryshe edhe si Despotati i Artës, pasi Arta ishte kryeqendra e tij. Drejtuesi i parë i despotatit ishte Mihali I Engjëll.	• Fillesat e Despotatit datojnë pas Kryqëzatës IV (1204). • Despotati shtrihej në veri deri në malet Akrokeraune, në jug deri në gjirin e Artës, në perëndim deri në Berat dhe në lindje deri në malet e Pindit. • Përbërja e popullsisë ishte heterogjene: arbër pjesa më e madhe dhe të tjerët ishin vllahë, grekë, sllavë. • Qytetet më të rëndësishme të Despotatit kanë qenë: Janina, Paramithia, Berati, Kanina, Durrësi. • Drejtuesit e tij kanë qenë: Mihali I Engjëll, Tedori, Mihali II Engjëll.
Marrëdhëniet e Despotatit të Epirit me Perandorinë Bizantine kanë qenë kryesisht konfliktuale.	• Sundimtarët e despotatit ishin bizantinë dhe e cilësonin veten trashëgimtarë të P. Bizantine. • Me ardhjen në krye të Despotatit të Epirit, Teodorit dhe në krye të P. Bizantine të perandorit të vetëshpallur latin Pier dë Kurtëne, marrëdhëniet mes tyre u acaruan. Teodori i theu trupat latine që kishin zbarkuar në Durrës, në vitin 1217, duke zënë rob dhe Kurtënenë. Pas kësaj Teodori e shpalli veten perandor autokrat të bizantinëve. • Mihali II Engjëll, pasi mori drejtimin e Despotatit, iu rikthye politikës ekspansioniste, duke hyrë në rivalitet me Perandorinë e Nikesë. Kjo e fundit mori edhe mbështetjen e fisnikëve arbërorë të pakënaqur nga politika e Mihalit II. Në vitin 1253, aleanca arbërore-nikease triumfoi mbi Despotatin, ndërsa në vitin 1256 morën Durrësin. • Ardhja në krye të Perandorisë së Nikesë së Mihalit III paleolog i dha goditjen përfundimtare Despotatit të Epirit, ndërsa i hapi rrugën zotërimit të Kostandinopojës, të cilën e mori në vitin 1261.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Gjatë kësaj faze nxënësit vazhdojnë punën me tekstin, duke identifikuar konceptet kyçe, të cilat i shpjegojnë duke i shkruar në fletore sipas shembullit.

Koncepti	Shpjegimi
Perandoria Bizantine Despotati i Epirit Mbretëria e Siqelisë Perandoria e Nikesë	

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në plotësimin e detyrave në secilën etapë mësimore.

Detyra: Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni qëndrimet tuaja.


Cili është refleksioni juaj mbi dobësimin e Bizantit në Ballkan dhe qëndrimin e arbërve në këtë proces? Pse?

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUHDHËN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)

Planifikimi ditor i orës së mësimimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Formacionet shtetërore në trevat arbërore (shek. XII)		Situata e të nxënit: Në një letër që Papa i dërgonte Dhimitrit më 1208 e quante këtë kryezot "Nobili Viro Demetrio arbanesi principi" d.m.th. "burrë fisnik, princ i arbëreshëve". Më 1909, Papa në një letër të dytë e quan atë me një titull akoma më të lartë juridik "Judex" d.m.th. "Gjykatësi i arbëreshëve". Çfarë tregon kjo për fuqinë e Dhimitrit?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon gjendjen politike në Ballkan në shek. XII. • Shpjegon kushtet e krijimit të Principatës së Arbrit (shek. XII). • Gjykon mbi mënyrën e organizimit dhe të qeverisjes së Principatës së Arbrit.		Fjalët kyçe: Principata e Arbrit, principes, familja e Skurajve.	
Burimet: Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Braingstorming

Gjatë kësaj faze, nxiten nxënësit për të marrë pjesë përmes njohurive paraprake në realizimin e teknikës braingstormig. Nxënësit risjellin në klasë të gjitha dijet që mbajnë mend në lidhje me termin "principatë".





Ideat e nxënësve renditen në tabelë, pavarësisht saktësisë. Le të jetë klasa ajo që do të vendosë pasi të jetë realizuar braingstorming se cilat përgjigje janë të sakta e cilat prej tyre duhen fshirë.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Organizuesi grafik i informacionit – Punë me gjithë klasën

Nxënësit familjarizohen me tekstin për rreth tre minuta. Mësuesi/ja gjatë kësaj kohe realizon në tabelë skema për të organizuar në mënyrë grafike informacionin e ri. Gjatë plotësimit të skemave, nxitet pjesëmarrja aktive e gjithë klasës.





Faza e tretë: Përforcimi – Diskutim

Në këtë fazë i fton nxënësit në diskutim në lidhje me çështjen:

Roli i Principatës së Arbrit në themelet e shtetit të parë shqiptar.

Jepen mendime të ndryshme, ndërsa mësuesi/ja orienton diskutimin përmes ndërhyrjeve, nëse janë të domosdoshme.


Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve gjatë diskutimit dhe përfshirjen në plotësimin e skemave.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për formacionin shtetëror mesjetar të vendbanimit tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Principatat kryesore arbërore, shek. XIV-XV. Tiparet dhe mënyra e qeverisjes.		Situata e të nxënit: Gjergj I Balsha, Gjergj Balsha II, Leka I Dukagjini, Teodor Muzaka, Andrea Topia, Karl Topia, Gjin Bue Shpata, Gjon Kastrioti. Cili ka qenë roli dhe statusi i këtyre figurave historike në historinë arbërore mesjetare?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Shpjegon shkaqet e zhvillimit të principatave arbërore në shek. XIV, tiparet dhe mënyrën e tyre të qeverisjes. - Tregon ndërveprimin mes principatave arbërore dhe formacioneve të tjera shtetërore në Ballkan.		Fjalët kyçe: Principata e Balshajve, Principata e Dukagjinit, Principata e Gjirokastrës (Zenëbishtëve), Principata e Muzakajve, Principata e Topiajve, Despotati i Artës (Epirit), Principata e Arianitëve, Principata e Shpatajve (Çamëri), Principata e Kastriotëve.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim Mësuesi/ja prezanton para klasës situatën e të nxënit dhe i fton nxënësit të bashkëbisedojnë rreth figurave historike që lidhen me periudhën e krijimit dhe ekzistencës së principatave kryesore në radhët e arbërve.			
Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Lexim i orientuar – Kllaster Orientohen nxënësit në leximin e tekstit. Sipas ndarjes në rreshta, nxënësit orientohen të lexojnë në çështje të caktuara të mësimi. Ndërkohë, në tabelë organizohet skema e kllasterit, e cila do të plotësohet në bashkëpunim me gjithë klasën. Secili rresht jep kontributin e tij në plotësimin e rubrikave për të cilat ka lexuar.			
Faza e tretë: Përforcimi – Punë me tekstin – Diskutim Në këtë fazë, vëmendja ndalet në çështjen e tretë të mësimi. Pasi përvetësohet informacioni, hidhet tema për diskutim. Sa të rëndësishme ishin lidhjet martesore në mesjetë për të garantuar aleancat? Nxënësit sjellin mendimet e tyre, përmes shembujve nga historia shqiptare dhe ajo botërore.			

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve, pjesëmarrjen në diskutim dhe përfshirjen në plotësimin e kllasterit.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

a. Shkaqet e zhvillimit të principatave arbërore në shek. XIV, tiparet dhe mënyrën e tyre të qeverisjes.

b. Ndërveprimin mes principatave arbërore dhe formacioneve të tjera shtetërore në Ballkan.

Formuloni përgjithësime.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUHDHËN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Republika e Venedikut (Shën Markut) dhe zotërimet veneciane në Arbëri		Situata e të nxënësve: Arbëria Venedikase (Albania vënetë) është një koncept historiko-geografik i përdorur për zotërimet venedikase të përtej detit në Dalmacinë Jugore dhe në krahinën e Shkodrës, territore që tanimë i përkasin Malit të Zi dhe Shqipërisë.	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan marrëdhëniet midis Venedikut dhe Perandorisë Bizantine. • Përcakton në hartë shtrirjen e zotërimeve veneciane në Arbëri. • Shpjegon veprimtarinë ekonomike të Venedikut në Arbëri. • Tregon veçoritë e organizimit të qyteteve shqiptare nën administratën e Venedikut.		Fjalët kyçe: Republika e Shën Markut, Dukati Venecian i Durrësit, feude, Republika e Raguzës, Mbretëria e Hungarisë, Perandoria Bizantine, Dukagjinët, Balshajt, statutet e vetëqeverisjes, rektori.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Arbëria venedike, O.J. Schmit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE	P- PËRFORCIMI
Përgatitja për të nxënësit (10 min)	Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Në tabelë shkruhen togfjalëshat **“Albania Veneta”** dhe **“Dukati Venecian i Durrësit”**. Pyeten nxënësit nëse i kanë hasur më herët këto koncepte, cili është informacioni që kanë në lidhje me to?
 Diskutimi mund të nxitet edhe përmes imazheve të paraqitura në tekst, të cilat përdoren për orientim paraprak.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Ditari i të nxënësve- INSERT

U kërkohet nxënësve që në një fletë A4 të ndërtojnë skemën e INSERT. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë materialin e ri mësimor dhe të plotësojnë tabelën INSERT, sipas asaj që udhëzojnë shenjat:

“√” Për informacionin që njohin.

“-” Kur informacioni që hasen në tekst është i ndryshëm nga ai që ata kanë ditur më herët.

“+” Për informacionin e ri.

“?” Për informacionin e paqartë.

“√”	“-”	“+”	“?”
Republika e Venedikut, e njohur edhe si Republika e Shën Markut, e cila shtrihej në Italinë e Veriut gjatë mesjetës, ka luajtur një rol të rëndësishëm në hapësirën mesdhetare, pasi ishte fuqia kryesore detare në Mesdhe. Angazhimi i saj në Ballkan kishte synime tregtare.	Në synimet e saj për kontroll në tregtinë me arbrit, venecianët ishin në rivalitet me Republikën tregtare të Raguzës, por edhe me Mbretërinë e Hungarisë, e cila nga Paqja e Torinos e vitit 1381 siguronte interesat e saj në bregdetin nga Istria deri në Durrës.	Venecianët kaluan nga prania tregtare në atë ushtarake në bregdetin Jon dhe Adriatik, fillimisht me vendosjen e trupave të tyre në Korfuz në vitin 1386 dhe, pas marrëveshjes me princin arbëror Gjini Zebeishti, në Butrint, ku kryen edhe fortifikime të qytetit. Pas Butrintit, me kërkesën e princit Karl Topia si zotëruar i Durrësit, venecianët u vendosën edhe në këtë qytet, të cilin po ashtu e fortifikuan.	Shembullin e Karl Topisë e ndoqën Dukagjinët, të cilët u ofruan venecianëve me marrëveshje qytetin e Lezhës në vitin 1393. Tre vjet më vonë ishin Balshajt që u ofruan venecianëve kontrollin mbi Shkodrën, Drishtin, Shasin, Dejën dhe territoret përfaqë të tyre gjithnjë mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe.

Pasi është organizuar i gjithë informacioni sipas secilës shenjë, nxënësit krahasojnë dhe diskutojnë mes tyre mënyrën e vendosjes së shenjave.

Faza e tretë: Përforcimi – Pyetja binare

Gjatë kësaj faze, mësuesi i parapërgatit nxënësit për të diskutuar në lidhje me pyetjen binare. Klasa ndahet në dy grupe: Pro dhe Kundër. Hidhet çështja për diskutimet dhe priten argumentet përkatëse.



Bashkëpunimi mes venecianëve dhe arbërve ishte i domosdoshëm në rrethanat kur në Ballkan bëhej përherë e më i pranishëm rreziku osman

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Marrëdhëniet midis Venedikut dhe Perandorisë Bizantine.
- b. Shtrirjen e zotërimeve veneciane në Arbëri.
- c. Veprimtarinë ekonomike të Venedikut në Arbëri.
- d. Veçoritë e organizimit të qyteteve shqiptare nën administratën e Venedikut.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përhapja, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IV-XIV)		Situata e të nxënësve: <i>"Peshkopët e kishës romake Damasi, Valeriani dhe të tjerët që morën pjesë në Sinodin e Shenjtë (në Serdikë) përshëndesin vëllezërit e tyre të dashur nga zotipeshkopët në Ilirik, peshkopët e Ilirikut përshëndesin në emër të zotit kishat e perëndisë dhe peshkopët e dioqezës së Azisë, Frygisë, Karofrygisë dhe Pakatianës"</i> Theodoreti, historian kishtar shek. V.	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton rëndësinë e pjesëmarrjes së krerëve kishtarë shqiptarë në Sinodet e para Ekumenike. • Analizon ndryshimet e juridiksionit kishtar të trevave shqiptare ndërmjet Papatit të Romës dhe Patriarkanës së Kostandinopojës. • Shpjegon shkaqet politike dhe fetare të lkonoklastisë dhe shtrirjen e saj në hapësirën shqiptare (shek. VIII). • Shpjegon shkaqet që sollën Skizmën e Madhe (viti 1054). • Përcakton pasojat e Skizmës së Madhe në hapësirën shqiptare.		Fjalët kyçe: bazilikë paleokristiane, Sinodi i Shenjtë, Sinode Ekumenike, Iliriku, Shkodër, Justiniana Sekunda (në Dardani), Nikopojë, Durrës, kryepeshkopatë, peshkopatë, mitropoli, patriarkanë, ikonografi bizantine, vikar, kleri katolik, kleri ortodoks.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Shqipëria paraturke, M. Schuffai.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE	P- PËRFORCIMI
Përgatitja për të nxënësit (10 min)	Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Hapet mësimi me pyetjet frontale, të cilat e drejtojnë këtë etapë mësimore drejt një bashkëbisedimi të gjerë:

1. Cili është tipari thelbësor i besimeve fetare në vendin tonë?

2. Mendoni se bashkëjetesa fetare ka rrënjë të thella në shoqërinë tonë, apo është një shfaqje e kohëve bashkëkohore?

3. Jepni shembuj për të mbështetur mendimin tuaj.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Udhëzohen nxënësit që, gjatë leximit të informacionit të ri mësimor, të mbahen shënime në mënyrë të strukturuar. Kjo teknikë do ta ndihmojë nxënësin të mos mbetet në nivelin riprodhues, por të shpjegojë, analizojë dhe vlerësojë informacionin e ri, mbështetur në rubrikat që i udhëzohen. Në tabelë realizohet modeli i skemës me të cilën do të punojnë nxënësit. Për leximin e tekstit dhe plotësimin e skemës, nxënësit u lihet një hapësirë kohore prej 18 minutash. Pjesa tjetër e kohës do të shërbejë për t'i organizuar shënimet në tabelë.

Prania e krishterimit në territoret arbërore/
dëshmitë arkitekturore - pjesëmarrja në
Sinodet e krishtera - hierarkia kishtare
arbërore

Lufta kundër ikonave - Perandori bizantin
Leon III - kisha arbërore nuk u përfshi shumë
në këtë konflikt - perandori bizantin hoqi në
vitin 732 juridiksionin papal mbi kishat
arbërore, por papati vijoi të ushtronte
autoritet mbi peshkopatat arbërore të
Prevalit dhe të Dardanisë

Krishterimi në trevat arbërore

Ndarja e kishave - 1054 - riti katolik dhe riti
ortodoks - ndarja e territoreve arbërore sipas
dy riteve fetare - papati i forcoi pozitën e tij në
trojet arbërore në Kosovë dhe Principatën e
Arbrit - ndërsa kisha ortodokse u paraqit më
e fuqishme aty ku edhe ishte më i fuqishëm
autoriteti bizantin.

Organizimi kishtar në Arbëri kontrollohej nga:
Kryepeshkopata e Shkodrës, Justinana
Sekunda, Nikopjës dhe Durrësit (shek. IV-VI)-
Mitropolia e Durrësit (deri në shek. XI)-
Kryepeshkopatat e Naupaktit, Durrësit dhe
Ohrit (shek.XI) - Kryepeshkopata e Tivarit
(1077) - Kryepeshkopata e Raguzës (1199).

Faza e tretë: Përforcimi – Punë me tekstin

Jepet një hartë mece e trojeve arbërore. Udhëzohen nxënësit të lokalizojnë:

- Patriarkanat që kanë vepruar në këto troje.
- Përhapjen e dy riteve të krishterimit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe shënimeve, plotësimin e hartës.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja mbi pasojat e Skizmës së Madhe në vendbanimin tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Roli i krishterimit në jetën shoqërore të arbërve		Situata e të nxënit: Bazilika paleokristiane e Linit ndodhet në pjesën perëndimore të Kepit të Linit dhe përfaqëson një nga monumentet më të rëndësishme të Shqipërisë. Struktura ishte e dekoruar me mozaikë shumëngjyrësh me motive floreale, gjeometrike dhe skena eukaristike, tipike të periudhës paleokristiane. Gërmimet arkeologjike dhe të dhënat numizmatike mbështesin datimin e bazilikës dhe të dyshemesë me mozaik në shek. V- VI.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Dallon ndikimin e krishterimit në trashëgiminë tonë kulturore materiale dhe jomateriale (arkitekturë, skulpturë, pikturë, letërsi/kodikë, muzikë etj.). • Jep shembuj të kulturës materiale dhe jomateriale me ndikim bizantin në vendbanimin e tij.		Fjalët kyçe: urdhra fetarë katolikë, Peshkopata e Arbrit, herezi.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Shqipëria paraturke, M. Schufli.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	

Faza e parë – Parashikimi – Prezantim i gjetjeve - Diskutim i situatës së të nxënësve

Nxënësit janë lajmëruar që një orë më parë që në këtë orë të kenë me vete informacion shtesë për urdhrat fetarë që kanë vepruar në territorin tonë. Të ndarë në dy grupe, nxënësit paraqesin në këtë fazë gjetjet e tyre:

Grupi i parë – Urdhri Dominikan

Grupi i dytë – Urdhri Françeskan

Pas prezantimit të gjetjeve, në monitor shfaqet pamje e Bazilikës paleokristiane të Linit.

Nxënësit e caktuar, paraqesin informacionin mbi këtë bazilikë dhe mozaikun e saj, si vlerë e madhe dhe burim informacioni për rolin e krishterimit tek arbërit.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Punë me grupe

Klasa organizohet në grupe që një orë më parë. Secili grup do të punojë në lidhje me një temë të përbashkët. Mënyra e prezantimit do të bëjë diferencën mes grupeve. Grupet do të sistemojnë në klasë gjetjet e tyre sipas rubrikave të udhëzuara dhe do të zgjedhin t'i prezantojnë ato.

Tematika e grupeve: Krishterimi në jetën shoqërore të arbërve

Brenda grupeve punohet për organizimin e informacionit sipas këtyre rubrikave:

- Bazilikat e hershme kristiane.
- Kishat katolike mesjetare që sot janë pjesë e trashëgimisë kulturore.
- Manastiret mesjetare në trojet shqiptare, si dëshmi e përhapjes së krishterimit.
- Klerikët arbërorë si udhëheqës fetarë dhe diplomatë.
- Ndikimi i krishterimit te banorët arbër.

Secila rubrikë mund të shoqërohet me dokumente, foto apo harta, të cilat e bëjnë më të pasur punën e secilit grup. Pasi ka përfunduar faza e përzgjedhjes dhe paraqitjes në postera të punimeve, zgjidhen dy anëtarë nga secili grup për të bërë prezantimin.

Faza e tretë: Përforcimi – Diskutim – Vlerësime mes nxënësve

Në këtë fazë, pasi kanë përfunduar prezantimet për secilin grup, diskutohet mbi cilësinë e tyre, sasinë e informacioneve, saktësinë dhe seriozitetin e punimeve, nivelin e prezantimit etj. Nxënësit lihen të lirshëm të bëjnë vlerësimet, sugjerimet dhe kritikën përkatëse.

Në përfundim të kësaj faze, fjala e fundit i mbetet mësuesit/es për të bërë vlerësimin në bazë grupesh, por edhe duke veçuar elementët që spikatën më tepër.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja mbi ndikimin e krishterimit në trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale (arkitekturë, skulpturë, pikturë, letërsi/kodikë, muzikë etj.) të vendbanimit tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Arbëria dhe Bizanti. Aspekte të së drejtës dhe veçoritë e jetës ekonomike		Situata e të nxënit: Nxivrni konkluzionin: Në fund të shek. XIV, një pronar nga familja Dukagjini i përgjigjej thirrjes së kryezotit për luftë duke u paraqitur me 40 kalorës e 100 këmbësorë.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon karakteristikat e ligjit agrar bizantin dhe ndikimin e tij në hapësirën shqiptare. • Dallon karakteristikat e sistemit feudal bizantin në hapësirën shqiptare dhe e krahason me sistemin feudal europian.		Fjalët kyçe: marrëdhëniet e pronësisë, Ligji Bujqësor, pronat e bashkësisë fshatare, prona të trashëgueshme, mistiotë, thema, stratiotë, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë, bajraku, cenzi, Legjislacioni i Justinianit, krisovlua, nomokanone.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Shqipëria paraturke, M. Schufilai.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim

Lexohet situata e të nxënit dhe kërkohet nga nxënësit të nxjerrin konkluzione.

Për të arritur një bashkëbisedim me një pjesëmarrje të të gjithë nxënësve, mësuesi/ja ndërhyr përmes pyetjeve nxitëse:

1. Çfarë është pronia?
2. A rrjedhin detyrime nga të paturit nën zotërim pronien?
3. Si ndikoi pronia në fuqizimin e feudalizmit në territoret arbërore gjatë sundimit bizantin.

Përmes këtyre pyetjeve, mësuesi/ja arrin edhe një qëllim tjetër: bën matjen e nivelit të njohurive paraprake të nxënësve në lidhje me veçoritë e jetës ekonomike në Bizant.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Tabela konceptuale

Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimi përmes një tabele konceptuale. Nxënësit udhëzohen të lexojnë tekstin mësimor në faqet 81-82, të mbajnë shënime dhe të ndihmojnë në plotësimin e tabelës konceptuale nr. 1 dhe nr. 2.

Tabela nr. 1 – Organizmi i pronave në Perandorinë Bizantine

Pronat e trashëgueshme	Pronat e bashkësisë fshatare	Pronat me karakter ushtarak
1. Arat 2. Kopshtet 3. Vreshtat 4. Bagëtitë 5. Mullinjtë 6. Punishtet etj.	1. Kullotat 2. Pyjet 3. Ujërat 4. Tokat djerrë etj.	1. Stratiotika 2. Pronia 3. Territoria

Tabela nr. 2 – E drejta bizantine dhe ajo vendëse në territoret arbërore

Llojet e të drejtave	Sanksiononin	Aktet
E drejta bizantine	Baza e legjislacionit bizantin ishin Kodeksi dhe Novelat e Justinianit, të hartuara në vitin 529. Ky legjislacion rregullonte marrëdhëniet e pronës, sanksiononte angarinë për nevoja shtetërore; përcaktonte llojet e ndryshme të marrëveshjeve dhe detyrimet që rridhnin prej tyre (të cilat u kalonin pronarëve të rinj të tokës); përcaktonte familjen dhe pasuritë e saj; mbronin tokën e fshatarit që kishte marrë hua dhe fëmijët e braktisur nga skllavëria.	Liengi - sistem tatimor ku përgjigjej bashkësia fshatare dhe individit për detyrimet Solemnia - akt juridik dhurues i perandorit për kishën dhe bujarët Patronati - akt juridik i perandorit që u jepte feudalëve privilegje financiare dhe tatimore, duke marrë në patronazh bashkësitë fshatare Eskusia - akt juridik i perandorit që çlironte feudalët nga detyrime të ndryshme; Pronia - akt juridik i perandorit për bujarë ushtarakë që të vilnin detyrime të caktuara.
Kanuni	Kanuni ishte një ligj i pashkruar, i cili vinte nga lashtësia dhe përshtatej sipas kushteve të kohës. Në mesjetë, në trojet arbërore funksiononin disa kanune, si: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë etj.	Kanuni i Lekë Dukagjinit është i përbërë nga 1263 norma – “nene”. Në të janë trajtuar të gjitha llojet e marrëdhënieve midis individëve, familjeve dhe komuniteteve, si dhe institucioneve si kisha, kuvendet, mënyra e gjykimit dhe dënimit të veprimeve që binin në kundërshtim me kanunin etj.
Rregullat fetare	Kisha kishte ligjet e veta duke ushtruar pushtet ligjor për një kategori çështjesh, si: lindjet, martesat, vdekjet, divorcet etj.	-----

Faza e tretë: Përforcimi – Punë me tekstin – Zbërthimi i koncepteve

Në këtë fazë nxënësit punojnë individualisht ose në dyshe për të shpjeguar konceptet kyçe. Zbërthimi i koncepteve mund të realizohet edhe duke përdorur fjalorë enciklopedikë online, nëse kjo është e mundur (sdm për klasat digjitale).

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, plotësimin e tabelave të koncepteve, zbërthimin e koncepteve, bashkëpunimin me shokët.

Detyra:

Identifikoni: Justiniani, Lekë Dukagjini, Skënderbeu. Cila është lidhja e këtyre figurave historike me aspektet e së drejtës dhe veçoritë e jetës ekonomike në trojet arbërore?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Veçoritë e jetës ekonomike në trojet arbërore		Situata e të nxënit: Që në shek. XI dhe akoma më shumë në shekujt pasardhës, tregtarë venecianë sillnin në Durrës produkte të ndryshme, një pjesë të të cilave e çonin drejt Lindjes nëpërmjet rrugës “Egnatia”. Veprimtari e ethshme zhvillohej edhe në krahun e kundërt, nga Kostandinopoja e Selaniku për në Durrës, e prej andej, me anije, drejt Venedikut.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton veçoritë e feudalizmit arbëror. • Liston shkaqet e zhvillimit të zejeve dhe tregtisë në Arbëri. • Vlerëson rëndësinë e zhvillimit të zejeve, tregjeve ndërkrahinore dhe panairëve fetare për jetën ekonomike.		Fjalët kyçe: pronia, feudalizëm patriarkal, esnafa.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Shqipëria paraturke, M. Schuflai.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim


Në këtë fazë bëhet organizimi i njohurive paraprake në lidhje me zhvillimet e jetës ekonomike në trojet arbërore gjatë sundimit bizantin. Për këtë zhvillohet teknika brainstorming për dy togfjalëshat:



Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Harta e të pyeturit

Nxënësve u shpërndahen fleta në të cilën mësuesi/ja ka realizuar hartën e të pyeturit. Nxënësit lexojnë në heshtje për tre deri në katër minuta tekstin dhe më pas ndërtojnë në fletore hartën e përgjigjeve.

Model i hartës së të pyeturit.



Faza e tretë: Përforsimi – Diskutim

Për ta bërë më gjithëpërfshirëse orën mësimore, në këtë fazë nxitet diskutimi në lidhje me çështjen: Roli i esnafëve në zhvillimin e ekonomisë.

Klasa organizohet në dy grupe të mëdha, të cilët mbrojnë ide të ndryshme.

- Grupi i parë mbron idenë se esnafet kanë një ndikim pozitiv në zhvillimin e ekonomisë, pasi, përmes tyre rritet cilësia dhe çmimi mbahet nën kontroll.
- Grupi i dytë mbron idenë se esnafet pengojnë konkurrencën dhe, si rrjedhojë, kanë më tepër efekt negativ.


Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e përgjigjeve me gojë dhe me shkrim, idetë e sjella në fazën e diskutimit.

Detyra:

Lexoni dokumentin. Vendosini një titull dhe shkruani idenë kryesore që përcjell lidhur me veçoritë e jetës ekonomike në trojet arbërore.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në mesjetë		Situata e të nxënit: Kujtoni emërtimet: arvanitas, alvanitas, arbëreshë. Çfarë ju kujtojnë nga historia e shqiptarëve?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon shkaqet dhe tregon drejtimet e emigrimeve shqiptare në shek. XIV-XV. • Evidenton përmasat e emigrimeve arbërore në Greqi dhe në Itali gjatë shek. XIV-XV. • Tregon vendosjen dhe organizimin e jetës së arbërve (arvanitas, arbëresh) në Greqi dhe në Itali. • Evidenton rimëkëmbjen e qyteteve në Arbëri (shek. XIII-XIV).		Fjalët kyçe: arvanitas, arbëreshë, arhondi.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Bizantine, George Ostrogorski; interneti; Historia e Popullit shqiptar; Shqipëria paraturke, M. Schufilai.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë – Parashikimi – Braingstorming U prezantohet nxënësve situata e të nxënit dhe më pas, përmes përgjigjeve që vijnë nga nxënësit, ndërtohet skema braingstorming për tre koncepte kyçe:			



Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Kllaster - Tabelë konceptesh

Mësuesi/ja skicon në tabelë dy skema: kllaster dhe tabelë konceptesh. Nxënësit udhëzohen të lexojnë tekstin dhe të bëjnë shënimet përkatëse, me qëllim përgatitjen për të plotësuar së bashku me mësuesin/en modelet në tabelë.

Kllaster – Emigrimet arbërore në mesjetë.

Emigrimet arbërore në mesjetë (shek. XIV-XV)

Vala e parë e emigrimit u drejtua në Thesali, Peloponez, Atikë, Meseni etj.

Kjo valë emigrimi kishte karakter ekonomik. Arbrit që emigruan përmes kësaj vale u quajtën "arvanitas".

Vala e dytë e emigrimit arbëror përfshiu arbrit në drejtim të Italisë së Jugut, Venedikut, Raguzës dhe bregdetit dalmat.

Kjo valë emigrimi ishte e detyruar për shkaqe politike dhe sociale. Zë fill me rënien e shtetit të Skënderbeut. Aty ku u vendosën u njohën si "arbëreshë".

Tabelë konceptesh – Qytetet mesjetare arbërore

Qytete që vijnë ekzistencën	Qytete që u braktisën	Qytete të reja	Veçoritë e qyteteve të reja dhe atyre që vijuan jetën	Ishin të mbrojtura me mure të fuqishëm (Shkodra, Ulqini, Kruja etj.) dhe në disa prej tyre kishte edhe kështjella (Berati).
Durrësi Shkodra Lezha Shkupi	Apollonia Bylisi Butrinti Ulpiana Onhezmi Amantia etj.	Berati Drishti Deja Shasi Prizreni Kruja Kanina etj.		Disa prej tyre ishin njësi të rëndësishme administrative (Durrësi), ndërsa të tjera kishin rëndësi tregtare (Shufadaja, Pirgu, Vlora etj.).
				Disa qytete zotëronin arhondi = territore rurale përqark tyre të përbëra nga vreshta, ullishta etj.
				Banorët e qyteteve ndaheshin në Nobiles = fisnikët dhe Populares = popullorët.
				Popullsia e qyteteve erdhi duke u rritur për shkak të ardhjes së popullsisë nga fshatrat, por edhe për shkak të të huajve (p.sh. hebrenjtë).

Faza e tretë: Përforcimi – Pyetje frontale

Mësuesi/ja, për të matur nivelin e përvetësimit të njohurive, drejton disa pyetje të shkurtra për të marrë përgjigje të shpejta.

1. Në cilën periudhë kohore kanë nisur emigrimet në trojet tona?
2. Cilat janë dy valat më të mëdha të emigrimit tek arbrit?
3. Si u njohën arbrit e emigruar në Greqi dhe Italinë Jugore?
4. Si klasifikohen qytetet arbërore për nga funksioni?
5. Si ndahej popullsia e qyteteve arbërore?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e përgjigjeve dhe plotësimin e skemave.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Shkaqet dhe drejtimet e emigrimeve shqiptare në shek. XIV-XV.
- b. Përmasat e emigrimeve arbërore në Greqi dhe në Itali gjatë shek. XIV-XV.
- c. Vendosi dhe organizimin e jetës së arbërve (arvanitas, arbëresh) në Greqi dhe në Itali.
- d. Rimëkëmbjen e qyteteve në Arbëri (shek. XIII-XIV).

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Fshati arbëror shek. VI-XIV		Situata e të nxënit: Edhe në viset malore, të cilat kishin qenë tradicionalisht “vatra të fshatarësisë së lirë”, vihet re diferencimi shoqëror në shek. XIII-XIV. Krerët e fshatrave grumbullojnë jo vetëm toka dhe bagëti, por edhe pushtet. Kujtoni shembuj nga historia sesi familjet feudale rritën ndikimin dhe rolin e tyre në këtë periudhë?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton ndryshimet që ndodhën në fshatin arbëror gjatë mesjetës. • Shpjegon faktorët që kushtëzuan ndryshimet në fshatin mesjetar.		Fjalët kyçe: fshati arbëror, ekonomia bujqësore.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Eposi i Kreshnikëve; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë – Parashikimi – Bashkëbisedim			
Mësuesi/ja prezanton situatën e të nxënit dhe i fton nxënësit në bashkëbisedim, në lidhje me pyetjen: • Kujtoni shembuj nga historia sesi familjet feudale rritën ndikimin dhe rolin e tyre në këtë periudhë. Si u rrit fuqia e tyre?			

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Lexim i orientuar – Nxjerrja e konkluzioneve


Në këtë fazë, nxënësit orientohen të lexojnë tekstin sipas çështjeve të mëposhtme. Për secilën çështje, së bashku me mësuesin/en, do të nxirren konkluzionet.

Çështja	Konkluzionet
Zhvillimi i ekonomisë fshatare në mesjetë	• Varej nga kushtet natyrore, rrjeti rrugor, pozita gjeografike dhe administrimi i territorit. • Ekonomia bujqësore përbënte bazën e ekonomisë feudale. • Rajonet më të zhvilluara ishin: Fusha Ilirike (Myzeqeja), Fusha e Shkodrës, Fusha e Korçës, Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës në veri dhe Vegetenia në jug. • Prodhimet ishin të larmishme: bujqësore, blegtorale, fruit dhe vitikultura, peshkimi etj. • Ekonomia fshatare kishte nivel të atillë zhvillimi saqë bëhej tregti me Raguzën dhe Venedikun.

Fshati arbëror mesjetar	• Mënyra e jetesës ndryshonte në varësi të kushteve natyrore dhe infrastrukturës. • Zonat fushore dhe kodrinore kishin mundësi më të mira për zhvillim. • Në zonat malore fshatrat ishin të rralla e me numër të pakët banorësh. • Banesat në fshat ishin të vogla, të thjeshta e të ndërtuara me qerpiç e me kashtë. • Ekonomia e tyre bazohej në punën në ngastrat e tyre, pronën e bashkësisë, pronave të të pasurve dhe institucioneve fetare. Të tjerë që nuk gjenin mundësi të tilla angazhoheshin në ushtri. • Jeta shoqërore ishte e kufizuar, vetëm në ritet fetare, fejesa, martesë, pagëzime fëmijësh, frekuentimin e panairove dhe tregjeve.
-------------------------	---

Faza e tretë: Përforsimi – Diagram Veni

Për më pak se 5 minuta nxënësit rilexojnë edhe njëherë tekstin. Pas kësaj plotësojnë në fletore diagramin e Venit.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në detyrat e dhëna.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi: Ndryshimet që ndodhën në fshatin arbëror gjatë mesjetës.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Qytetet arbërore në mesjetë midis civilizimit bizantin dhe atij europian		Situata e të nxënit: Në shek. XIII edhe qendra të tjera shqiptare, si Drishti, Deja, Shasi, Prizreni, Lezha, Kruja, Berati, Kanina etj. bënë një hap të rëndësishëm drejt kthimit të tyre nga kështjella me fizionomi kryesisht ushtarake, në qendra urbane të zhvilluara. Në pamundësi për t’u zhvilluar brenda rrethit të mureve të trashëguara nga e kaluara, qytetet në fjalë u shtrinë jashtë tyre. U formuan kështu lagjet e jashtme (proastion, suburbium), të cilat shumë shpejt u kthyen në qendra të jetës ekonomike të qytetit. Këtu zhvilloheshin tregjet dhe ishin përqendruar dyqanet e punishtet.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan jetën sociale dhe ekonomike në qytetet arbërore në bazë të statuteve dhe kanuneve (shek. XIII-XIV). • Evidenton rolin e institucioneve qeverisëse në jetën e qyteteve arbërore. • Arsyeton mbi shkallën e zhvillimit të qyteteve në Arbërinë mesjetare, duke i krahasuar me qytetet bizantine dhe ato europiane (shek. XIII-XIV).		Fjalët kyçe: qytet i tipit dalmato-italian, qytet i tipit bizantin, komunitet hebre, familja Kabashi, familja Frëngu.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Eposi i Kreshnikëve; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe u kërkon nxënësve të ofrojnë mendimet e tyre lidhur me të. Gjatë bashkëbisedimit u prezantohet nxënësve situatë e të nxënit, përmes të cilës nxitet edhe më tej pjesëmarrja e tyre.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – pyetja sjell pyetjen – veprimtari e drejtuar

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për teknikën që do të ndiqen gjatë kësaj faze. Fillimisht orientohen nxënësit në leximin e tekstit, sipas një ndarjeje rastësore në grupe të vogla. Ndërkohë në tabelë renditen pyetjet kyçe, rreth të cilave do të fokusohet vëmendja e nxënësve:

1. Si ishte e organizuar jeta sociale në qytetet arbërore në mesjetë?
2. A pati ndikime të jashtme në jetën kulturore të qyteteve arbërore?
3. Cilat ishin marrëdhëniet mes qyteteve arbërore dhe pushtetit bizantin, norman, venedikas, serb dhe me fisnikërinë vendëse?

4. Si ndikonin institucionet qeverisëse në zhvillimin e jetës qytetare në trojet arbërore?
5. Në çfarë shkalle zhvillimi ishin qytetet në Arbërinë mesjetare krahasuar me qytetet bizantine dhe ato europiane?

Pasi njihen me pyetjet nxënësit studiojnë materialin e ri, duke punuar në grup. Informacioni organizohet në skemën e përgjigjeve:

Çfarë po mësoj në këtë çast?	Çfarë di më parë rreth kësaj çështjeje?	Çfarë mësova?
• •	•	•

Faza e tretë: Përforcimi - prezantimi i rezultateve

Pasi nxënësit kanë punuar, diskutuar dhe sistemuar informacionin në grup, është radha për të prezantuar punën e tyre. Materialet e grupeve afishohen në tabelë, ndërsa përfaqësues nga grupet lexojnë përfundimet. Diskutohen rezultatet dhe mund të shtohen ide të reja në punimet e secilit grup.

Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën në grup, saktësinë e mendimeve dhe nivelin e prezantimit të tyre. Për një vlerësim sa më objektiv, mësuesi e ndjek nga afër punën e pavarur.

Detyra:

Shkruani një ese: “Vendbanimi im gjatë periudhës së sundimit bizantin”.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Kultura mesjetare arbërore mes civilizimit bizantin dhe atij bizantin		Situata e të nxënit: Lexim i legjendës së “Gjergj Elez Alisë”. Shfrytëzohet material i plotë, jo vetëm paragrafi që jepet në tekst. Shfrytëzohet material nga Eposi i Kreshnikëve.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Dëshmon ndikimin kulturor evropian dhe bizantin në kulturën arbërore. • Vlerëson ndikimet kulturore europiane dhe bizantine në hapësirën arbërore në arsim, letërsi, arkitekturë, skulpturë, pikturë, arte etj.		Fjalët kyçe: Muji, Halili, Gjergj Elez Alia, Peshkopi Mihal, Anastasi.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Eposi i Kreshnikëve; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, Qytetari.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforsimi (10 min)	

Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim

Nxënësit të lajmëruar që një orë më parë, lexojnë në këtë fazë, pjesë nga Eposi i Kreshnikëve. Pas leximit të disa pjesëve, diskutohet mbi rolin që ka krijimtaria gojore në zhvillimin e kulturës ndër popullsinë e thjeshtë dhe njohjen e historisë.

Theksohet elementi “mitik” i heronjve në krijimtarinë gojore, si tipar dallues për të pasqyruar vlerat, e ilirëve dhe arbërve por edhe për të rritur ndjenjën e guximit, mbrojtjes së vendit.

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh

Gjatë kësaj faze, nxënësi punon me tekstin nga afër, për të specifikuar veçoritë dalluese të kulturës mesjetare, sipas rubrikave kryesore.

Mësuesi/ja sistemon në tabelë njohuritë thelbësore, ndërsa nxënësit mbajnë shënime.

Krijimtaria gojore: {

- Përfshin përralla, fjalë të urta, gojëdhënat dhe eposin.
- Kishte karakter tregimtar dhe letrar.
- Tematika kryesore e eposit ishin heronjtë si Muji dhe Halili, Gjergj Elez Alia.
- Përmes saj përcilleshin vlerat dhe vlerat e ilirëve dhe arbërve.
- Eposi ndihmoi edhe në rezistencën e arbërve ndaj rrezikut sllav.

Tiparet e arsimit gjatë sundimit bizantin: {

- Arsimi kishte karakter fetar.
- Zhvillohej në gjuhën greke ose latine.
- Arsimi ishte privilegj i shtresave të pasura.
- Ishte i organizuar në dy nivele: cikli i ulët fillor dhe i mesëm.
- Arsimi i lartë mund të merrej në Kostandinopojë, Venedik, Raguzë etj.
- Në zhvillimin e arsimit luajtën rol të rëndësishëm Urdhrat Fetarë.

VI-XII.

Letërsia
përveç vlerave

- Letërsia e shkruar ishte kryesisht fetare dhe zhvillohej në qytete.
- Botimet më të hershme fetare janë kodikët, të cilët fillojnë të shkruhen në shek.
- Kodikët më të famshëm janë Kodikët e Beratit (Beratinus I, II), të cilët, fetare, përcjellin edhe vlera historike.
- Pjesë e letërsisë janë edhe kronikat, si ajo e peshkopit Mihal nga Devolli.

Arkitektura

- Sipas funksioneve, ishte civile, publike, ushtarake dhe fetare.
- Banesat në zonat rurale ndërtoheshin me lëndë të thjeshta, si: guri, druri, balta dhe kashta.
- Banesat në qytete ndryshonin nga ato të fshatrave, vetëm në rastet e parisë qytetare.
- Këto banesa ishin 2-3 katëshe dhe shpesh të mobiluara me prodhime të huaja.
- Punimi i drurit realizohej nga mjeshtër, të cilët kanë realizuar monumente dhe banesa.
- Arkitektura fetare, dallohej për ndërtesa monumentale të pasura me zbukurime të shumta.
- Në objektet e fesë katolike mbizotëronte stili italian, ndërsa në ato të besimit ortodoks stili bizantin.
- Ndërtimet ushtarake u fortifikuan me mure mbrojtëse dhe kulla.

Faza e tretë: Përforcimi – nxjerrja e përfundimeve – diskutim

Në këtë fazë nxirren konkluzionet për secilën çështje.

Diskutohet në lidhje me përfundimin kryesor:

Përfundimi: Pavarësisht nivelit dhe kohës së zhvillimit, kultura arbërore ishte në një marrëdhënie të ndërsjellë me atë bizantine dhe europiane. Vihet re një ndikim i madh i këtyre dy qytetërimeve në arsim, letërsi, arkitekturë, art, muzikë etj.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.


Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike: Cili është refleksioni juaj mbi: ndikimet kulturore europiane dhe bizantine në hapësirën arbërore në arsim, letërsi, arkitekturë, skulpturë, pikturë, arte etj.


Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Ardhja e osmanëve në Ballkan. Rezistenca e shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit		Situata e të nxënit: Osmanët ishin pasardhës të turqve oguzë. Këta u shpërngulën si tribu nga Azia Qendrore dhe u vendosën në Anadoll në fund të shek. XI, pas disfatës së rëndë ushtarake që turqit selxhukë i shkaktuan Perandorisë Bizantine (1071). Turqit oguzë hynë në histori kur prijësi i tyre Ertogrulli mori si shpërblim prej sulltanit selxhuk një zotërim të vogël në brigjet e lumit Sangaria (Sakaria). I biri i Ertogrullit, Osmani I (1290-1323), e zgjeroi zotërimin atëror dhe e ktheu në një shtet të pavarur me emrin Emirati Osman, që u bë bërthama e Perandorisë Osmane.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton sulmet e para të pushtimit osman në Ballkan dhe në territoret shqiptare. • Analizon situatën politike në Bizant dhe në gjithë rajonin e Ballkanit. • Analizon përpjekjet e princave ballkanikë dhe arbërorë për t’u përballur me pushtimin osman dhe koalicionet e krijuara me këtë funksion. • Identifikon në hartë vendbetejat kryesore të qëndresës antiosmane në Ballkan dhe në territoret shqiptare.		Fjalët kyçe: osmanë, Perandoria Osmane, beteja e Savrës, Beteja e Fushë-Dardanisë, Beteja e Maricës.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Interneti; Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Nxitet interesi i nxënësve për të organizuar dijet e tyre paraprake për Perandorinë Osmane në formën e “braingstorming”. Perandoria Osmane			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – kllaster

Mësuesi/ja organizon njohuritë e reja në formën e kllasterit në tabelë. Nxënësit dihet që kanë njohuri paraprake në lidhje me temën, ndaj përfshihen aktivisht në këtë etapë të mësimin përmes pyetjeve frontale që drejton mësuesi/ja.

**Faza e tretë: Përforcimi – linja e kohës**

Pasi nxënësit janë njohur me tekstin, udhëzohen të punojnë me linjën e kohës, sipas modelit që mësuesi/ja realizon në tabelë. Linja e kohës do të ketë tematikën: Perandoria Osmane dhe Ballkani.

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në realizimin e detyrave që caktohen.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për: ardhjen e osmanëve dhe qëndresën e banorëve në vendbanimin tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe koha e tij		Situata e të nxënit: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu është më i famshmi nga të gjithë, jo vetëm nga të gjitha krahinat ilire, të prefekturës së Epirit të ri, Dardanisë, por edhe të një pjesë të Epirit të vjetër të cilat i bashkoi... ” – Guillaume de Vaudoncourt, 1821. Cili është mesazhi që merrni përmes këtij vlerësimi që një studiues i huaj i bën figurës së Skënderbeut?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan raportet e vendosura mes shtetit osman dhe familjeve fisnike shqiptare. • Shpjegon strategjinë e Gjergj Kastriot Skënderbeut për arritjen e bashkimit në planin e brendshëm. • Analizon sistemet e aleancave ndërkombëtare të Gjergj Kastriot Skënderbeut në funksion antiosman. • Shpjegon nevojën dhe procesin e kalimit nga aleanca e princave te shteti i përqendruar dhe vë në dukje tiparet e këtij të fundit.		Fjalët kyçe: regjimi i timareve, Principata e Kastriotëve, Lidhja e Lezhës, Republika e Venedikut, Perandoria Osmane, Dukagjinët, Arianitët, Prizreni, Muzakajt, Balshajt, Topiajt.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Interneti; Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran; Skënderbeu, O. Schmit; Jeta dhe bëmat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, M. Barleti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Mësimi nis me një bashkëbisedim në lidhje me figurën e Gjergj Kastriotit. 1. Ku shtrihej Principata e Kastriotëve? 2. Cili qe sundimtari i saj? 3. Pse Skënderbeu u dërgua në oborrin e sulltanit? 4. Çfarë informacionesh keni për jetën e tij, përpos faktit të dorëzimit peng te sulltani?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja i orienton nxënësit në realizimin e ditarit dypjesësh në lidhje me çështjet e sugjeruara prej tij/saj. Nxënësit punojnë individualisht me tekstin. Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e pavarur të secilit.

Ditari dypjesësh

Çështja	Komenti
Kryengritjet antiosmane	Gjatë viteve 1431-'32 osmanët filluan zbatimin e <i>regjimit të timareve</i> . Kjo gjë i bëri të pakënaqur jo vetëm fshatarët pronarë të tokave, por edhe fisnikët shqiptarë që panë t'u cenoheshin interesat ekonomike, krahas atyre politike. Sulltani kishte vendosur marrëdhënie vasaliteti me fisnikët shqiptarë dhe i mbante ata të kërcënuar, duke marrë pengje pjesëtarë të familjeve të tyre. Në këto kushte, gjatë viteve '30 të shek. XV, fisnikët shqiptarë kundërshtuan politikën osmane duke organizuar disa kryengritje të armatosura të udhëhequra nga fisnikët <i>Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Dep Zenevisi, Nikollë Dukagjini</i> etj.
Gjergj Kastrioti-kthimi në atdhe	
Kuvendi i Lezhës	
Vendimet e Kuvendit të Lezhës	
Nga Lidhja në shtetin e përqendruar	

Faza e tretë: Përfundimi - turi i galerisë

Pasi nxënësit kanë përfunduar detyrën e caktuar dhe kanë prezantuar në formate A3, ditarin dypjesësh, i afishojnë ato në ambientin e klasës duke improvizuar një "miniekspozitë". Pas kësaj mësuesi/ja i fton nxënësit që të vizitojnë punimet e njëri-tjetrit dhe të bëjnë sugjerimet apo vlerësimet përkatëse.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Ese: "Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ashtu si e njoha unë!"

Punimi vendoset në portofolin e të nxënit.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane. (Ora e parë)		Situata e të nxënit: Taksat më kryesore ishin ajo e martesës, gjoba për faje e delikte, taksa e tapisë, e sendeve që lënë skllëvërit e arratisur, e dhjeta e kullotës etj. Sipas kanunave të reja, në qoftë se nusja ishte bijë myslimani, madhësia e taksës së martesës që dhëndri duhej t’i jepte spahiut ishte 60 akçe, në rast se nusja ishte vejushë dhëndri duhej t’i jepte po spahiut 30 akçe. Kur nusja ishte bijë jomyslimani, dhëndri jepte gjysmën e saj. Gjobat ishin në varësi të fajit të bërë, për shkelje të normave të së drejtës dokesore, si për rrahje, plagosje, vrasje, vjedhje, përdhunim, dehje me verë etj. Ju duken taksa të çuditshme, në këndvështrimin aktual të detyrimeve?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon parimet e organizimit territorial dhe shtetëror të Perandorisë Osmane. • Vë në dukje raportin mes qendërimit dhe decentralizimit të pushtetit në kuadër të perandorisë. • Diferencon qëndrimin e shtetit osman ndaj krahinave të ndryshme dhe trajtimit të tyre nga pikëpamja e organizimit të brendshëm. • Analizon sistemin ekonomik dhe fiskal të zbatuar nga autoritetet osmane.		Fjalët kyçe: ejaleti, bejlerbeu, sanxhaku, Ejaleti i Rumelisë, kaza, sulltani-kalif, veziri, Sheh-ul-islami, Divani, sheriati, kurani, kanunametë, berate, fermanët, kapitualcione, kadiu, poligami, haraç, rekabe, mirie, mylk, tasarufi, vakëf, timare, zeameti, hase, timarliu, ispenxha, xhizja, badiava-erë, avarizi, susrati, ishtiza.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Interneti; Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran; Skënderbeu, O. Schmit; Jeta dhe bëmat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, M. Barleti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, diskutohen tre prej koncepteve kryesore që do të trajtohen në këtë fazë mësimore: - Elajet			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh

Nxënësve u prezantohet informacioni i ri, përmes organizuesit grafik. Gjatë sqarimit të informacionit, mësuesi/ja ndalet më së shumti në konceptet e reja, në të cilat sheh që qasja e nxënësve është më e vështirë.

**Faza e tretë: Përforcimi – diskutim i lirë – ndarja e detyrave**

Duke qenë se kjo është një temë mësimore dyorëshe, nxënësve u lihen detyra për orën pasardhëse. Të ndarë në grupe, ata do të hulumtojnë dhe do të prezantojnë informacion më të thelluar, lidhur me organizimin shtetëror dhe ekonomik të territoreve shqiptare gjatë sundimit osman. Në klasë krijohen 5 grupe. Detyrat sipas grupeve ndahen si më poshtë:

Grupi i parë – Ndarja administrative në territoret arbërore gjatë sundimit osman.

Grupi i dytë – Institucionet shtetërore të Perandorisë Osmane, roli dhe funksionet. Në fokus të veçantë legjisllacioni osman.

Grupi i tretë – Krahinat autonome në territorin shqiptar gjatë sundimit osman. Raporti me shtetin osman.

Grupi i katërt – Roli i gruas në shoqërinë shqiptare gjatë sundimit osman.

Grupi i pestë – Sistemi i pronave dhe taksave në Perandorinë Osmane.

Pas ndarjes së detyrave, kalohet në diskutim të lirë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore.

Detyra:

Sipas ndarjes në grupe.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Organizimi shtetëror dhe jeta ekonomike e territoreve shqiptare në sundimin e Perandorisë Osmane. (Ora e dytë)		Situata e të nxëniti: Taksat më kryesore ishin ajo e martesës, gjoba për faje e delikte, taksa e tapisë, e sendeve që lënë skllevërit e arratisur, e dhjeta e kullotës etj. Sipas kanunave të reja, në qoftë se nusja ishte bijë myslimani, madhësia e taksës së martesës që dhëndri duhej t’i jepte spahiut ishte 60 akçe, në rast se nusja ishte vejushë dhëndri duhej t’i jepte po spahiut 30 akçe. Kur nusja ishte bijë jomyslimani, dhëndri jepte gjysmën e saj. Gjobat ishin në varësi të fajit të bërë, për shkelje të normave të së drejtës dokesore, si për rrahje, plagosje, vrasje, vjedhje, përdhunim, dehje me verë etj. Ju duken taksa të çuditshme, në këndvështrimin aktual të detyrimeve?	
Rezultatet e të nxëniti të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon parimet e organizimit territorial dhe shtetëror të Perandorisë Osmane. • Vë në dukje raportin mes qendërimit dhe decentralizimit të pushtetit në kuadër të perandorisë. • Diferencon qëndrimin e shtetit osman ndaj krahinave të ndryshme dhe trajtimit të tyre nga pikëpamja e organizimit të brendshëm. • Analizon sistemin ekonomik dhe fiskal të zbatuar nga autoritetet osmane.		Fjalët kyçe: ejaleti, bejlerbeu, sanxhaku, Ejaleti i Rumelisë, kaza, sulltani-kalif, veziri, Sheh-ul-islami, Divani, sheriat, kurani, kanunametë, berate, fermanët, kapitularione, kadiu, poligami, haraç, rekabe, mirie, mylk, tasarufi, vakëf, timare, zeameti, hase, timarliu, ispenxha, xhizja, badiava-erë, avarizi, susrati, ishtiza.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran; Skënderbeu, O. Schmit; Jeta dhe bëmat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, M. Barleti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxëniti (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim – kontroll frontal i njohurive

Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja bën një kontroll të shpejtë frontal në lidhje me njohuritë e marra një orë më parë:

1. Cilat ishin parimet e organizimit territorial dhe shtetëror të Perandorisë Osmane?
2. Në ç'mënyrë strategjia e centralizimit dhe decentralizimit të pushtetit ndihmoi Perandorinë të jetonte gjatë?
3. Në ç'mënyrë qëndrimi i shtetit osman ndaj krahinave të ndryshme nga pikëpamja e organizimit të brendshëm i sillte atij ekuilibër?
4. Cili ishte thelbi i sistemit ekonomik dhe fiskal të zbatuar nga autoritetet osmane?

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë me grupe – prezantimi i punimeve

Pasi është kryer kontrolli frontal, kalohet në prezantimin e punimeve sipas grupeve.

Secilit grup i lihet një hapësirë kohore nga 5 deri 7 minuta për të kryer prezantimin. Sipas preferencave të nxënësve, prezantimi mund të realizohet nga një përfaqësues i grupit ose secili prej anëtarëve prezanton në mënyrë të përmbledhur gjetjet e veta.

Gjatë prezantimit, pjesa tjetër e klasës dëgjon me vëmendje, mban shënime dhe përgatitet për të dhënë vlerësime, bërë kritika dhe sugjerime.

Mësuesi/ja mban shënime mbi ecurinë e prezantimit për secilin grup dhe anëtar grupi, në drejtim të gjuhës së përdorur, saktësisë së formulimit dhe tonit të zërit.

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim mbi prezantimet

Nxënësit diskutojnë mes tyre dhe me mësuesin/en në lidhje me punimet e prezantuara.

Vlerësojnë punimet më cilësore dhe nxjerrin përfundime lidhur me temën mësimore. Mësuesi/ja jep vlerësimet për secilin nxënës.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve, origjinalitetin e prezantimeve, angazhimin serioz në diskutim dhe interpretim.

Detyra:

Nuk parashikohen.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Statusi i feve të ndryshme në kuadër të legjislacionit të Perandorisë Osmane		Situata e të nxënit: Islamizimi i popullsisë shqiptare ishte një proces me ndikime të ndjeshme edhe në shumë aspekte të kulturës shpirtërore. Në doket, martesat dhe në krijimtarinë artistike (gojore dhe të shkruar) u dukën shpejt elementët e kulturës islamike-orientale. Martesat në përgjithësi filluan të bëheshin brendapërbrenda secilit komunitet fetar (djemtë myslimanë me vajza myslimane, ndërsa ata të krishterë me vajza të krishtera), ndërkohë që popullsia e islamizuar nisi të dallohej edhe nga mënyra e veshjes. Më të spikatura këto dallime ishin në veshjen e grave myslimane që banonin në qytete, të cilat filluan të përdornin ferexhenë për të mbuluar pjesërisht ose tërësisht fytyrën në publik.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Analizon pozicionin e feve të ndryshme në kuadër të legjislacionit të Perandorisë Osmane. - Vlerëson trajtimin e popullsisë jomyslimane në Ballkan dhe në trojet shqiptare nga pikëpamja e të drejtave politike dhe ekonomike nën sundimin osman.		Fjalët kyçe: katolicizmi, ortodoksia, kishë autoqefale, arqipeshkëvia e Tivarit, arqipeshkëvia e Durrësit, urdhri fetar i Benediktit, urdhri fetar françeskan, kryepeshkopata e Ohrit, kryepeshkopata e Pejës, milete.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Perandorisë Osmane, R. Mantran; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim U tërhiqet vëmendja nxënësve, përmes situatës së të nxënit dhe më pas hapet bashkëbisedimi në lidhje me çështjen: Bashkëjetesa fetare te shqiptarët si vlerë historike.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mbajtja e strukturuar e shënimeve

Orientohen nxënësit për mënyrën e organizimit të informacionit të ri, duke sqaruar teknikën “mbajtja e strukturuar e shënimeve”. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë në tekst në faqet 109-111 dhe të japin mendimet se çfarë duhet të përfshihet në skemë. Nxënësit mund të propozojnë çështje të tilla për të realizuar skemën.

- Krishterimi në territoret shqiptare gjatë sundimit osman.
- Politikat e diferencuara të Perandorisë Osmane kundrejt besimeve fetare.
- Qëndrimi i Perandorisë Osmane në konfliktin mes ortodoksisë sllave dhe Patriarkanës.
- Trajtimi i popullsisë jomyslimane në Ballkan.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit ndërtojnë skemën në tabelë. Gjatë leximit të tekstit bëhen nënvizime dhe mbahen shënime për mënyrën e organizimit të këtij informacioni në skemë.

Krishterimi në territoret shqiptare gjatë sundimit osman	Politikat e diferencuara të Perandorisë Osmane kundrejt besimeve fetare	Qëndrimi i Perandorisë Osmane në konfliktin mes ortodoksisë sllave dhe Patriarkanës	Trajtimi i popullsisë jomyslimane në Ballkan
Trojet shqiptare gjendeshin, gjatë shek. XV në vijën e kontaktit midis katolicizmit me qendër në Vatikan dhe ortodoksisë me qendër Patriarkanën e Stambollit. Rivaliteti midis dy besimeve ndikonte negativisht në stabilitetin e institucioneve fetare. Besimi katolik organizohej nën kujdesin e Arqipeshkëvisë së Tivarit dhe Durrësit. Perandoria Osmane e njohu Arqipeshkëvinë e Tivarit, por qasja e saj ndaj besimit katolik u bë edhe më liberale pas presionit që bënë fuqitë europiane për më shumë liri fetare në Ballkan.	Edhe pse legjislacioni Osman njihte barazinë mes institucioneve fetare, në realitet kishte diferencime. Për të kontrolluar shpejt territorin e Ballkanit me disa rite fetare, u ndoq politika e diskriminimit të disave dhe favorizimit të të tjerave. Diskriminimi kishte karakter ekonomik dhe politik. Kështu ortodoksët dhe katolikët ishin më të ngarkuar me taksa sesa ato myslimane. Pjesëmarrja në administratë dhe ushtri varej nga përkatësia fetare.	Në rivalitetin midis ortodoksisë sllave me Patriarkanën, pushteti osman mbajti anën e kësaj të fundit duke ndaluar funksionimin e kryepeshkopatave të Ohrit dhe Pejës në favor të Patriarkanës. Në këtë qëndrim të pushtetit osman ndikoi edhe interesimi në rritje i kishës ortodokse ruse në mbështetje të kishave ortodokse sllave në Ballkan. Krejt e kundërta ndodhi me qëndrimin e pushtetit osman ndaj besimit katolik shqiptar, i cili ishte në juridiksionin e Vatikanit që konsiderohej një armik i Perandorisë Osmane.	Popullsitë jomyslimane, pavarësisht se cilësoheshin si të barabarta me myslimanët, jo vetëm që kishin një barrë fiskale më të madhe, por edhe nga legjislacioni osman ishin të diskriminuar. Kështu, nëse një mysliman kishte kryer një vepër penale, nuk mund të dërgohej për gjykim pa dy dëshmitarë myslimanë. Ndërsa, nëse një jomysliman akuzohej për një vepër penale, ai dërgohej për gjykim pa nevojën e dëshmitarëve. Edhe pjesëmarrja në administratën osmane, në sistemin gjyqësor dhe në ushtri, ishte privilegj i myslimanëve, ndërsa jomyslimanët ishin të privuar nga këto funksione.

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim i punimeve

Nxënësit kanë përfunduar skemën me ndihmën e mësuesit/es dhe diskutojnë mbi konkluzionet që nxorën si në drejtim të njohurive të reja, ashtu dhe në drejtim të vlerës që pati për ta realizimi i një teknike të tillë.

Është e rëndësishme që nxënësve t'u merret herë pas here mendimi në lidhje me strategjitë dhe teknikat e të mësuarit që përdoren përgjatë një ore mësimore.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Cilat janë pasojat e administrimit fetar nën sundimin osman në vendbanimin tuaj?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rilindja Europiane		Situata e të nxënit: Në vitin1453, Gutenberg i bëri provat e para të shkrirjes së shkronjave një nga një dhe bëri shtypin me to. Ky vit merret si vit zbulimi i shtypshkronjës. Presën e parë me material të drurit për shtyp me shkronja lëvizëse një nga një e punoi në Mainz. Me zbulimin e saj filloi një periudhë e re në veprimtarinë grafike, ndërsa dituria u bë pasuri gjithënjëzore.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon kuptimin e konceptit Rilindje, parimet intelektuale bazë të saj, figurat më përfaqësuese të kësaj lëvizjeje. • Përkshruan prirjet kryesore të artit dhe të arkitekturës së Italisë në shek. XV-XVI.		Fjalët kyçe: Françesko Petrarka, Xhovani Bokaçio, Rafaelo, Mikelanxhelo, Donatelo, Leonardo da Vinçi, Makiaveli, Baldazar Kastilione, Miguel Servantes, Erasmus i Roterdamit, Rembrandt Harmenszoon van Rijn, Uilliam Shekspiri, Johan Gutenberg.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming Rikujtohen njohuritë në lidhje me Rilindjen Europiane, përmes teknikës “brainstorming”. Idetë dhe njohuritë që evokohen, shkruhen në tabelë nga ana e nxënësve. Idetë, fjalët kyçe, të dhënat shoqërohen me komente të shkurtra.			
</			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabelë konceptesh

Mësuesi/ja prezanton në tabelë modelin e një tabele konceptesh dhe udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin duke mbajtur parasysh çështjet që kërkohen për plotësimin e saj.

Rilindja Europiane	Humanizmi	Qendrat e Rilindjes Europiane	Familja Medici	Arti i Rilindjes	Letërsia e Rilindjes
Rilindja Europiane ishte një lëvizje kulturore e elitës intelektuale europiane e shfaqur sidomos në humanizëm, art, letërsi dhe filozofi, e cila shënoi një rikthim në vlerat e kulturës antike greko-romake me synim vënien e individit në qendër të shoqërisë.	Humanizmi që i kishte rrënjët në shek. XIV ishte zhvilluar në shek. XV, duke pasur si protagonist njeriun dhe vlerat e tij. Filozofia humaniste besonte dhe predikonte rolin e individit në ndryshimin e shoqërisë njerëzore për ta bërë atë më të drejtë dhe më të mirë për të gjithë.	Rilindja, ashtu si dhe humanizmi, lindi në Italinë e Veriut, ku pati si përfaqësues të parë Françesko Petrarka dhe Xhovani Bokaçio. Zhvillimi i vrullshëm i disa prej qyteteve të Italisë së Veriut si Venediku, Firenze, Gjenova, Milano etj., gjatë shek. XIV-XV krijoi mundësi për investime në art dhe kulturë.	Medicët, ishin italianë, të cilët kishin bërë pasuri të mëdha sidomos me bankat e tyre, donin të linin gjurmë në histori dhe ia arritën duke financuar ndërtime publike, ku u angazhuan artistët më të mirë italianë të kohës.	Në fusha të ndryshme të artit në këtë kohë krijuan artistë të tillë si piktori Rafaelo Sanzio, skulptorë si: Mikelanxhelo Ludovik Buonaroti dhe Donatelo Bardi, poliedrik si Leonardo da Vinci, politikan si Makiaveli dhe filozof si Baldazar Kastilione. Arti italian i Rilindjes ishte orientuar drejt të bukurës, por edhe të paraqitjes së realitetit, duke vënë në qendër të krijimtarisë njeriun si qenie shoqërore i aftë të ndryshojë botën.	Në Spanjë, ndikimi i saj ishte sidomos në letërsi me përfaqësuesin më të shquar Miguel Servantes dhe kryeveprën e tij Don Kishoti i Mançës ku stigmatizohet rendi feudal. Në Holandë u shquan humanisti Erasmus i Roterdamit dhe piktori Rembrandt Harmenszoon van Rijn. Në Angli, Uilliam Shekspiri u bë i famshëm me veprën e tij letrare sidomos në komedi dhe tragjedi.

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim

Gjatë kësaj faze, nxënësit të familjarizuar me informacionin e ri, diskutojnë rreth pohimit:

“Shpikja e makinës së shtypit nga Johan Gutemberg e çoi në një nivel edhe më të lartë idenë e Rilindjes për edukim dhe arsimim.”

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- “Filozofia humaniste besonte dhe predikonte rolin e individit në ndryshimin e shoqërisë njerëzore për ta bërë atë më të drejtë dhe më të mirë për të gjithë”. Formuloni qëndrimet tuaja.
- Rilindjen, parimet intelektuale bazë të saj.
- Figurat më përfaqësuese të kësaj lëvizjeje.
- Prirjet kryesore të artit dhe të arkitekturës së Italisë në shek. XV-XVI.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rilindja Europiane dhe shqiptarët		Situata e të nxënit: Mësuesja përzgjedh foto të disa prej rilindësve shqiptarë. Nxënësit dallojnë figurat historike.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon përhapjen e ideve të Rilindjes Europiane në trojet shqiptare. • Identifikon figurat më përfaqësuese të rilindësve shqiptarë. • Përshkruan rolin e rilindësve shqiptarë dhe atyre europianë në njohjen e vlerave të popullit shqiptar në luftë kundër pushtuesve osmanë nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut.		Fjalët kyçe: “Rrethimi i Shkodrës”, “Historia e jetës dhe veprave të princit epirot Skënderbeu”, “Meshari”.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e popullit shqiptar; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Në këtë fazë trajtohet situata e të nxënit. Mund të përdoren imazhet në tekst ose të identifikohen përmes videoprojektorit foto të tjera të rilindësve të parë shqiptarë. Diskutimi fokusohet në kontributin e dhënë prej tyre në drejtim të përhapjes së vlerave të popullit shqiptar në qëndresën kundër pushtuesit osmanë.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik i informacionit Mësuesi/ja organizon informacionin në tabelë përmes organizuesit grafik. Ndalet duke trajtuar përmes shpjegimit çështjet kryesore.			

Kontakti i shqiptarëve me Rilindjen evropiane erdhi si pasojë e lidhjeve të hershme me pellgun e Adriatikut, sidomos me Republikën e Venedikut.

Rilindasit e parë emigruan drejt qyteteve italiane ku dhe u arsimuan. mes tyre dallohen: Marin Barleti, Marin Beçikemi, Gjon Gazuli, leonik Tomeu etj.

Veprat më të rëndësishme të kësaj periudhe janë ato të Marin Barletit: "Rrethimi i Shkodrës" dhe "Historia e jetës dhe veprave të princit epirot Skëndërbeu"

Gjatë Rilindjes u vu re:

- Zhvillimi i gjuhës shqipe
- Njohja e qëndresës antiosmane të shqiptarëve
- përfshirja në Rilidjen shqiptarëve të klerikëve

Qëndresa shqiptare antiosmane mori përmasa të mëdha nën drejtimin e Gjergj Kastriotit.

Kjo qëndresë mbrojti popullin shqiptar nga pushtimi dhe Evropën nga vërshimi osman.

Kontributi i popullit shqiptar u njoh nga Vatikani dhe bota evropiane që në atë kohë.

Papa Piu II e emëroi Skëndërbeun kryekomandant të ushtrisë së Vatikanit-është dëshmi e vlerësimit për të dhe qëndresën antiosmane të shqiptarëve

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Në këtë fazë, nxënësit orientohen në tekst. Vërehen fotot dhe bëhet interpretimi bazuar në kërkesën:

Cila është lidhja e tyre me historinë e Rilindjes shqiptare dhe atë evropiane? Çfarë mesazhi përcjellin për ju?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Cili ishte roli i rilindësve shqiptarë dhe atyre evropianë në njohjen e vlerave të popullit shqiptar në luftën kundër pushtuesve osmanë nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Perandoria Habsburgase		Situata e të nxënit: Habsburgët, që nga themeluesi i tyre, Rudolfi I në shekullin trembëdhjetë, kishin ndërtuar plot zell një legjendë mbi origjinën e tyre, që i veçonte ata nga njerëzimi i zakonshëm. Rrëfehej se Rudolfi, tek kishte dalë për gjah, kish takuar një prift që mbante kungatën e një njeriu që po vdiste. Prifti ndeshi në një përrua të tejfryrë në mal dhe nuk dinte si të kalonte. Rudolfi i ofroi menjëherë kalin e tij dhe e udhëhoqi për në anën tjetër, por kur prifti kërkoi që t’ia rikthente kalin, ai kundërshtoi, duke thënë që nuk do të mund të hipte kurrë në një kafshë që kish mbajtur trupin e Krishtit.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje krijimin e Perandorisë Habsburge, karakterin e saj politiko-fetar dhe procesin e zgjerimit dhe fuqizimit të saj. • Përcakton shkaqet e konfliktit mes Perandorisë Habsburgase dhe Perandorisë Osmane. • Identifikon në hartë shtrirjen territoriale të Perandorisë Habsburgase.		Fjalët kyçe: Perandoria Habsburgase, Paqja e Kalrovizit, Vjena, Perandoria e Romës së Shenjtë.	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze diskutohet mbi situatën e të nxënit. Pasi lexohet legjenda: bëhet lidhja mes pushtetit fetar dhe atij shtetëror në Evropën e shek. XV-XVII. Nxiten nxënësit të hedhin mendime lidhur me rëndësinë që kishte kisha katolike në Europë dhe domosdoshmëria e mbrojtjes nga vërshimi osman.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabela kronologjike


Mësuesi/ja bën organizimin kronologjik të njohurive, me ndihmën e nxënësve.

Viti	Ngjarja
1521	Perandoria e Romës së Shenjtë fillon të drejtohet nga princi Ferdinand, i dinastisë Habsburgase.
1529	Rrethimi i parë i Vjenës nga trupat osmane.
1532	Rrethimi i dytë i Vjenës nga trupat osmane.
1618-1648	Lufta 30-vjeçare midis vendeve katolike dhe atyre protestante. P. Habsburgase u përfshi.
1663	Osmanët nisën një tjetër sulm ndaj territoreve të P. Habsburgase. Osmanët dështuan, pasi perandoria u ndihmua nga mbreti polak.
1669	U nënshkrua Paqja e Kalrovizit. Perandoria Habsburgase rimerrte zotërimet në Ballkan
1683	Rrethimi i tretë i Vjenës.
1700	Shpërthen lufta mes Austrisë dhe Francës për kurorën e fronit spanjoll, të mbajtur deri atëherë nga Karli II i dinastisë habsburgase.
Shek. XVIII	Sundimi i Maria Terezës dhe djalit të saj Xhuzepe. Nisin reformat për një shtet të centralizuar dhe modern. Me rënien e fuqisë së Perandorisë Osmane rritet gjithmonë e më shumë roli i Perandorisë Habsburgase.

Faza e tretë: Përforsimi – punë me tekstin – diagram veni

Nxënësit familjarizohen me temën e re dhe bëjnë një kujtesë të shpejtë të temës 3-4, Tematika 4 (faqe 106-108).

Pas kësaj, dy perandoritë më të fuqishme të kohës vendosen përballë njëra-tjetrës në një diagram veni.

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

Krijimin e Perandorisë Habsburge, karakterin e saj politiko-fetar, procesin e zgjerimit dhe fuqizimit të saj. Formuloni qëndrimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Islamizimi i shqiptarëve		Situata e të nxënit: Islamizimi fillonte me kryefamiljarët dhe meshkujt e rritur, të cilët bashkëjetonin me anëtarët e tjerë të familjes të paislamizuar ende. Pastaj procesi në fjalë shtrihej te gratë dhe te fëmijët. Detyrimi ekonomik ka qenë rruga kryesore për islamizimin në masë të shqiptarëve.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Tregon procesin e përhapjes së fesë islame në territoret shqiptare. • Identifikon rrugët e përhapjes së procesit të islamizimit. • Analizon shkaqet e islamizimit të popullsisë shqiptare.		Fjalët kyçe: besimi ortodoks, besimi katolik, besimi islam, devshirme, timarlinj të krishterë, bektashizmi, halvetizmi, rufaizmi, xhize, ispenxhë.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti; Historia e Popullit Shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi - bashkëbisedim Fillon bashkëbisedimi i nxënësve përmes pyetjeve frontale: 1. Kur nisi përhapja e fesë islame në trojet shqiptare? 2. Cilat ishin format e përhapjes së saj? 3. Si është sot i përhapur besimi islam në trojet shqiptare?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe nis organizimin grafik të njohurive.			

Feja islame kishte depërtuar në territorin shqiptar që para pushtimit osman. Disa nga shkaqet e përhapjes së myslimanizmit ishin:

- Konvertimi i fisnikëve vendës si mundësi për të ruajtur dhe fituar privilegje.
- Barra e madhe e taksave për banorët jomyslimanë brenda Perandorisë Osmane.
- Sistemi i Devshirmes
- Dhuna e ushtruar nga pushtuesit osman.
- Joshja e fisnikëve me poste dhe ofiqe, duke mundësuar konvertimin masiv të popullsisë së varur prej tyre.



Në trojet shqiptare, myslimanizmi u përhap në variatën e tij kryesore, atë sunit. Por për shkak të liberalizmit, një përhapje të gjerë gjeti varianti tjetër, bektashizmi. Arsyeja e përhapjes së bektashizmit lidheshin me faktin se:

- bektashizmi predikon dashuri, vëllazëri dhe bashkim.
- lejon përdorimin e pijeve alkoolike.
- lejon daljen në publik me fytyrë të zbuluar.
- ka tolerancë ndaj besimeve të tjera fetare.



Pasojat e përhapjes së islamit në trojet shqiptare ishin:

- U krijua struktura fetare me tre grupe kryesore: ortodoks, islamik dhe katolik.
- Ndikimi që i madh në arkitekturë (objektet e kultit islam, shkollat medrese).
- Ndikim i madh në veshje, gatim, letërsi dhe art.
- Krijimi i lagjeve fetare në qytete.

Pavarësisht përhapjes, ky proces nuk arriti të depërtonte në ndjenjat e popullit shqiptar, por u konceptua si një mundësi mbijetese kundrejt pushtimit. Këtë e dëshmon më së miri bashkëjetesa harmonike fetare.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin – ese pesëminutëshe

Nxënësit familjarizohen nga afër me tekstin dhe më pas reflektojnë lidhur me njohuritë përmes një eseje pesëminutëshe.

“Shqiptarët, shembull i harmonisë fetare”

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit individualisht për nivelin e saktësisë së mendimit dhe përgjigjeve gjatë pjesëmarrjes në secilën prej etapave mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. “Me përhapjen e fesë islame, struktura fetare e popullit shqiptar u diversifikua në tre besime kryesore: ortodoks, katolik dhe islam”.
- b. Procesin e përhapjes së fesë islame në territoret shqiptare.
- c. Rrugët e përhapjes së islamizimit.
- d. Shkaqet e islamizimit të popullsisë shqiptare.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Qyteti dhe kultura shqiptare (shek. XVI-XIX)		Situata e të nxënit: Sipas Robert Elsie, “Akademia e Re ose Hellênikon Frontistêrion” ishte një qendër e dijes e themeluar më 1744 në Voskopojë. Akademia e Re, Biblioteka dhe e vetmja Shtypshkronjë e Perandorisë së asaj kohe, ka qenë një trekëndësh kulturor unik në Ballkanin e mesit të shekullit XVIII.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon rëndësinë e pozitës gjeografike dhe gjeopolitike të viseve shqiptare në kuadër të planeve ekspansioniste të Perandorisë Osmane. • Përshkruan mënyrën e organizimit të brendshëm të qendrave urbane shqiptare. • Evidenton zhvillimin e kulturës shqiptare dhe ndikimet e saj nga elemente të kulturave lindore dhe perëndimore.		Fjalët kyçe: pozita gjeografike, pozita gjeopolitike, “Egnatia”, Akademia e Re.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti; Historia e Popullit Shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforsimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – pyetje frontale – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, nisur nga njohuritë paraprake të nxënësve, drejtohet pyetja frontale, e cila synon të nxisë mendimin dhe bashkëbisedimin mes nxënësve dhe mësuesit/es. • Cila është rëndësia aktuale e pozitës gjeografike të trojeve shqiptare?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar – kllaster Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë mësimin çështje pas çështje. Gjatë leximit nxënësit bëjnë nënvizimet e duhura, për t`u bërë pjesë aktive e ndërtimit të kllasterit.			



Faza e tretë: Përforcimi – pyetja binare

Në këtë fazë, drejtohet pyetja binare:

- **Roli i Perandorisë Osmane në jetën kulturore të qyteteve shqiptare, ishte pozitiv apo negativ?**

Idetë, sipas qëndrimeve që do të mbështetin nxënësit, organizohen sipas një skeme në tabelë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.


Detyra:

Identifikoni:

a. Durrës, Stamboll, Beograd, Berat, Vlorë, Shkodër, Prizren, Shkup, Elbasan, Prishtinë, Gjirokastrë, Vuçiternë, Voskopojë. Çfarë procesesh të historisë së jetës qytetare dhe kulturore të trojeve shqiptare nën sundimin osman dëshmojnë këto vende?


b. Dhaskal Todri, Theodor Kavalioti, Grigor Voskopojari, Nezim Frakulla, Onufri, David Selenicasi, Çetiri, vëllezërit Kostandin, Athanas Zografi. Çfarë procesesh të historisë së jetës qytetare dhe kulturore të trojeve shqiptare nën sundimin osman dëshmojnë këto figura historike?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Zhvillimet fetare dhe politike në Europë dhe në Perandorinë Osmane		Situata e të nxënit: Giordano Bruno ishte filozof, prift, kozmolog dhe okultist italian. Bruno u dogj për së gjalli në turrën e druve, pas shtatë viteve burgim, i akuzuar nga Kisha Katolike Romake dhe realizuar nga Inkuizicioni Romak për shkak të të pasurit të mendimeve të kundërta me besimin katolik. Bruno thoshte se dielli lëviz e ndryshon pozicion kundrejt yjeve, se edhe atmosfera e tokës lëviz bashkë me të etj.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Vë në dukje zhvillimet fetare dhe politike në Europë në kuadër të procesit të Reformacionit dhe ndikimet e tyre në situatën e brendshme dhe të jashtme të shteteve europiane. - Analizon ndikimin e ardhjes së fesë islame në Europë dhe pozicionin e Perandorisë Osmane në lidhje me zhvillimet fetare-politike në Europë, në funksion të synimeve të saj gjeostrategjike. - Evidenton përhapjen e Protestantizmit në Europë dhe kundërpërgjigjen e kishës katolike ndaj tij.		Fjalët kyçe: indulgjencë, Reformacion, Testamenti i Ri, protestantizëm, paqja e Augsburgut, Konkili i Trentos, Urdhri i Jezuitëve.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti; Historia e Popullit Shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën kyçe: Protestantizëm. Fton nxënësit të rikujtojnë njohuritë e tyre lidhur me këtë konceptet. Përmes mendimeve dhe përgjigjeve të nxënësve ndërtohet skema e “braingstorming”.			




Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – pyetja sjell pyetjen

Organizohen nxënësit në grupe me tre deri në katër anëtarë. Secilit grup u jepen pyetjet që do të përdoren gjatë leximit. Anëtarët e grupeve kanë për detyrë të zbërthejnë përmbajtjen e përgjigjes për pyetjet që u caktohen. Mësuesi/ja u shpërndan grupeve fletat me pyetjet që do zbërthen prej tyre dhe ndjek nga afër punën e secilit nxënës.

**Faza e tretë: Përforcimi – diagram veni**

Të familjarizuar me tekstin, shumë mirë, nxënësit janë gati për të realizuar fazën e fundit të mësimin. Mësuesi/ja ndërton në tabelë diagramin e venit dhe i nxit nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë në fletoret e tyre. Më pas bëhet plotësimi i tij sipas modelit.

**Vlerësimi:**

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në detyrat e dhëna.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

a. Xhordano Brunon dhe veprën e tij. Shpjegoni pse ai u dogj në turrën e druve nga kisha? Formuloni përfundimet tuaja.

b. Bëni një listë të kombeve europiane që ndjekin besimin katolik protestant dhe një listë të atyre kombeve që ndjekin besimin katolik.

c. Çfarë po ndodhte në Shqipëri, në kohën e Reformës protestante? Grumbulloni të dhëna e diskutoni në klasë.

d. Në komunitetin ku ju jetoni, cilat besime ndjekin njerëzit? Grumbulloni të dhëna dhe diskutoni në klasë.

Planifikimi ditor i orës së mësimimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Iluminizmi dhe filozofia në Europën Perëndimore, shek. XVIII		Situata e të nxënit: “Unë nuk jam dakord me atë që thua, por do ta mbroj deri në vdekje të drejtën tënde që ta thuash.” Volter. Diskutoni duke zbërthyer shprehjen.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton zhvillimet në fusha të ndryshme të shkencës në Europën e shek. XVII. • Shpjegon përhapjen e mendimit kritik kundrejt dijeve tradicionale dhe ndikimit të fesë mbi shkencën. • Shpjegon përmbajtjen e ideve kryesore iluministe dhe evidenton rrymat kryesore të mendimit iluminist. • Identifikon figurat kryesore të iluminizmit me theks të veçantë të filozofët francezë.		Fjalët kyçe: iluminizëm, “Revolucioni i ideve”, “Enciklopedi”, Revolucion Industrial Anglez.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; interneti; Historia e Popullit Shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Në këtë fazë, lexohet situata e të nxënit. Diskutohet me nxënësit shprehja e iluministit francez, Volter: “Unë nuk jam dakord me atë që thua, por do ta mbroj deri në vdekje të drejtën tënde që ta thuash.”			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë me grupe Mësuesi/ja e organizon klasën në grupe me 4-5 anëtarë. Secilit grup i caktohet tema për të diskutuar. Brenda grupeve ndahen përgjegjësitë, mbështetur në nivelet e nxënësve. Pasi punohet me tekstin, secili grup prezanton në formate A3 ose kartonë rezultatet e arritura.			
Grupi i parë – Zhvillimet në fusha të ndryshme të shkencës në Europë shek. XVIII nën ndikimin e iluminizmit. Grupi i dytë – Përfaqësuesit kryesorë të iluminizmit dhe idetë e tyre. Grupi i tretë – Monarkët e ndriçuar, politika e tyre të qeverisjes. Grupi i katërt – Shprehja e ideve iluministe në shoqërinë e sotme politike dhe civile.			
Nëse grupet janë më tepër se 4, dublohen çështjet për shqyrtim. Ndërkohë që punojnë, grupet mund të formulojnë pyetje për ato pika që kanë paqartësi dhe t’i diskutojnë me anëtarët e tjerë të klasës.			

Faza e tretë: Përforcimi – prezantimi i rezultateve

Përfaqësues të grupeve prezantojnë para klasës gjetjet e tyre, të cilat mund të jenë të organizuara në skema grafikë, tabela, kllastera etj.

Grupet ndjekin me vëmendje njëri-tjetrit, japin mendime, sugjerime dhe bëjnë vlerësime për punën e secilit grup. Të njëjtin rol luan edhe mësuesi/ja, duke mbajtur shënime për performancën në grup dhe atë individuale.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në detyrat e dhëna.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Ndikimin e ideve iluministe për të drejtat natyrore të njeriut në zhvillimin e shoqërisë shqiptare sot.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përsëritje nr. 6 (para testimit të periudhës së parë)		Situata e të nxëniti: Sasia e informacionit me të cilin nxënësit janë njohur është e konsiderueshme. Ka ardhur momenti që njohuritë të provohen para ballafaqimit me testin.	

Rezultatet e të nxëniti të temës mësimore:

Nxënësi:

- Evidenton ndikimin e qytetërimeve të para në qytetërimin grek dhe romak.
- Përcakton kohën dhe rrethanat e lindjes së qytetërimit grek dhe atij romak.
- Shpjegon fazat e zhvillimit të qytetërimit grek dhe romak.
- Përshkruan elemente të jetës së përditshme, botës kulturore materiale dhe shpirtërore në qytetërimin antik grek dhe romak.
- Shpjegon formimin e etnosit ilir mbështetur në gjurmët arkeologjike të periudhës prehistorike dhe historike.
- Shpjegon konceptet *etnogjenezë, etnos, ilir, Iliri, Epir, epirotë* etj.
- Argumenton rëndësinë e pasqyrim të qytetërimit ilir dhe nivelit të zhvillimit të tij ekonomik e kulturor në shkrimet greko-romake.
- Ndërton shkallën e kohës për periudhën nga shek. V p.e.s. – shek. I p.e.s.
- Gjykon rolin që luajtën kolonitë helene në shkëmbimin kulturor ndërmjet dy qytetërimeve.
- Evidenton shkaqet e kalimit të qendrës së Perandorisë nga Roma në Kostandinopojë.
- Përshkruan tiparet e jetës sociale dhe ekonomike të hapësirës ilire gjatë kalimit nga antikiteti në mesjetë (shek. IV-VI).
- Evidenton lëvizjet e popujve në Ballkan dhe pasojat e tyre.
- Arsyeton përfshirjen e arbërve në konfliktet e normanëve dhe anzhuinëve me Perandorinë Bizantine
- Shpjegon gjendjen politike në Ballkan në shek. XII.
- Shpjegon mënyrën e organizimit dhe të qeverisjes së principatës së Arbrit, shek. XII.
- Shpjegon shkaqet politike dhe fetare të Ikonoklastisë dhe shtrirjen e saj në hapësirën shqiptare (shek. VIII).
- Tregon veçoritë e organizimit të qyteteve shqiptare nën administratën e Venedikut.
- Shpjegon shkaqet dhe tregon drejtimet e emigrimeve shqiptare në shek. XIV.
- Evidenton momentet e para të pushtimit osman në Ballkan dhe në territoret shqiptare.
- Përshkruan raportet e vendosura mes shtetit osman dhe familjeve fisnike shqiptare.
- Shpjegon strategjinë e Skënderbeut për arritjen e bashkimit në planin e brendshëm.
- Shpjegon parimet e organizimit territorial dhe shtetëror të Perandorisë Osmane.
- Vlerëson trajtimin e popullsisë jomuslimane në Ballkan dhe në tokat shqiptare nga pikëpamja e të drejtave politike dhe ekonomike brenda shtetit osman.
- Vë në dukje zhvillimet fetare dhe politike në Europë në kuadër të procesit të Reformacionit dhe ndikimet e tyre në situatën e brendshme dhe të jashtme të shteteve europiane.
- Shpjegon përmbajtjen e ideve kryesore iluministe dhe evidenton rrymat kryesore të mendimit iluminist.

Fjalët kyçe:

Histori, arbër, shqiptarë, makejë, dorë, helenë, metekë, lojërat olimpike, komicie, oligarkia patrician, republikë aristokratike, perandori, e drejta romake, plebejtë, patricët, Lidhja e Peloponezit, Lidhja e Delosit, etnosi ilir, etnogjenezë, epir, Iliri, epirotë, federate fisnore, Dardanë, enkelejë, dasaretë, taulantë, koinon, Lidhja molose, Aleanca Epirote, bazilika, kultet ilire, qytete koloni, proces romanizimi, ekonomi feudale, latifonde, barbarë, hunë, sllavë, kultura e Komanit, marrëdhënie feudale, kronistë, arbër, Arbëri, normanë, kryqëzata, troje arbërore, Republika e Venedikut, Despotati i Epirit, Principata e Arbrit, principes, familje feudale, statutet e qeverisjes, kleri katolik, kleri ortodoks, Urdhëra fetarë, Peshkopata e Arbrit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Labërisë, Legjislacioni i Justinianit, Krisovula, nomokanone, pronia, feudalizëm patrikal, esnafe, arvanitas, arbëreshë, arhondi, fshati arbëror, ekonomi bujqësore, qytet i tipi dalmato-italian, qytet i tipit bizantin, kodikët e beratit, UNESCO, urdhër kishtar, osmanë, Perandoria Osmane, Principata e Kastriotëve, Lidhja e Lezhës, Skënderbeu, elajeti, sanxhaku, kapitulacione, fermane, ispenxha, mirie, mylk, Divani, Sheriati, kishë autoqefale, urdhri fetar françeskan, Kryepeshkopata e Ohrit, Rilindja Europiane, Humanizmi, Meshari, Marin Barleti, Perandoria Habsburgase, devshirme, bektashizmi, islami, Akademia e Re, indulgjencë, reformacion, Koncili i Trentos, iluminizëm, revolucion i ideve, revolucion industrial.

Burimet: Interneti. Teksti mësimor.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënë(10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes(25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi(10 min)
--	--	-------------------------------------

Faza e parë – Parashikimi – Parashtrim i ideve

Mësuesi/ja e hap orën e mësimit duke shënuar në dërrasë çështjet/idetë që do të diskutohen. Ftohen nxënësit që të shtojnë të tjera ide, sipas nevojave vetjake.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – Diskutim i ideve

Përmes ideve të rënditura në tabelë, nxënësit diskutojnë mbi paqartësitë që kanë rreth secilës çështje apo ide. Drejtojnë pyetje nëse kanë paqartësi.

Idetë që mund të trajtohen janë:

- Historia dhe vlerat e saj.
 - Burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve (arkivat kryesorë dhe puna me to, veprat monumentale të albanologëve të njohur).
 - Bota greke dhe kontributi i saj në qytetërimin e sotëm evropian.
 - Roma dhe veçoritë e trashëgimisë së saj në botën moderne.
 - Marrëdhëniet mes formacioneve politike në antikitet (grek-romak)
 - Procesi i formimit të etnosit ilir.
 - Tiparet e qytetërimit ilir.
 - Iliret dhe Iliria sipas autorëve antike. Arsimi, kultura dhe besimi tek iliret.
 - Ndikimi i qytetërimit greko-romak në kulturen ilire.
 - Mënyra e jetesës tek iliret.
 - Transformimet e Perandorisë romake dhe hapësira ilire në mesjetën e hershme (shek. IV-VI).
 - Dyndjet e popujve dhe ndryshimi i përbërjes etnike në Ballkan.
 - Arbëria në përballjen Lindje-Perëndim.
 - Dobësimi i Bizantit në Ballkan.
 - Formacionet shtetërore në trevat arbërore gjatë shek. XII-XIV.
 - Republika e Shën Markut dhe zotërimet veneciane në Arbëri.
 - Krishterimi - fe zyrtare e Perandorisë Bizantine: përhapja, organizimi dhe veçoritë e krishterimit në trevat arbërore (shek. IX-XIV).
 - Arbëria dhe Bizanti: Aspekte të së drejtës dhe veçoritë e jetës ekonomike.
 - Shoqëria arbërore dhe emigrimet arbërore në mesjetë.
 - Kultura në mesjetë mes civilizimit bizantin dhe atij evropian.
 - Kalimi i osmanëve në Ballkan dhe Bizanti.
 - Skënderbeu dhe koha e tij.
 - Perandoria Osmane dhe administrimi i saj.
 - Perandoria Osmane, Ballkani dhe Shqipëria.
 - Rilindja Europiane dhe Perandoria Habsburge.
 - Rilindja Europiane dhe shqiptarët
 - Islamizimi i shqiptarëve.
 - Qyteti dhe kultura shqiptare (shek. XVI-XIX).
 - Perandoria Osmane dhe Europa (lindja e protestantizmit).
 - Iluminizmi dhe filozofia në Europën Perëndimore, shek. XVIII.
- Në varësi të nivelit të klasës, mësuesi/ja përzgjedh të heqë ose të shtojë ide të tjera për diskutim.

Faza e tretë: Përforcimi – Konkluzione

Në këtë fazë bëhet një organizim i ideve përmes konkluzioneve të nxjerra nga nxënësit, të cilat përcillen me gojë. Mësuesi/ja bën kujdes që gjatë kësaj faze të aktivizojë sa më tepër nxënësit, duke synuar pjesëmarrjen edhe të nxënësve që përgjithësisht shfaqin pasivitet.

Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësim i përgjigjeve me gojë dhe i aftësisë për të punuar në grup, këmbyer dhe komunikuar informacionin.

Detyra: nuk parashikohen.

IV. MODEL TESTI, PERIUDHA E PARË (SHTATOR-DHJETOR)**Grupi A**

Data: ____/____/____

Emër _____

Mbiemër _____

1. Fisi grek që themeloi qytetërimin Mikenas ishte fisi i: (1 pikë)

- a. Akejve
- b. Dorëve
- c. Etolëve

2. Patricët dhe plebejtë i shuan konfliktet mes tyre në vitin 287 p. e. s, duke formuar një aristokraci të re, e cila u quajt: (1 pikë)

- a. Civitas
- b. Principes
- c. Nobilitas

3. Të Drejtën Romake e ushtronin vetëm: (1 pikë)

- a. Qytetarët romakë
- b. Pelegrinët
- c. Të gjithë banorët e lirë pas vitit 212

4. Midis Romës dhe Kartagjenës u zhvilluan gjithsej: (1 pikë)

- a. 2 luftëra
- b. 3 luftëra
- c. 4 luftëra

5. Cili liqen mbante emrin lyknid në antikitet? (1 pikë)

- a. Liqeni i Prespës
- b. Liqeni i Ohrit
- c. Liqeni i Shkodrës

6. U cilësua aleati më i afërt i Skënderbeut: (1 pikë)

- a. Alfonsi V i Napolit
- b. Huniadi i Hungarisë
- c. Papa Klementi

7. Kalimi i emrit nga ilirë në arbër ndodhi në: (1 pikë)

- a. Shek. X
- b. Shek. XI
- c. Shek. XII

8. Stratotët në Perandorinë Bizantine përfaqësonin: (1 pikë)

- a. Bujqit-fshatarë
- b. Bujqit-ushtarë
- c. Kalorësit

9. Cila prej këtyre zonave nuk u popullua nga arbër gjatë valës së parë të emigrimit? (1 pikë)
- Peloponez
 - Atikë
 - Raguzë
10. Rilindja Europiane i ka fillesat në qytetet e: (1 pikë)
- Italisë Veriore
 - Francës Jugore
 - Anglisë Qendrore
11. Renditni tre vendimet që u morën në Kuvendin e Lezhës, më 2 mars 1444. (3 pikë)
- _____
 - _____
 - _____
12. Listoni tre shtresat shoqërore në Athinë. (3 pikë)
- _____
 - _____
 - _____
13. Si rregulloheshin çështjet gjyqësore brenda Perandorisë Osmane? (3 pikë)
- _____
- _____
- _____
14. Renditni tre nga shkaqet që çuan në fillimin e luftërave iliro-romake: (3 pikë)
- _____
 - _____
 - _____
15. Si trajtohej popullsia myslimane në kuadër të Perandorisë Osmane? (3 pikë)
- _____
- _____
- _____
16. Shpjegoni konceptet. (3 pikë)
- Iluminizëm _____
 - Epiri _____
 - Organe komunale _____
17. Evidentoni tri nga shkaqet e rënies së qytetërimit grek. (3 pikë)
- _____
 - _____
 - _____
18. Arbrit janë pasardhës të ilirëve. Argumentoni këtë pohim. (4 pikë)

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on its right side, suggesting it's resting on a surface.

19. Veçoni tri ngjarjet më të rëndësishme në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe venedikasve. (3 pikë)

- a. _____
- b. _____
- c. _____

20. Tregoni dy betejat e para që u zhvilluan mes ballkanasve dhe Perandoria Osmane. **(2 pikë)**

- a. _____
b. _____

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 10	11 - 16	17 - 22	23 - 28	29 - 33	34 - 37	38 - 40

Viti shkollor ____ - ____

Semestri I

Çelësi i zgjidhjes së grupit A

1. Fisi grek që themeloi qytetërimin Mikenas ishte fisi i:
 - a. **Akejve**
 - b. Dorëve
 - c. Etolëve
2. Patricët dhe plebejtë i shuan konfliktet mes tyre në vitin 287 p.e.s, duke formuar një aristokraci të re, e cila u quajt:
 - a. Civitas
 - b. Principes
 - c. **Nobilitas**
3. Të Drejtën Romake e ushtronin vetëm:
 - a. **Qytetarët romakë**
 - b. Pelegrinët
 - c. Të gjithë banorët e lirë pas vitit 212
4. Midis Romës dhe Kartagjenës u zhvilluan gjithsej:
 - a. 2 luftëra
 - b. **3 luftëra**
 - c. 4 luftëra
5. Cili liqen mbante emrin lyknid në antikitet?
 - a. Liqeni i Prespës
 - b. **Liqeni i Ohrit**
 - c. Liqeni i Shkodrës
6. U cilësua aleati më i afërt i Skënderbeut:
 - a. **Alfonsi V i Napolit**
 - b. Huniadi i Hungarisë
 - c. Papa Klementi
7. Kalimi i emrit nga ilirë në arbër ndodhi në:
 - a. Shek. X
 - b. **Shek. XI**
 - c. Shek. XII
8. Stratiotët në Perandorinë Bizantine përfaqësonin:
 - a. Bujqit-fshatarë
 - b. **Bujqit –ushtarë**
 - c. Kalorësit
9. Cila prej këtyre zonave nuk u popullua nga arbër gjatë valës së parë të emigrimi?
 - a. Peloponez
 - b. Atikë
 - c. **Raguzë**
10. Rilindja Europiane i ka fillesat në qytetet e:
 - a. **Italisë Veriore**
 - b. Francës Jugore
 - c. Anglisë Qendrore
11. Renditni tre vendimet që u morën në Kuvendin e Lezhës, më 2 mars 1444.
 - a. U krijua një aleancë politiko-ushtarake e njohur si Besëlidhja e Lezhës.

- b. U krijua një ushtri shqiptare nën komandën e Gjergj Kastriot Skënderbeut.
- c. U krijua një arkë e përbashkët për përbashimin e shpenzimeve të shtetit të ri shqiptar që po lindte.

12. Listoni tre shtresat shoqërore në Athinë.

- a. Aristokratët
- b. Demosi
- c. Skllëvërit

13. Si rregulloheshin çështjet gjyqësore brenda Perandorisë Osmane?

Në Perandorinë Osmane, sistemi gjyqësor ishte i përbërë nga gjykatat osmane dhe gjykatat e sistemeve jomyslimane. Ndarja e këtij sistemi favorizonte myslimanët. Kjo dukej edhe në rastin kur myslimanët kryenin një krim nuk kishte nevojë për dëshmitarë që të mbrohej, ndërsa një jomyslimani i duheshin dy dëshmitarë. Ai që jepte drejtësi në emër të sulltanit ishte Kadiu, i cili merrte vendime juridike, duke u mbështetur në ligjin e shenjtë islam-sheriatin.

14. Renditni tre nga shkaqet që çuan në fillimin e luftërave iliro-romake:

- a. Synimet e Romës për zgjerim në Gad. Ballkanik.
- b. Veprimtaria aktive e Mbretërisë Ilire nën drejtimin e Teutës, rriti xhelozinë e shtetit romak.
- c. Pushtimet e Mbretërisë Ilire dhe bashkëpunimi me piratët që vepronin në d. Adriatik.

15. Si trajtohej popullsia myslimane në kuadër të Perandorisë Osmane?

Perandoria Osmane, edhe pse në legjislacion njihte të drejtën e lirisë së besimit, në praktikë bënte diferencime në trajtimin e popullsisë, bazuar në besimin e tij. Kështu, popullsia myslimane ishte e privilegjuar: nuk paguante shumë taksë, mund të zhvillonte lirshëm aktivitetin ekonomik, integrohej lehtësisht në administratë dhe ushtri, gëzonte lehtësira në proceset gjyqësore, përfitonte prona nga shteti etj. Përballë këtyre përfitimeve popujt e nënshtruar nga Perandoria Osmane zgjodhën të konvertoheshin në myslimanë.

16. Shpjegoni konceptet.

Iluminizëm = Lëvizje kulturore dhe shkencore e shek. XVII, që kishte në qendër arsyen dhe ndriçimin e së vërtetës. Përmes “Revolucionit të ideve” i kundërvijehet errësirës mesjetare, obskurantizmit fetar dhe shfrytëzimit të njeriut. Iluministët e vinin theksin tek të drejtat natyrore të individit për të qenë i lirë dhe i barabartë në shoqëri.

Epiri = Quhej territori që ndodhej përballë ishullit të Korkyrës. Aty u krijua dhe u zhvillua shteti i Epirit.

Organe komunale = Zgjidheshin prej parisë së qytetit mesjetar arbëror dhe merreshin me administrimin e tij. Hartonin statutin, parashikonin mënyrën e qeverisjes, detyrimet dhe të drejtat e shtetasve etj.

17. Evidentoni tri nga shkaqet e rënies së qytetërimit grek.

- a. Greqia mbeti gjithnjë e copëtuar duke mos formuar asnjëherë një formacion të bashkuar politik.
- b. Sulmet nga jashtë, luftërat e zgjatura greko-persiane.
- c. Lufta e gjatë e midis Athinës dhe Spartës.

18. Arbrit janë pasardhës të ilirëve. Argumentoni këtë pohim.

Nxënësi merr pikët nëse në argumentimin e tij përdor disa prej këtyre argumenteve:

- a. Të dhënat historike, emri Alban-Arbër, rrjedh nga fisi i albanëve që ka jetuar në prapatokën e Durrësit.
- b. Të dhënat arkeologjike, me fokus “Kulturën e Komanit”.
- c. Të dhëna gjeografike, shtrirja territoriale e ilirëve dhe arbërve.
- d. Të dhëna gjuhësore, nga ilirishtja kanë ardhur emra sendesh, njerëzish, vendbanimesh etj.
- e. Të dhëna etnografike (elementë të veshjes ilire që i gjejmë edhe tek arbërit).
- f. Të dhënat e kulturës materiale dhe shpirtërore.
- g. Të dhënat e vendbanimeve, ndërtimi i qyteteve arbërore mbi ato ilire etj.

19. Veçoni tri ngjarjet më të rëndësishme në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe venedikasve.

- a. Në shek. XI u krijua Dukati Venecian i Durrësit.
- b. Nënshkrimi i marrëveshjeve me princat vendas në shek. XIV (me Gjin Zenëbishtin, Karl Topisë etj.).
- c. Konfliktet e armatosura pas ngarkesës me taksë kundrejt arbërve në fillim të shek. XV.


20. Tregoni dy betejat e para që u zhvilluan mes ballkanasve dhe Perandorisë Osmane.

- a. Beteja e Maricës në vitin 1371.
- b. Beteja e Fushë-Kosovës (Dardanisë) në vitin 1389.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rusia u bë fuqi e madhe botërore (shek. XVIII-fillimi i shek. XIX)		Situata e të nxënit: “Rusia nuk ishte më një zonë e depresuar e Orientit të largët, por pjesë përbërëse e Europës. Jo më e ngrirë në liturgji dhe struktura mesjetare e bizantine, ajo dominonte detet dhe ulej në klubin e ngushtë e monarkive të mëdha. Pjetri i siguroi një pjesë të rëndësishme në skenën europiane”. Si e gjykoni pohimin e bërë nga historiani Uilliam Mareshall?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje konsolidimin dhe modernizimin e shtetit rus dhe daljen e Rusisë si fuqi e madhe botërore. • Tregon rolin dominues të Rusisë në botën ortodokse dhe rëndësinë e këtij pozicionimi në drejtimet e politikës së jashtme të saj, duke u përqendruar kryesisht te Ballkani. • Shpjegon qëllimin e projektit grek të Rusisë dhe rëndësinë e tij në zgjerimin e ndikimit rus në Mesdhe.		Fjalët kyçe: sistem autokratik, Dumë, senat, Sinodi i Shenjtë, Perandoria Ruse, Lufta ruso-turke, rusifikimi i nacionaliteteve, “projekti grek”, kishë autoqefale.	
Burimet: Teksti mësimor; Pjetri i Madh, A. Tolstoi; Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Mësuesi/ja u lexon nxënësve situatën e të nxënit dhe shfaq në videoprojektor shtrirjen e Rusisë në shek. XVIII. Më pas hedh për diskutim pyetjen: Si e gjykoni pohimin e bërë nga historiani Uilliam Mareshall? Për ta bërë bashkëbisedimin më aktiv në videoprojektor shfaqen imazhet e Pjetrit të Madh dhe Katerinës II, si dy perandorët që e rritën së tepërmi imazhin e Perandorisë Ruse në sytë e Europës.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – kllaster

Materiali mësimor nuk është i panjohur për nxënësit. Ata kanë mësuar për shtetin rus në klasën e dhjetë, por edhe në klasat e nëntëvjeçares, ndaj pritet që gjatë ndërtimit të njohurive, pjesëmarrja aktive e nxënësve të jetë e lartë. Informacioni i ri mund të përcillet shumë lehtë përmes teknikës kllaster. Modeli hartohet në tabelë nga ana e mësuesit/es dhe në fletoren e nxënësit.



Faza e tretë: Përforsimi – punë me tekstin

Gjatë kësaj faze, kalohet në teknikën e diskutimit të lirë.

A vazhdon ende Rusia të dominojë në Ballkan dhe në botën ortodokse? Si e shihni ju rolin e saj?


Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në detyrat e dhëna.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për: Rolin dominues të Rusisë sot në botën ortodokse dhe rëndësinë e këtij pozicionimi në drejtimet e politikës së jashtme të saj, duke u përqendruar kryesisht te Ballkani.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Pashallëqet shqiptare dhe përpjekjet për shkëputje përfundimtare		Situata e të nxënit: Pashallëqet shqiptare janë një pjesë e rëndësishme e historisë së popullit tonë. Ju kujtohet Konfederata Ilirike? Pse u projektua? Si e kujtoni figurën e Ali Pashë Tepelenës? Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje nga jeta e tij?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon kuptimin politiko-administrativ të termit pashallëk dhe zhvillimin e tij në territoret shqiptare. • Analizon zhvillimin e pashallëqeve shqiptare dhe politikat e tyre që çonin drejt synimit për shkëputje përfundimtare nga Perandoria Osmane. • Vlerëson rolin dhe ndikimin e pashallarëve të mëdhenj shqiptarë në skenën ndërkombëtare euroaziatike.		Fjalët kyçe: pashallëk, hase, çifligje, Porta e Lartë, Sanxhaku i Shkodrës, Bushatllinjtë, Çauzhollaj, Lidhja Ilirike, Perandori Osmane, dervishë, interlokutor.	
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës, I. Koçollari.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi(10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, aplikohet teknika brainstorming. Hapet mësimi me situatën e të nxënit dhe plotësohet në tabelë skema përkatëse, lidhur me figurën e Ali Pashë Tepelenës.			



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – diagram veni – lexim i orientuar

Mësuesi/ja i fton nxënësit në njohjen e materialit të ri mësimor. Fillimisht jepen sugjerime në lidhje me leximin e orientuar. Udhëzohen të kihen parasysh këto pyetje gjatë leximit të tekstit:

1. Çfarë dëshmon krijimi i pashallëqeve në raport me krijimin e principatave?
2. Kur e arriti fuqinë më të madhe Pashallëku i Shkodrës? Pse ra?
3. Cilat ishin karakteristikat e qeverisjes në Pashallëkun e Shkodrës?
4. Ku shtrihej Pashallëku i Janinës?
5. Cila ishte përbërja e popullsisë së tij?
6. Cili ishte qëndrimi i Ali Pashës ndaj fesë?
7. Cili ishte qëllimi kryesor i Ali Pashës në politikën e tij të jashtme?

Pasi kanë kryer një lexim intensiv dhe janë thelluar në studimin e tij, nxënësit kalojnë në plotësimin e diagramit të venit, sipas modelit që u jepet në tabelë:

Pashallëku i Shkodrës	Të përbashkëtat	Pashallëku i Janinës
• U krijua nga rivaliteti mes familjes së Çauhsolljave dhe Bushatllinjve. • Drejtuesit e tij kanë qenë Mehmet Pasha, Karamahmut Pasha dhe Ibrahim Pasha. • Krijoi Lidhjen Ilirike, me pjesëmarrjen e forcave shqiptaro-malazeze-boshnjake etj.	• Zgjeruan territoret. • I sollën vështirësi të mëdha Portës së Lartë në shek. XVIII-fillim shek. XIX. • Kombinuan legjislacionin Osman me urdhëresat e pashallarëve • etj.	• U krijua në vitin 1787, me ardhjen Ali Pashë Tepelenës në krye të Janinës. • Kishte në përbërje të tij popullsi me origjinë të ndryshme: shqiptare, greke, vllehe dhe turke. • Aliu mori një sërë masash që i forcuan pushtetin personal: eliminoi bandat plaçkitëse, kundërshtarët politikë, kufizoi gjakmarrjen, vendosi rend e qetësi, lidhi aleanca me Fuqi të Mëdha europiane (Francën, Rusinë, Anglinë) etj.

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim i lirë

Tashmë të informuar mirë në lidhje me pashallëqet shqiptare dhe rolin e tyre në përpjekje për të dobësuar Perandorinë Osmane, nxënësit përfshihen në diskutim të lirë, në lidhje me pyetjen:

E realizuan Pashallëqet shqiptare misionin e tyre për të ulur dominimin osman në Ballkan dhe kryesisht në hapësirën shqiptare?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për punën e pavarur në klasë, strategjitë e të komunikuarit, njohuritë e reja, bashkëpunimin në dyshe dhe nivelin e përfshirjes në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Zhvillimin e pashallëqeve shqiptare.
- b. Politikën e pashallëqeve drejt synimit për shpëtimin përfundimtar nga Perandoria Osmane.
- c. Rolin dhe ndikimin e pashallarëve të mëdhenj shqiptarë në skenën ndërkombëtare euro-aziatike.
- d. Shkaqet e rënies së pashallëqeve dhe rëndësinë e krijimit të tyre.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Revolucioni Francez dhe krijimi i modelit të shtetit komb		Situata e të nxënit: “Revolucioni francez ka qenë burimi dhe fillimi i të gjitha koncepteve të sotme komuniste, anarkiste dhe socialiste”. Diskutoni mbi thënien e Princit Pjetër Kropotkini, një studiues rus.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton karakterin e shoqërisë franceze dhe diferencimin e saj të thellë në prag të përmbyesjes së monarkisë. • Shpjegon raportin e ri të vendosur shtet-kishë dhe karakterin laik të shtetit francez pas revolucionit. • Analizon konceptin e shtetit-komb dhe faktorët historikë që çuan në formimin e shteteve-kombe në Europë.		Fjalët kyçe: fisnikëri, kleri, borgjezi, punëtorë, fshatarë, zanatçinjtë, Asamble e Përgjithshme, Përfaqësi e Përgjithshme, Asamble Kombëtare, Asamble Kushtetuese, Bastijë, Komiteti i Përhershëm, Roje Kombëtare, Asamble Kushtetuese Kombëtare, pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv, pushteti gjyqësor, Monarki Kushtetuese, zhirondinë, jakobinë, Konventa Kombëtare, koalicioni austro-prusian, Komuna, Komiteti i Shpëtimit Publik, Direktorati, kombi-shtet.	
Burimet: Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg; Historia politike e Revolucionit Francez, A. Aulard.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Nëpërmjet një videoje të animuar, nxënësit krijojnë një ide të përgjithshme në lidhje me Revolucionin Francez, shkaqet, zhvillimet kryesore dhe pasojat. Hapet në video-projektor materiali visual “The French revolution”. https://youtu.be/X1_2NëmlObU Pas pamjeve, nxënësit japin mendime të shpejta e më pas kalohet në fazën e dytë.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabela e koncepteve

Mësuesi/ja planifikon që në këtë fazë të përcjellë sa më qartë dhe në mënyrë të organizuar informacion për një nga ngjarjet më me ndikim në botë gjatë shek. XVIII. Për këtë qëllim aplikohet teknika, tabela e koncepteve. Mësuesi/ja ndërton tabelën në dërrasë, ndërsa nxënësit mbajnë shënime në fletore, sipas modelit të dhënë.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhën E DYTË (JANAR-MARS)

Çështja	Shkaqet e Revolucionit	Qëndrimi i fuqive europiane	Zhvillimet kryesore	Figurat që dominuan	Organet e reja që u krijuan	Format e qeverisjes	Dokumenti themelor	Pasojat
Përmbytja	- Diferencimi i thellë social. - Kriza ekonomike - Rritja e popullsisë. - Paaftësia e qeverisjes absolute. - Idetë e Rilindjes dhe Iluminizmit.	- Austria dhe Prusia krijuan koalicion antirevolucion.	- 5 maj 1789, Mbledhja e Përfaqësues së Përgjithshme. - 14 korrik 1789, sulmi mbi Bastijë. - 4 gusht 1789, U miratua DDNJQ - 1791, u sanksionua kushtetuta. - Prill 1792, lufta me koalicionin Austro-Prusian. - 23 shtator 1792, u vendos Republika. - 1795 u vendos Direktorati.	- Luigji XVI, Maria Antoneta, Maksimilian Robespieri, Zhan Pol Marati, Zhorzh Dantoni.	Asambleja Legjislative, Konventa Kombëtare, Komiteti i Shpëtimit Publik, Direktoriati, Këshilli i 500-ve, Këshilli i Pleqësisë.	- Monarki Absolute - Monarki Kushtetuese - Republikë - Regjimi i Terrorit - Direktorati	- Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, e cila sanksionoi: anulimin e privilegjeve feudale e fshatare dhe deklaroi barazinë mes qytetarëve.	- I dha fund rendit feudal. - Shpalli lirinë e besimit. - Shpalli barazinë e votës. - Ndau shtetin nga kisha. - Franca u bë shtet modern. - U nxit krijimi i komb-shteteve. - U hap rruga zhvillimit kapitalist. - Revolucionin nxiti lëvizjen për liri dhe pavarësi edhe jashtë Europë.

Faza e tretë: Përforsimi – punë me tekstin

Gjatë kësaj faze, synohet përforsimi i dijeve të marra. Mësuesi/ja e quan situatën e realizuar nëse nxënësit arrijnë t'u përgjigjen pyetjeve:

1. Cilat ishin shkaqet e shpërthimit të Revolucionit Francez?
2. Cila ishte ngjarja kryesore e Revolucionit?
3. Si ndryshoi raporti mes kishës dhe shtetit gjatë Revolucionit?
4. Cilat ishin pasojat e Revolucionit Francez?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

- a. Konceptin shtet-komb.
- b. Krijimin e shteteve-kombe në Europë. Cilat ishin ato?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Kongresi i Vjenës dhe restaurimi i Europës pas Napoleonit		Situata e të nxënit: Historiani A.Bopp, në librin e tij “Napoleoni dhe shqiptarët”, tregon dhe për marrëdhëniet e Napoleonit me Ali Pashën. Megjithatë, fakte të reja tregojnë se Napoleoni i vlerësonte shqiptarët dhe tregonte një interes të veçantë për pozicionin gjeografik e strategjik të Shqipërisë. Madje, për një periudhë mjaft të shkurtër, vetëm në muajin qershor 1806, ekzistojnë shumë letra të shkruara prej Napoleonit rreth Shqipërisë. Si e komentoni ju këtë lidhje me shqiptarët?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: ● Përshkruan fazat e fundit të Revolucionit Francez dhe rënien e sistemit republikan. ● Evidenton karakterin ekspansionist të shtetit francez nën drejtimin e Napoleon Bonapartit dhe krijimin e Perandorisë Franceze. ● Analizon reagimin e shteteve europiane ndaj Napoleonit dhe diferencon rolin britanik në këtë qëndrim. ● Argumenton karakterin restaurues të vendimeve të Kongresit të Vjenës.		Fjalët kyçe: Konsull i Parë i Republikës, Kodi Civil (Kodi i Napoleonit), Senati i Republikës, Perandori i Parë Francez, Kongresi i Vjenës.	
Burimet: Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg; Ditari sekret i Napoleon Bonapartit, Patrik Ravinjan.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, mes mësuesit/es dhe nxënësve nxitet një bisedë e lirë lidhur me figurën e Napoleon Bonapartit. Për ta filluar bashkëbisedimin, përdoret situata e të nxënit. U jepet vëmendje e veçantë marrëdhënieve të Napoleon Bonapartit me Ali Pashë Tepelenën. Kujtoni që edhe Viktor Hygo ka bërë një krahasim interesant mes këtyre dy figurave, duke thënë: “Aliu për Napoleonin ishte si tigri për luanin ose si petriti për shqiponjën!”.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh

Gjatë kësaj faze mësuesi/ja, aplikon ditarin dypjesësh. Udhëzon nxënësit që të lexojnë mësimin e ri, në faqet 140-142 dhe të bëjnë nënvizimet e duhura për të plotësuar më pas modelin e ditarit dypjesësh sipas modelit që realizohet në tabelë.

Çështja	Komenti
Karriera e Napoleon Bonapartit	– 1789, Napoleon Bonaparti u vetëshpall Konsull i Parë i Republikës. – 1800-1804 ndërmori një sërë reformash, të cilat, përpos ndikimit pozitiv në zhvillimin e Francës, forcuan pushtetin vetjak të Napoleonit. – 1804, senati i Republikës e kurorëzoi Perandor të Francës. – Franca u shndërrua nga Republika në Perandori. – Karriera e tij në krye të shtetit lidhet më së tepërmi me luftërat dhe dëshirën për ekspansion.
Vendimet e Kongresit të Vjenës krijuan një rend të ri europian	
Harta e re e Europës, pas Kongresit të Vjenës, u realizua mbi baza interesash	-

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Në këtë fazë, nxënësit përfshihen në rrjetin e diskutimit dhe nxirren konkluzionet për dy çështjet kyçe:

- Roli i Napoleon Bonapartit në krye të Francës.
- Karakteri restaurues i vendimeve të Kongresit të Vjenës.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Vëreni fotot dhe interpretoni. Cila është lidhja e tyre me Kongresin e Vjenës dhe restaurimin e Europës pas Napoleonit? Çfarë mesazhi përcjellin për ju? Përshkruajini ato dhe formuloni përfundimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rusia dhe kryengritja serbe për shkëputje nga Perandoria Osmane. Pansllavizmi.		Situata e të nxënit: Rusia është cilësuar përherë si “nëna” e sllavëve të Ballkanit. A mund të sillni mendime, të mbështetura në fakte, lidhur me këtë pohim?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje përpjekjet e popullit serb për shkëputje nga Perandoria Osmane. • Evidenton rolin kyç të Rusisë si mbrojtëse e lëvizjes serbe për shkëputje. • Shpjegon konceptin e pansllavizmit dhe analizon idetë kryesore të tij. • Përrshkruan hapat e procesit të shkëputjes së Serbisë nga Perandoria Osmane.		Fjalët kyçe: serbë, Perandori Osmane, Akademia e Kievit, knjazë, milici lokale, vojvod, lufta ruso-turke, politikë pansllaviste, Serbi autonome, skupshtina, principatë autonome, Traktati i Shën Stefanit, Mbretëria Serbe, pansllavizmi.	
Burimet: Interneti, Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg, teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe më pas lexon situatën e të nxënit, duke i hapur kështu rrugën bashkëbisedimit lidhur me ndikimin që ka pasur dhe ka aktualisht Rusia në vendet e Ballkanit. 1. Pse Rusia cilësohet si “nëna” e sllavëve të Ballkanit? 2. Cila është lidhja mes serbëve dhe rusëve? 3. Si ndihmoi Rusia në krijimin e shtetit serb?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar – punë në grupe

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe me 4-5 anëtarë. Secilit prej grupeve i ngarkohet një detyrë e caktuar për të realizuar.

Grupi i parë:

Serbët, origjina dhe situata e tyre në shek. XVIII.

Grupi i dytë:

Kryengritja e parë serbe (1804-1813).

Grupi i tretë:

Kryengritja e dytë serbe (1815-1834).

Grupi i katërt:

Dinastia e Karagjeorgjeviçëve dhe Obrenoviçëve, në ndërtimin e shtetit serb.

Grupi i pestë:

Roli i Rusisë në kryengritjet serbe për shkëputje nga Rusia.

Grupi i gjashtë

Koncepti i pansllavizmit dhe idetë e tij.

Pasi janë ndarë detyrat për secilin grup, mësuesi/ja ndjek nga afër punën e kryer dhe bën ndërhyrjet e duhura, jep sugjerime dhe mban shënime për kontributin individual të nxënësve gjatë të nxënimit në bashkëpunim. Udhëzohen nxënësit për mënyrat e prezantimit të arritjeve përmes posterave, letrave flipçarte apo lojës me role.

Faza e tretë: Përforsimi – prezantim i punimeve

Secili prej grupeve prezanton punimin e tij, përmes të gjithë anëtarëve ose 1 apo 2 përfaqësuesve. Gjatë prezantimeve, pjesa tjetër e klasës mban qetësi dhe dëgjon me vëmendje për të gjykuar drejt mbi nivelin e prezantimit të secilit prej grupeve.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit nga ana e mësuesit/es për saktësinë e mendimeve, angazhimin individual dhe në grup gjatë secilës etapë mësimore. Bëhet vlerësimi ndër nxënës, për punimet e realizuara dhe strategjinë e të prezantuarit.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Ndikimin e politikës pansllaviste në proceset e integritetit evropian të vendeve të Ballkanit sot (këtë punim mund ta vendosni në portofolin e nxënësit).

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Kryengritja greke, roli i Fuqive të Mëdha të kohës në fitoren e pavarësisë dhe ndërtimin e shtetit të ri grek		Situata e të nxënit: Është fakt, tashmë nuk mund të diskutohet, edhe pse deri tani pjesërisht ishte fshehur që 90 ndër 100 heronjtë e kryengritjes së vitit 1821 ishin arvanitas. Diskutoni rreth pjesëmarrjes së arvanitasve në Kryengritjen Greke të vitit 1821.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje centralitetin e idesë së ortodoksizmit në përpjekjet për shkëputje të popujve ballkanikë dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në Ballkan. • Tregon rolin e shoqërisë Filiki Eteria në organizimin e kryengritjes greke dhe zhvillimin e saj. • Vlerëson rolin dhe mbështetjen e Fuqive të Mëdha në fitoren e pavarësisë greke dhe ndërtimin e shtetit të ri grek.		Fjalët kyçe: Ortodoksizmi, Patriarkana e Stambollit, Perandoria Osmane, armatolikë, Filiki Eteria, Porta e Lartë, direktorati, Këshill Regjence.	
Burimet: Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	

Faza e parë: Parashikimi – DDM

Në këtë fazë, mësimi hapet me leximin e situatës së të nxënit. Pasi dëgjohen disa nga mendimet e nxënësve rreth saj, mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe më pas modelin e ditarit trepjesësh (DDM). Nxënësi e realizon në fletore dhe nis të organizojë dijet e tij. Dy rubrikat e para plotësohen në këtë etapë mësimore. Rubrika e tretë plotësohet në etapën e dytë në bashkëpunim mësues-nxënës.

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – vazhdon DDM


Mësuesi/ja shpjegon temën e re, duke tërhequr vëmendjen përmes pyetjeve që ata kanë formuluar që në fazën e parë.

Kësisoj nxënësit përfitojnë për të plotësuar skemën, por edhe për të strukturuar më mirë dijet e reja.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Grekët janë një popull i lashtë, me tradita të një qytetërimi me ndikim botëror, arritje të gjithanshme, të cilat kanë ardhur deri në ditët e sotme. Të gjendur të përçarë, Perandoria Osmane e pati të lehtë të shtrinte ndikimin e saj edhe në këto vise. Por në territoret greke më i fortë se ndikimi osman qe ai fetar i kishës ortodokse, ndaj të cilës edhe Porta e Lartë ishte më dashamirëse. Kreu i Patriarkanës zgjidhej nga sulltani dhe përherë nga radhët e grekëve. Revolucioni grek nisi në shek. XIX. Disa prej heronjve të revolucionit ishin nga radhët e arvanitasve.	– Si ishte situata në Greqi në prag të lëvizjes revolucionare? – Cili ishte roli i Patriarkanës në përpjekjet për shkëputjen nga Perandoria Osmane? – Në cilat rrethana u organizua Kryengritja Greke? – Çfarë roli pati Ali Pashë Tepelena në kryengritjen greke? – Kur u shpall Pavarësia e Greqisë? – Çfarë qëndrimi mbajtën Fuqitë e Mëdha? – Pse lufta me osmanët vazhdoi edhe pas shpalljes së Pavarësisë? – Kush ishin drejtuesit e parë të shtetit grek?	– Grekët nën sundimin osman, ndryshe nga popujt e tjerë, ishin më të privilegjuar. Kjo vinte më së tepërmi nga roli që luanin grekët në Patriarkanën e Stambollit. - Këto privilegje i gëzonin më së tepërmi banorët e qyteteve dhe fisnikëria, pasi në zonat rurale ishte e vështirë.

Faza e tretë: Përforsimi – diagram veni

Të njohur tashmë me dy kryengritjet më të rëndësishme antiosmanë në Ballkan gjatë shek. XIX, nxënësit realizojnë diagramin e venit, duke krahasuar kryengritjen serbe kundrejt asaj greke:



Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Udhëheqësin e kryengritjes greke Teodor Kollokotroni dhe kontributin e arvanitasve në Pavarësinë e Greqisë nga Perandoria Osmane.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Çështja shqiptare dhe qëndrimi i Perandorisë Osmane		Situata e të nxënit: Çfarë ju kujtojnë këto figura historike: Mustafa Pashë Bushatlliu, Omer Pashë Vrioni, Iliaz bej Vlora?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan situatën në trojet shqiptare pas rënies së pashallëqeve të mëdha. • Vë në dukje përpjekjet e shqiptarëve për shkëputje nga Perandoria Osmane pas rënies së pashallëqeve. • Evidenton qëndrimin e shtetit osman ndaj shqiptarëve dhe çështjes shqiptare.		Fjalët kyçe: çështja shqiptare, Porta e Lartë.	
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Shfaqen fotot e tre figurave historike: Mustafa Pashë Bushatlliut, Iliaz Bej Vlorës dhe Omer Pashë Vrionit. Pyeten nxënësit: 1. Cili është kontributi i tyre për çështjen shqiptare? 2. A është ndonjëri prej tyre nga vendlindja juaj? 3. Çfarë dini më tepër rreth veprës së tij patriotike?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – pyetja sjell pyetjen Mësuesi/sja orienton nxënësit në tekst, në faqet 149-151, duke i udhëzuar që gjatë leximit ata duhet të formulojnë pyetje pas pyetje dhe në bashkëpunim me shokun e bankës të punojnë për gjetjen e përgjigjeve.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËn E DYTË (JANAR-MARS)



Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Gjatë kësaj faze vazhdon puna me tekstin për gjetjen e përgjigjeve. Pas përfundimit hapet diskutimi i lirë, dëgjohen dhe diskutohet saktësia e përgjigjeve. Bëhen korrigjimet e nevojshme dhe nxirren konkluzionet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- "Në kushtet kur Perandoria Osmane po fillonte të humbte pjesë të saj në Ballkan nga Pavarësia e Greqisë dhe krijimi i principatave autonome të Serbisë, Malit të Zi, Rumanisë etj., territori shqiptar merrte rëndësi të veçantë". Pse?
- Përpjekjet e shqiptarëve për shkëputje nga Perandoria Osmane pas rënies së pashallëqeve.
- Qëndrimin e shtetit osman ndaj shqiptarëve dhe çështjes shqiptare.


Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shqipëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shqiptarët dhe Tanzimatit (1839-1879)		Situata e të nxënit: Në reformat e Tanzimatit, edhe pse u tha se garantohej barazia mes kombeve, shqiptarët nuk u trajtuan si komb më vete, por si turq, latinë e grekë. Si mendoni ju, pse këtij populli nuk iu lejua të krenohej me prejardhjen?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: ☐ Shpjegon thelbin e Tanzimatit dhe domethënien e tyre për shqiptarët. ☐ Tregon përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për përparimin e çështjes shqiptare me theks të veçantë në përhapjen e arsimit dhe të kulturës.		Fjalët kyçe: Tanzimatit, lufta ruso-turke, rregullore ushtarake, jeniçerë, spahinj, sekt i bektashinjve, Gjylhane-“Shtëpia e trëndafilave”, elajete, vilajete, sanxhaqe, kaza, nahije, mejtepe, medrese, sistemi feudal-ushtarak, xhize.	
Burimet: Shqipëria dhe Tanzimatit, Zana Lito; Historia e Popullit Shqiptar; interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë: Parashikimi – brainstorming


Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi, lexon situatën e të nxënit dhe zhvillon teknikën brainstorming në lidhje me Reformat e Tanzimatit.



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – kllaster

Mësuesi/ja ndërton në tabelë skemën e kllasterit dhe udhëzon nxënësit të mbajnë shënime. Me qëllim pjesëmarrjen sa më aktive të të gjithë klasës, drejtohen pyetje frontale për të ndërtuar një kllaster sa më të strukturuar. Pyetjet që mund të përdorë mësuesi janë:

1. Kur u shpallën Reformat e Tanzimatit?
2. Pse ishte i domosdoshëm aplikimi i tyre?
3. Cilat ishin fushat që prekeshin nga ndryshimet e Tanzimatit?
4. Si u trajtuan shqiptarët nga këto reforma?
5. Si organizoheshin reformat sipas arsimit, ekonomisë, ushtrisë dhe administrimit territorial?
6. Cili qe reagimi i shqiptarëve ndaj reformave?
7. A ishin këto reforma shtysa e zhvillimit të Rilindjes Kombëtare?
8. Cilët janë rilindësit e parë?
9. Si e dhanë kontributin e tyre?



Faza e tretë: Përforcimi – nxjerrja e konkluzioneve

Në këtë fazë, mësuesi/ja mat nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënës, përmes disa pyetjeve. Situata quhet e realizuar nëse nxënësi arrin të:

- Sqarojë konceptet: Tanzimat, sistem fiskal, sistem feudalo-ushtarak, Rilindje Kombëtare.
- Identifikojë shkaqet që sollën nevojën e reformave në Perandorinë Osmane.
- Identifikojë fushat në të cilat u aplikuan reformat dhe reformat kryesore për secilën fushë.
- Sqarojë reagimin e shqiptarëve ndaj këtyre reformave.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen e secilës prej teknikave të përdorura.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Konsiderimin e banorëve shqiptarë të besimit mysliman si turq dhe ata të besimit ortodoks si grekë. Pse?
- Thelbin e Tanzimatit dhe pasojat e tij për shqiptarët.
- Përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare për përparimin e çështjes shqiptare në fushën e përhapjes së arsimit dhe të kulturës.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Fuqizimi i nacionalizmave ballkanike		Situata e të nxënit: Rikujtoni konceptet “Megali Idea” dhe “Naçertania”. Diskutoni rreth thelbit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: ☐ Identifikon thelbin e ideologjive nacionaliste greke dhe serbe. ☐ Gjykon mbi ndikimin e tyre në zhvillimin e çështjes shqiptare që nga shek. XIX e deri sot.		Fjalët kyçe: Megali Idea, Kriza e Tretë Lindore, Naçertania, Principata Serbe, Perandoria Serbe e Dushanit, Perandoria Habsburge, çetnikë, Partia Kombëtare Kroate.	
Burimet: Shqipëria dhe Tanzimati, Zana Lito; Historia e Popullit Shqiptar; Internet; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Për këtë temë mësimore, nxënësit janë orientuar që një orë më parë. U është kërkuar që të kërkojnë dhe të marrin me vete informacione shtesë lidhur me dy platformat nacionaliste që preknin interesat dhe territoret shqiptare në shek. XIX. Duke besuar se detyra është realizuar nga e gjitha klasa, mësimi fillon me një bashkëbisedim lidhur me dy konceptet: - Megali idea - Naçertania			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – Ese krahasuese Me materialet e gjetura dhe tekstin përpara nxënësve u kërkohet që të shkruajnë një ese krahasuese mes dy platformave nacionaliste serbe dhe greke të shek. XIX dhe impaktin që kanë pasur ato në historikun e marrëdhënieve mes popujve të Ballkanit. Tema e esesë: Megali Idea dhe Naçertania deri në ditët tona. Eseja duhet të realizohet sipas rregullave të drejtshkrimit, e strukturuar, mbështetur në fakte dhe argumente të karakterit historik, me shumë pak ndikim letrar dhe e zhveshur nga ndjesitë emocionale. Duhet të përmbajë një informacion të organizuar me 200-300 fjalë. Mësuesi/ja e ndjek nga afër punën e nxënësve, këshillon dhe sqaron në rast nevojë.			
Faza e tretë: Përforcimi – prezantimi i punimeve Për efekt kohe, përzgjidhen të lexohen në mënyrë rastësore disa ese. Ndërkohë që pjesa tjetër e tyre i nënshtrohet kontrollit të mësuesit/es dhe vlerësohet me notë, e cila përlllogaritet si pjesë e vlerësimit të portofolit të të nxënit.			
Vlerësimi: Vlerësim individual i çdo nxënësi për qartësinë e mendimeve, saktësinë dhe strategjinë e përdorimit të fakteve historike, respektimin e rregullave të shkrimit të esesë.			
Detyra: Nuk parashikohen.			

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Nacionalizmi shqiptar dhe përpjekjet e para për organizim		Situata e të nxënit: Nacionalizmi shqiptar është shfaqur me Rilindjen Kombëtare, e cila ishte një lëvizje kulturore e politike për formimin dhe përhapjen e vetëdijes kombëtare shqiptare dhe për themelimin e një shteti kombëtar. Po sot si shfaqet nacionalizmi te shqiptarët?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje dobësimin e pozitës ndërkombëtare të Perandorisë Osmane dhe ndikimin e saj në gjendjen e brendshme të perandorisë. • Evidenton reagimin e Perandorisë Osmane ndaj nacionalizmit në Ballkan në mesin e shek. XIX dhe veçoritë e nacionalizmit shqiptar. • Dallon rreziqet me të cilat përballeshin viset shqiptare në raport me fqinjët dhe përpjekjet e nacionalistëve shqiptarë për t’u bërë atyre ballë. • Analizon faktorët që çuan në një ringjallje të kishës katolike në tokat shqiptare dhe ndikimin e saj në afirmimin e nacionalizmit shqiptar.		Fjalët kyçe: Fuqi të Mëdha, Porta e Lartë, nacionalizmi shqiptar, Bushatllinjte, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Perandoria Austriake.	
Burimet: Shqipëria dhe Tanzimati, Zana Lito; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim			
Gjatë kësaj faze zhvillohet një bashkëbisedim midis nxënësve, nën drejtimin e mësuesit/es, në lidhje me pyetjet e mëposhtme:			
1. Çfarë është nacionalizmi?			
2. Çfarë është nacionalizmi shqiptar?			
3. Si shfaqet sot nacionalizmi në radhët e shqiptarëve?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mësimi i strukturuar – shpjegim

Mësuesi/sja shkruan në tabelë temën e mësimt dhe gjatë shpjegimit strukturon informacionin në çështje dhe ide kryesore. Nxënësit këshillohen të mbajnë shënime.

Perandoria Osmane dobësohet

- Kriza Lindore ndikoi fuqishëm në dobësimin e pozitës ndërkombëtare të Perandorisë Osmane.
- Situata e vështirë ndërkombëtare ngadalësoi aplikimin e reformave të Tanzimatit.
- Ranë investimet në ekonomi, arsim, shëndetësi etj.
- Humbën territoret dhe u pakësuan të ardhurat.
- Porta e Lartë haste vështirësi në administrim e territorit.

**Reagimi ndaj
Lëvizjeve
Nacionaliste**

- Synonte shtypjen e tyre që në shfaqje.
- Për shkak të shkallës dhe fuqisë së tij, u reagua me dhunë (rasti grek).
- Në disa raste reagoi edhe me lëshime graduale (rasti i serbëve, bullgarëve etj.).
- Në rastin e shqiptarëve, u synua përçarja dhe kontrolli i Lëvizjes Nacionaliste.

**Kushtet e lindjes
së Nacionalizmit
Shqiptar**

- U ndikua nga shthurja e marrëdhënieve feudale dhe lindja e atyre kapitaliste.
- Krijimi i Pashallëqeve shqiptare dhe synimi i tyre për shkëputje nga Stambolli.
- Roli i figurave historike dhe paria qytetare që aspironin krijimin e shtetit shqiptar.
- Aplikimi i Reformave të Tanzimatit.
- Lindja e rrezikut për copëtim të territoreve, prej pretendimeve fqinje.

Qëllimi i nacionalizmit shqiptar ishte çlirimi i vendit nga pushtimi osman dhe bashkimi i tyre në një shtet të vetëm.

**Rreziku i
copëtimit të
trojeve shqiptare**

- U vu në dukje pas krijimit të shteteve ballkanike, të cilat synuan zgjerim territorial.
- Viset jugore dhe ato veriore u vunë nën shënjestrën e fqinjëve.
- Porta e Lartë rezultoi e paaftë që të mbronte viset shqiptare.
- Shqiptarët quajtën si më të përshtatshme forcimin e pozitave shqiptare brenda Perandorisë Osmane.
- U punua gjithashtu për forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

**Ndikimi i kishës
katolike në
nacionalizmin
shqiptar**

- Me ndihmën e Perandorisë Austriake gjallëroi besimin katolik në trojet shqiptare.
- Nxiti lëvizjen emancipuese kulturore, arsimore dhe patriotike të shqiptarët.
- Bëri përpjekje për të njohur çështjen shqiptare në kancelaritë europiane.
- Veprimtarët e Rilindjes Kombëtare i përkisnin klerit katolik.

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim

Pasi janë familjarizuar me informacionin e ri, edhe përmes një leximi të pavarur, kalohet në diskutimin e lirë lidhur me pyetjen:

Si ndikon aktualisht nacionalizmi shqiptar në krijimin e një klime bashkëpunuese në rajonin e Ballkanit?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për nivelin e pjesëmarrjes në secilën etapë mësimore, formulimin e përgjigjeve dhe aktivizimin në diskutimet që zhvillohen në klasë.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Nacionalizmin në vendbanimin tuaj dhe përpjekjet e tij për organizim gjatë shek. XIX.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhën E DYTË (JANAR-MARS)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla:VI	Klasa:XII
Tema mësimore: Kërcënimi Rus në Ballkan, Perandoria Osmane dhe Kongresi i Berlinit		Situata e të nxënësve: Traktati i Shën-Stefanit nuk e zinte fare në gojë Shqipërinë, e cila për Rusinë nuk ekzistonte si subjekt të drejtash politike. Sipas Traktatit të Shën-Stefanit, gati gjysma e trojeve shqiptare u jepej shteteve sllave ballkanike. Si ndikoi ky Traktat në zgjimin e shqiptarëve?	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi:		Fjalët kyçe:	
• Shpjegon thelbin e Krizës Lindore dhe ndikimin e luftërave ruse-turke në dobësimin progresiv të Perandorisë Osmane. • Evidenton vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, të imponuara nga Fuqitë e Mëdha mbi Perandorinë Osmane. • Analizon pasojat e këtyre vendimeve mbi integritetin e trojeve shqiptare dhe rrezikun nga synimet ekspansioniste të fqinjëve.		Krizat Lindore, lufta ruso-osmane, Lufta e Krimesë, Traktati i Parisit, Principata e Vllahisë, Principata e Moldavisë, Traktati i Shën Stefanit, Sanxhaku i Novi Pazarit, Kongresi i Berlinit, Rumelia Lindore, Komisioni Europian “privilegjet dhe imunitetet” e Mirditës.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; Interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënësve (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforsimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim			
Gjatë kësaj faze, mësuesi/sja e përqendron vëmendjen e klasës te situata e të nxënësve. Përmes vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit, organizon në klasë bashkëbisedimin me temë: Traktati i Shën Stefanit ndikoi në zgjimin kombëtar të shqiptarëve.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar –diagram veni

Gjatë kësaj faze, orientohen nxënësit të lexojnë tekstin duke u dhënë rëndësi këtyre çështjeve:

- Kriza e Parë Lindore
- Kriza e Dytë Lindore
- Traktati i Shën Stefanit
- Kongresi i Berlinit

Pasi janë thelluar në lexim, nxënësit punojnë për të plotësuar diagramin e venit sipas kërkesave:

Diagrami i parë: Krahësimi i dy Krizave Lindore.

Kriza e Parë Lindore	Të përbashkëta	Kriza e Dytë Lindore
– U zhvillua në vitet 1830-1840 – Shkaku i fillimit të saj lidhet me figurën e sundimitarit të Egjiptit, Mehmet Aliu.	– Në të dyja krizat ndërhyjnë Fuqitë e Mëdha Europiane (Anglia, Franca, Austria dhe Prusia)	– U zhvillua në vitet 1853-1856. – Shkaku i saj lidhet me ndërhyrjen e trupave ruse në Moldavi.

Diagrami i dytë: Krahasimi i Traktatit të Shën Stefanit dhe Traktatit të Berlinit

Traktati i Shën Stefanit	Të përbashkëtat	Traktati i Berlinit
– U nënshkrua më 3 mars 1878. – Parashikonte krijimin e një Bullgarie të madhe.	– Cenuan rëndë interesat e popullit shqiptar. – Nuk e njihnin Shqipërinë si njësi politike të veçantë. – Nuk i njohu Shqipërisë asnjë të drejtë kombëtare.	– U arrit më 13 qershor 1878. – Ideja e një principate bullgare mbeti në fuqi, por me territore trefish më pak se në Traktatin e Shën Stefanit.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Në këtë fazë, mësuesi/ja kontrollon nivelin e përvetësimit të njohurive përmes disa pyetjeve. Situata quhet e realizuar nëse nxënësit janë në gjendje të:

1. Përcaktojnë thelbin e Krizave Lindore.
2. Tregojnë vendimet kryesore të Traktatit të Shën Stefanit.
3. Përcaktojnë rolin e Kongresit të Berlinit në rrudhosjen e territoreve shqiptare.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e mendimeve, punën e pavarur në plotësimin e diagramit të venit, organizmin e informacionit në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Pasojat e vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit mbi integritetin e vendbanimit tuaj dhe rrezikun nga synimet ekspansioniste të fqinjëve.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:				
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII				
Tema mësimore: Reagimi shqiptar - Lidhja e Prizrenit		Situata e të nxënit: Ditën kur u hap Kongresi i Berlinit, më 13 qershor 1878, qytetarët shkodranë i drejtuan ministrit të Jashtëm britanik, lordit Bikonstild, një memorandum me një përmbajtje të lartë patriotike. Aty thuhej midis të tjerave: “Shqipëria nuk mund të përfaqësohet nga qeveria osmane. Shqiptari, qoftë katolik, qoftë ortodoks, qoftë mysliman, e urren aq pushtuesin turk sa edhe çdo pushtues tjetër të huaj. Porta e Lartë e ka mundur, por jo nënshtruar Shqipërinë...”					
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton situatën dhe rreziqet për trojet shqiptare pas Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit. • Analizon zhvillimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ballafaqimin e qëndrimeve të drejtuesve të saj dhe rëndësinë e kësaj ngjarje. • Argumenton nevojën për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare dhe përpjekjet e qarqeve patriotike shqiptare në këtë drejtim.		Fjalët kyçe: Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, Lidhja e Prizrenit.					
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; interneti; Lidhja e Prizrenit, K. Frashëri; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi					
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve							
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim – braingstorming Në këtë fazë, përmes bashkëbisedimit, nxënësit evidentojnë vendimet dhe rëndësinë historike të Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, duke ndërtuar në tabelë dy skema:							
Traktati i Shën Stefanit Kongresi i Berlinit <tr><td colspan="4">Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e re të mësimi. Pas kësaj, përmes organizuesit grafik, sistemon informacionin e ri. Këshillohen nxënësit të mbajnë shënime. Herë pas here, mësuesi/ja nxit pjesëmarrjen e nxënësve përmes pyetjeve frontale.</td></tr>				Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e re të mësimi. Pas kësaj, përmes organizuesit grafik, sistemon informacionin e ri. Këshillohen nxënësit të mbajnë shënime. Herë pas here, mësuesi/ja nxit pjesëmarrjen e nxënësve përmes pyetjeve frontale.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e re të mësimi. Pas kësaj, përmes organizuesit grafik, sistemon informacionin e ri. Këshillohen nxënësit të mbajnë shënime. Herë pas here, mësuesi/ja nxit pjesëmarrjen e nxënësve përmes pyetjeve frontale.							

Pasojat e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit

- U bëri të qartë shqiptarëve që duhet të merrnin vetë në dorë fatin e tyre.
- I vunë shqiptarët përballë asimilimit dhe copëtimit nga ana e fqinjëve.

Më 18 dhjetor 1877 u krijua Komiteti i Stambollit. Kryetar i tij ishte Abdyl Frashëri. Ky komitet vendosi të organizonte kryengritje të armatosur për të shpallur pavarsinë kombëtare, por me kalimin e kohës u kalua në pretendime më realiste, të cilat synonin bashkimin e vendit në një vilajet të vetëm.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (10 qershor 1878)

QËLLIMET:

- Ndalimi i aneksimit të territoreve shqiptare si detyrë imediate.
- Krijimi i kushteve për shpalljen e autonomisë së trojeve shqiptare.

OBJEKTIVAT:

- Ruajtja e sovranitetit të sulltanit në trojet shqiptare, si garanci për moscopëtimin e tyre.
- Mbrotjtja e tërësisë territoriale shqiptare.

ORGANET E LIDHJES:

- Këshilli i Përgjithshëm i drejtuar nga Iliaz Pashë Dibra.
- Komiteti Qendror, i përbërë nga Komisioni i Punëve të Jashtme (A. Frashëri) dhe i Punëve të Brendshme (Haxhi Shabani) dhe ai i Financës (S. Vokshi)

Ndërkombëtarizimi i çështjes shqiptare

Fuqitë e Mëdha e kishin harruar kontributin e madh të shqiptarëve të Epokës së Skënderbeut dhe Pashallëqeve shqiptare në drejtim të dobësimit të perandorisë.

Shqiptarët nuk ndalën së vijuari përpjekjet për ta bërë të njohur çështjen shqiptare. Rol të madh luajtën botimet në gjuhë të huaj të veprave të rilindësve shqiptarë dhe gjallërimi i diasporës shqiptare.

Faza e tretë: Përforcimi – punë me tekstin

Në këtë fazë, udhëzoj nxënësit që të plotësojnë tabelën e koncepteve sipas modelit të dhënë:

Data e krijimit të Lidhjes së Prizrenit	Qëllimi	Organet	Figurat drejtuese	Aktivitetet kryesore

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive. Vlerësohen për saktësinë dhe arsyetimin e përdorur në realizimin e teknikave për secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi:

“Para Shqipërisë qëndronte si detyrë e ngutshme ruajtja e tërësisë së saj tokësore... Në kushtet e reja pavarësia kombëtare e Shqipërisë ishte e perealizueshme, pasi ajo nuk gëzonte mbështetje në arenën ndërkombëtare”. Pse?

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUDHËN E DYTË (JANAR-MARS)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Dokumente themelore të nacionalizmit shqiptar		Situata e të nxënit: “Vetëm mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës mund ta çojnë atdheun në mesin e vendeve të qytetëruara”. Diskutoni për thënien e Naum Veqilharxhit.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Argumenton rëndësinë e veprave të rilindësve shqiptarë për njohjen dhe projektimin e çështjes shqiptare. - Interpreton vizionin e rilindësve për të ardhmen e një Shqipërie të pavarur.		Fjalët kyçe: Perandori Osmane, “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, Këshill Pleqësie, Këshill i Përgjithshëm, Organ i Lartë.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; Lidhja e Prizrenit, K. Frashëri.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, zhvillohet një bashkëbisedim aktiv lidhur me thënien e famshme të Naum Veqilharxhit: “Vetëm mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës mund ta çojnë atdheun në mesin e vendeve të qytetëruara”.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi. Nxënësit janë informuar që një orë më parë lidhur me atë që do të trajtohet në këtë orë, ndaj duhet të paraqiten të përgatitur me informacionin shtesë për të punuar në klasë. Klasa organizohet në grupe me 4 ose 5 anëtarë. Secili prej grupeve merr dhe trajton njërin nga temat që mësuesi/ja shkruan në tabelë: Tema 1. Pashko Vasa dhe vepra e tij “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” Tema 2. Sami Frashëri dhe vepra e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet” Secili anëtar brenda grupeve punon me një nëntemë të caktuar, e cilat trajtohet edhe përmes informacionit shtesë të marrë në botime apo internet. Nëntemat: 1. “Biografia, në vija të përgjithshme të informacionit, të autorit përkatës” 2. “Pasqyrimi i çështjes kombëtare në veprat e tij” 3. “Alternativat që u shpalosën për krijimin e shtetit shqiptar” Gjatë gjithë kohës mësuesi/ja ndjek nga afër punën e nxënësve, ndërhyr përmes vërejtjeve dhe këshillave.			
Faza e tretë: Përforcimi – prezantimi i arritjeve Grupet prezantojnë me radhë punimet e tyre, të cilat mund të jenë të formave të ndryshme: organizues grafikë, postera, ese individuale të anëtarëve sipas nëntemave etj. Dëgjohen prezantimet dhe diskutohen arritjet mes nxënësve.			
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.			
Detyra: Mendoni në mënyrë kritike. Cili është refleksioni juaj mbi: a. “Gjuha e tij si dhe ata që e flasin ka qëndruar kundër çdo gjëje dhe shqiptari ka mbetur pellazg kudo që është vendosur”. b. “Shqiptarët duhet të lidhin fjalë midis tyre, të bashkohen gjithë sa janë, të japin e të marrin besë burrërisht, të qëndrojnë në fjalë të patundur dhe të kërkojnë të drejtën e tyre nga Turqia dhe nga Evropa”.			

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përpyjekjet e shqiptarëve për afirmimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare		Situata e të nxënit: Komentoni vargjet “Lumja ti moj Korça, lule, që i le pas shoqet e tua! Si trimja në ballë u sule, ta paçim përjetë hua!”	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton përpyjekjet e shqiptarëve për përhapjen e gjuhës shqipe, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. • Përshkruan procesin e krijimit të alfabetit të shqipes deri në Kongresin e Manastirit. • Evidenton përpyjekjet dhe vështirësitë me të cilat u përballën patriotët rilindës për hapjen e shkollave shqipe. • Analizon rolin dhe kontributin e kolonive shqiptare në vende të ndryshme për kauzën e gjuhës dhe të arsimit shqip.		Fjalët kyçe: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lëvizja e Turqve të Rinj, Kongresi i Manastirit, Kongresi i Elbasanit, Shkolla Normale e Elbasanit, shoqëria e “Stambollit”, shoqëria “Drita”, shtypshkronja “Mbrothësia”.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; Lidhja e Prizrenit, K. Frashëri.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforsimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja e fillon orën e mësimit me poemën “Korça” të Naim Frashërit. Mund të shihet dhe mundësia e recitimit të vargjeve nga ndonjëri prej nxënësve të talentuar të klasës. Kjo do ta bënte më interesante fillimin e orës mësimore. Pas dëgjësës, klasa bashkëbisedon mbi madhështinë e vargjeve dhe mesazhit të përcjellë.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari trepjesësh

Pasi mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi, fillon ndërtimin e skemës së ditarit trepjesësh. Nxënësit informohen mbi teknikën që do të përdoret dhe që të realizohet me sukses, lexohet paraprakisht teksti në faqet 169-171.

Çështja	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Krijimi i një alfabeti	Në vitin 1844, Naum Veqilharxhi botoi abetaren e parë në gjuhën shqipe. Alfabeti i krijuar nga Kostandin Kristoforidhi në vitin 1867 gjeti shumë përdorim. Alfabeti që do të zinte një rëndësi të madhe ndër shqiptarët ishte alfabeti i Stambollit, i vendosur më 1879 nga një grup rilindësish me në krye Sami Frashërin.	Ishte e domosdoshme, në ato rrethana (rreziku i copëtimit të trojeve) të punohej për unifikimin e gjuhës shqipe përmes një alfabeti të gjithëpranuar. Mënyra përfundimtare e pushtimit mund të arrihej vetëm përmes zhdukjes së identitetit kombëtar. Nëse shqiptari nuk fliste shqip, atëherë as Shqipëria nuk do të ekzistonte.
Kongresi i Manastirit		
Kongresi i Elbasanit		
Shoqëritë patriotike në diasporë dhe roli i tyre në zhvillimin e arsimit		

Faza e tretë: Përfundimi – diskutim

Në këtë fazë, nxënësit orientohen drejt diskutimit të lirë në lidhje me:

- Rëndësia e Kongresit të Manastirit dhe Elbasanit në zhvillimin e arsimit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Përpjekjet e banorëve të vendbanimit tuaj për afirmimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Perandoria Osmane, Austro-Hungareze dhe Ruse në fillim të shek. XX		Situata e të nxënit: “Në çdo 10 nëntor ora e Turqisë ndal disa sekonda në nderim të Ataturkut, që vdiq në vitin 1938.” Diskutoni përmes kësaj thënie rëndësinë e Ataturkut në krijimin e shtetit turk.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton arsyet pse Ballkani ishte vend i përplasjeve mes interesave të Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane. - Argumenton synimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike për rregullimin gjeopolitik të Ballkanit pasosman. - Shpjegon kuptimin e gjendjes ekzistuese dhe karakterin e përkohshëm të saj.		Fjalët kyçe: Perandoria Osmane, Traktati i Paqes i Lozanës, Turqit e Rinj (xhonturqit), politikë integruuese dhe centralizuese, Perandoria Austro-Hungareze, Perandoria Ruse.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming Gjatë kësaj faze zhvillohet teknika brainstorming lidhur me Perandoritë e Mëdha që kishin interesat e tyre në Ballkan.			
Perandoritë e Mëdha dhe Ballkani			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik Mësuesi/sja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe më pas e strukturon informacionin në një organizues grafik, me qëllim përcjelljen më të qartë për nxënësit.			

Perandoria Austro-Hungareze në fillim të shek. XX, synimet në Ballkan:

- Pas Kongresit të Berlinit, fuqia e saj në Ballkan rritet.
- Në vitin 1878, trupat austro-hungareze zgjeruan territoret kroate, dalmate dhe sllovene me territore të reja. Vendosja e tyre u shoqërua edhe me investime.
- Politika austriake në Ballkan synonte të rriste ndikimin katolik dhe të ulte atë sllav, ndaj nisi kolonizimi i territoreve.
- Në vitin 1908, Austro-Hungaria shpalli aneksimin e Bosnje-Hercegovinës dhe njohu pavarësinë e Bullgarisë.

Perandoria Osmane në fillim të shek. XX:

- Humbi shumë zotërime në Ballkan.
- Në fund të shek. XIX, hyri në një krizë të brendshme.
- Filloi një krizë e brendshme, e cila i ndau kundërshtarët në dy kampe: ata që kërkonin reforma dhe modernizim dhe në ata që reformat i quanin të dëmshme.
- Kriza ekonomike i përgjysmoi të ardhurat.
- Në vitin 1876, sultan Abdyl Hamiti shpalli Kushtetutën e parë osmane.
- Në vitin 1908, filloi Revolucioni Xhonturk dhe u shpallën zgjedhjet parlamentare, ku fituan xhonturqit.
- Perandoria Osmane u shpall Monarki kushtetuese, por jo për shumë kohë, pasi xhonturqit forcuan pushtetin e tyre.

Perandoria Ruse në fillim të shek. XX dhe synimet e saj në Ballkan:

- Gjatë fillimit të shek. XX, Rusia u përfshi në disa konflikte, si: Lufta Ruso-Japoneze e vitit 1905, nga e cila doli e humbur.
- Problemet e brendshme ishin të shumta dhe çuan në Revolucionin e vitit 1905.
- Vazhdoi me intensitet përpjekjet për dominim në Ballkan në rivalitet me Perandorinë Austro-Hungareze.
- Ajo intensifikoi marrëdhëniet me Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë dhe Greqinë.



Faza e tretë: Përforsimi – konsolidimi i njohurive

Gjatë kësaj faze nxirren konkluzionet dhe konsolidohen njohuritë.

Situata quhet e realizuar nëse nxënësit janë në gjendje t'u përgjigjen këtyre pyetjeve:

1. Pse Ballkani ishte vend i përplasjeve mes interesave të Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane?
2. Cilat ishin synimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike për rregullimin gjeopolitik të Ballkanit pasosman?
3. Pse gjendja ekzistuese në Ballkan kishte karakter të përkohshëm?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Vëzhgoni hartën në tekst dhe interpretoni. Cila është lidhja e saj me politikat e Perandorisë Osmane, Perandorisë Austro-Hungareze dhe Perandorisë Ruse në fillim të shek. XX? Formuloni përfundimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Luftërat Ballkanike dhe Pavarësia e Shqipërisë		Situata e të nxënit: "Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/1912 Pas fjalëvet që tha z. Kryetar <u>Ismail Kemal beu</u> , me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria më sot të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme". Reflektoni për rëndësinë e këtij dokumenti.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon raportet dhe ekuilibrat mes shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane në fillim të shek. XX. • Përshkruan shkaqet dhe zhvillimin e Luftës I Ballkanike dhe ndikimin e saj në ngjarjet që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. • Shpjegon arsyet e shpërthimit të Luftës II Ballkanike, pasojat e saj për shtetin e ri të pavarur shqiptar.		Fjalët kyçe: aleancë serbo-bullgare-malazeze, Lufta e Parë Ballkanike, Lufta e Dytë Ballkanike, Pavarësia e Shqipërisë.	
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – Parashikimi me terma paraprake Në këtë fazë, nxënësit punojnë për të ndërtuar një tekst të shkurtër historik, duke përdorur disa koncepte kyçe. “Fuqi të Mëdha, Luftëra Ballkanike, Lëvizje Kombëtare, Porta e Lartë, Mbledhja e Taksimit, Ismail Qemali, Aleatë, Kuvendi i Vlorës, Deklarata e Pavarësisë.” Secili nxënës shkruan tekstin e tij në mënyrë të pavarur. Lexohen disa prej teksteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë në grupe – lexim i orientuar

Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimit dhe ndan detyrat sipas grupeve:

Grupi i parë – Raportet mes shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane në fillim të shek. XX.

Grupi i dytë – Lufta e Parë Ballkanike dhe pasojat e saj për shqiptarët.

Grupi i tretë – Lufta e Dytë Ballkanike dhe pasojat për krijimin e shtetit shqiptar.

Grupi i katërt – Kalimi nga platforma e autonomisë tek ajo e Pavarësisë.

Grupi i pestë – Shpallja e Pavarësisë – krijimi i shtetit shqiptar.

Grupi i gjashtë – Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës për çështjen shqiptare.

Secili prej grupeve zhvillon punën në mënyrë të pavarur dhe me seriozitet. Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e secilit prej grupeve dhe mban shënime, të cilat lidhen me kontributin individual të nxënësve.

Edhe pse grupet kanë tematika të ndryshme pune, janë të detyruar që të lexojnë të gjithë informacionin në tekst për të kuptuar më drejt punimet e grupeve të tjera.

Faza e tretë: Përfundimi – prezantimi i arritjeve

Grupet prezantojnë punimet e tyre, në këtë fazë, sipas radhës kronologjike të ngjarjeve. Më tepër kohë i lihet grupit të pestë dhe të gjashtë, për shkak të rëndësisë që ka tema që ata kanë trajtuar. Gjatë prezantimit grupet e tjera mbajnë shënime, bëjnë vlerësime duke shprehur mendimin e tyre përmes diskutimit në fund të secilit prezantim.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Pasojat e Luftërave Ballkanike në vendbanimin tuaj dhe shpalljen e Pavarësisë së tij.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Lufta e Parë Botërore dhe Paqja e Versajës		Situata e të nxënit: Vrasja e Franz Ferdinand dhe gruas së tij Sophie, Dukeshë e Hohenberg, ndodhi më 28 qershor 1914, në Sarajevë, kur ata u plagosën nga Gavrilo Princip. Vrasja solli drejtpërdrejt Luftën e Parë Botërore, kur Austria-Hungaria më pas lëshoi një ultimatum për Mbretërinë e Serbisë, i cili u refuzua pjesërisht. A mund të parandalohet LIB?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton parimet themelore të pranuar nga Konferenca e Versajës për ravigjëzimin e hartës së re politike. - Analizon rrjedhojat që sollën shpërbërjet e Perandorive të Mëdha (Habsburgase, Osmane dhe Ruse). - Evidenton karakterin e Marrëveshjes së Paqes me Gjermaninë dhe pasojat e tij për zhvillimet e mëtejshme europiane. - Pasqyron hartën e re politike të Europës pas Paqes së Versajës.		Fjalët kyçe: Antanta, Aleanca Trepalëshe, Organizata Nacionaliste Serbo-Boshnjake, Revolucion Popullor, Lidhja e Kombeve.	
Burimet: Historia botërore dhe qytetërimi, K. Grimberg; Interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Gjatë kësaj faze, nxiten nxënësit përmes situatës së të nxënit që të zhvillojnë bashkëbisedimin lidhur me Luftën e Parë Botërore. Gjatë bashkëbisedimit drejtohen pyetje frontale, për ta nxitur pjesëmarrjen e nxënësve; 1. Si nisi LIB? 2. Pse Europa u përfshi menjëherë në këtë luftë? 3. Si u gjend Shqipëria gjatë LIB?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabela e koncepteve – lexim i pavarur

Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimit. Gjatë shpjegimit të temës së re plotësohet tabela e koncepteve e ndarë në dy pjesë: Lufta e Parë Botërore dhe Konferenca e Paqes në Versajë.

Shkaqet e LIB	Preteksti	Aleancat ushtarake	Frontet kryesore	Pasojat e Luftës për vendet e përfshira
– Rivaliteti i shteteve europiane për sundim territorial. – Krijimi i aleancave ushtarake. – Lufta për liri e pavarësi e popujve nën sundimin e Perandorive të Mëdha. – Rivaliteti ekonomik mes vendeve europiane.	– Vrasja e princit Ferdinand, trashëgimtar i perandorit austriak. - Ai u vra nga një nacionalist serb në Sarajevë, më 28 qershor 1914. – Austria i dërgoi ultimatum Serbisë.	Antanta (Francë, Angli, Rusi + Serbi, SHBA, Japoni, Itali). Aleanca Trepalëshe (Gjermani, Austro-Hungari + Bullgari, Perandoria Osmane).	– Fronti Perëndimor. – Fronti Lindor. – Fronti i Afrikës Veriore. – Fronti i Lindjes së Largët. – Fronti i Ballkanit.	- Europa u dobësua dhe u varfërua. Filloi rënia edhe në aspektin kulturor. - SHBA u pasuruan, shtuan prodhimin dhe u bënë fuqia më e madhe ekonomike dhe politike e botës. - Japonia forcoi lidhjet tregtare me vendet aziatike, në dëm të vendeve europiane.

Traktati i Versajës	Marrëveshja e Paqes me Gjermaninë	Harta e re e Europës
– U firmos më 28 qershor 1919 nga Këshilli i të Katërve, me përjashtim të SHBA-ve.	– U nënshkrua në vitin 1921, me dëme të mëdha në kurriz të Gjermanisë.	– U shpërbënë 3 perandoritë e mëdha.

Faza e tretë: Përforsimi – punë me tekstin

Pasi kanë kryer leximin e pavarur dhe ndjekur me kujdes shpjegimin, nxënësit do të fokusohen në këtë fazë në rubrikën e vetëvlerësimit në tekst. Në fletoret e tyre, do të punohet ushtrimi 3.

Vëreni fotot dhe interpretoni:

a. “Shkatërrimi i qytetit Ypres, gjatë Luftës së Parë Botërore”.

b. “Puna e grave në fabrika të prodhimit të armëve gjatë luftës”.

1. Çfarë mesazhi përcjellin ato për ju?

2. Diskutoni në klasë qëndrimet tuaja.

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, realizimin e detyrave që u kërkohen, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Në Tiranë gjendet një shesh me emrin *sheshi “Willson”* dhe një monument në mes të sheshit. Gjithashtu, gjendet shkolla me emrin e presidentit amerikan *Uidro Uillson* etj., etj. Pse shqiptarët e nderojnë atë? Nxirrni përfundime dhe diskutoni ato në klasë.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rinjohja e shtetit të pavarur shqiptar dhe përcaktimi i kufijve të tij		Situata e të nxënit: Presidenti U. Uillson ka qenë një mik i përhershëm i shqiptarëve. Ka mbetur prej tij shprehja e jashtëzakonshme “një votë kam edhe atë do t’ia jap Shqipërisë”. Diskutoni mbi rëndësinë që kishte Shqipëria asokohe, një shtet i vogël, për një Fuqi të Madhe si SHBA.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan ecurinë e procesit të njohjes së shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në Konferencën e Paqes dhe atë të Ambasadorëve në Paris. • Arsyeton mbi rëndësinë e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe ndikimin që ajo pati në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris. • Shpjegon procesin e përcaktimit të kufijve të shtetit shqiptar nga viti 1913 deri në vitin 1926.		Fjalët kyçe: Konferenca e Londrës, Fuqitë e Mëdha, Principatë Autonome, Sovrane dhe Trashëgimtare, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK), Traktati i Fshehtë i Londrës, Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve.	
Burimet: interneti; teksti mësimor; Historia e Popullit Shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Detyra e shtëpisë e një ore më parë, bën një lidhje natyrore me mësimin e ri të kësaj ore. Nxënësit kanë hulumtuar për figurën e Udro Uillsonit dhe lidhjen e tij me Shqipërinë, ndaj diskutohet rreth pyetjes: - Si e ka ndihmuar Udro Uillson popullin shqiptar?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – harta e konceptit Në këtë fazë, punohet materiali i temës së re. Për ta përcjellë sa më qartë informacionin zgjidhet si teknikë harta e konceptit.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËn E DYTË (JANAR-MARS)



Faza e tretë: Përforcimi – pyetja binare

Në këtë fazë, mësuesi/ja e shtyn klasën drejt një diskutimi të lirë lidhur me pyetjen binare. Përmes vendimeve të saj KAL, ndikoi pozitivisht apo negativisht për trojet shqiptare?



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Ecurinë e procesit të njohjes së shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në Konferencën e Paqes dhe atë të Ambasadorëve në Paris.
- Rëndësinë e pranimin të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe ndikimin që ajo pati në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Paris.
- Procesin e përcaktimit të kufijve të shtetit shqiptar nga viti 1913 deri në vitin 1926.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Aspekte të organizimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar(1920-1939)		Situata e të nxënit: Vitet 1920-1939 përbëjnë një periudhë intensive në përpjekjet për ndërtimin e shtetit shqiptar. Cilën ngjarje veçoni nga ajo kohë? Përse?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton organizimin e shtetit shqiptar në vitet 1912-1914. - Ballafaqon statutet e viteve 1920-1939 dhe shpjegon ecurinë e ndryshimeve në to. - Dallon elemente të ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit kombëtar në Shqipërinë e viteve 1920-1939.		Fjalët kyçe: Qeveri e përkohshme, Pleqësi, formë e qeverisjes monarkike, Kuvend Kombëtar, “Kanuni për administratën civile të Shqipërisë”, organizimi administrativ, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK), Statuti Organik, Principatë Kushtetuese Sovrane dhe Trashëgimore, Kongresi i Durrësit, sistemi monarkik parlamentar, Kongresi i Lushnjës, Partia Popullore, Partia Përparimtare, “Atdheu” (Bashkimi), Republikë Parlamentare, Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë, Republikë Presidenciale, mbret i shqiptarëve, Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare.	
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Hapet mësimi me situatën e të nxënit. Nxënësit veçojnë ngjarje të historisë shqiptare të viteve ‘20-’39. Mendimet e dhëna shkruhen sipas një skeme në tabelë. Veçohen, përmes bashkëbisedimit, ngjarjet që kanë patur një impakt më të madh në fatin e popullit shqiptar.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe më pas u kërkon nxënësve të hapin tekstet në faqet 188-191. Sipas një modeli që hartohet në tabelë, nxënësit do të punojnë ditarin dypjesësh, teksa lexojnë në mënyrë të orientuar temën e re të mësimi.			

Ngjarja	Komenti
Ismail Qemali zgjidhet kryetar i Qeverisë së Përkohshme	
Konferenca e Ambasadorëve zgjodhi si princ të Shqipërisë, Vilhelm Vidin	
Vilhelm Vidi largohet nga Shqipëria	

Më 25 dhjetor 1918, fillon punimet Kongresi i Durrësit	
Më 21 janar hap punimet Kongresi i Lushnjës.	
Fan Noli krijon dhe drejton Partinë Popullore, ndërsa Hoxhë Kadri Prishtina krijon dhe kryeson Partinë Përparimtare	
Nga qershori deri në dhjetor 1924 qeveris Fan Noli.	
1925-1928, Ahmet Zogu drejton Republikën Presidenciale të Shqipërisë	
Në shtator 1928, Ahmet Zogu shpallet mbret i shqiptarëve	

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Në këtë fazë, zhvillohet një diskutim i lirë lidhur me kontributin që kanë dhënë në shtetin shqiptar, figurat e mëposhtme historike:

- Ismail Qemali
- Vilhelm Vidi
- Esat Pashë Toptani
- Sulejman Delvina
- Fan Noli
- Ahmet Zogu

Diskutimi mbyllet me përgjigjen e pyetjes: Cili prej tyre ndikoi më tepër pozitivisht në ndërtimin e shtetit shqiptar? Po më negativisht?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

a. Organizimin e shtetit shqiptar në vitet 1912-1914.

b. Statutet e viteve 1920-1939.

c. Ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit kombëtar në Shqipërinë e viteve 1920-1939.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të europianizimit të saj (1920-1939)		Situata e të nxënësve: Lordi Donogal i Britanisë bëri një udhëtim nëpër Shqipëri në vitin 1938. Në shkrimin e tij në gazetën “Sunday Dispatch” ai shprehu habinë e madhe që kushtet e jetesës ishin shumë më të mira se ajo që ishin raportuar më parë. Rrugët ishin më të gjera se të Jugosllavisë. Qytetarët ishin të veshur mirë dhe të sjellshëm. Në Tiranë kishte hotele të klasit të parë, ushqim të mirë, dyqane me parfume, filma për aparatet e tij fotografik Laika dhe orëndreqës të mirë. Ai u shpreh pozitivisht për aeroportin e Tiranës, për gratë e çliruara nga perçja, për qytetin-port të Durrësit dhe së fundmi për sjelljen dashamirëse të njerëzve.	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi: • Tregon elementet e qytetërimit Perëndimor në hartimin e legjislacionit shqiptar (kode), në ndërtimet publike dhe në jetën e përditshme. • Evidenton përpjekjet për emancipimin e gruas dhe të shoqërisë shqiptare. • Gjykon mbi procesin e emancipimit të shoqërisë shqiptare. • Gjykon mbi arritjet në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare. • Evidenton ndarjen e shtetit nga feja si një nga parimet bazë të shtetit modern. • Analizon masat dhe përpjekjet e shtetit shqiptar për të reformuar jetën e komuniteteve fetare në Shqipëri.		Fjalët kyçe: prefekturë, prefekt, nënprefekturë, komunë, bashki, Gjykata e Diktimit, ndërmarrje industriale, shoqëri aksionare, Itali, Banka Kombëtare Shqiptare, Shoqëria për Zhvillimin e Shqipërisë, Reformë Agrare, liceu femëror në Tiranë, Shkolla Teknike Amerikane, Shkolla Normale e Elbasanit, “Shoqëria e Arteve të Bukura”, shoqëria “Rozafa”, shoqëria “Përparimi”, Familja Marubi, Biblioteka Kombëtare.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Historia e popullit shqiptar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënësit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)

Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim

Në monitor shfaqen imazhe filmike të Tiranës apo dhe zonave të tjera të Shqipërisë së viteve '20-'30. Përmes imazheve, nxënësit mbajnë shënim të dhëna që u bien në sy, në lidhje me arkitekturën, veshjen e banorëve, mënyrat e transportit, aktivitetet ditore, vendet e argëtimit (bare, restorante, teatro etj.) Në përfundim të pamjeve, bashkëbisedohet në klasë lidhur me informacionin që njohën përmes imazheve.

Në mungesë të monitorit, mund të shfrytëzohen materialet në tekst ose foto të tjera të sjella në klasë nga mësuesi/ja.

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – teknika e hartimit të pyetjeve

Gjatë kësaj faze, aplikohet mësimi zbulues, përmes pyetjeve kyç, nxënësi zbulon dhe përvetëson informacionin e ri, sipas rëndësisë që ai paraqet.

Mësuesi/ja përcakton disa pyetje themelore dhe ua jep nxënësve në fleta të fotokopjuara ose i shkruan ato në tabelë. Udhëzohen nxënësit që këtë veprimtari ta realizojnë individualisht e në mënyrë të pavarur. Ata duhet të kërkojnë në tekst përgjigje për këto pyetje:

1. Në cilat aspekte dëshmohen elemente të qytetërimit Perëndimor në hartimin e legjislacionit shqiptar (kode), në ndërtimet publike dhe në jetën e përditshme?
2. Cilat ishin përpjekjet për emancipimin e gruas dhe të shoqërisë shqiptare?
3. Cilat janë arritjet në fushën e arsimit dhe të kulturës shqiptare?
4. Pse u nda shteti nga feja? Çfarë karakteri i jep kjo shtetit?
5. Në ç'mënyrë u përpoq shteti shqiptar për të reformuar jetën e komuniteteve fetare në Shqipëri?

Mësuesi/ja e ndjek nga afër punën e nxënësve, duke sqaruar ndonjë paqartësi të mundshme. Është e rëndësishme të mbahen edhe shënime për një vlerësim sa më objektiv në fund të orës mësimore.

Faza e tretë: Përforsimi – nxjerrja e konkluzioneve

Pasi kanë zbuluar përgjigjet, mësuesi i pyet nxënësit rreth tyre. Idetë kryesore që formulohen gjatë secilës përgjigje listohen në tabelë në formën e konkluzioneve.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve dhe përfshirjen në diskutim e interpretim.

Detyra:


Cili është refleksioni juaj mbi:

Përpjekjet për emancipimin e gruas dhe të shoqërisë shqiptare.

Ndarjen e shtetit nga feja si një nga parimet bazë të shtetit modern.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Interesimi i shtetit amë për shqiptarët jashtë kufijve		Situata e të nxënit: Në Lidhjen e Kombeve në 17 dhjetor 1920 të huajt dëgjuan një oratori burri, fjala e të cilit ra si bombë, sikurse thotë haptas “Daily Telegraph-i”. Dhe përfaqësuesi i 400 milionë kinezëve që dëgjonte me vëmendje Nolin e një milion shqiptarëve duke mos ditur se ç’popullsi ishim ne, e pyeti Nolin: – A s’më thoni hirësi, ç’popullsi përfaqësoni? Noli i përgjigjet: – Një milion, por mos harroni se janë një milion shqiptarë. Vlerësoni figurën e Nolit.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: ☐ Analizon përpjekjet e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene/Jugosllavi dhe në Greqi. ☐ Evidenton përpjekjet e shtetit shqiptar për të penguar shkëmbimin e popullsisë shqiptare nga Greqia dhe Jugosllavia drejt Turqisë. ☐ Evidenton përpjekjet e shtetit amë për mbështetjen e diasporës shqiptare.		Fjalët kyçe: Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, shpopullim, kolonë serbë, çështja e popullsisë shqiptare në Greqi, Lidhja e Kombeve, Këshilli i Lidhjes së Kombeve.	
Burimet: Historia e Popullit Shqiptar; Shqiptarët, E. Jacques; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Lexohet situata e të nxënit dhe më tej diskutohet figura e Fan Nolit, si personi që i ka mbrojtur shumë shqiptarët dhe të drejtat e tyre në organizma ndërkombëtarë. Nëse koha premton, mësuesi/ja mund të nxisë nxënësit që të ofrojnë mendime në lidhje me temën: “Shqipëria është rast unik në botë, që në kufijtë e saj ka popull shqiptar.”			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik i informacionit Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e re të mësimi dhe i udhëzon nxënësit që të lexojnë në heshtje tekstin për 3-5 minuta. Gjatë kësaj kohe, ai/ajo organizon në tabelë, në mënyrë grafike, njohuritë e reja. Është e këshillueshme që nxënësit të mbajnë shënime dhe të përfshihen aktivisht në plotësimin e organizuesit grafik.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)



Faza e tretë: Përforsimi – tabelë konceptuale

Pasi janë njohur me informacionin, mësuesi/ja u shpërndan nxënësve formate të gatshëm të tabelës konceptuale për të plotësuar.

Tabela plotësohet individualisht nga çdo nxënës dhe më pas përdoret për t'u vendosur në portofolin e të nxënit.

Mësuesi/ja mund të përdorë këtë model ose ta hartojë atë sipas nevojave të klasës.

Shqiptarët në:	Politika e ndjekur ndaj tyre	Kërkesat e qeverisë shqiptare në mbrojtje të tyre	Marrëveshje ndërkombëtare në dëm të shqiptarëve	Vendime ndërkombëtare në favor të shqiptarëve
Jugosllavi				
Greqi				
Diasporë				


Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion: Roli i Fan Nolit dhe Faik Konicës në mbrojtje të çështjes shqiptare.

Planifikimi ditor i orës së mësimi		Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI
Tema mësimore: Krijimi i Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene/Jugosllavisë si shtet shumetnik		Klasa: XII
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton momentet kryesore në krijimin e shtetit jugosllav si shtet shumetnik. - Shpjegon konfliktet e brendshme mes etnive të shtetit jugosllav. - Dallon tipare të jetës ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi. - Gjykon mbi pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi.		Situata e të nxënit: Kujtohet roli i familjes së Karagjorgjeviçëve dhe Rosisë në krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene.
		Fjalët kyçe: Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene, Partia Radikale, ustash (nacionalist) kroat, Mbretëria Jugosllave, Lufta e Dytë Botërore, Lufta Serbo-Kroate, konvertimi fetar i shqiptarëve, politika e shpërnguljes, Idriz Seferi, Azem Galica, Shote Galica, Lidhja e Kombeve.
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Në këtë fazë nxiten nxënësit që të rikujtojnë njohuritë në lidhje me Karagjeogjeviçët dhe rolin e tyre në krijimin e MSKS-së. Shkruhen në tabelë paralelisht dy koncepte dhe nxënësit shkruajnë përbri mendimet e tyre. Është i pranueshëm ai mendim i cili përputhet me anën shkencore dhe historike të termave.		



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabelë kronologjike – ditar dypjesësh

Në këtë fazë, nxënësit, pasi kanë rikujtuar njohuritë për dy konceptet kyçe, familjarizohen me temën e re, përmes dy teknikave: tabelës kronologjike dhe ditarit dypjesësh.

Mësimi fillon me organizimin kronologjik të ngjarjeve që shoqëruan procesin e krijimit të Jugosllavisë.

Viti	Ngjarja
1915	Kroatët të trembur nga vendimet e TFL, propozuan krijimin e një shteti jugosllav. Partizanët e kësaj ideje, Ante Trumbić dhe Frano Supilo, formuan në Romë një “Komitet Jugosllav”.
1917	Pasi përfunduan bisedimet midis princit serb Aleksandër dhe Ante Trumbić, u arrit marrëveshja për të krijuar pas fitores së luftës një “mbretëri të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve”.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhën E DYTË (JANAR-MARS)

1918	Pas luftës, u krijua një qeveri e përkohshme e delegacionit serbo-kroato-sllloven. Marrëveshjes iu bashkuan asamblatë krahinore të Bosnje-Hercegovinës dhe Vojvodinës.
1 dhjetor 1918	Princi trashëgimtar serb Aleksandri I shpalli “Bashkimin e Mbretërisë së Serbisë dhe të vendeve të shtetit të pavarur të serbëve, kroatëve dhe slllovenëve në një Mbretëri të Bashkuar të Serbëve, Kroatëve dhe Slllovenëve”.
1920	U organizuan zgjedhjet e para parlamentare të shtetit të ri jugosllav. Zgjedhjet nxorën fituese Partinë Radikale Serbe, e udhëhequr nga Pashiç, si dhe forca të tjera politike të rëndësishme Partinë Demokratike, Partinë Fshatare Kroate dhe Partinë Komuniste.
1921	Pasi hoqi qafe komunistët jugosllavë, Aleksandri e bindi parlamentin të votonte në 1921 Kushtetutën sipas interesit të tij, pavarësisht kundërshtimeve të deputetëve kroatë që e bojkotuan votimin e saj. Sipas Kushtetutës, mbreti emëronte kryeministrin dhe ishte komandant i Përgjithshëm i ushtrisë jugosllave.
1928	Paqëndrueshmëria politike e Jugosllavisë u trondit në 1928, nga vrasja e tre deputetëve kroatë nga një radikal malazez, duke rrezikuar ndarjen në dy pjesë të Mbretërisë Jugosllave.
1929	Aleksandri I shpërndau parlamentin dhe shfuqizoi Kushtetutën në 1929, duke kaluar nga mbretëria konstitucionale në monarki. MSKS-ja u bë Jugosllavi.
1931	U shpall një kushtetutë të re, e cila u kundërshtua nga kroatët. Ata kërkuan autonomi për rajonet e banuara prej tyre.
1934	U vra Aleksandri I, nga një nacionalist kroat në Marsejë. Froni i kaloi princit Pjetër II, i cili, duke qenë minoren, pati si regjent princin Pavël.

Pas plotësimit të tabelës, kalohet në realizimin e ditarit dypjesësh. Kjo detyrë i takon nxënësit, i cili, pasi lexon me kujdes pjesët mësimore në faqet 200-201, punon për komentet për çështjet e caktuara.

Çështja	Komenti
Zhvillimi ekonomik në Mbretërinë Jugosllave	
Jeta sociale në Mbretërinë Jugosllave	
Gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi	

Faza e tretë: Përforcimi – diskutim

Në mbyllje të mësimit, mësuesi/ja i orienton nxënësit në dhënien e mendimit vetjak lidhur me pyetjen:

Pse shteti Jugosllav nuk i rezistoi kohës?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Momentet kryesore në krijimin e shtetit jugosllav si shtet shumetnik.
- b. Konfliktet e brendshme mes etnive të shtetit jugosllav.
- c. Tiparet e jetës ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi.
- d. Pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhojat e saj në Ballkan		Situata e të nxënit: Dërgesat e emigrantëve, sidomos e atyre nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përbënin një zë të konsiderueshëm në ekonominë shqiptare. Para krizës ekonomike, emigrantët dërgonin mesatarisht 10 milionë franga ari në vit. Gjatë krizës, ata dërgonin më pak se 4 milionë franga, çka dobësoi më shumë fuqinë blerëse dhe paguese të detyrimeve fiskale nga ana e familjeve shqiptare. Lidhni ngjarjet ndërkombëtare me ato kombëtare.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: ☐ Vë në dukje momentet kyç të krizës ekonomike botërore. ☐ Analizon ndikimet që pati kriza ekonomike botërore në ekonominë dhe në politikën shqiptare dhe ballkanike.		Fjalët kyçe: Bursa e Nju Jorkut, politika proteksioniste, kriza e likuiditetit ndërkombëtar, New Deal, Lufta e Dytë Botërore, krizë financiare, fajdexhinj, Reforma Agrare.	
Burimet: Teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming Gjatë kësaj faze, pasi lexohet situata e të nxënit, realizohet teknika “brainstorming”, në lidhje me Depresionin e Madh. Mendimet që sjellin nxënësit, renditen në tabelë. Pasi kanë përfunduar mendimet, mësuesi/ja së bashku me nxënësit bën lidhjet me situatën e të nxënit.			



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - tabelë konceptesh - lexim i orientuar

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë tekstin për gati 3-4 minuta. Gjatë leximit nxënësit orientohen të përqendrohen në disa çështje kryesore, të cilat do të jenë të dobishme për të plotësuar tabelën e koncepteve.

Pasi nxënësit kanë lexuar tekstin, atyre u shpërndahen fleta me modelin e gatshëm të tabelës së koncepteve, ose realizohet në dërrasë dhe nxënësit e kopjojnë në fletore. Pas kësaj ata punojnë individualisht ose në dyshe për ta plotësuar me informacionin përkatës.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)

Shteti	Shkaqet e krizës	Tiparet e krizës	Pasojat e krizës	Politikat për kapërcimin e saj
SHBA	1. Superprodhimi 2. Kriza e bursës së Nju Jorkut. 3. Paqëndrueshmëria financiare. Dhënia e kredive në mënyrë të	- U shfaq në vitet 1929-1933. - Preku të gjitha shtresat e popullsisë. - U përhap në industri, tregti dhe bujqësi.	1. U rrënuan shumë familje. 2. U shtua ndjeshëm papunësia. 3. Falimentuan mijëra banka dhe	- U aplikua New Deal me ardhjen e presidentit Ruzvelt.
Francë	pakontrolluar para fillimit të krizës. 4. Rritja e masave proteksioniste.	- U shfaq në vitin 1930. - U ulën pagat dhe çmimet.	dhjetëra mijëra ndërmarrje. 4. U vu në pikëpyetje sistemi ekonomik dhe politikat e ndjekura nga fuqi botërore.	- U aplikua Kursi i Ri i Leon Blumit.
Britani e Madhe	5. Rritja e çmimeve të transportit. 6. Kërkesa dhe oferta nuk ecën paralelisht me njëra-tjetrën.	- U shfaq njëkohësisht me krizën në SHBA. - Filloi aplikimi i politikave proteksioniste.	5. Ra fuqia blerëse.	- U ndoq bashkëpunimi politik për gjetjen e politikave që do ta nxirrnin vendin nga kriza.
Brazil		- U ndikua nga rënia e fuqisë blerëse në Europë dhe Amerikën Veriore.		- Superprodhimi u dogj në lokomotivat e trenave.
Shqipëri		- Zgjati në vitet 1929-1935. - U shoqërua me krizë financiare dhe frenim të kredive bankare.		- Shkurtimeve të shpenzimeve për oborin mbretëror, administratën dhe ushtrinë. - Ulja e taksave doganore për importimin e lëndëve të para me qëllim nxitjen e investimeve vendëse. - U aprovua ligji për Reformën Agrare. - Marrëveshje për hua pa kamatë me Italinë.

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim – lidhja me të sotmen.

Në këtë fazë kalohet në diskutim të lirë. U drejtohet nxënësve pyetja:

- Si mund ta përdorim të shkuarën në shërbim të së tashmes?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

a. Si i ruajti pozitat ekonomike gjatë krizës Britania?

b. Në ç'mënyrë Mbretëria Shqiptare ruajti pozitat ekonomike gjatë krizës?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Fuqitë e Mëdha dhe bashkëpunimi ballkanik - Konferencat e viteve '30		Situata e të nxënit: Kujtoni interesin e shprehur nga shtetet perëndimore (Itali, Francë, Angli) mbi shtetin shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Cila prej tyre përbënte një rrezik serioz për vendin tonë asokohe?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Dallon ndikimin që patën Fuqitë e Mëdha në Ballkan në periudhën midis dy luftërave botërore. • Analizon paktin Kellog-Briand, duke evidentuar ndikimin që ai pati në bashkëpunimin ballkanik. • Përshkruan disa nga vendimet e Konferencave Ballkanike të viteve '30. • Evidenton qëndrimin që mbajti shteti shqiptar ndaj këtyre vendimeve.		Fjalët kyçe: Lufta e Parë Botërore, Antanta e Vogël, Lidhja e Kombeve, ustashë kroatë, Pakti Kellog- Briand, Bashkimi Paneuropian, Konferenca e Parë Ballkanike, Konferenca e Dytë Ballkanike, Konferenca e Tretë Ballkanike, Konferenca e Katërt Ballkanike, Antanta Ballkanike, Bankë Ballkanike.	
Burimet: Interneti; Teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Në këtë fazë mësuesi/ja shkruan në tabelë emrat e tre shteteve perëndimore me interesa në Ballkan pas LIB: Itali, Angli, Francë. Më pas hidhet pyetja për bashkëbisedim: - Cili prej këtyre shteteve përbënte rrezik për shtetin e brishtë shqiptar?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – metoda e kombinimit – grupet e ekspertëve Gjatë kësaj faze klasa organizohet në grupe me katër deri në pesë anëtarë. Secili prej anëtarëve në grupe është në rolin e një eksperti. Pasi janë vendosur në grupe, nxënësit rigrupohen sërish sipas ekspertëve. 1-shat bëhen së bashku, 2-shat gjithashtu e kështu me radhë. Secili ekspert ka një detyrë të caktuar.			
Eksperti nr. 1 – Italia, Franca dhe Anglia me ndikimin e tyre në Ballkan. Eksperti nr. 2 – Përmbajtja e Paktit Briand-Kellog. Eksperti nr. 3 – Konferencat Ballkanike. Eksperti nr. 4 – Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj konferencave ballkanike.			
Pasi ekspertët kanë bashkëpunuar mes tyre dhe kanë zgjidhur problemin që u është caktuar, kthehen sërish në grupet fillestare. Aty shpjegojnë njohuritë e fituara, diskutojnë dhe shkëmbejnë mendime. Njohuritë e fituara i përcillen grupet nga secili ekspert. Anëtarët në grupe i kushtojnë vëmendjen e duhur njëri-tjetrit për të realizuar më pas një prezantim të plotë të detyrës së tyre.			

Faza e tretë: Përforsimi – konkluzione – prezantimi i rezultateve

Pasi ekspertët kanë përfunduar këmbimin e informacionit brenda grupeve të tyre, nxirren konkluzionet dhe, përmes formave të përzgjedhura nga vetë nxënësit, bëhet prezantimi i tyre. Gjatë prezantimit mësuesi/ja vazhdon të mbajë shënime, të domosdoshme për të kryer vlerësimin e grupeve dhe të ekspertëve në fund të prezantimit.

Nxënësit gjithashtu vlerësojnë njëri-tjetrin përmes këshillave, kritikave apo miratimit për atë që prezantohet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a.** Ndikimin që patën Fuqitë e Mëdha në Ballkan në periudhën midis dy luftërave botërore.
- b.** Paktin Kellog-Briand, duke evidentuar ndikimin që ai pati në bashkëpunimin ballkanik.
- c.** Vendimet e Konferencave Ballkanike të viteve '30.
- d.** Qëndrimin që mbajti shteti shqiptar ndaj këtyre vendimeve.

(Nxënësi zgjedh të realizojë si detyrë vetëm njërin prej pikave).

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Ideologjitë totalitare dhe Ballkani		Situata e të nxënit: Franca krijoi më 1920 të ashtuquajturën “Antantën e Vogël” - Praga, Beogradi, Bukureshti - e emërtuan me lajkë si “Cordon sanitaire” i Europës Juglindore, do të duhej ta mbronte Europën Juglindore si nga Perandoria Gjermane, ashtu edhe nga Rusia bolshevike. Diskutoni për interesin francez mbi Ballkanin.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan gjendjen politike të Ballkanit në vitet ‘20-‘30. • Shpjegon bazën ideologjike të sistemeve autoritare në Ballkan. • Analizon ndikimin e ideologjisë komuniste në vendet e Ballkanit.		Fjalët kyçe: Parti Komuniste, Revolucioni Socialist i Tetorit 1917, Lufta e Parë Botërore, krizë ekonomike, propagandë populiste, politikë centralizuese, antisemite, Partia Fashiste Italiane, “garda e hekurt”, “Këmishët e gjelbra”, oligarki ushtarako-burokratike, Traktati i Paqes i Versajës, Organizatë Politiko- Terroriste, VMRO, Bashkimi Agrar, “Internacionale e gjelbër”, “Marrëveshja Kombëtare”, Federata Jugosllavo-Bullgare, partia e Venizellosit, gjenerali Metaksa, Organizata Kombëtare e Rinisë, kisha ortodokse greke.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming			
Pasi diskutohet shkurt situata e të nxënit, u kërkohet nxënësve të risjellin në kujtesë njohuritë e tyre në lidhje me ideologjitë totalitare në përgjithësi dhe ato që gjetën hapësira zhvillimi në Ballkan në veçanti, në periudhën mes dy luftërave botërore.			
↑ ←Totalitarizmi→ ↓			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar – INSERT

Në këtë fazë, nxënësve u bëhet e qartë metoda që do të ndiqet për të punuar me materialin e ri mësimor. Duke qenë se janë të familjarizuar me teknikën INSERT, në tabelë shënohen vetëm shenjat, pa qenë e nevojshme shpjegimi i tyre. Secili nxënës fokusohet në leximin e tekstit në faqet 208-210 dhe e organizon informacionin në tabelë.

"√"	"+"	"-"	"?"
Në Ballkan filloi krijimi i partive komuniste që pas ngjarjeve të Revolucionit Socialist të Tetorit 1917 në Rusi.			

Faza e tretë: Përforcimi – kllaster

Me ndihmën e klasës mësuesi/ja realizon në tabelë kllasterin "Shtetet ballkanike mes dy luftërave botërore". Nxitet pjesëmarrja e sa më shumë nxënësve, edhe përmes pyetjeve kyçe.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Gjendjen ekonomike, politike dhe shoqërore të Shqipërisë në periudhën midis dy luftërave botërore.

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Ravijëzimi i blloqeve ndërluftuese dhe momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore		Situata e të nxënit: Gjykoni mbi informacionin: <i>Më 1938, kur kryeministri i Britanisë Neville Chamberlain u kthye nga Mynihu për të shpallur “paqen në kohën tonë,” Winston Churchill denoncoi në mënyrë të famshme vendimin që Britania dhe Franca sapo kishin marrë. “Juve ju dha të zgjidhnit mes luftës dhe turpit,” tha ai. “Ju zgjodhët turpin dhe ju do të keni edhe luftën.”</i>	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Identifikon blloqet kundërshtare të Luftës së Dytë Botërore. • Evidenton procesin e formimit të Boshtit dhe të Aleancës së Kombeve të Bashkuara dhe shpjegon karakteristikat e secilit prej tyre. • Përshkruan momentet më kryesore të Luftës së Dytë Botërore.		Fjalët kyçe: Nacional-Socialiste (fashiste), Paqja e Versajës, Lufta e Dytë Botërore, Boshti Romë-Berlin-Tokio, Traktati i Fshehtë Sovjeto-Gjerman.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Zhvillohet në këtë fazë teknika braingstorming. Pasi lexohet situata e të nxënit, nxiten nxënësit të sjellin ndër mend ngjarjet që i paraprinë dhe u zhvilluan gjatë Luftës së Dytë Botërore.			
↑ ← Lufta e Dytë Botërore → ↓			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabelë konceptesh – prezantim vizual


Lufta e Dytë Botërore është një pjesë e rëndësishme e historisë së shek. XX, për të cilën nuk mjafton vetëm një orë mësimi. Për ta përcjellë informacionin sa më këndshëm, do të ishte me vend zgjedhja e disa strategjive dhe teknikave mësimore. Fillimisht prezantohet një video e shkurtër rreth Luftës së Dytë Botërore, e cila gjendet në Youtube në linkun <https://youtu.be/NWH6uWEXBS0>. Pas kësaj, mësuesi/ja plotëson me ndihmën e nxënësve tabelën konceptuale sipas këtij modeli.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)

Lufta e Dytë Botërore	Shkaqet e fillimit të Luftës së Dytë Botërore	Hitleri dhe Musolini	Bloqet ndërluftuese	Ngjarjet vendimtare
	-Vendimet e padrejta të Konferencës së Paqes në Versajë më 1919. -Vendosja e regjimeve totalitare në Europë pas Luftës së Parë Botërore. -Rritja e nacionalizmit të skajshëm, imperializmit, racizmit dhe militarizimit. -Qëndrimi neutral i shteteve Perëndimore ndaj ngjarjeve në kontinent etj.	-Benito Musolini e mori pushtetin në vitin 1924, si drejtues i Partisë Fashiste. -Partia Fashiste ishte si një repart ushtarak që kontrollonte në detaje jetën e italianëve. -Gjendja e vështirë ekonomike në Gjermani pas Luftës së Parë Botërore i hapi rrugën për pushtet Partisë Nacional-Socialiste të Adolf Hitlerit. -Partia e Hitlerit erdhi në pushtet në vitin 1933 etj.	- Pakti Romë-Berlin -Tokio (27 shtator 1940). -Koalicioni i Madh Antifashist (Britani, Francë, SHBA, BS).	-1 shtator 1939, pushtimi i Polonisë nga Gjermania. -1940, Gjermania pushton Danimarkën, Finlandën, Norvegjinë. -1940, Italianët sulmojnë Greqinë dhe trupat gjermane vazhdojnë pushtimet në Belgjikë, Holandë dhe Francë etj.

Faza e tretë: Përforsimi – diagram veni

Duke u rikthyer për 2-3 minuta lexim në faqet 180-183, nxënësit punojnë për plotësimin e diagramit të venit për dy luftërat botërore.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Vëreni fotot dhe interpretoni. Cila është lidhja e tyre me ravijëzimin e blloqeve ndërluftuese dhe momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore? Çfarë mesazhi përcjellin për ju? Formuloni përfundimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar		Situata e të nxënit: Keni mësuar se gjatë Luftës së Dytë Botërore, një numër jo i pakët shqiptarësh, midis tyre shumë intelektualë, bashkëvepruan me pushtuesit. Pse ndodhi ky bashkëpunim, sidomos në radhët e intelektualëve?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Analizon diferencat mes pushtimit italian dhe atij gjerman në lidhje me organizimin e brendshëm të Shqipërisë. • Analizon qëndrimet e autoriteteve pushtuese ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë e në Çamëri dhe evidenton arsyet e këtyre qëndrimeve. • Shpjegon reagimin e shqiptarëve të Kosovës e të Çamërisë ndaj pushtuesve, duke diferencuar rrymat e ndryshme politike në gjirin e tyre.		Fjalët kyçe: Komiteti Administrativ, Asambleja Kushtetuese, Kurora e Shqipërisë, Ministria e Partisë Fashiste, Këshilli i Shtetit, Statuti i Ri i Mbretërisë Shqiptare, Këshilli i Epërm Fashist Korporativ, fasha e Liktorit, Partia Kombëtare Fashiste Shqiptare, Zyra Qendrore për Ndërtimet dhe Urbanistikën, Hekurudha e parë Durrës-Labinot, Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare, Xhandarmëria Mbretërore, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, bolshevizmi, Këshilli i Lartë i Regjencës.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Në këtë fazë, mësuesi/ja i drejton nxënësit në një bisedë të frytshme, në lidhje me arsyet që mund t’i kenë shtyrë disa shqiptarë të radhiten në krah të pushtuesit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në funksion të kësaj bisede mësuesi/ja sjell shembuj të këtyre bashkëpunimeve.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë në grupe dhe lexim i orientuar

Nxënësit janë lajmëruar që një orë më parë për mënyrën sesi do të zhvillohet kjo orë mësimi. Ata janë përgatitur për të qenë sa më aktivë, përmes leximit paraprak të tekstit në faqet 218-221, grumbullimit të informacionit për pushtuesit italianë dhe gjermanë në Shqipëri, forcave politike që vepruan gjatë luftës, si dhe figurat më aktive të asaj periudhe.

Sapo të përfundojë faza e parë e mësimi, organizohen grupet dhe pozicionohen në zona të caktuara të klasës, për të vijuar punën në mënyrë të pavarur. Secili grup përgatitet për të prezantuar një temë të caktuar. Ndarja e grupeve dhe temave mund të bëhet edhe një orë më parë, nëse mësuesi/ja e sheh të arsyeshme.

Grupi i parë – Vendosja e administratës italiane të pushtimit.

Grupi i dytë – Vendosja e administratës gjermane të pushtimit.

Grupi i tretë – Reagimi i forcave politike shqiptare ndaj pushtuesit.

Grupi i katërt – Mundësitë për bashkim të territoreve shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Grupi i pestë – Diferencat mes pushtuesit italian dhe atij gjerman në vendin tonë.

Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e grupeve dhe kujdeset për qetësinë gjatë periudhës së punës. Në përfundim grupet prezantojnë arritjet e tyre, përmes formave të larmishme që mund të zgjedhin.

Faza e tretë: Përforcimi – konkluzione – turi i galerisë

Pasi kanë përfunduar punimet e grupeve, të realizuara në postera, flipçarte, mozaik fotosh etj., nxënësit shohin nga afër punimet e tyre. Bëjnë komentet përkatëse duke kritikuar dhe vlerësuar punën e gjithsecilit. Vlerësohet grupi më i mirë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni përgjigje për pyetjet:

1. Cilat qenë qëndrimet e autoriteteve pushtuese ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në Çamëri?

Pse?

2. Si reagues shqiptarët e Kosovës dhe të Çamërisë ndaj pushtuesve?

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rezistenca shqiptare kundër boshtit si pjesë e luftës së Aleatëve të Kombeve të Bashkuara		Situata e të nxënit: Diskutohet pyetja kyçe: Si e kanë ndikuar dhe e ndikojnë rrjedhën e së ardhmes së Shqipërisë zhvillimet politike të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vë në dukje vendin e rezistencës shqiptare në kuadrin e rezistencës europiane kundër Boshtit. • Evidenton qëndrimin e Aleatëve të Mëdhenj ndaj rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. • Analizon rolin e misioneve të Aleatëve të Mëdhenj në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. • Shpjegon ndikimin e rrjedhës së rezistencës shqiptare në të ardhmen e Shqipërisë.		Fjalët kyçe: Lufta e Dytë Botërore, Lufta Nacionalçlirimtare, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Legaliteti, Balli Kombëtar, Fronti Nacionalçlirimtar, Aleatët e Mëdhenj.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – pyetje kyç Mësimi hapet përmes pyetjes kyç: Si e kanë ndikuar dhe e ndikojnë rrjedhën e së ardhmes së Shqipërisë zhvillimet politike të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri? Gjatë diskutimit, përdoren edhe sqarime shtesë lidhur me konceptet: Lufta Nacionalçlirimtare, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Aleatët e Mëdhenj, komunistët etj.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik Mësuesi/ja e prezanton mësimin përmes organizuesit grafik. Për këtë mund të përdorë skema të gatshme të parapërgatitura ose ta realizojë atë, ndërkohë që nxënësit lexojnë me vëmendje tekstin në faqet 222-224. Nxënësit paralajmërohen që, gjatë organizimit të informacionit në mënyrë grafike, do të kërkohet shpesh mendimi dhe përgjigjja e tyre.			

- Populli shqiptar që në fillim zgjodhi rezistencën e armatosur kundër pushtuesit.
- Deri në vitin 1943, populli shqiptar nuk priti ndihmë nga Fuqitë Perëndimore.
- Populli shqiptar nuk pranoi të luftonte kundër fqinjëve.
- Gjatë luftës, shqiptarët mikëpritën dhe mbrojtën qindra hebrenjë.
- Shqipëria ishte ndër të paktit në Europë që u çlirua pa ndërhyrjen e aleatëve, por duke u mbështetur tërësisht te forcat e veta.
- Lufta e Dytë Botërore u shoqërua me pasoja të mëdha ekonomike, sociale, njerëzore, infrastrukturore etj.

- Aleatët patën qëndrime të ndryshme ndaj Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.
- Fillimisht mbajtën qëndrim indiferent, por pas vitit 1943, nga territori grek erdhën trupat e misionit ushtarak britanik.
- Misionarët britanikë dhe amerikanë ndihmuan në LANÇ përmes ndihmave ushtarake dhe materialeve të nevojshme për luftën. Ndihma pati edhe nga misione sovjetike.
- Të tre misionet u vendosën pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kurse misionet britanike e amerikane u vendosën edhe pranë Legatit dhe Ballit Kombëtar.

- Lufta Antifashiste e popullit shqiptar mori edhe tiparet e një lufte politike për pushtet.
- Komunistët krijuan Këshillat Nacionalçlirimtar në zonat e çliruara dhe filluan të merrnin pushtetin.
- Këtij qëllimi i shërbeu edhe Kongresi i Përmetit (24-28 maj 1944) dhe Plenumi i Beratit (20-23 tetor 1944).

Faza e tretë: Përforcimi – pyetja binare

Gjatë kësaj faze nxënësit diskutojnë rreth pyetjes binare, duke argumentuar qëndrimin e tyre.

Në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri ndikuan:

Faktorë të
brendshëm?

Faktorë të
jashtëm?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Rezistencën e banorëve të vendbanimit tuaj kundër pushtuesve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Lëvizjet e rezistencës në Ballkanin Perëndimor (Jugosllavi dhe Greqi)		Situata e të nxënit: Reflektoni: Në vendet e Ballkanit u vu re një ndarje e forcave ndërluftuese. Mungesa e bashkëpunimit mund të cilësohet si një arsye e pushtimit të zgjatur të Ballkanit nga pushtuesit nazifashistë.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Tregon situatën në Ballkanin Perëndimor pas pushtimit të saj nga Gjermania e Hitlerit. • Evidenton grupet kryesore të rezistencës në Jugosllavi dhe në Greqi dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. • Identifikon përpjekjet për bashkëpunim të rezistencës në Shqipëri me atë në Greqi dhe në Jugosllavi. • Evidenton përpjekjet e Aleatëve për të krijuar një front të përbashkët dhe fatin e këtyre lëvizjeve pas lufte.		Fjalët kyçe: Lufta e Dytë Botërore, Lufta Italo-Greke, Pakti Trepalësh i Boshtit, Boshti Trepalësh, Këshilli Antifashist (AVNOJ), Partia Komuniste Bullgare, Fronti Kombëtar i Çlirimit (EAM), Ushtria Popullore e Çlirimit Kombëtar (ELAS), Ushtria Kombëtare Demokratike Greke (EDES).	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Gjatë kësaj faze nxiten nxënësit të marrin pjesë aktive në evokimin e njohurive, lidhur me rezistencën antifashiste në Ballkanin Perëndimor. Idetë e tyre organizohen në tabelë, duke realizuar kështu skemën braingstorming.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mësimi zbulues – marrëdhënia pyetje-përgjigje

Përmes mësimi zbulues, nxënësi/ja merr përsipër të hulumtojë dhe zbulojë fakte, përgjigje, duke u nisur nga pyetjet. Në këtë mënyrë, ai/ajo do të jetë në rol parësor, aktor i rëndësishëm gjatë orës mësimore, ndërsa mësuesi/ja do të pozicionohet në rolin e drejtuesit, këshilluesit dhe vëzhguesit. Kjo do të nxisë mendimin kritik dhe do të forcojë te nxënësit kompetencat e arritjeve.

Për t'ia lehtësuar hulumtimin, nxënësit i ofrohen pyetjet kryesore, rreth të cilave do të përqendrohet puna e tij/e saj.

1. Cila ishte situata në Ballkanin Perëndimor pas pushtimit të saj nga Gjermania e Hitlerit?
2. Cilat qenë grupet kryesore të rezistencës në Jugosllavi dhe në Greqi?
3. Si bashkëpunuan dhe u ndanë grupet e rezistencës në Ballkan?
4. Çfarë përpjekjesh bënë Aleatët për të krijuar një front të përbashkët antifashist në Ballkan?
5. Si përfunduan lëvizjet antifashiste pas lufte?

Për secilën nga pyetjet, nxënësi/ja mban shënimet personale. Ai/ajo mund të konsultohet me shokët/shoqet e klasës, mund të ndryshojë qëndrim, duke zbatuar rregullat e një ore mësimore, pa sjellë shqetësime për nxënësit e tjerë.

Nëse nxënësit gjatë punës së tij i lind nevoja të sqarojë edhe pyetje të tjera, është i lirë të punojë për të gjetur përgjigjet e tyre.

Gjatë gjithë orës mësimore, mësuesi/ja ndjek nga afër punën e gjithsecilit. Ndërhyn për sqarime në ato raste kur e vëren që nxënësi/ja has vështirësi.

Faza e tretë: Përforcimi – rrjeti i diskutimit

Pasi kanë arritur të njihen më nga afër me informacionin, nxënësit lexojnë ose tregojnë përgjigjet për pyetjet e dhëna. Mësuesi/ja zgjedh në mënyrë të pavarur metodën e kontrollit të detyrave që u realizuan në klasë. Pasi janë dhënë të gjitha përgjigjet, nxënësit përgatiten të diskutojnë rreth pyetjes:

Pse në Ballkan ka qenë përherë i vështirë e gati i pamundur bashkëpunimi dhe unifikimi edhe në rast rreziku?

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Situatën në Ballkanin Perëndimor pas pushtimit të saj nga Gjermania e Hitlerit.
- b. Grupet kryesore të rezistencës në Jugosllavi dhe në Greqi dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.
- c. Përpjekjet për bashkëpunim të rezistencës në Shqipëri me atë në Greqi dhe në Jugosllavi.
- d. Përpjekjet e Aleatëve për të krijuar një front të përbashkët.
- e. Fatën e këtyre lëvizjeve pas lufte.

(Nxënësi zgjedh vetëm njërin prej pikave për të shprehur refleksionin e tij).

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Diplomacia e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946		Situata e të nxënit: Prezantohen emrat e “Tre të Mëdhenjve”, duke nxitur në klasë diskutim rreth rolit të secilit prej tyre gjatë Luftës II Botërore. Theksi vihet te Konferencat e organizuara gjatë luftës, me qëllim vendosjen e paqes.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton rëndësinë e Kartës së Atlantikut dhe parimeve të saj në nxitjen e rezistencës antifashiste. • Analizon vendimet e konferencave kryesore të Aleatëve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës dhe shpjegon ndikimin e tyre në botën e Pasluftës. • Evidenton ndryshimet dhe ngjashmëritë në planet e Aleatëve të Mëdhenj për botën e Pasluftës. • Krahason skenën ndërkombëtare pas dy luftërave botërore, duke vënë në dukje ndryshimet dhe të përbashkëtat mes tyre.		Fjalët kyçe: Karta e Atlantikut, Lufta e Dytë Botërore, OKB, Deklarata e Kombeve të Bashkuara, Fuqitë e Boshtit, Konferenca e Kazablankës, fronti i Paqësorit dhe Lindjes së Largët, Tre të Mëdhenjtë, operacioni Overlord (Pushtuesi), Konferenca e Jaltës.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Nxënësit nxiten të rikujtojnë njohuritë në lidhje me figurat historike të periudhës së Luftës II Botërore të njohur si “Tre të Mëdhenjtë”. Tre të Mëdhenjtë			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i pavarur – tabelë konceptesh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në mënyrë të pavarur. Ndërkohë në dërrasë plotësohen tabelat e koncepteve për dokumentet themelore dhe Konferencat ndërkombëtare në periudhën mes dy luftërave botërore.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)

	Viti	Pjesëmarrësit	Qëllimi	Përmbajtja
Karta e Atlantikut	14 gusht 1941	Presidenti amerikan F. Ruzvelti. Kryeministri britanik U. Çurçill.	Deklarohej dëshira për “të drejtat sovrahe dhe të drejtat e vetëqeverisjes për të gjithë ata që ishin privuar nga to me anë të forcës” dhe përfundohej me dëshirën që “pas shkatërrimit përfundimtar të tiranisë naziste do të lindte një rend botëror i dominuar nga paqja dhe stabiliteti, duke braktisur veprimet luftënxitëse si mjet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet kombeve”.	- Në Kartë përcaktohet parimet bazë të rendit të ardhshëm botëror, si: ndalimi i ekspansionit territorial; vetëvendosja e brendshme dhe e jashtme; demokracia, paqja si marrëveshje e lirë larg frikës së nevojës; heqje dorë nga përdorimi i forcës; sistem sigurie i përgjithshëm që lejon çarmatimin etj.

	Viti	Pjesëmarrësit	Qëllimi	Përmbajtja
Deklarata e “Kombëve të Bashkuara”	1 janar 1942	26 qeveri nacionale, mbështetëse të Kartës së Atlantikut.	Bashkimi i Fuqive për të dëmtuar Boshtin e çeliktë.	Mobilizimi i të gjitha burimeve të disponueshme në luftën kundër Fuqive të Boshtit dhe të ndalonte negociimin e veçuar me ndonjë prej tyre.

	Viti	Pjesëmarrësit	Qëllimi	Përmbajtja
Konferenca e Kazablankës	Janar 1943	Franklin Ruzvelt, Uinston Çurçill, Stalini.	Planifikimi i strategjisë europiane të Aleatëve gjatë Luftës II Botërore.	- Vazhdimi i luftës deri në eliminimin total të armikut. - Mbështetje BS me furnizime maksimale. - Mundja e Gjermanisë brenda vitit 1943 etj.

	Viti	Pjesëmarrësit	Qëllimi	Përmbajtja
Konferenca e Teheranit	28 nëntor-1 dhjetor 1943	“Tre të Mëdhenjtë”.	Planifikimi i strategjisë përfundimtare për luftën kundër Gjermanisë naziste.	- Nënshkrimi i një protokollit që njihte pavarësinë e Iranit. - Mbështetjen e partizanëve të Titos në Jugosllavi. - Mirëprirjet pjesëmarrja në luftë e Turqisë krahas aleatëve etj.

	Viti	Pjesëmarrësit	Qëllimi	Përmbajtja
Konferenca e Jaltës	4-11 shkurt 1945	“Tre të Mëdhenjtë”	Trajtimi i problemeve për vazhdimin e luftës, të ardhmen e Polonisë dhe për krijimin e OKB-së.	- Europa ishte e lirë dhe bëhej thirrje për zgjedhje demokratike në të gjitha territoret e çliruara nga nazistët. - Mbajtja e një konference ku do të krijohet OKB.

Faza e tretë: Përforsimi – pyetjet frontale

Gjatë kësaj faze, përqendrohet vëmendja në kontrollin e njohurive të sapomarra, në lidhje me diplomacinë gjatë periudhës së Luftës II Botërore. U drejtohen nxënësve këto pyetje:

1. Cilat ishin parimet bazë të rendit të ardhshëm botëror përcaktuar në Kartën e Atlantikut?
2. Si ndikoi Karta e Atlantikut në nxitjen e rezistencës antifashiste?
3. Cilat janë vendimet e Konferencave të zhvilluara nga Fuqitë e Mëdha gjatë Luftës së Dytë Botërore?
4. Sa të ngjashme dhe të ndryshme janë planet e Aleatëve të Mëdhenj për botën e Pasluftës?
5. Sa janë të ngjashme dhe të ndryshme skenat ndërkombëtare pas dy luftërave botërore?

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra: Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Rëndësinë e Kartës së Atlantikut në nxitjen e rezistencës antifashiste.
- b. Vendimet e konferencave kryesore të Aleatëve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës.
- c. Ndryshimet dhe ngjashmëritë në planet e Aleatëve të Mëdhenj për botën e Pasluftës.
- d. Skenën ndërkombëtare pas dy luftërave botërore.

Planifikimi ditor i orës së mësimi		
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI
Tema mësimore: Fillimet e Luftës së Ftohtë		Situata e të nxënit: Pas Luftës II Botërore, SHBA dhe BS nisën të kërkonin dominim ndërkombëtar dhe, ndërkohë që kishte aguar epoka bërthamore, ato ndërtuan, testuan dhe magazinuan armë bërthamore shumë të fuqishme, që mund të shkatërronin botën. Konflikti, pa një veprim total ushtarak mori emrin Lufta e Ftohtë, një term që ndoshta është pagëzuar prej një artikulli të vitit 1945 të Xhorxh Oruellit, për të përshkruar një konfrontim ideologjik mes dy fuqive. Diskutoni mbi këtë përplasje ideologjike, ekonomike dhe ushtarake.
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan ndarjen politiko-ideologjike të Europës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. • Dallon bazën e doktrinëve të palëve kundërshtarë të Luftës së Ftohtë dhe vë në dukje momentet që shënojnë fillimin e Luftës së Ftohtë. • Ballafaqon përplasjen e interesave të ish-Aleatëve të Luftës së Dytë Botërore në Europë, si dhe tregon ngjarjet fillestare të këtyre përplasjeve.		Fjalët kyçe: Lufta e Ftohtë, Lufta e Dytë Botërore, ndryshime gjeopolitike, ndryshime politiko-ideologjike, liria individuale, liria e masave, zgjedhje të lira dhe demokratike, monopartiake, individ, masat punonjëse, pronë private, pronë e përbashkët, pronë shtetërore, nomenklaturë, dhunë shtetërore, ligj, dogmë komuniste, dy kampe të kundërta, demokratik, kapitalist, diktatorial socialist, Traktati i Varshavës.
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Zhvillohet teknika braingstorming, duke rikujtuar të gjitha ngjarjet apo konceptet që kanë lidhje me Luftën e Ftohtë. Lufta e Ftohtë		

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i pavarur – diagram veni

Në këtë fazë, mësuesi/ja i orienton nxënësit që të lexojnë materialin në tekst, në faqet 232-234. Gjatë leximit nxënësit, përmes përdorimit të stilolapsave me dy ngjyra, diferencojnë tiparet për dy shtetet që u përplasën gjatë Luftës së Ftohtë. Kjo procedurë do t'u vijë në ndihmë atyre për të plotësuar më shpejt dhe lehtë diagramin e venit.

BRSS	Të përbashkëtat	SHBA
– Mbështetëj në Doktrinën Komuniste. – Liria individuale i nënshtrohej lirisë së masave dhe shtetit, duke nënkuptuar kufizimin e saj. – Demokracia u zëvendësua me sistemin monopartiak, ku partitë e tjera, veç Partisë Komuniste, ndalohehin me ligj. – Në komunizëm, njeriut iu mohua prona private dhe ai u shndërrua në një shërbëtor të shtetit. – Rendi dhe qetësia siguroheshin përmes dhunës shtetërore, e cila nënkuptonte edhe asgjësimin fizik të kundërshtarëve etj.	– Kanë qenë aleatë gjatë Luftës II Botërore. – Ishin dy superfuqitë që dominonin botën gjatë shek. XX. – Kishin qenë shtetet që ndanë territoret etj.	– Mbështetet në Doktrinën kapitaliste demokratike. – Liria individuale nuk mund të kufizohet nga sistemi. Njeriut i njihen dhe i respektohen liritë dhe të drejtat. – Sistemi kapitalist bazohet në parimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike ku konkurrojnë forca të ndryshme politike. – Sipas ideologjisë kapitaliste, prona private është e shenjtë dhe e pacenueshme. – Në ideologjinë kapitaliste rendi, qetësia dhe paqja sociale sigurohen nëpërmjet zbatimit të ligjit.

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Në këtë fazë nxitet pjesëmarrja aktive në diskutimin rreth:

- Luftës së Ftohtë dhe rolit të saj në shekullin XX.

Përmes kësaj faze, mësuesi/ja bën matjen për arritjen e rezultateve të të nxënit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Të dhënat që dëshmojnë shkatërrimin e jetës së njerëzve, për shkak të bindjeve të ndryshme ideologjike në periudhën komuniste në vendin tonë.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Krijimi i Bllokut Perëndimor		Situata e të nxënit: Arsyeja kryesore e Planit Marshall ishte frika e kaosit në Europën Perëndimore. Këtë e shihje po të shkoje në kinema çdo fundjavë. Para se të fillonte filmi, dokumentari fliste për problemet e Europës. Gratë dhe fëmijët, që gati po vdisnin nga uria, prekën zemrat amerikane. Pra, nga njëra anë, ishin gratë dhe fëmijët në Europën Perëndimore. Nga ana tjetër ishte fuqia e Partisë Komuniste në vende si Franca dhe Italia, gjë që ishte shqetësuese.” Ju si mendoni: Ndihma që SHBA dha nëpërmjet Planit Marshall kishte qëllim ekonomik apo politik?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton ndryshimin e fuqisë dhe balancave mes shteteve të Europës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore. - Vë në dukje gjendjen e vështirë të pasluftës në Europë, përpjekjet për tejkalimin e saj dhe nevojën për krijimin e një aleance politiko-ushtarake transatlantike. - Argumenton nevojën për një proces integrimi mes vendeve Perëndimore si kundërpeshë kundrejt rrezikut sovjetik.		Fjalët kyçe: Blloku Perëndimor, Lufta e Dytë Botërore, Plani Marshall, Organizata Europiane e Bashkëpunimit Ekonomik, Lufta e Ftohtë, Komiteti i Kooperimit Ekonomik Europian, Blloku Komunist, Bashkësia Europiane e Qymyrit dhe Çelikut, Bashkësia Ekonomike Europiane, Tregu i Përbashkët Europian, Bashkësia Europiane e Mbrojtjes, NATO.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor, Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – PTP Gjatë kësaj faze, përmes teknikës PTP, nxënësit krijojnë në mënyrë të pavarur një tekst me përmbajtje historike. Për të ndërtuar tekstin u jepen nxënësve disa terma kyçe: “Lufta e Dytë Botërore, Konferenca e Jaltës, Blloku Perëndimor, Blloku Lindor, Lufta e Ftohtë, Plani Marshall, KNER.”			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mësimi zbulues – marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar përcjelljen e njohurive të reja, zgjidhet organizimi i mësimi zbulues. Gjatë leximit të informacionit, nxënësit do të përqendrohen më së tepërmi në gjetjen e përgjigjeve, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të formuluar me fjalorin e përshtatshëm. Gjatë leximit, nxënësit këshillohen të formulojnë pyetje të tjera, të cilat i këmbëjnë me njëri-tjetrin gjatë punës në dyshe.

Pyetjet orientuese janë:


1. Si ishte gjendja e pasluftës në Europë?
2. Si ndryshoi fuqia dhe balanca mes shteteve të Europës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore?
3. Cili ishte thelbi i Planit Marshall? Pse?
4. Cilat shtete europiane patën më shumë përfitime nga Plani Marshall?
5. Çfarë përpjekjesh bënë vendet e Bllokut Perëndimor për integrimin e tyre në fushën ekonomike dhe ushtarake? Pse?
6. Sa të domosdoshme ishin struktura të tilla si KEQÇ dhe NATO?

Për secilën nga pyetjet, pasi nxënësit kanë përfunduar punën e tyre, nevojitet ndërhyrja e mësuesit/es për të saktësuar përgjigjet, nëse do të jetë e nevojshme.

Faza e tretë: Përforsimi – nxjerrja e konkluzioneve

Për të përforsuar dijet e fituara, në tabelë ndërtohet një skemë, ku organizohen konkluzionet e orës së mësimi.

Secili nxënës shkruan në fletore konkluzionet që arriti dhe të gjithë së bashku i organizojnë në tabelë me ndihmën e mësuesit/es.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Vëzhgoni hartën dhe interpretoni. Cila është lidhja e saj me krijimin e Bllokut Perëndimor? Pse? Formuloni përfundimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shqipëria dhe marrëdhëniet me Perëndimin		Situata e të nxënësve: Kryetari i UNRRA-s citohet se ka thënë: “Asgjëkundi tjetër në botë nuk kam parë kaq shumë uri sa kam parë në Shqipëri.” Po na vijnë shumë letra nga njerëz, që aspak nuk lypin, por kërkojnë falje se kanë nevojë për ushqime dhe veshje. Çfarë konkluzionesh nxirrni?	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi: - Tregon raportet e diferencuara të Shqipërisë me Aleatët e Mëdhenj antifashistë menjëherë pas luftës. - Analizon qëndrimet e anglo-amerikanëve ndaj qeverisë shqiptare, e drejtuar nga Enver Hoxha, dhe kërkesat e tyre për legjitimimin e sistemit me anë të zgjedhjeve të lira. - Evidenton arsyet e prishjes së marrëdhënieve të qeverisë komuniste shqiptare me Britaninë e Madhe dhe SHBA-në.		Fjalët kyçe: Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rimëkëmbje (UNRRA), Aleatët e Mëdhenj, Kongresi i Përmetit, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënësve (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes(25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming Shfaqet në videoprojektor një video e rrallë e gjendjes së Shqipërisë gjatë Luftës II Botërore. Për këtë video mësuesi/ja përdor paraprakisht linkun https://youtu.be/J39xAIAQZk4 . Pasi shihet video, nxënësve u prezantohet situata e të nxënësve dhe më pas zhvillohet bashkëbisedim, duke nxjerrë përfundime mbi gjendjen e vështirë të shqiptarëve gjatë dhe pas lufte.			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari trepjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për teknikat që do të aplikohen në fazën e ndërtimit të njohurive. Fillimisht bëhet leximi i orientuar i mësimi nr. 18, në faqet 238-240.

Pasi leximi ka përfunduar dhe janë sqaruar disa nga konceptet e paqarta për nxënësit, plotësohet në tabelë dhe në fletore ditari trepjesësh.

Çështja	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit/es
Ndihmat nga UNRRA	Qeveria shqiptare iu drejtua UNRRA-s për ndihma materiale në fund të Luftës II Botërore. Në gusht 1945, u nënshkrua marrëveshja, e cila solli në vendin tonë një mision për shpërndarjen e ndihmave. Ndihmat erdhën nga viti 1945 deri në vitin 1947 dhe konsistonin në drithëra, makineri bujqësore, makineri bujqësore etj.	Por ndihma e UNRRA-s nuk u fokusua vetëm në këtë drejtim. Afro 1.45 milionë dollarë u ofruan prej saj për të ndihmuar të shpërngulurit nga Greqia. UNRRA shpenzoi për Shqipërinë 32 milionë dollarë dhe ndihmoi edhe në riatdhesimin e italianëve dhe hebrenjve që gjendeshin në Shqipëri.

Njohja nga Fuqitë e Mëdha		
Prishja e marrëdhënieve me SHBA-në		
Incidenti i Kanalit të Korfuzit		

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Në këtë fazë, mësuesi/ja përcjell një informacion më të gjerë lidhur me Incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe nxënësit përfshihen në diskutim.

“Shqipëria apo Britania e Madhe? Cila prej tyre është përgjegjëse për incidentin e Kanalit të Korfuzit?”

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:


- Raportet e diferencuara të Shqipërisë me Aleatët e Mëdhenj antifashistë menjëherë pas luftës.
- Qëndrimet e anglo-amerikanëve ndaj qeverisë shqiptare të drejtuar nga Enver Hoxha dhe kërkesat e tyre për legjitimimin e sistemit me anë të zgjedhjeve të lira.
- Arsyet e prishjes së marrëdhënieve të qeverisë komuniste shqiptare me Britaninë e Madhe dhe SHBA-në.

(Nxënësi zgjedh të punojë njërën prej pikave të dhëna dhe e dokumenton detyrën në Portofolin e të nxënësit.)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Krijimi i Bllokut Lindor		Situata e të nxënit: “Nga Stettini në Balltik dhe deri në Trieste, Adriatik, një perde e hekurt është vendosur në të gjithë kontinentin. Prapa asaj perdeje shtrihen kryeqytetet e shteteve të lashta të Europës Qendrore dhe Lindore – Berlioni, Varshava, Praga, Vjena, Budapesti, Beogradi, Bukureshti dhe Sofja; të gjitha këto qytete të famshëm me popullsinë e tyre ndodhen në atë që do ta quaj Sfera Sovjetike dhe që në një formë apo tjetër i nënshtrohen jo vetëm ndikimit sovjetik, por në një masë shumë të madhe dhe në disa raste në rritje edhe kontrollit nga Moska.....” W. Churchill.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan vendin që zinte Europa Lindore dhe Qendrore në synimet gjeostrategjike të Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore. • Shpjegon taktikat dhe rrugët e përdorura nga Bashkimi Sovjetik për vendosjen e regjimeve komuniste në Europën Lindore. • Përcakton arsyet e krijimit të KNER-it dhe Traktatit të Varshavës, si mekanizmat kryesorë të kontrollit sovjetik mbi vendet e Europës Lindore.		Fjalët kyçe: Aleanca Atlantike Veriore, Luftë e Ftohtë, Blloku Lindor, Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke (KNER), Byroja Informative e Partive Komuniste, Traktati i Varshavës, BS.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Duke qenë se nxënësit kanë informacion paraprak për Bllokun Lindor, zhvillohet teknika braingstorming. Nxënësit evokojnë njohuritë lidhur me këtë koncept kyç, duke përdorur edhe njohuritë për <i>perden e hekurt</i> . Idetë e nxënësve renditen në tabelë:			
<			


Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i orientuar – kllaster

Në këtë fazë orientohen nxënësit në leximin e tekstit në faqet 241-243 dhe më pas punohet modeli i kllasterit sipas prezantimit që bën mësuesi/ja në dërrasë.



Faza e tretë: Përforcimi – diagram veni

Pasi janë realizuar dy etapat e para të mësimin, në këtë fazë nxënësi punon individualisht dhe në mënyrë të pavarur, duke u fokusuar në përzgjedhjen dhe organizmin e informacionit të ri, që ka mësuar në orët e fundit të mësimin. Në funksion të përforcimit të njohurive, realizohet diagrami i venit për dy blloqet politiko-ekonomike që lindën pas Luftës së Dytë Botërore.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.


Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Vendin që zinte Europa Lindore dhe Qendrore në synimet gjeostrategjike të Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore.
- Taktikat dhe rrugët e përdorura nga Bashkimi Sovjetik për vendosjen e regjimeve komuniste në Europën Lindore.
- Arsyet e krijimit të KNER-it dhe Traktatit të Varshavës, si mekanizma kryesorë të kontrollit sovjetik mbi vendet e Europës Lindore.


Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948)		Situata e të nxënit: Përmendet Mbledhja e Mukjes. Renditen vendimet dhe, më pas, arsyet e anulimit. Hidhet tema për diskutim: A u shit Kosova me anulimin e Mbledhjes së Mukjes?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Shpjegon rolin e emisarëve jugosllavë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. - Analizon format dhe metodat e përdorura prej jugosllavëve për vendosjen e kontrollit të tyre në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948. - Argumenton rolin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.		Fjalët kyçe: Lufta e Dytë Botërore, Federata Ballkanike, Partia Komuniste Jugosllave, Republika Federative e Jugosllavisë, Partia Komuniste Shqiptare, Fronti Nacionalçlirimtar Shqiptar, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, Lëvizja Nacionalçlirimtare Shqiptare, Marrëveshja e Mukjes, Republika Popullore e Shqipërisë (RPSH), Republika Popullore Federative e Jugosllavisë (RPFJ), Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke, franga shqiptare, dinari jugosllav.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – diskutim Gatë kësaj faze lexohet dhe diskutohet rreth situatës së të nxënit. Mbledhja e Mukjes i tregoi qartë interesat e PKSH-së, mundësitë dhe pamundësitë që ajo pati gjatë marrjes së pushtetit. Në këtë kontekst pati rolin e saj edhe Jugosllavia. Nxënësit përfshihen në diskutim rreth pyetjes: A u shit Kosova me anulimin e Mbledhjes së Mukjes?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i pavarur – organizuesi grafik i informacionit. Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e re të mësimi. Pas kësaj prezanton materialin e ri mësimor përmes organizuesit grafik të tij.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E DYTË (JANAR-MARS)



Faza e tretë: Përforcimi – linja e kohës

Në këtë fazë, nxënësi pasi është njohur me informacionin jo vetëm përmes shpjegimit të mësuesit/es, por edhe përmes leximit të pavarur, punon në fletore për të ndërtuar linjën e kohës për marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë gjatë e pas Luftës II Botërore.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.


Detyra:

Kërkoni informacion:

Miladin Popoviç, Dushan Mugosha, Enver Hoxha, Nako Spiro, Josif Stalin, Josif Broz Tito.

Cila është lidhja e këtyre figurave historike me Shqipërinë dhe Jugosllavinë në vitet 1944-1948?

Planifikimi ditor i orës së mësimi		Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI
Tema mësimore: Shqipëria dhe BRSS		Klasa: XII
		Situata e të nxëniti: Jepni mendimet tuaja: Pse u lidhën marrëdhëniet me BS? Pse këto marrëdhënie morën rrjedhë tjetër pas vdekjes së Stalinit?
Rezultatet e të nxëniti të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton rolin e BS-së në raport me Shqipërinë gjatë viteve 1945-1953. • Tregon ndryshimet e ndodhura në BS pas vdekjes së Stalinit dhe shpalosjes së Kursit të Ri të Hrushovit, duke evidentuar ndikimin e tyre në politikën shqiptare. • Shpjegon zhvillimet në Konferencën III të PPSH-së për Tiranën dhe gjykon mbi domethënien e saj për të ardhmen e Shqipërisë. • Evidenton arsyet e ngritjes së bazës ushtarake të Vlorës. • Analizon arsyet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike dhe pasojat e saj për Shqipërinë.		Fjalët kyçe: Fronti Nacionalçlirimtar, kanali i Korfuzit, Byroja Informative e Partive Komuniste, Federata Ballkanike, Konferenca e Tretë e Partisë për Tiranën, Komiteti Qendror i PPSH-së, NATO, Partia Komuniste Kineze (PKK).
Burimet: Interneti, teksti mësimor, Historia e Ballkanit, G. Castellan, Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxëniti (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – brainstorming Mësimi hapet përmes risjelljes ndër mend të njohurive në lidhje me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BRSS në komunizëm. Çdo informacion ose ide përmbledhet shkurtazi në skemën brainstorming që ndërtohet në dërrasë.		



Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mësimi zbulues – tabela kronologjike

Gjatë kësaj faze nxënësit orientohen në leximin e informacionit të ri. Gjatë leximit ata i kushtojnë rëndësi zbulimit të përgjigjeve për disa pyetje. Përgjigjet e gjetura do të shërbejnë për të organizuar informacionin në tabelën kronologjike. Mësuesi/ja prezanton në dërrasë modelin e tabelës, ndërsa nxënësit punojnë me tekstin. Pas kësaj, duke ndërthtur mendimet e nxënësve, plotësohet tabela.

Marrëdhëniet me BRSS	Filloi në:	Protagonistët	Faktorët ndikues	Masa konkrete	Përfundimi
Faza e afërimit	Gjatë Luftës së Dytë Botërore.	Stalini – Tito – Enver Hoxha	Synimi i krijimit të Federatës Ballkanike.	- Dërgimi i misionit ushtarak pranë FNÇL. - Njohja diplomatike e Shqipërisë pas lufte. - Mbrojtja e Shqipërisë në Hagë, lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit.	Gjatë kësaj faze, Shqipëria shihej si pjesë e Jugosllavisë dhe përfaqësohej në Organizmat Ndërkombëtare Komuniste përmes PKJ-së.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhën E DYTË (JANAR-MARS)

Faza e bashkëpunimit	1948-1961	Stalini - Enver Hoxha - Nikita Hrushovi	-Konflikti midis Stalinit dhe Titos. -Prishja e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare me urdhër të Stalinit. -Mungesa e një rreziku real nga ana e BRSS, duke qenë se ndodhej larg Shqipërisë. -Interesi sovjetik mbi bregdetin shqiptar (baza e Pasha Limanit në Vlorë).	-Ardhja e specialistëve dhe këshilltarëve sovjetikë në të gjitha fushat. -U kopjua modeli stalinist në ekonomi dhe udhëheqje. -U ndryshua emri nga PKSH në PPSH. - U synuan ndryshime në PPSH pas vdekjes së Stalinit. Për këtë qëllim u organizua Konferenca e Tiranës.	-Shqipëria përfitoi prej ndihmave ekonomike që i erdhën nga BS, por përfituesi kryesor ishte Enver Hoxha, i cili e konsolidoi edhe më tepër pushtetin e tij. Konferenca e Tiranës dhe dështimi i saj treguan forcën e madhe që kishte tani Enver Hoxha, falë edhe mbështetjes që i erdhi nga BS gjatë qeverisjes së Stalinit.
Faza e ndarjes	1957-1961	Enver Hoxha - Hrushovi - Mao Ce Dun	-Enver Hoxha e kundërshtoi kursin e Hrushovit, duke i qëndruar besnik linjës staliniste. - Intensifikimi i kontakteve me PKK. -Mbledhja e Moskës(1960)	-U ndërprehen ndihmat ekonomike dhe kreditë. -U shfaqën probleme në fushën e arsimit. Studentët shqiptarë në BRSS dhe Lindje ndërprehen studimet, madje edhe u ndanë nga familjet. -Tregtia pësoi stanjacion me vendet e Lindjes. -U tërhoqën nëndetëset nga baza ushtarake e Vlorës.	Enver Hoxha, për ta përforsuar edhe më shumë pushtetin personal, përdori armën e ideologjisë, për ta shkëputur Shqipërinë nga ndikimi sovjetik, gjë që u shoqërua me pasoja të rënda ekonomike, ushtarake e sociale. Në rrethana të tilla, Enver Hoxha piketoi një aleat të ri: Kinën.

Faza e tretë: Përforsimi – diskutim

Mësuesi/ja hap diskutimin rreth informacionit të mëposhtëm:

Baza ushtarake sovjetike në Pasha Liman ishte dhe kurorëzim i ëndrrës së vjetër ruse për dalje në detin Mesdhe. Në fakt, kjo bazë ushtarake përbënte një kërcënim për sovranitetin e Shqipërisë, gjë që nuk u shfrytëzua nga Hrushovi në prag të prishjes së marrëdhënieve, duke shmangur kështu një konflikt të mundshëm midis dy vendeve.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Marrëdhëniet Shqipëri-BRSS gjatë viteve 1945-1953.
- b. Kursit të Ri të Hrushovit, duke evidentuar ndikimin e tyre në politikën shqiptare.
- c. Zhvillimet në Konferencën III të PPSH-së për Tiranën dhe mbi domethënien e saj për të ardhmen e Shqipërisë.
- d. Arsyet e ngritjes së bazës ushtarake të Vlorës.
- e. Arsyet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike dhe pasojat e saj për Shqipërinë.

Planifikimi ditor i orës së mësimit			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërmjet dy blloqeve		Situata e të nxënit: Shfaqet në videoprojektor imazhi “The red iceberg” i një autori të panjohur. U kërkohet nxënësve të interpretojnë imazhin, si parahyrje e mësimit të ri.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon rrjedhojat e përplasjeve mes blloqeve në arenën ndërkombëtare dhe vë në dukje momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë. • Arsyeton mbi konfliktin në fushën ideologjike mes blloqeve dhe pasqyrimin e tij nëpërmjet propagandës. • Analizon ecurinë e marrëdhënieve mes dy superfuqive, konceptin e “detantës” dhe zbatimin e saj në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.		Fjalët kyçe: Lufta e Koresë, kriza e raketave sovjetike, Lufta e Ftohtë, propaganda komuniste, disidenca, teknologjia, izolimi i plotë nga Perëndimi, bashkekzistenca paqësore.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)		N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	
		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – diskutim Gjatë kësaj faze mësuesi/ja, pasi prezanton situatën e të nxënit, punon me të gjithë klasën për të nxitur pjesëmarrjen në diskutim. Përmes imazhit “The red iceberg”, nxënësit formulojnë mendime mes gjendjes që ekzistonte mes dy blloqeve gjatë viteve 1960-1970.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – mësimi zbulues – marrëdhënia pyetje-përgjigje Në këtë fazë, klasa organizohet në grupe me katër deri në pesë anëtare. Grupet do të punojnë brenda tyre përmes metodës “marrëdhënia pyetje-përgjigje”, me qëllim realizimin e mësimit zbulues. Nxënësve u shpërndahen fletat me pyetjet orientuese. Secili anëtar i grupit merr përsipër detyrat dhe fillon punën. Disa pyetje që mund të përdoren janë: 1. Cilat ishin rrjedhojat e përplasjeve mes blloqeve në arenën ndërkombëtare? 2. Cilat ishin momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë? 3. Si e vlerësoni konfliktin në fushën ideologjike mes blloqeve? 4. Si u pasqyrua ai nëpërmjet propagandës? 5. Cila është ecuria e marrëdhënieve mes dy superfuqive? 6. Cili është kuptimi i konceptit të “detantës”? 7. Në ç’mënyrë u zbatua “detanta” në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare? Gjatë gjithë kohës që u lihet grupeve për të punuar, mësuesi/ja ndjek nga afër punën e gjithsecilit, jep sqarime, bën sugjerime dhe mban shënime, të vlefshme për fazën e vlerësimit.			

Faza e tretë: Përforcimi – prezantimi i arritjeve

Pasi është përfunduar puna, secili prej grupeve, përmes përfaqësuesve të tij bën prezantimin e rezultateve të arritura. Që situata të quhet e realizuar duhet që në secilin prej grupeve të jenë gjetur saktë të gjitha pyetjet e sugjeruara. Është vlerësim shtesë nëse grupet kanë formuluar dhe u janë përgjigjur pyetjeve të tjera.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- a. Rrjedhojat e përplasjeve mes blloqeve në arenën ndërkombëtare.
 - b. Momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë.
 - c. Konfliktin në fushën ideologjike mes Blloqeve dhe pasqyrimin e tij nëpërmjet propagandës.
 - d. Ecurinë e marrëdhënieve mes dy superfuqive.
 - e. Konceptin e “detantës” dhe zbatimin e saj në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
- (Nxënësi zgjedh të punojë njërin prej kërkesave të ushtrimit.)

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përsëritje nr. 10		Situata e të nxënës: Sasia e informacionit me të cilin nxënësit janë njohur është e konsiderueshme. Ka ardhur momenti që njohuritë të provohen para ballafaqimit me testin.	

Rezultatet e të nxënës të temës mësimore:**Nxënësi:**

Tregon rolin dominues të Rusisë në botën ortodokse dhe rëndësinë e këtij pozicionimi në drejtimet e politikës së jashtme të saj duke u përqendruar kryesisht te Ballkani.

Analizon zhvillimin e pashallëqeve shqiptare dhe politikën e tyre që çonin drejt synimit për shkëputje përfundimtare nga Perandoria Osmane.

Shpjegon raportin e ri të vendosur mes shtetit dhe kishës dhe karakterin laik të shtetit francez pas revolucionit.

Evidenton karakterin ekspansionist të shtetit francez nën drejtimin e Napoleon Bonapartit dhe krijimin e Perandorisë Franceze.

Argumenton karakterin restaurues të vendimeve të Kongresit të Vjenës.

Shpjegon konceptin e pansllavizmit dhe analizon idetë kryesore të tij.

Vë në dukje centralitetin e idesë së Ortodoksizmit në përpjekjet për shkëputje të popujve ballkanike dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në Ballkan.

Vë në dukje përpjekjet e shqiptareve për shkëputje nga Perandoria Osmane pas rënies së pashallëqeve.

Shpjegon thelbin e reformave të Tanzimatit dhe domethënien e tyre për shqiptarët.

Vë në dukje dobësimin e pozitës ndërkombëtare të Perandorisë Osmane dhe ndikimin e saj në gjendjen e brendshme të perandorisë.

Evidenton vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, të imponuara nga Fuqitë e Mëdha mbi Perandorinë Osmane.

Analizon zhvillimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ballafaqimin e qëndrimeve të drejtuesve të saj dhe rëndësinë e kësaj ngjarje.

Interpreton vizionin e rilindësve për të ardhmen e një Shqipërie të pavarur.

Evidenton përpjekjet e shqiptareve për përhapjen e gjuhës shqipe, të arsimit dhe të kulturës shqiptare.

Argumenton synimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike për rregullimin gjeopolitik të Ballkanit pas Osmanit.

Përshkruan shkaqet dhe zhvillimin e Luftës I Ballkanike dhe ndikimin e saj në ngjarjet që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Pasqyron hartën e re politike të Europës pas Paqes së Versajës.

Përshkruan ecurinë e procesit të njohjes së shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në Konferencën e Paqes dhe atë të Ambasadorëve në Paris.

Evidenton organizimin e shtetit shqiptar në vitet 1912-1939.

Gjykon mbi pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Analizon ndikimet që kriza ekonomike botërore pati në ekonominë dhe në politiken shqiptare dhe ballkanike.

Analizon paktin Kellog-Briand, duke evidentuar ndikimin që ai pati në bashkëpunimin ballkanik.

Evidenton procesin e formimit të Boshtit dhe të Aleancës së Kombeve të Bashkuara dhe shpjegon karakteristikat e secilit prej tyre.

Përshkruan momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore.

Shpjegon tentativat e A. Zogut në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për të evituar pushtimin italian.

Vë në dukje vendin e rezistencës shqiptare në kuadrin e rezistencës europiane kundër Boshtit.

Analizon vendimet e konferencave kryesore të Aleatëve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës dhe shpjegon ndikimin e tyre në Botën e Pasluftës.

Përshkruan ndarjen politiko-ideologjike të Europës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.

Vë në dukje dallimet mes dy blloqeve ideologjike gjatë Luftës së Ftohtë.

Analizon marrëdhëniet e shtetit diktatorial shqiptar me perëndimin dhe vendet e lindjes.

Diskuton mbi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet e Bllokut Lindor.

Fjalët kyçe:

System autokratik, dumë, projekti grek, pashallëk, çifligje, Porta e lartë, Lidhja Ilirike, pashallëku i Shkodrës, Pashallëku i Janinës, përfaqësi e përgjithshme, roje kombëtare, konventa kombëtare, jakobinë, zhironinë, direktorat, monarki kushtetuese, konsull i parë, kongresi i Vjenës, politikë pansllaviste, vojevode, Traktati i Shën Stefanit, Pansllavizmi, Patriarkana e Stambollit, armatolikë, Filiki eteria, Tanzimati, jeniçerë, mejtepe, xhize, nahije, Megali idea, Kriza e tretë lindore, Principata serbe, Perandoria habsburge, Fuqi të mëdha, Rilindja Kombëtare, Principata e Vllahisë, Kongresi i Berlinit, Komisionet Evropiane, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, Lidhja e Prizrenit, Këshill Pleqësie, Turqit e rinj, Kongresi i Manastirit, Kongresi i Elbasanit, Normalja e Elbasanit, Traktati i Lozanës, Lufta e Parë Ballkanike, Lufta e Dytë Ballkanike, Pavarësia e Shqipërisë, Antanta, Aleanca Trepalëshe, Lidhja e Kombeve, Konferenca e Londrës, Fuqitë e Mëdha, Principatë Autonome, KNK, Traktati i Fshehtë të Londrës, Qeveri e Përkohshme, Pleqësi, KAL, Konferenca e Paqes, Statuti Organik, Kongresi i Durrësit, Kongresi i Lushnjës, Statuti Themeltar, MSKS, Mbretëria Jugosllave, Kriza ekonomike, New Deal, Lufta e Parë Botërore, Konferenca e Parë Ballkanike, Konferenca e Dytë Ballkanike, Revolucion i socialist të tetorit 1917, Traktati i Paqes së Versajës, Lufta e Dytë Botërore, Boshti Romë-Berlin, Traktati i fshehtë sovjetogjerman, PKSH, Balli Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Konferenca e Pezës, Mbledhja e Mukjes, Këshilli i Lartë i Regjencës, Lufta Nacional-çlirimtare, Aleatët e mëdhenj, EDES, EAM, Karta e Atlantikut, OKB, Tre të mëdhenjtë, Blloku perëndimor, blloku Lindor, Lufta e Ftohtë, monopartiak, pluralizëm politik, ekonomi kapitaliste, ekonomi e centralizuar, BE, Plani marshall, NATO, KNER, Traktati i Varshavës, Federata Ballkanike, Lufta e Koresë, kriza e raketave, detanta, disidenca, Partia komuniste kineze, liberalizmi hrushovian, restaurimi brezhnëvian, talebanë, TPE etj.

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhën E DYTË (JANAR-MARS)

Burimet: Interneti. Teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënët(10min)		N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes(25 min)	
		P- PËRFORCIMI Përforcimi(10 min)	
Faza e parë – Parashikimi – parashtrim i ideve Mësuesi/ja e hap orën e mësimi duke shënuar në dërrasë çështjet/idetë që do të diskutohen. Ftohen nxënësit që të shtojnë të tjera ide, sipas nevojave vetjake.			
Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – diskutim i ideve Përmes ideve të rënditura në tabelë, nxënësit diskutojnë mbi paqartësitë që kanë rreth secilës çështje apo ide. Drejtojnë pyetje nëse kanë paqartësi. Idetë që mund të trajtohen janë: – Ngritja e Rusisë dhe fillimet e çështjes Lindore (shek. XVIII – fillimi i shek. XIX). – Pashallëqet shqiptare (gjysma II e shek. XVIII fillimi i shek. XIX) dhe përpjekjet për shkëputje përfundimtare nga Perandoria Osmane. – Revolucioni Francez dhe krijimi i modelit të shtetit komb. – Kongresi i Vjenës dhe restaurimi i Europës pas Napolonit. – Rusia dhe kryengritja serbe. Autonomia e Serbisë brenda Perandorisë Osmane. Pansllavizmi. – Rusia dhe Kryengritja Greke. – Rënia e pashallëqeve shqiptare dhe lindja e çështjes Shqiptare. – Shqiptaret dhe Tanzimati, (1839-1879). Fuqizimi i nacionalizmave ballkanike. – Nacionalizmi shqiptar dhe përpjekjet e para për organizim. – Kërcënimi rus në Ballkan, Perandoria Osmane dhe Kongresi i Berlinit. – Reagimi shqiptar: Lidhja e Prizrenit. – Dokumentet themelore të nacionalizmit shqiptar. – Përpjekjet shqiptare për afirmimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare. – Perandoria Osmane, Perandoria Austro- Hungareze dhe Perandoria Ruse në fillim të shek. XX – Luftërat ballkanike dhe Pavarësia e Shqipërisë – Paqja e Versajës dhe krijimi i rendit të ri botëror. – Rinjohja e shtetit të pavarur shqiptar dhe përcaktimi i kufijve të tij. – Aspekte të organizimit dhe të konsolidimit të shtetit shqiptar (1920-1939). – Aspekte të jetës shoqërore shqiptare dhe elemente të europianizimit të saj (1920-1939). – Interesimi i shtetit amë për shqiptarët jashtë kufijve (1920-1939). – Krijimi i Mbretërisë Serbo-Kroato- Sllovene/Jugosllavisë si shtet shumetnik. – Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhojat e saj në Ballkan. – Fuqitë e Mëdha dhe bashkëpunimi ballkanik: Konferencat e viteve ’30. – Ideologjitë totalitare dhe Ballkani. – Ravijëzimi i blloqeve ndërluftuese dhe momentet kryesore të Luftës së Dytë Botërore. – Përpjekjet për shmangien e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit italian të Shqipërisë – Politikat e pushtuesve italianë dhe gjermanë kundrejt nacionalizmit shqiptar. – Rezistenca shqiptare si pjesë e luftës së Aleateve të Kombeve të Bashkuara kundër Boshtit. – Lëvizjet e rezistencës në Ballkanin Perëndimor (Jugosllavi dhe Greqi). – Diplomacia e Kombeve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1946. Fillimet e Luftës së Ftohtë. – Krijimi i Bllokut Perëndimor. Shqipëria dhe marrëdhëniet me Perëndimin. – Krijimi i Bllokut Lindor. – Shqipëria dhe Jugosllavia (1944-1948). – Shqipëria dhe BRSS (1948-1961). – Marrëdhëniet ndërmjet dy blloqeve			
Faza e tretë: Përforcimi – Konkluzione Në këtë fazë bëhet një organizim i ideve përmes konkluzioneve të nxjerra nga nxënësit, të cilat përcillen me gojë. Mësuesi/ja bën kujdes që gjatë kësaj faze të aktivizojë sa më tepër nxënës, duke synuar pjesëmarrjen edhe të nxënësve që përgjithësisht shfaqin pasivitet.			
Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësim i përgjigjeve me gojë dhe i aftësisë për të punuar në grup, këmbyer dhe komunikuar informacionin.			
Detyra: nuk parashikohen			

Data: ____/____/____

Test për gjimnazin (Periudha e dytë)**Grupi A**

Emër _____ Mbiemër _____

1. Zhvillimin më të madh Rusia e arriti nën drejtimin e: **1 pikë**
 - a. Pjetrit I
 - b. Katerinës II
 - c. Careshës Ana
2. Lidhja Ilirike, ishte një projekt për bashkimin e territoreve të dikurshme ilire i ideuar nga:
 - a. Pashallëku i Beratit
 - b. Pashallëku i Janinës
 - c. Pashallëku i Shkodrës
3. Krijimi i shtet – kombeve në Evropë e mori nxitjen në : **1 pikë**
 - a. Revolucionin Amerikan
 - b. Revolucionin Francez
 - c. Revolucionin Anglez
4. Rendi i Ri European u përcaktua nga vendimet e: **1 pikë**
 - a. Kongresit të Vjenës
 - b. Kongresit të Berlinit
 - c. Konferencës së Helsinkit
5. Cili udhëheqës sovjetikë i dha i pari frymë liberale BRSS? **1 pikë**
 - a. Nikita Hrushovi
 - b. Leonida Brezhnjevi
 - c. Mihail Gorbaçovi
6. Cili prej shteteve të mëposhtme prezantoi një projekt që cënonte sovranitetin e shtetit shqiptar pas LIIB? **1 pikë**
 - a. Jugosllavia
 - b. BRSS
 - c. Greqia
7. Gurthemeli për krijimin e OKB-së ishte: **1 pikë**
 - a. Karta e Atlantikut
 - b. Konferenca e Kazablankës
 - c. Konferenca e Teheranit
8. SHBA u përfshi aktivisht në Luftën e Dytë Botërore pas sulmit të: **1 pikë**
 - a. Japonisë mbi Pearl Harbor
 - b. I Gjermanisë ndaj Polonisë
 - c. I Italisë ndaj Etiopisë
9. Cili prej shteteve të mëposhtme të Ballkanit nuk pati regjim totalitar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore? **1 pikë**
 - a. Bullgaria
 - b. Jugosllavia
 - c. Greqia
10. Në cilin prej këtyre Kongreseve u diskutua për një alfabet të gjuhës shqipe? **1 pikë**
 - a. Kongresi i Manastirit
 - b. Kongresi i Elbasanit
 - c. Kongresi i Dibrës

11. Renditni tre nga vendimet që u morën në Kongresin e Berlinit 1878. **3 pikë**

- a. _____
b. _____
c. _____

12. Listo emrat e “Tre të mëdhenjve” që drejtuan botën gjatë Luftës së Dytë Botërore. **3 pikë**

- a. _____
b. _____
c. _____

13. Si lindi nacionalizmi shqiptar? Cili qe synimi i tij? **3 pikë**

14. Renditni tre nga pasojat e Luftës së parë Botërore: **3 pikë**

- a. _____
b. _____
c. _____

15. Si cenoheshin interesat e shtetit shqiptar në Traktatin e Fshtehtë të Londrës? **3 pikë**

16. Shpjego konceptet. **3 pikë**

Ekonomi e centralizuar _____
Reformat e Tanzimatit _____
Megali idea _____

17. Evidento tri nga vendimet e Kongresit të Lushnjës. **3 pikë**

- a. _____
b. _____
c. _____

18. Krahaso dy shtetet që u bënë pjesë e Luftës së Ftohtë: SHBA dhe BRSS. **4 pikë**

19. Veço tre tipare të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar. **3 pikë**

- a. _____
b. _____
c. _____

20. Trego dy mjetet përmes të cilave SHBA ushtronte kontroll mbi Bllokun Perëndimor. **2 pikë**

- a. _____
b. _____

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 10	11 - 16	17 - 22	23 - 28	29 - 33	34 - 37	38 - 40

Data: ____/____/____

Test për gjimnazin (Periudha e dytë)**Çelësi i zgjidhjes****Teza A**

Emër _____ Mbiemër _____

1. Zhvillimin më të madh Rusia e arriti nën drejtimin e:
a. Pjetrit I
b. Katerinës II
c. Careshës Ana
1 pikë
2. Lidhja Ilirike, ishte një projekt për bashkimin e territoreve të dikurshme ilire i ideuar nga:
a. Pashallëku i Beratit
b. Pashallëku i Janinës
c. Pashallëku i Shkodrës
3. Krijimi i shtet – kombeve në Evropë e mori nxitjen në:
a. Revolucionin Amerikan
b. Revolucionin Francez
c. Revolucionin Anglez
1 pikë
4. Rendi i Ri European u përcaktua nga vendimet e:
a. Kongresit të Vjenës
b. Kongresit të Berlinit
c. Konferencës së Helsinkit
1 pikë
5. Cili udhëheqës sovjetikë i dha i pari frymë liberale BRSS?
a. Nikita Hrushovi
b. Leonida Brezhnjevi
c. Mihail Gorbaçovi
1 pikë
6. Cili prej shteteve të mëposhtme prezantoi një projekt që cënonte sovranitetin e shtetit shqiptar pas LIIB?
1 pikë
a. Jugosllavia
b. BRSS
c. Greqia
7. Gurthemeli për krijimin e OKB-së ishte:
a. Karta e Atlantikut
b. Konferenca e Kazablankës
c. Konferenca e Teheranit
1 pikë
8. SHBA u përfshi aktivisht në Luftën e Dytë Botërore pas sulmit të:
a. Japonisë mbi Pearl Harbor
b. I Gjermanisë ndaj Polonisë
c. I Italisë ndaj Etiopisë
1 pikë

9. Cili prej shteteve të mëposhtme të Ballkanit nuk pati regjim totalitar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore? 1 pikë

- a. Bullgaria
- b. Jugosllavia
- c. **Greqia**

10. Në cilin prej këtyre Kongreseve u diskutua për një alfabet të gjuhës shqipe? 1 pikë

- a. **Kongresi i Manastirit**
- b. Kongresi i Elbasanit
- c. Kongresi i Dibrës

11. Renditni tre nga vendimet që u morën në Kongresin e Berlinit 1878. 3 pikë

- a. **U pakësuan përfitimet politike e territoriale të Rusisë në Ballkan.**
- b. **Ideja e një Principate Bullgare mbeti në fuqi, por me kufij të zvogëluar midis lumit Danub dhe maleve Ballkan.**
- c. **Njohu pavarësinë e Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi.**
- d. **Kufizoheshin përfitimet territoriale të Malit të Zi.**
- e. **Austro- Hungaria fitoi të drejtën për të administruar Bosnjën dhe Hercegovinën.**
- f. **Trojet shqiptare përdorëshin për të plotësuar interesat e Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Etj.**

12. Listo emrat e “Tre të mëdhenjve” që drejtuan botën gjatë Luftës së Dytë Botërore. 3 pikë

- a. **Uinston Çurçill**
- b. **Franklin Ruzvelt**
- c. **Josif Stalin**

13. Si lindi nacionalizmi shqiptar? Cili qe synimi i tij? 3 pikë

Nacionalizmi shqiptar lindi në kushtet e shturjes së marrëdhënieve feudale dhe lindjes së marrëdhënieve kapitaliste. Përmes tij synohej çlirimi i vendit nga pushtuesit osmanë dhe bashkimi i trojeve në një shtet të vetëm. U udhëhoq nga borgjezia dhe çifligarët e borgjezuar, por mbështetja kryesore ishte fshatarësia, e cila ushqente shpresa për çlirim, bashkim dhe zhvillim kombëtar.

14. Renditni tre nga pasojat e Luftës së parë Botërore: 3 pikë

- a. **Ndryshuan raportet ekonomike dhe politike mes shteteve.**
- b. **U shpërbënë tre perandoritë e mëdha: Habsburge, Osmane dhe Ruse.**
- c. **U krijuan shtete të pavarura si Polonia, Letonia, Finlanda dhe Lituania, etj.**

15. Si çënoheshin interesat e shtetit shqiptar në Traktatin e Fshehtë të Londrës? 3 pikë

Italisë i premtuhej aneksimi i Vlorës, Tepelenës, Himarës dhe ishulli i Sazanit si dhe protektorati mbi shtetin e cunguar shqiptar. Shteti shqiptar kufizohej në hapësirën mes lumenjëve Vjosa në jug dhe Mat në veri.

16. Shpjego konceptet. 3 pikë

Ekonomi e centralizuar = Pronat janë të përqëndruara në duart e shtetit. Ai kontrollon dhe drejton zhvillimin ekonomik, duke ndaluar nismën e lirë private.

Reformat e Tanzimatit = përbëjnë një sërë reformash të ndërmarra duke nisur nga viti 1839 nga sulltan Abdyl Mexhiti, me qëllim modernizimin e Perandorisë Osmane.

Megali idea = u quajt platforma nacionaliste greke, e cila zuri fill në kohën e Kryengritjes Greke, sipas të cilës Greqia duhej të zgjerohej edhe me territore jogleke në Epir, Thesali, Maqedoni, Thraki etj.

17. Evidento tri nga vendimet e Kongresit të Lushnjes.

3 pikë

- Hodhi poshtë vendimet e konferencës së paqes për copëtimin e Shqipërisë.
- Mori vendimin për çlirimin e Vlorës nga italianët dhe largimin e tyre nga Shqipëria.
- Miratoi të drejtën për vetëqeverisje pa asnjë kontroll të huaj.
- Nuk njohu qeverinë e Durrësit që ishte nën diktatin italian.
- Zgjodhi një qeveri të përkohshme që ishte e drejtuar nga Sulejman Delvina.
- Zgjodhi Këshillin e Lartë dhe Këshillin Kombëtar.
- U miratua statuti i shtetit shqiptar që përcaktonte si formë qeverisjeje sistemin monarkik parlamentar.

18. Krahaso dy shtetet që u bënë pjesë e Luftës së Ftohtë: SHBA dhe BRSS.

4 pikë

BRSS	Të përbashkëta	SHBA
Mbështetej në Doktrinën Komuniste. Liria individuale i nënshtrohet lirisë së masave dhe shtetit, duke nënkuptuar kufizimin e saj. Demokracia u zëvendësua me sistemin monopartiak, ku partitë e tjera veç P. Komuniste ndaloheshin me ligj. Në komunizëm njeriut iu mohua prona private dhe ai u shndërrua në një shërbëtor të shtetit. Rendi dhe qetësia sigurohen përmes dhunës shtetërore, e cila nënkupton edhe asgjësimin fizik të kundërshtarëve.	Kanë qenë aleatë gjatë LIIB. Ishin dy superfuqitë që dominonin botën gjatë shek. XX. Kishin qenë shtetet që ndanë territoret.	Mbështetej në Doktrinën kapitaliste demokratike. Liria individuale nuk mund të kufizohet nga sistemi. Njeriut i njihen dhe i respektohen liritë dhe të drejtat. Sistemi kapitalist bazohet në parimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike ku konkurrojnë forca të ndryshme politike. Sipas ideologjisë kapitaliste, prona private është e shenjtë dhe e pacenueshme. Në ideologjinë kapitaliste rendi, qetësia dhe paqja sociale sigurohen nëpërmjet zbatimit të ligjit.

19. Veço tre tipare të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar.

3 pikë

- Tregoi virtytet e popullit shqiptar, sidomos atë të besës përmes strehimit dhe mbrojtjes së hebrenjve.
- Ishte një luftë që i'a doli pa ndihmë nga jashtë të çlironte territorin nga pushtuesit.
- Mori tiparet edhe të një lufte civile, për marrjen e pushtetit pas mbarimit të luftës.
- Kontribuoi në disfatën ushtarake të bllokut nazi-fashist etj.

20. Trego dy mjetet përmes të cilave SHBA ushtronte kontroll mbi Bllokun Perëndimor.

2 pikë

- Plani Marshall
- NATO

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 10	11 - 16	17 - 22	23 - 28	29 - 33	34 - 37	38 - 40

Data: ____/____/____

Test për gjimnazin (Periudha e dytë)

Grupi B

Emër _____ Mbiemër _____

1. “Projekti grek” synonte të zëvendësonte dominimin osman në Ballkan me atë rus. Ky projekt u hartua gjatë qeverisjes së: **1 pikë**
 - a. Pjetrit I
 - b. Katerinës II
 - c. Careshës Ana

2. Në kulmin e fuqisë së tij, në të përfshiheshin 7 pashallëqe. Për cilin Pashallëk bëhet fjalë?
 - a. Pashallëkun e Beratit
 - b. Pashallëkun e Janinës
 - c. Pashallëkun e Shkodrës

3. Në cilin prej këtyre revolucioneve u krijua një formë e re qeverisjeje që njihet si Direktorat? **1 pikë**
 - a. Revolucionin Amerikan
 - b. Revolucionin Francez
 - c. Revolucionin Anglez

4. Lufta e Ftohtë mori fund gjatë punimeve të: **1 pikë**
 - a. Kongresit të Vjenës
 - b. Kongresit të Berlinit
 - c. Konferencës së Helsinkit

5. Cili udhëheqës sovjetikë ka fituar çmimin Nobel për paqe? **1 pikë**
 - a. Nikita Hrushovi
 - b. Leonida Brezhnjevi
 - c. Mihail Gorbaçovi

6. Cili prej këtyre shteteve shërbeu si model për krijimin e shtetit totalitar shqiptar? **1 pikë**
 - a. Jugosllavia
 - b. BRSS
 - c. Kina

7. Në cilën prej konferencave “Tre të mëdhenjtë” deklaruan ndihmë për forcat partizane të Titos? **1 pikë**
 - a. Konferenca e Jaltës
 - b. Konferenca e Kazablankës
 - c. Konferenca e Teheranit

8. Lufta e Dytë Botërore filloi si pasojë e sulmit të: **1 pikë**
 - a. Japonisë mbi Pearl Harbor
 - b. Gjermanisë ndaj Polonisë
 - c. Italisë ndaj Etiopisë

9. Cili prej shteteve të mëposhtme të Ballkanit nuk ndoqi modelin stalinist pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore? **1 pikë**
 - a. Bullgaria
 - b. Jugosllavia
 - c. Shqipëria

10. Cili prej këtyre Kongreseve diskutoi dhe vendosi hapjen e një shkolle për përgatitjen e arsimtarëve? **1 pikë**
 - a. Kongresi i Manastirit
 - b. Kongresi i Elbasanit
 - c. Kongresi i Dibrës

11. Renditni tre nga vendimet që u morën në Kongresin e Vjenës 1815. **3 pikë**
 - a. _____
 - b. _____
 - c. _____

- 12.** Listo emrat e shteteve që ishin pjesë e “Boshtit të çeliktë” gjatë LIIB. **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
- 13.** Si u shpall pavarësia e shtetit shqiptar? **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
- 14.** Renditni tre nga shtetet që pretenduan territoret shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike: **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
- 15.** Si përfundoi Lufta e Dytë Botërore? **3 pikë**
- _____
- _____
- _____
- 16.** Shpjego konceptet. **3 pikë**
- Ekonomi kapitaliste _____
- Perde e hekurt _____
- Naçertania _____
- 17.** Evidento tri nga Konferencat Ballkanike të viteve `30. **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
- 18.** Krahajo Bllokun Perëndimor me Bllokun Lindor. **4 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- 19.** Veço tre arsye përse Shqipëria lidhi marrëdhënie me Kinën pasi ndërpreu marrëdhëniet me BRSS-në. **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
- 20.** Trego dy mjetet përmes të cilave BRSS ushtronte kontroll mbi Bllokun Lindor. **2 pikë**
- a. _____
- b. _____

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 10	11 - 16	17 - 22	23 - 28	29 - 33	34 - 37	38 - 40

Data: ____/____/____

Test për gjimnazin(Periudha e dytë)

Çelësi zgjidhjes Teza B

Emër _____ Mbiemër _____

1. “Projekti grek” synonte të zëvendësonte dominimin osman në Ballkan me atë rus. Ky projekt u hartua gjatë qeverisjes së: **1 pikë**
 - a. Pjetrit I
 - b. **Katerinës II**
 - c. Careshës Ana
2. Në kulmin e fuqisë së tij, në të përfshiheshin 7 pashallëqe. Për cilin Pashallëk bëhet fjalë?
 - a. Pashallëkun e Beratit
 - b. **Pashallëkun e Janinës**
 - c. Pashallëkun e Shkodrës
3. Në cilin prej këtyre revolucioneve u krijua një formë e re qeverisjeje që njihet si Direktorat? **1 pikë**
 - a. Revolucionin Amerikan
 - b. **Revolucionin Francez**
 - c. Revolucionin Anglez
4. Lufta e Ftohtë mori fund gjatë punimeve të: **1 pikë**
 - a. Kongresit të Vjenës
 - b. Kongresit të Berlinit
 - c. **Konferencës së Helsinkit**
5. Cili udhëheqës sovjetikë ka fituar çmimin Nobel për paqe? **1 pikë**
 - a. Nikita Hrushovi
 - b. Leonida Brezhnjevi
 - c. **Mihail Gorbaçovi**
6. Cili prej këtyre shteteve shërbeu si model për krijimin e shtetit totalitar shqiptar? **1 pikë**
 - a. Jugosllavia
 - b. **BRSS**
 - c. Kina
7. Në cilën prej konferencave “Tre të mëdhenjtë” deklaruan ndihmë për forcat partizane të Titos? **1 pikë**
 - a. Konferenca e Jaltës
 - b. Konferenca e Kazablankës
 - c. **Konferenca e Teheranit**
8. Lufta e Dytë Botërore filloi si pasojë e sulmit të: **1 pikë**
 - a. Japonisë mbi Pearl Harbor
 - b. **Gjermanisë ndaj Polonisë**
 - c. Italisë ndaj Etiopisë
9. Cili prej shteteve të mëposhtme të Ballkanit nuk ndoqi modelin stalinist pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore? **1 pikë**
 - a. Bullgaria
 - b. **Jugosllavia**
 - c. Shqipëria

10. Cili prej këtyre Kongreseve diskutoi dhe vendosi hapjen e një shkolle për përgatitjen e arsimtarëve? **1 pikë**

- a. Kongresi i Manastirit
- b. **Kongresi i Elbasanit**
- c. Kongresi i Dibrës

11. Renditni tre nga vendimet që u morën në Kongresin e Vjenës 1815. **3 pikë**

- a. **Franca u rikthye në kufijtë e vitit 1789.**
- b. **Franca humbi territore dhe duhej të paguante dëmshpërblimin dhe të kthente veprat e grabitura gjatë periudhës napoleoniane.**
- c. **U përcaktua harta e re politike e Evropës.**
- d. **U krijua Lidhja e Shenjtë. etj**

12. Listo emrat e shteteve që ishin pjesë e “Boshtit të çeliktë” gjatë LIIB. **3 pikë**

- a. **Gjermani**
- b. **Itali**
- c. **Japoni**

13. Si u shpall pavarësia e shtetit shqiptar? **3 pikë**

Shpërthimi i Luftës së Parë Ballkanike më 1912 nxori në pah rrezikun e copëtimit përfundimtar të trojeve shqiptare midis shteteve të Aleancës Ballkanike. Përballë këtij rreziku patriotët shqiptarë me në krye ismail Qemalin vendosën të deklarojnë shpalljen e pavarësisë në trojet e banuara nga shqiptarë më 28 nëntor 1912.

14. Renditni tre nga shtetet që pretenduan territoret shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike: **3 pikë**

- a. Mali i Zi
- b. Greqia
- c. Serbia

15. Si përfundoi Lufta e Dytë Botërore? **3 pikë**

Në 8 maj 1945 kapitulloi Gjermania, pas izolimit në berlinin nga forcat anglo-amerikane në perëndim dhe ato sovjetike në lindje. Pas hedhjes së bombave në Hiroshima dhe Nagasaki, respektivisht në 6 dhe 9 gusht, Japonia u detyrua të pranonte kapitullimin pa kushte më 15 gusht 1945. Lufta mori fund në 2 shtator 1945.

16. Shpjego konceptet. **3 pikë**

Ekonomi kapitaliste = konsiston në mbrojtjen e pronës private dhe nxitjen e iniciativës së lirë. Shteti luan rolin e rregullatorit dhe jo të kontrolluesit të ekonomisë.

Perde e hekurt = u quajt në mënyrë metaforike nga ana e U. Çurçill, vija që lidhte Detin Balltik dhe atë Adriatik duke ndarë dy sistemet ideologjike: komuniste dhe kapitaliste.

Naçertania = E ideuar nga Ilia Garashanin, ajo përbën projektin e nacionalizmit serb, në thelb të të cilit qëndronte uniteti serbo-malazez dhe aneksimi i Bosnje-Hercegovinës, duke i siguruar Serbisë dalje në Adriatik.

17. Evidento tri nga konferencat ballkanike të viteve `30: **3 pikë**

- a. **Konferenca e parë Ballkanike në Athinë, 1930.**
- b. **Konferenca e Dytë Ballkanike në Stamboll, 1931.**
- c. **Konferenca e Tretë Ballkanike në Bukuresht, 1932.**
- d. **Konferenca e Katërt Ballkanike në Selanik, 1933.**

18. Krahazo Bllokun Perëndimor me Bllokun Lindor.

4 pikë

Blloku Lindor	Të përbashkëtat	Blloku Perëndimor
Dominonte ideologjia marksiste-leniniste, e cila kishte prodhuar regjime totalitare ku respektohej dhe nderohej kulti i individit dhe partia –shtet. Ekonomia ishte e planifikuar, çka nënkuptonte kontrollin e plotë të shtetit mbi pronën. Prona private u likujdua dhe shteti kontrollonte deri në prodhim e shpërndarje sistemin ekonomik. Mohoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut, pavarisisht legjislacioneve që i “shprehnnin” ato. Përdorej dhuna dhe propaganda në indoktrinimin e ideologjisë komuniste. Censura ishte prezente dhe mjaft e rreptë në çdo fushë të jetës. Niveli i ulët i jetesës, pengimi i besimit të lirë fetar, kufizimi i lëvizjes së lirë. Etj	Përballje indirekte në Krizën e Koresë, Krizën e raketave etj. Ulja e tensioneve mes dy blloqueve njihet si detanta ose bashkëekzistenca paqësore. Etj	Dominonte qeverisja demokratike, e cila mbështetej mbi parimet e shtetit të së drejtës, pluralizmit politik dhe ekonomisë së tregut. Ekonomia e tregut të lirë, vlerësonte si parësore dhe të shenjtë pronën private. Nxiteshin investimet e lira dhe shteti luante rol rregullator në raste krizash ekonomike. Liritë dhe të drejtat e njeriut garantoheshin me ligj dhe respektoheshin në praktikë. Dëhohej përdorimi i dhunës dhe propagandohej përdorimi i mjeteve paqësore në zgjidhjen e konflikteve. Njërëzit ishin të lirë të shprehnnin mendimin e tyre në çdo fushë të jetës, pa ndjerë censurën. Papunësi dhe probleme të herë pas hershme me protestat e punëtorëve. Rritje e shkallës së kriminalitetit dhe degjeneremi moral i shoqërisë. etj

19. Veço tre arsye përse Shqipëria lidhi marrëdhënie me Kinën pasi ndërpreu marrëdhëniet me BRSS-në.

3 pikë

- Ndërprerja e marrëdhënieve me BRSS, sillte nevojën urgjente të një aleati.
- Të dy shtetet kishin të njëjtën ideologji sunduese.
- Shqipëria kishte nevoja urgjente financiare, ushtarake dhe për specialistë.
- Kina ndodhej larg dhe nuk cënonte sovranitetin territorial të Shqipërisë.

20. Trego dy mjetet përmes të cilave BRSS ushtronte kontroll mbi Bllokun Lindor.

2 pikë

- KNER.
- Pakti i Varshavës.
- Byroja informative e partive komuniste.

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 10	11 - 16	17 - 22	23 - 28	29 - 33	34 - 37	38 – 40

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Kina brenda dhe jashtë blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë		Situata e të nxënësve: Nxënësve u shfaqen imazhe të “tank man = njeriut tank”, i cili është bërë simbol i protestës antikomuniste në sheshin Tien an Men në vitin 1989. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këtij simboli.	
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton situatën në Kinë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, marrjen e pushtetit nga komunistët dhe rolin e Kinës në Bllokun Lindor të udhëhequr nga BS-ja. - Evidenton veçantitë e komunizmit kinez. - Shpjegon marrëdhëniet kineze-sovjetike, duke dalluar fazat e ndryshme deri në prishjen e tyre. - Analizon politikën e jashtme të Kinës dhe përpjekjet e saj për afrimin me SHBA-në dhe Perëndimin.		Fjalët kyçe: Partia Komuniste Kineze, sistemi sovjetik stalinist i ekonomisë, “njëqind lule”, sheshi Tien An Men, edukimi socialist, revolucioni kulturor, Bota e Tretë.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënës (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – diskutim U tregohet nxënësve imazhi “tank man”. Pasi u jepet një informacion i shkurtër mbi imazhin, nxitet diskutimi të nxënësve rreth këtij simboli të demonstratave antikomuniste në Kinë. Gjatë diskutimit nxënësit mund të ofrojnë idetë e tyre mbi fatin e “tank man” pas protestës që kreu.			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik i informacionit Mësuesi/ja zgjedh të përcjellë të nxënësve informacionin e ri përmes organizuesit grafik.			

Kina pas Luftës II Botërore	Komunizmi kinez	Politika e jashtme kineze
• U vendos regjimi komunist, nën drejtimin e Mao Ce Dun. • U aplikua modeli stalinist i ekonomisë. Që nga viti 1950 u realizua Reforma Agrare, shtetëzimi i pronave, aplikimi i planeve 5-vjeçare etj. • Në vitin 1956, Mao Ce Dun shpali vizionin e ri socialist. Filloi Fushata e “100 luleve”. • Pas vitit 1958 filloi distancimi nga BRSS.	• Është shoqëruar nga një luftë e krahut të majtë dhe krahut të djathtë brenda PKK. • Karakterizohet nga kontrolli i plotë i jetës së vendit nga PKK. • Nuk është lejuar asnjë lloj forme disidence. • Aplikimi i “Revolucionit kulturor” pengoi krijimin e një elite intelektuale e të pasur që do të ndikonte në demokratizim dhe emancipim. • Kina nuk mori pjesë as në KNER, as në Traktatin e Varshavës.	• Pati probleme me fqinjët për zonat e influencës (Indinë, BS, Vietnam). • Problemi më i madh ishte ai i bashkimit të Kinës me Tajvanin. • Pas prishjes së marrëdhënieve me BRSS-në, rriti influencën në shtetet e paangazhuara-lindi teoria e “Botës së tretë”. • 1971, nis komunikimi diplomatik me SHBA-në. • Aktualisht është një faktor i rëndësishëm në arenën ndërkombëtare.

Faza e tretë: Përforsimi – linjë kronologjike

Gjatë kësaj faze, pasi kanë rilexuar edhe njëherë informacionin në tekst, nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me linjën kronologjike, duke evidentuar në fletoret e tyre pikat më kulminante të marrëdhënieve mes Kinës dhe dy superfuqive të shek. XX, sipas modelit.

Viti	BRSS	SHBA
1950	Filloi aplikimi i modelit stalinist	Acarim i marrëdhënieve për shkak të Tajvanit
1958		
1959		
1961		
1971		
1972		
1989		

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Vëreni fotot dhe interpretoni.

Cila është lidhja e tyre me rolin e Kinës brenda dhe jashtë blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë?

Po me revolucionin kulturor?

Çfarë mesazhi përcjellin për ju? Formuloni përfundimet tuaja.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shqipëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shqipëria dhe Kina		Situata e të nxënit: Në videoprojektor shfaqet kronika e shkurtër në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-kineze gjatë komunizmit, sipas gazetës “New York Times” https://www.youtube.com/watch?v=YIZYXXpYtPg Bëhet një diskutim i shkurtër rreth materialit audio-vizual.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Analizon raportet shqiptaro-kineze dhe identifikon arsyet e forcimit të tyre, sidomos në vitet ‘60 të shek. XX. • Vë në dukje bashkëpunimin ekonomik dhe ndihmën kineze për zhvillimin e Shqipërisë. • Shpjegon reflektimin e Revolucionit të Madh Kulturor kinez në Shqipëri. • Arsyeton mbi shkaqet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe pasojat e saj mbi ekonominë dhe politikën shqiptare.		Fjalët kyçe: Blloku Lindor, OKB, Revolucioni Kulturor, Lufta e Klasave, njeriu i ri socialist, Mësim-Punë prodhuese-Edukim fizik dhe ushtarak, propaganda komuniste, marksizëm-leninizëm, Bota e Tretë, izolimi i vendit, ndërtimi i socializmit me forcat tona, tufëza, racionim.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Gjatë kësaj faze risillen ndër mend dhe komunikohen në klasë njohuritë në lidhje me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kinës gjatë periudhës komuniste.			
↑ ← Shqipëria dhe Kina → ↓			


Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabela kronologjike

Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi. Pas kësaj u shpërndan nxënësve fleta me modelin e tabelës kronologjike. Udhëzon nxënësit për plotësimin e secilës prej kërkesave në tabelë dhe ndjek nga afër punën e secilit nxënësi. Mund të përdoret ky model i tabelës kronologjike.

Marrëdhëniet Shqipëri-Kinë	Fazat e bashkëpunimit	Ndihma kineze për Shqipërinë	Revolucioni kulturor në Shqipëri	Investime në vend me ndihmën e kinezëve	Arsyet e bashkëpunimit dhe arsyet e prishjes së marrëdhënieve diplomatike.
	-Etapa e neutralitetit (1945-1961). -Etapa e bashkëpunimit (1961-1978). -Etapa e prishjes së marrëdhënieve (1978-1990)	-Tre marrëveshje ekonomike (1961, 1966, 1970). -Ndihma me drithëra, pajisje, teknologji, uzina, specialistë kinezë etj.			

Faza e tretë: Përforsimi – pyetja binare

Në këtë fazë i nxis nxënësit të marrin pjesë në diskutimin rreth pyetjes binare:



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Ndikimin e Revolucionit të Madh Kulturor Kinez në vendbanimin tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Zhvillimet brenda blloqeve - Blloku Lindor		Situata e të nxënit: KNER dhe Traktati i Varshavës u krijuan me iniciativën e BS dhe dominuan Bllokun Lindor pas Luftës II Botërore. Si i gjykoni ju: Si organizma që duan t'i kundërvihen demokracisë apo si mekanizma për të rritur influencën e Moskës? Diskutoni.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton arsyet e zhvillimit të shpejt ekonomik-shoqëror të Europës Perëndimore në periudhën e pasluftës. - Vlerëson rolin intelektual në përparimin e sistemit dhe vlerave demokratike, si dhe rritjen e nivelit të emancipimit të shoqërisë Perëndimore. - Tregon tensionet ekonomiko-shoqërore në Europën Perëndimore, SHBA dhe shpjegon përpjekjet për kapërcimin e tyre.		Fjalët kyçe: Blloku Lindor, Blloku Perëndimor, nacional-komunizmi, liberalizmi hrushovian, restaurimi brezhnjevian, Byroja Informative e Partive Komuniste, Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke, kontrolli politik, kontrolli ekonomik, shpronësimi dhe shtetëzimi i pronës private, kolektivizimi i bujqësisë, centralizimi i ekonomisë, kontrolli ushtarak, Traktati i Varshavës, kulti i Stalinit, kolkoze, bashkekzistencë paqësore, sovranitet i kufizuar, talebanë.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforsimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Mësimi hapet përmes teknikës braingstorming, në lidhje me tiparet e Bllokut Lindor			
Tiparet e Bllokut Lindor			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive - punë me tekstin - organizim i informacionit

Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi para se të fillojë shpjegimin. I vendos nxënësit të lexojnë mësimin e ri për gati 3-4 minuta. Gjatë kësaj kohe, mësuesi/ja përfiton dhe shkruan në tabelë disa ide kryesore për çështjet kryesore të mësimi.


Blloku Lindor, një strukturë e fortë kontrolli nga ana e BRSS

- Kontrolli i BRSS në Bllokun Lindor shtrihej në ekonomi, politikë dhe ushtri.
- Kontrolli ushtrohej përmes partive komuniste dhe organizmave të tjerë si Byroja Informative e Partisë Komuniste.
- Ndryshimi i udhëheqësit në BRSS shoqërohej edhe me ndryshimin e tyre vendet e Bllokut.
- Ekonomia kontrollohej përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe KNER-it.
- Huatë dhe kreditë gjithashtu përdorehin për të vënë nën kontroll shtetet.
- Përmes Traktatit të Varshavës kontrolloi edhe anën ushtarake të vendeve.

Liberalizmi hrushovian	-Filloi të aplikojë në vitin 1954 me ardhjen në pushtet të N. Hrushovit. -Tiparet në planin e brendshëm: zbuti luftën e klasave, liroi të burgosurit politikë, - dënoi kultin e Stalinit, filloi hapjen e PKBS etj. -Në kulturë i dha më shumë liri artit dhe letërsisë antistaliniste. -Filloi hapjen për bashkëpunim me Perëndimin=bashkekzistenca paqësore. -U këmbyen vizita diplomatike mes R.Nikson dhe N.Hrushovit (1959). -Në ekonomi iu dha më shumë liri veprimi ndërmarrjeve dhe kolkozeve. -Filloi rivaliteti kozmik me SHBA-në.
Restaurimi brezhnjevian	-Anuloi reformat e Nikita Hrushovit. -Rriti kontrollin mbi vendet e Bllokut Lindor. -Në vitin 1968, trupat ushtarake të Traktatit të Varshavës ndërhyjnë në Çekosllovakia, - për të përmbysur me forcë udhëheqësin reformator A. Dubçek. -Ai hodhi tezën e “soveranitetit të kufizuar”. -Braktisi “bashkekzistencën paqësore” të Hrushovit. -Filloi luftën në Afganistan.
Përpijekjet për shkëputje	-Grevat e punëtorëve polakë të Poznanit. -Protesta studentore në Budapest (1956) që solli në pushtet Imre Nagin. -Në të dyja rastet humbjet njerëzore ishin të larta.

Faza e tretë: Përforsimi – diagram veni

Gjatë kësaj faze, nxënësit i thellojnë më tej njohuritë e marra përmes diagramit të venit: Liberalizmi hrushovian/restaurimi brezhnjevian.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Format dhe instrumentet e kontrollit të Bllokut Lindor nga ana e BS-së.
- Pasqyrimin e liberalizmit hrushovian dhe restaurimit brezhnjevian në situatën e brendshme të vendeve anëtare të Bllokut Lindor.
- Karakterin e nacional-komunizmit të disa prej vendeve të Bllokut Lindor për të fituar një autonomi më të madhe nga kontrolli sovjetik. (Nxënësit zgjedhin të realizojnë njërin nga kërkesat e detyrës).

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Zhvillimet brenda blloqeve - Blloku Perëndimor		Situata e të nxënit: Vendosen në tabelë imazhet e tre figurave të njohura historike: Margaret Theçer, Martin Luter King dhe Xhorxh Marshall. Nxënësve u drejtohen këto pyetje: 1. Kush janë këto figura historike? 2. Cila është pesha që ata mbajnë në historinë e Bllokut Perëndimor?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton arsyet e zhvillimit të shpejt ekonomiko-shoqëror të Europës Perëndimore në periudhën e pasluftës. - Vlerëson rolin intelektual në përparimin e sistemit dhe vlerave demokratike, si dhe rritjen e nivelit të emancipimit të shoqërisë Perëndimore. - Tregon tensionet ekonomiko-shoqërore në Europën Perëndimore, SHBA dhe shpjegon përpjekjet për kapërcimin e tyre.		Fjalët kyçe: Blloku Perëndimor, Plani Marshall, Lufta e Dytë Botërore, Partia Laburiste, Tregu i Përbashkët European (TPE), Bashkimi European (BE), afro-amerikanë, Lufta e Vietnamit, kastë oligarkiko-financiare, brigadat e kuqe, lëvizja feministe, lëvizja e “hipive”.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi - brainstorming Mësimi hapet përmes evokimit të njohurive në lidhje me Bllokun Perëndimor. Blloku Perëndimor			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i pavarur – pyetja sjell pyetjen Gjatë kësaj faze, mësuesi udhëzon nxënësit që gjatë leximit të pavarur të tekstit në faqet 262-264, të punojnë për gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që u jepen. Pas secilës përgjigje vjen një pyetje e re dhe pas saj një tjetër përgjigje e kështu me radhë. Nxënësit mund të punojnë në dyshe për rezultate më të shpejta dhe cilësore.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E TRETË (PRILL-QERSHOR)



Faza e tretë: Përforsimi – tabelë konceptesh

Pasi është përmbyllur me sukses faza e dytë e mësimit, në dërrasë mësuesi/ja dhe në fletore nxënësit realizohet tabela e koncepteve sipas modelit:

Kërkesa	Francë	RFGJ	Britani	SHBA
Tiparet ekonomike				
Tiparet politike				

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Lëvizjet e të rinjve në Bllokun Perëndimor.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Tipare të artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në dy blloqet kundërshtare		Situata e të nxënit: Dëgjohet kënga “Thw wind of change”. https://www.youtube.com/watch?v=-V022x8XYc8 Disa fraza të saj shkruhen në tabelë dhe hapet diskutimi: Si mund të ndikojë muzika në emancipimin social?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi: • Krahason rolin e njerëzve të artit, kulturës e shkencës në shoqërinë e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor. • Analizon rolin e arsimit në vendet e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor, duke evidentuar diferencat e mundshme mes tyre. • Shpjegon konceptin “disidencë” dhe evidenton format e mjetet e shprehjes së saj në Bllokun Lindor.		Fjalët kyçe: Blloku Perëndimor, ekzistencializmi, absurditeti, realizmi magjik, ekspresionizmi abstrakt, arti pop, Bitëllsat, Rolling Stone, Blloku Lindor, censurë, disidentë, parti-shtet.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – diskutim Në këtë fazë u prezantohet nxënësve situata e të nxënit. Pasi dëgjohet kënga “Thw wind of change”, hapet diskutimi rreth pyetjes: Si mund të ndikojë muzika në emancipimin social?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – lexim i pavarur – diagram veni Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi. I orienton që gjatë leximit të vënë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë në zhvillimin e artit, kulturës, arsimit e shkencës mes dy blloqeve, për të plotësuar më pas diagramin e venit.			

Blloku Lindor	Të përbashkëtat	Blloku Perëndimor
Arti dhe kultura i nënshtroheshin kontrollit të partisë-shtet që aplikonte edhe censurën për veprat e cilësuar të padenja për regjimin. Në letërsi dhe pikturë pasqyroheshin arritjet e njeriut të ri socialist, demaskoheshin armiqtë dhe nxitej lufta e klasave.	Në të dyja zonat pati një zhvillim të fushave të artit. Artistë të mëdhenj jetuan e lanë pas veprat e tyre.	U shfaqën rryma të reja në art dhe letërsi, si: ekzistencializmi, realizmi magjik, ekspresionizmi abstrakt. Një nga degët që u zhvillua me shpejtësi ishte kinematografia, si një industri më vete. Muzika njohu një revolucion të vërtetë. Arti dhe kultura zhvilloheshin edhe si iniciativa shtetërore, ashtu dhe private.

Shkenca u zhvillua në ato drejtime që i interesonte regjimit, duke iu nënshtruar një kontrolli të rreptë shtetëror. Fushat kryesore ishin ushtria dhe hapësira.	Zhvillimi shkencor u vu mbi baza konkurruese edhe në funksion të Luftës së Ftohtë.	Shkenca mori një zhvillim të madh pas Luftës II Botërore, në sajë të sistemit arsimor, i cili ishte në gjendje të kultivonte talentin dhe të nxiste krijimtarinë. Universitet u shndërruan në qendra të kërkimit shkencor, duke stimuluar edhe nga ana financiare kërkuesit.
Për mbajtjen nën kontroll të krijimtarisë artistike, regjimet komuniste shpikën “artin dhe kulturën e realizmit socialist”, që shërbente si manual i krijimtarisë artistike, me anë të së cilës krijuesit duhej t’i shërbenin regjimit. Edhe ata pak shkrimtarë dhe artistë, të cilët guxuan në veprat e tyre të pasqyronin realitetin e regjimit komunist dhe aspekte negative të tij, përfunduan në shumicën e tyre në burg, duke i mbyllur kështu rrugën çdo mundësie për disidencë.	Emigrimi i trurit i preku të dy blloqet, por ai Lindor pati humbje, ndërsa ai Perëndimor përfitime.	Shtetet në përfundim jo vetëm që nuk vendosën nën kontroll krijimtarinë në të gjitha fushat, por u bënë edhe nxitëse të zhvillimit të tyre përmes financimeve, shpërblimeve dhe lirshmërisë në të vepruar.

Faza e tretë: Përforsimi – bashkëbisedim

Gjatë kësaj faze, orientohet biseda drejt tipareve të artit, kulturës, arsimit dhe shkencës në Shqipërinë komuniste si pjesë e Bllokut Lindor.

Nxënësit mund të sjellin shembuj të censurës shtetërore në fusha të ndryshme dhe shfaqjeve të disidencës.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Rolin e njerëzve të artit, kulturës e shkencës në shoqërinë e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor.
- Rolin e arsimit në vendet e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor.
- Diferencat e arsimit midis dy blloqeve.
- Elitën “disidente” në Bllokun Lindor.

(Nxënësi zgjedh të realizojë njërin prej kërkesave të detyrës).

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Vetizolimi i Shqipërisë		Situata e të nxënit: Shfaqen dy imazhe: 1. “Radha për ushqime në dyqane” 2. “Tollon” Nxiten nxënësit për diskutim përmes pyetjes: Si e përcjellin vetizolimin e Shqipërisë komuniste, këto imazhe?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon arsyet e thellimit të izolimit ndërkombëtar të Shqipërisë nga fundi i viteve ‘70 të shek. XX. • Analizon karakterin autarkik të shtetit komunist dhe pasojat e vetizolimit në jetën dhe ekonominë e vendit. • Vë në dukje ndikimin e vetizolimit në krizën e gjithanshme të regjimit komunist. • Evidenton përpjekjet e Ramiz Alisë për të dalë nga kriza dhe për të vendosur e thelluar bashkëpunimin rajonal.		Fjalët kyçe: Vetizolim, Blloku Lindor, imperializmi amerikan, social-imperializmi sovjetik, pronë personale, Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin European (OSBE).	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Faza e parë: Parashikimi - bashkëbisedim Në këtë fazë nxitet bashkëbisedimi nxënës-mësues-nxënës përmes situatës së të nxënit. Pasi janë shfaqur imazhet: • Radha për ushqime • Tollon Hapet biseda përmes pyetjes: Si e përcjellin vetizolimin e Shqipërisë komuniste këto imazhe?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik i informacionit Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe më pas e përcjell informacionin e ri, përmes organizuesit grafik. Shpesh mësuesi kërkon ndërhyrjen e nxënësve nëpërmjet pyetjeve frontale me përgjigje të shkurtra.			

Vetizolimi i Shqipërisë në fund të viteve 70

Vetizolimi i plotë filloi pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën në vitin 1978. Enver Hoxha i shpalli luftë imperializmit amerikan, social-imperializmit sovjetik dhe tradhtarëve kinezë. Pa asnjë mbështetje nga jashtë, vendi hyri në një krizë pa rrugëdalje. U aplikuan zgjidhje të tilla, si: mbjellja e misrit me kubikë, krijimi i tufëzimit dhe arrëzave të përbashkëta, të cilat i dhanë goditjen e fundit zhvillimit ekonomik, në vend që ta përmirësonin. Filloi kriza e tregut, e cila u vu në pah me racionimin e produkteve bazë. Për t'i shkëputur shqiptarët nga kriza, E. Hoxha përdorte propagandën e një sulmi nga jashtë, duke e shoqëruar me përgatitje ushtarake dhe bunkerizim. Kriza nuk anashkaloi edhe spastrimet politike përmes akuzave, dhunës psikologjike dhe eliminimit fizik (Mehmet Shehu, Beqir Balluku, Kadri Hazbiu etj).

Përpjekje për të dalë nga kriza

Hapja e marrëdhënieve ekonomike-tregtare me fqinjët, Jugosllavinë dhe Greqinë, përmes nënshkrimit të disa marrëveshjeve gjatë viteve 80. Në v. 1984, u nisën bisedimet për përmirësimin e marrëdhënieve me RFGJ-në, përmes vizitës së kryeministrit të landit të Bavarisë, Franc Jozef Shtraus. Ramiz Alia u përpoq të lejonte lirshmëri në administrimin e ndërmarrjeve dhe kooperativave, por pa rezultat. Ramiz Alia deklaroi në vitin 1990 se vendi ishte gati të vendoste marrëdhënie me SHBA dhe BRSS. Pas vizitës së sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në maj 1990, Shqipëria ishte gati për t'u anëtarësuar në OSBE. Qershor 1990, kongresmeni amerikan Tom Lantosh viziton Shqipërinë. 2 korrik 1990, Ramiz Alia pranon kërkesat e protestuesve nisur nga ngjarjet e ambasadave dhe manifestimeve në Kavajë, Shkodër etj. 1991, Ramiz Alia merr pjesë në punimet e OKB-së.

Faza e tretë: Përforsimi - linja e kohës

Në këtë fazë, nxënësit plotësojnë linjën e kohës për ngjarjet që ishin dominuese të jetës politike në Shqipërinë e vetizolimit.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Gjendjen ekonomike dhe shoqërore të banorëve të vendbanimit tuaj në periudhën e vetizolimit.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përfundimi i Luftës së Ftohtë (Ora e parë)		Situata e të nxënit: <i>“Sekretari i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqen, nëse kërkon begatinë për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, nëse kërkon liberalizimin: Eja këtu, te kjo portë! Z. Gorbaçov, hape këtë portë! Z. Gorbaçov, shembe këtë mur!”</i> Ky është një fragment nga fjalimi që presidenti amerikan Ronald Regan mbajti në Berlin më 12 qershor 1987.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan konkurrencën e gjithanshme mes blloqeve në periudhën e pasluftës. • Evidenton rëndësinë e Konferencës së Helsinkit si moment i rëndësishëm i bashkëpunimit mes blloqeve kundërshtarë. • Gjykon mbi rolin e lëvizjeve kundër regjimeve komuniste në liberalizimin relativ të disa prej vendeve të Bllokut Lindor. • Vlerëson ardhjen në krye të BS-së të Mikail Gorbaçovit dhe frymën reformiste të sjellë prej tij në BS dhe në Bllokun Lindor në përgjithësi. • Analizon arsyet e rënies së Bllokut Lindor dhe të përfundimit të Luftës së Ftohtë.		Fjalët kyçe: Luftë e Ftohtë, Konferenca e Helsinkit, ekonomi e lirë kapitaliste, ekonomi e centralizuar socialiste, stanjacion, NATO, Traktati i Varshavës, Solidarnost, Muri i Berlinit, pluralizmi politik.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
--	--	---

Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim

Gjatë kësaj faze këmbëhen mendime në lidhje me pjesën e shkëputur nga fjalimi i Ronald Regan, që prezantohet përmes situatës së të nxënit.

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – ditari dypjesësh – lexim i orientuar

Mësuesi/ja prezanton në dërrasë temën e re mësimore, përmes ditarit dypjesësh. Informacioni organizohet hap pas hapi, ndërkohë që nxënësit mbajnë shënime.

Çështja	Komenti
Konkurrencë e gjithanshme ekonomike	Konkurrenca mes dy sistemeve/blloqeve politike ishte e gjithanshme dhe u shpreh përmes: - garës së armatimeve; - garës ekonomike, duke nxjerrë në pah epërsinë e ekonomisë kapitaliste ndaj ekonomisë së centralizuar; - garës teknologjike, ku përmes shpikjeve vendet kapitaliste njohën ritme të shpejta zhvillimi. Ndërsa në vendet e Lindjes teknologjia e vjetruar u bë shkak për stanjacionin e zgjatur ekonomik.

Konferenca e Helsinkit	Konferenca i filloi punimet në vitin 1973 dhe më 1 gusht 1975 nënshkroi aktin final, i cili solli krijimin e OSBE-së. Aty morën pjesë 35 shtete, nën drejtimin e SHBA-së. Kjo ishte e para konferencë që kur kishte nisur Lufta e Ftohtë, ku morën pjesë përfaqësues të dy blloqeve. Diskutimet mes palëve zgjatën dy vjet dhe në fund ranë dakord të nënshkruanin një marrëveshje, sipas së cilës shtetet pjesëmarrëse: i respektojnë njëri-tjetrit të drejtën e barazisë dhe individualitet, të drejtën e sovranitetit në aspektin kombëtar e ndërkombëtar, në marrëdhëniet mes tyre heqin dorë nga përdorimi i forcës, respektojnë integritetin territorial të njëri-tjetrit, respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, respektojnë të drejtat e popujve për vetëvendosje, respektohet kontributi i minoriteve në zhvillimin e bashkëpunimit mes fushave etj. Rëndësia e Konferencës dhe krijimi i OSBE-së është i madhi, pasi shënohet fundi i Luftës së Ftohtë. OSBE, përveç rolit të sigurisë, luan rol të veçantë në bashkëpunimin e shteteve pjesëmarrëse dhe promovimin e lirive e të drejtave të njeriut.
Lëvizjet antiregjim	– Në 1980, në Poloni u krijua Solidarnosti, e udhëhequr nga Les Valesa, e cila organizoi protestat kundër regjimit diktatorial. – Në krye të BRSS erdhi Mihail Gorbaçov, i cili aplikoi reformat modernizuese të Gllasnosit dhe Perestrojkës. Përmes tyre u synua ristrukturimi i ekonomisë dhe rinovimi i udhëheqjes, duke i dhënë një frymë liberalizuese. – Muri i Berlinit ra dhe Gjermania u bashkua. – 1989, gjatë një takimi në Maltë, Xhorxh Bush dhe Gorbaçov i dhanë fund zyrtarisht Luftës së Ftohtë.
Rënia e Bllokut Lindor	– Ky proces ndodhi në vitet 1989-1991. – Në kushtet kur qeveritë komuniste u përpoqën ta mbanin pushtetin përmes reformave me karakter liberal, intelektualët u dyndën në sheshe duke protestuar. – Përballë protestave qeveritë komuniste lejuan pluralizmin politik. – U zhvilluan zgjedhjet e lira dhe demokratike, që shënuan ndryshimin e pushtetit. – Në rënien e tij u vunë re dy modele: ai paqësor dhe ai me dhunë. Në të dy rastet, faktorët ndikues ishin: 1. Dështimi i sistemit socialist sidomos në ekonomi. 2. Klima e favorshme në politikën e jashtme pas Konferencës së Helsinkit. 3. Ardhja në pushtet e Gorbaçovit solli një frymë të re në qeverisjen sovjetike.

Faza e tretë: Përforcimi – ndarja e grupeve

Duke qenë se ky mësim do të realizohet në dy orë mësimore, në këtë fazë ndahen nxënësit në grupe dhe u caktohen detyrat për prezantim në orën vijuese.

Grupi i parë – Paraqitja e fakteve konkrete për konkurrencë mes blloqeve në fusha të ndryshme.

Grupi i dytë – Konferenca e Helsinkit, ideja, pjesëmarrësit, marrëveshjet, krijimi i OSBE, rëndësia.

Grupi i tretë – Roli i Solidarnosit në transformimet politike të Polonisë.

Grupi i katërt – Rënia e Murit të Berlinit, bashkimi i Gjermanisë.

Grupi i pestë – Mihail Gorbaçov, njeriu që ndau BRSS-në, bashkoi botën dhe mori Çmimin Nobel.

Grupi i gjashtë – Pikat kulmore, rënia e regjimeve në vendet komuniste, në fokus Shqipëria.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Nuk parashikohen.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përfundimi i Luftës së Ftohtë (Ora e dytë)		Situata e të nxënit: “Sekretari i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqen, nëse kërkon begatinë për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, nëse kërkon liberalizimin: Eja këtu, tek kjo portë! Z. Gorbaçov, hape këtë portë! Z. Gorbaçov, shembe këtë mur!” Ky është një fragment nga fjalimi që presidenti amerikan Ronald Regan mbajti në Berlin më 12 qershor 1987.	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Përshkruan konkurrencën e gjithanshme mes blloqeve në periudhën e pasluftës. • Evidenton rëndësinë e Konferencës së Helsinkit si moment i rëndësishëm i bashkëpunimit mes blloqeve kundërshtarë. • Gjykon mbi rolin e lëvizjeve kundër regjimeve komuniste në liberalizimin relativ të disa prej vendeve të Bllokut Lindor. • Vlerëson ardhjen në krye të BS-së të Mikail Gorbaçovit dhe frymën reformiste të sjellë prej tij në BS dhe në Bllokun Lindor në përgjithësi. • Analizon arsyet e rënies së Bllokut Lindor dhe të përfundimit të Luftës së Ftohtë.		Fjalët kyçe: Luftë e Ftohtë, Konferenca e Helsinkit, ekonomi e lirë kapitaliste, ekonomi e centralizuar socialiste, stanjacion, NATO, Traktati i Varshavës, Solidarnost, Muri i Berlinit, pluralizmi politik.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	

Faza e parë: Parashikimi - kontroll i njohurive - pyetjet frontale

Gjatë kësaj faze, mësuesi/ja bën një kontroll të shpejtë frontal në lidhje me njohuritë e marra një orë më parë:

1. Në ç'fusha dëshmohet konkurrenca midis blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë?
2. Pse Konferenca e Helsinkit është një moment i rëndësishëm i bashkëpunimit mes blloqeve kundërshtarë?
3. Pse lëvizjet kundër regjimeve komuniste luajtën rol në liberalizimin relativ të disa prej vendeve të Bllokut Lindor?
4. Pse ardhja në krye të BS-së të Mikail Gorbaçovit ndikoi në frymën reformiste në BS dhe në Bllokun Lindor?
5. Pse ra Blloku Lindor?

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë në grupe – prezantimi i punimeve

Pasi është kryer kontrolli frontal, kalohet në prezantimin e punimeve sipas grupeve.

Secilit grup i lihet një hapësirë kohore nga pesë deri shtatë minuta për të kryer prezantimin.

Sipas preferencave të nxënësve, prezantimi mund të realizohet nga një përfaqësues i grupit ose secili prej anëtarëve prezanton në mënyrë të përmblodhur gjetjet e veta.

Gjatë prezantimit, pjesa tjetër e klasës dëgjon me vëmendje, mban shënime dhe përgatitet për të dhënë vlerësime, bërë kritika dhe sugjerime.

Mësuesi/ja mban shënime mbi ecurinë e prezantimit për secilin grup dhe anëtar grupi, në drejtim të gjuhës së përdorur, saktësisë së formulimit dhe tonit të zërit.

Faza e tretë: Përforsimi

Nxënësit diskutojnë mes tyre dhe me mësuesin/en në lidhje me punimet e prezantuara.

Vlerësojnë punimet më cilësore dhe nxjerrin përfundime lidhur me temën mësimore.

Mësuesi/ja jep vlerësimet për secilin nxënës.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen aktive në secilën prej etapave mësimore, saktësinë e mendimeve, origjinalitetin e prezantimeve, angazhimin serioz në diskutim dhe interpretim.

Detyra:

Nuk parashikohen.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Karakteristikat e tranzicionit në vendet komuniste		Situata e të nxënit: NATO dhe Traktati i Varshavës funksionuan gjatë Luftës së Ftohtë për t`iu kundërvënë njëra-tjetrës. Pse NATO është ende një organizatë e fuqishme, ndërsa Traktati i Varshavës është shpërbërë?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Evidenton situatën e re me të cilën u përballën qytetarët e vendeve të <i>Bllokut Lindor</i> në fillimet e periudhës së tranzicionit. • Tregon rrugët dhe format e ndryshme për zhvillimin ekonomik dhe për kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë. • Gjykon rreth aspekteve pozitive dhe negative të tranzicionit mbi shoqëritë e vendeve ish-komuniste.		Fjalët kyçe: Federata Ruse, ekonomia e centralizuar socialiste, ekonomi tregu, Këshilli i Europës, OSBE, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)	
Faza e parë: Parashikimi – braingstorming Në këtë fazë u jepet nxënësve termi “tranzicion”, duke u kërkuar të shprehin mendime dhe ide rreth tij. Kësisoj ndërtohet në tabela skema braingstoriming. Tranzicion			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – organizuesi grafik i informacionit Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi dhe përmes organizuesit grafik të informacionit përcjell dijet e reja te nxënësit. Gjatë shpjegimit, mësuesi/ja nxit nxënësit të marrin pjesë përmes informacionit paraprak që ata kanë rreth tranzicionit shqiptar.			

PLANIFIKIMI DITOR PËR PERIUdhËN E TRETË (PRILL-QERSHOR)

Tranzicioni në vendet ish-komuniste

Në disa shtete, si: Poloni, Hungari, Çekosllovakia periudha e tranzicionit ishte e shkurtër dhe me më pak pasoja se në vendet e tjera.

Në vende të tilla si Gjermania dhe BRSS, tranzicioni kaloi si një proces më specifik: Në Gjermani ishte problemi i bashkimit, ndërsa në BRSS ishte problemi i shpërbërjes.

Kalimi nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut të lirë

Ky kalim kërkonte: ndërmarrjen e reformave të thella ekonomike, anëtarësimin në struktura ndërkombëtare si NATO dhe BE.

Rrugët dhe format e kalimit ishin të ngjashme për të gjitha shtetet, por ritmet ndryshonin: Anëtarësimi në NATO ishte një proces më i thjeshtë sesa ai i anëtarësimit në BE. Për arritjen e tyre nevojitej jo vetëm puna e brendshme, por edhe ndihma nga jashtë.

Aspektet pozitive dhe negative të tranzicionit

Ndër aspektet pozitive të tranzicionit

janë: vendosja e sistemit demokratik, lirive dhe të drejtave themelore të njeriut; liria e pronës private dhe iniciativës së lirë; ekonomia e tregut; lëvizja e lirë e njerëzve, ideve dhe mallrave etj.
Të gjitha këto aspekte pozitive ndikuan në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror me ritme të larta, duke sjellë dhe një mirëqenie të paparë për shumicën e popullsisë në vendet ish-komuniste.

Periudha e tranzicionit në vendet ish-komuniste është shoqëruar edhe me aspekte të tjera negative, si: përdorimi i drogës, prostitucioni, korrupsioni etj., të cilat në regjimin socialist ose nuk ekzistonin, ose ishin më të kufizuara. Janë problemet që shoqërojnë tranzicionin në vendet ish-komuniste që detyrojnë BE të këmbëngulë në vendosjen e kriterëve të rrepta për anëtarësimin e mëtejshëm.

Faza e tretë: Përforcimi – rrjeti i diskutimit

Gjatë kësaj faze nxënësit përfshihen në rrjetin e diskutimit:

A është e domosdoshme që BE të përcaktojë kriteret e rrepta për pranime të reja në mesin e tij?

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përgjithësime. Cili është refleksioni juaj mbi:

- Situatën e re me të cilën u përballën qytetarët e vendeve të *Bllokut Lindor* në fillimet e periudhës së tranzicionit.
- Rrugët dhe format e ndryshme për zhvillimin ekonomik dhe për kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë.
- Aspektet pozitive dhe negative të tranzicionit mbi shoqëritë e vendeve ish-komuniste. (Nxënësi realizon, sipas zgjedhjes, vetëm njërën prej kërkesave të ushtrimit).

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Shqipëria në tranzicion		Situata e të nxënit: Termi “tranzicion” na shoqëron prej më shumë se 25 vitesh. Si e përjetoni ju tranzicionin shqiptar?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Shpjegon karakterin dhe natyrën e tranzicionit shqiptar drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. • Analizon tiparet e transformimit ekonomiko-shoqëror të Shqipërisë gjatë tranzicionit. • Gjykon mbi arritjet dhe dështimet e tranzicionit në Shqipëri.		Fjalët kyçe: pluralizmi politik, Partia Demokratike, Partia Social-Demokrate, Partia Republikane, Partia Agrare, operacioni “Pelikan”, firma piramidale, integrimi euro-atlantik, Këshilli i Atlantikut Verior (NATO), Këshilli i Europës.	
Burimet: Historia Botërore dhe Qytetërimi, K. Grimberg; Historia e Popullit Shqiptar; interneti; teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – diskutim Gjatë kësaj faze prezantohet para nxënësve situata e të nxënit dhe hapet diskutimi rreth pyetjes kyçe: Si e përjetoni ju tranzicionin shqiptar?			
Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – harta e të pyeturit – mësimi zbulues Nxënësve u shpërndahen formate me pyetje që kërkojnë përgjigje. Këshillohen të lexojnë në heshtje tekstin për 4-5 minuta, me qëllim njohjen paraprake të informacionit. Pasi të jetë realizuar ky hap, punohet për gjetjen e përgjigjeve dhe shndërrimin e hartës së të pyeturit në një hartë informacioni. Nxënësit duhet ta realizojnë hartën e tyre të informacionit në krahun tjetër të formatit që u ka dhënë mësuesi/ja. Në përfundim të orës së mësimi dorëzohet punimi i realizuar nga ana e secilit nxënës. Mësuesi/ja mund të zgjedhë për ta vendosur ose jo në portofolin e të nxënit.			



Faza e tretë: Përforcimi – tabelë konceptesh

Në këtë fazë, për të përforcuar edhe më tepër idetë e reja, plotësohet në dërrasë një tabelë konceptuale sipas këtij modeli

Tranzicioni shqiptar	
Arritjet	Dështimet

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:
Rënien e sistemit komunist dhe periudhën e tranzicionit në vendbanimin tuaj.

Planifikimi ditor i orës së mësimit		Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI
Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi		Klasa: XII
		Situata e të nxënit: BE është një aktor i rëndësishëm ndërkombëtar. Aktualisht BE është në proces zgjerimi. Anëtarësimi në BE ka kundërshtarët dhe mbështetësit e tij. Ju çfarë qëndrimi mbani?
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: - Evidenton nismat për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. - Analizon arkitekturën dhe efektivitetin e procesit të integritetit të vendeve ish-komuniste në Europën e Bashkuar. - Gjykon mbi pikat e forta dhe të dobëta të Bashkimit Europian dhe të debatit për të ardhmen e tij.		Fjalët kyçe: NATO, çështja palestineze, Bashkimi Europian (BE), Parlamenti Europian, Këshilli i Europës, Këshilli i Ministrave të BE-së, Banka Qendrore Europiane, supershteti federal, Europol.
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)	P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – diskutim		
Në këtë fazë fokusohet vëmendja në trajtesën e situatës së të nxënit. Nxënësit ofrojnë opinionet vetjake, në lidhje me nevojën e vendit tonë për të qenë pjesë e Bashkimit Europian. Diskutimi nxitet me pyetjen binare:		
Anëtarësimi në BE ka kundërshtarët dhe mbështetësit e tij. Ju çfarë qëndrimi mbani?		

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – tabela konceptuale

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë temën e re të mësimi. Përmes shpjegimit dhe plotësimit të tabelave konceptuale i përcjell njohuritë te nxënësit.

Tabela e parë konceptuale – Pas Luftës së Ftohtë

Konferenca e Helsinkit	Zgjerimi i NATO-s	Qëndrimi i Rusisë	Përplasjet në çështje ndërkombëtare
1 gusht 1975 i hapi rrugën bashkëpunimit dhe nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh sidomos mes SHBA-së dhe Rusisë.	U zgjerua me vende të Bllokut Lindor. Vendet e reja janë: Poloni, Estoni, Letoni, Lituani.	Rusia nuk e mirëpriti anëtarësimin e Bllokut Lindor në NATO, pasi e sheh si kërcënim instalimin e sistemeve të mbrojtjes në vendet fqinje.	Çështja e Krimesë. Çështja palestineze. Çështja siriane.

Tabela e dytë konceptuale – Bashkimi European

Organizata	Themelimi	Organet drejtuese	Funksionet e BE-së	Pikat e forta të BE-së	Pikat e dobëta të BE-së
Bashkimi European					

Faza e tretë: Përforcimi – punë me hartën

Ndahet klasa në dy grupe të mëdha. Secilit grup i jepet një fletë me hartën memece të Europës.

Grupi i parë – Ngjyros me ngjyrën blu të gjitha shtetet anëtare të NATO-s.

Grupi i dytë – Ngjyros me ngjyrën vjollcë shtetet anëtare të BE-së.

Punimi vendoset në Portofolin e nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Kërkoni informacion dhe formuloni përfundimet tuaja për:

Procesin e integritit të Shqipërisë në BE.

Planifikimi ditor i orës së mësimi			Data:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Ndryshimet që solli teknologjia		Situata e të nxënit: Shkenca dhe teknologjia e ka ndryshuar jetën shoqërore sidomos përgjatë viteve të fundit. Arritjet kanë efektin e vet pozitiv dhe negative. Sipas jush, cila arritje apo shpikje teknologjike e ka transformuar më tepër jetën e njerëzve?	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore. Nxënësi: • Vlerëson rolin e shkencës dhe të teknologjisë në jetën shoqërore dhe ekonomike bashkëkohore. • Gjykon mbi pasojat pozitive dhe negative të teknologjisë sidomos në lidhje me rininë.		Fjalët kyçe: teknologji e informacionit, shkenca kompjuterike, propagandë raciste, ksenofobe dhe terroriste, ISIS, krimet kibernetike.	
Burimet: Interneti; teksti mësimor; Historia e Ballkanit, G. Castellan; Europa në kohën tonë, U. Lakër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
P- PARASHIKIMI Përgatitja për të nxënit (10 min)	N- NDËRTIMI I NJOHURIVE Përpunimi i përmbajtjes (25 min)		P- PËRFORCIMI Përforcimi (10 min)
Faza e parë: Parashikimi – bashkëbisedim Në këtë fazë, nxitet pjesëmarrja e nxënësve në bisedën e përbashkët lidhur me ndikimin e madh që ka teknologjia në jetët tona. Biseda stimulohet përmes përdorimit të dy pyetjeve kyçe: 1. Cila arritje apo shpikje teknologjike e ka transformuar më tepër jetën e njeriut? 2. Në çfarë raporti qëndrojnë të mirat dhe të këqijat e përdorimit të mjeteve të teknologjisë dhe informacionit?			

Faza e dytë: Ndërtimi i njohurive – punë me tekstin – ditari trepjesësh

Mësuesi/ja prezanton në tabelë modelin e ditarit trepjesësh që do të përdoret për të organizuar dhe studiuar më mirë informacionin. Nxënësi punon në këtë etapë për të bërë komentet e tij për secilën çështje. Në përfundim të kësaj faze, mësuesi/ja shton komentin e tij/ e saj në secilën prej çështjeve që do të trajtohen.

Çështja	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Shkenca i shërben teknologjisë	Nuk jemi në epokën e zbulimeve të mëdha, por jemi në kohën e zbulimeve shkencore të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin njerëzor, si zbulimet në fushën e mjekësisë, të gjenetikës, të farmaceutikës etj., të cilat kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut. Shkenca e sotme, krahas kërkimit shkencor për fusha mjaft specifike, si hapësira kozmike, energjia nukleare, mikroorganizmat etj. po orientohet gjithnjë e më shumë në zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme.	Në ditët e sotme është e pamundur të konceptohet, realizohet dhe parashikohet një projekt pa qenë në mes shkenca, pa qenë në mes përdorimi i teknologjisë. Madje, përdorimi i teknologjisë ka pushuar së qeni luks. Tashmë është një domosdoshmëri jetike. Njeriu nuk bën dot pa teknologjinë, ndaj shkenca u dedikohet tërësisht shpikjeve të tjera e më të sofistikuara teknologjike.
Teknologjia i shërben zhvillimit ekonomik		
Zhvillimi ekonomik ka transformuar jetën e njeriut		
Rinia përballet me pasojat pozitive dhe negative të përdorimit të teknologjisë		

Faza e tretë: Përforsimi – rrjeti i debatit

Në këtë fazë ndahet klasa në dy grupe të mëdha dhe nis debate në lidhje me:

Përdorimi i teknologjisë nga të rinjtë ka më shumë efekt pozitiv apo negativ?

Nxënësit, pavarësisht opinionit real që kanë në lidhje me këtë temë, do të argumentojnë bazuar në qëndrimin e grupit ku bëjnë pjesë. Mësuesi/ja ndjek nga afër linjën e debatit, ndërhyr, këshillon dhe nxit. Gjithashtu mban shënime mbi nivelin e përfshirjes së nxënësve në diskutim.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për strategjitë e të menduarit dhe komunikimit të njohurive të reja me shkrim dhe me gojë. Vlerësohen për punën e pavarur në mënyrë individuale dhe në grup, si dhe pjesëmarrjen në secilën etapë mësimore.

Detyra:

Nuk parashikohen.

Planifikimi ditor i orës së mësimi		Data:	
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Përsëritje nr. 11		Situata e të nxënës: Sasia e informacionit me të cilin nxënësit janë njohur është e konsiderueshme. Ka ardhur momenti që të provohet qendrueshmëria e njohurive kryesore të trajtuara gjatë periudhës së tretë.	
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi: – Evidenton situatën në Kinë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, marrjen e pushtetit nga komunistët dhe rolin e Kinës në Bllokun Lindor të udhëhequr nga BS-ja. – Vë në dukje bashkëpunimin ekonomik dhe ndihmën kineze për zhvillimin e Shqipërisë. – Arsyeton mbi shkaqet e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe pasojat e saj mbi ekonominë dhe politikën shqiptare. – Shpjegon format dhe instrumentet e kontrollit të Bllokut Lindor nga ana e BS-së duke dalluar mes atyre politike, ekonomike dhe ushtarake. – Vë në dukje dhe krahason karakterin e nacional-komunizmit në disa prej vendeve të Bllokut Lindor si tentativa e tyre për një autonomi me të madhe nga kontrolli sovjetik. – Evidenton arsyet e zhvillimit të shpejtë ekonomik dhe shoqëror të Europës Perëndimore në periudhën e pasluftës. – Krahason rolin e njerëzve të artit, kulturës e shkencës në shoqërinë e Bllokut Lindor dhe atij Perëndimor. – Shpjegon arsyet e thellimit të izolimit ndërkombëtar të Shqipërisë nga fundi i viteve '70 të shek. XX. – Evidenton rëndësinë e Konferencës së Helsinkit si moment i rëndësishëm i bashkëpunimit mes blloqeve kundërshtarë. – Gjykon rreth aspekteve pozitive dhe negative të tranzicionit mbi shoqëritë e vendeve ish komuniste. – Shpjegon karakterin dhe natyrën e tranzicionit shqiptar drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. – Evidenton nismat për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. – Gjykon mbi pasojat pozitive dhe negative të teknologjisë sidomos në lidhje me rininë.		Fjalët kyçe: Sheshi Tien An Men, Edukimi socialist, revolucioni kulturor, Bota e Tretë, Mao Ce Dun, OKB, Blloku Lindor, Lufta e Klasave, tufëza, racionim, vetizolim, Byroja informative e partive komuniste, kolkoze, bashkekzistencë paqësore, kontrolli ushtarak, lëvizja feminist, lëvizja e hipive, kastë oligarkiko-financiare, ekzistencializmi, realizmi magjik, ekspresionizmi abstrakt, arti pop, imperializmi amerikan, pronë personale OSBE, Solidarnost, pluralizmi politik, Konferenca e Helsinkit, stanjacion, Këshilli i Evropës, BERZH, Federata Ruse, operacioni Pelikan, firma piramidale, Partia Demokratike, çështja palestineze, supershteti federal, racizëm, terrorizëm, ISIS, sulme kibernetike, kampet e punës, internim, vendet e kujtesës.	
Burimet: Interneti. Teksti mësimor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia, Gjuhët dhe komunikimi.	

Faza e parë – Parashikimi – parashtrimi i ideve

Mësuesi/ja e hap orën e mësimit duke shënuar në dërrasë çështjet/idetë që do të diskutohen. Ftohen nxënësit që të shtojnë të tjera ide, sipas nevojave vetjake.

Faza e dytë – Ndërtimi i njohurive – diskutim i ideve

Përmes ideve të renditura në tabelë, nxënësit diskutojnë mbi paqartësitë që kanë rreth secilës çështje apo ide. Drejtojnë pyetje nëse kanë paqartësi.

Idetë që mund të trajtohen janë:

- Kina brenda dhe jashtë Blloqeve të Luftës së Ftohtë.
- Shqipëria dhe Kina.
- Zhvillimet brenda blloqeve: Blloku Lindor.
- Zhvillimet brenda blloqeve: Blloku Perëndimor.
- Tipare të shoqërisë, artit, kulturës, shkencës dhe arsimit në Bllokun Perëndimor dhe në atë Lindor.
- Vetizolimi i Shqipërisë.
- Përfundimi i Luftës së Ftohtë.
- Karakteristikat e tranzicionit në vendet ish-komuniste.
- Shqipëria në tranzicion.
- Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi.
- Ndryshimet që solli teknologjia.

Faza e tretë: Përfundimi – konkluzione

Në këtë fazë bëhet një organizim i ideve përmes konkluzioneve të nxjerra nga nxënësit, të cilat përcillen me gojë. Mësuesi/ja bën kujdes që gjatë kësaj faze të aktivizojë sa më tepër nxënësit, duke synuar pjesëmarrjen edhe të nxënësve që përgjithësisht shfaqin pasivitet.

Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësim i përgjigjeve me gojë dhe i aftësisë për të punuar në grup, këmbyer dhe komunikuar informacionin.

Detyra: nuk parashikohen